

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Muhamet Jahiri

**ANALIZË KRITIKE E RAPORTIMIT TË GAZETAVE
DITORE SHQIPE PËR TRAZIRAT E MARSIT 2004**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2018

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF FILOLOGY

MA Muhamet Jahiri

**CRITICAL ANALYSIS OF ALBANIAN DAILY
NEWSPAPERS REPORTING TO THE MARCH 2004
RIOTS**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2018

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Muhamet Jahiri

ANALIZË KRITIKE E RAPORTIMIT TË GAZETAVE DITORE SHQIPE PËR TRAZIRAT E MARSIT 2004

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:
Prof. asoc. Milazim Krasniqi PhD

Prishtinë, 2018

INFORMACIONE PËR MENTORIN

Prof. asoc. MILAZIM KRASNIQI, PhD

Profesor i asocuar i gazetarisë dhe letërsisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Milazim Krasniqi udhëheq Departamentin e Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë, aty ku në vitin 2004 ka fituar titullin e Doktorit të Shkencave Filologjike. Themelues i Institutit të Medies, redaktori i parë i zhurnalit “Media”, Krasniqi ka shërbyer edhe si anëtar i Bordit të Drejtorëve të Radiotelevizionit Publik të Kosovës (2001-2009) dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (2008-2010).

Një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, bashkëpunëtor i afërt i presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, Krasniqi është profesor universitar, poet, romancier, dramaturg, publicist dhe komentues politik. Përmbi dhjetë vite ka shërbyer si sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, kryeredaktor i revistës “Fjala” dhe “Interesi Nacional”, redaktor përgjegjës i gazetës ditore “Bota Sot” dhe kolumnist i rregullt i gazetave dhe revistave të ndryshme. Disa vite ka qenë edhe bashkëpunëtor i rregullt i radios “Evropa e Lirë”, për emisionet në gjuhën shqipe.

Disa nga librat e tij, prej të cilave 30 e përfshijnë poezinë, romane, drama, studime dhe publicistikë, janë: Letërsia dhe besimet fetare, Soneti në poezinë shqipe, Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore, Fotografitë e kujtimeve, Rulet rus për Ali Pashën, Monedha e Gentit, Nacionalizmi shqiptar, E kujt është kjo kulturë? Krasniqi është autor edhe i teksteve universitare: “Hyrje në Gazetari” dhe “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, po ashtu mentor i shumë studentëve të nivelit Master dhe PhD. Ai ka një numër të punimeve akademike të botuara nëpër zhurnalë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë: Media dhe Seminari – Universiteti i Prishtinës, Sarajevske Sveske – Sarajevë, Vizione-Shkup, Vjetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, etj. Krasniqi ka prezantuar kumtesa në sesione të ndryshme shkencore, si në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në Universitetin Sakarya–Turqi, Universiteti UFO –Tiranë, etj.

Krasniqi, po ashtu, është intervistuar apo cituar nga BBC, CNN, Zëri i Amerikës, Evropa e Lirë, Radio Televizioni i Kosovës, RTV 21, RTSH, TV Klan, Epoka e Re, Kosova Sot si dhe nga medime të tjera rajonale, të shkruara dhe elektronike. Si komentues politik ka qenë i ftuar shumë herë në programe dhe debate televizive.

Krasniqi jeton në Prishtinë me të shoqen Edibe Krasniqin, me të cilën ka tre fëmijë.

Vepra e deritashme: letrare, shkencore dhe publicistike

POEZI

Imazhi gri	1982, Rilindja, Prishtinë	Poezi
Pirg vegimi	1985, Rilindja, Prishtinë	Poezi
Qeshje sardonike	1987, Rilindja, Prishtinë	Poezi
Formula e Katonit	1990, Rilindja, Prishtinë	Poezi
Kurs për pantomimë	1994, Rilindja, Prishtinë	Poezi
Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat	1996 Rilindja, Prishtinë	Poezi
Dritë në kujtime	2008, Arbëria, Tiranë	Poezi
Rigjetja e vetes	2013, Arbëria, Tiranë	Poezi
Poezia dhe vdekja	2017, Logos A, Shkup	Poezi

PROZË

Fotografitë e kujtimeve	2002, Logos A, Shkup	Roman
Fijet e shpirtit	1998, Dardania, Prishtinë	Roman

DRAMA/KOMEDI

Mos më merrni në qafë	1990, Rilindja, Prishtinë	Komedi
Zbulimi	1990, Rilindja, Prishtinë	Komedi
Punë Sizifi	1990, Rilindja, Prishtinë	Komedi
Kush i bie Fellit	1997, SHSHK, Prishtinë	Komedi
Bryma e vdekjes	2001, Prishtinë	Dramë
Liria po vjen	2007, Prishtinë	Dramë
Kosovë në ndërgjegje	2001, Prishtinë	Dramë
Monedha e Gentit	2003, Prishtinë	Dramë
Rulet rus për Ali Pashën	2004,	Dramë
Një Antigonë e re	2004, Prishtinë	Dramë
Kësulkuqja e shekujve	2004, Prishtinë	Dramë
Kur lindi partia	1995, SHSHK, Prishtinë	Komedi
Këmba e Titos nuk shkel më në Kosovë	1996, Prishtinë	Komedi

PUBLICISTIKA

Horrat në krye të detyrës	1998, Kosovarja	Publicistikë
Kosova pas 22 janarit 1998	2000, Dardania	Publicistikë
Meditime islame	2005, Furkan, Shkup	Publicistikë
Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore	2007, Prishtinë	Publicistikë
Në çfarë Kosove do të jetojmë	2008, Zëri	Publicistikë
Ankthi i vjetër në shekullin e ri (Presionet e Serbisë ndaj Kosovës pas vitit 1999)	2011, Zëri Ynë, Prishtinë	Publicistikë

STUDIME

Soneti në poezinë shqipe	2005, PEN, Prishtinë	Studim monografik
Dhuna dhe qytetërimi perëndimor: Islami si fillim i historisë	2006, Logos A, Shkup	Studim
Letërsia dhe besimet fetare	2010, Logos A, Shkup	Studim monografik
Nacionalizmi shqiptar	2014, Logos A, Shkup	Studim monografik
E kujt është kjo kulturë	2015, Logos A, Shkup	Studime kulturore dhe mediale
Hyrje në gazetari	2008,	Libër universitar
Ekskomunikimi si histori e fshehur	2016, ROZAF	Libër universitar

(<https://milazimkrasniqi.wordpress.com>)

Falënderim

Ndihem jashtëzakonisht i privilegjuar me njerëzit që më rrethojnë, familjen time, miqtë e mi, shoqërinë time.

Falënderoj familjen time, prindërit e mi, ndaj të cilëve jam mirënjohës përjetë për gjithçka që bënë për mua, e që ndanë bukën e gojës për edukimin e gjashtë fëmijëve të tyre.

Falënderoj bashkëshorten time Qëndresën, krahun tim të djathtë, që më dha forcën për të ecur tutje. Dimalin tim, dritën e syve të mi, motivin tim të përditshëm.

Falënderoj mentorin tim, Prof. asoc. Milazim Krasniqi PhD, udhërrëfyesin, profesorin dhe njeriun me kaq shumë vlera. Jam me fat që e kam njohur, që jam asistent i tij për një dekadë, e që kam përfituar aq shumë nga ai gjatë këtyre viteve. Faleminderit Profesor! Mirënjohës për jetë!

Në fund, por jo më pak të rëndësishëm, falënderoj miqtë e Departamentit të Gazetarisë, të cilët më kanë mbështetur përgjatë këtyre viteve.

Jam i bekuar nga Zoti që ju kam, ju paça gjithmonë!

Faleminderit nga zemra!

Dedikim

Engjëllit tim, Dimalit...

Rezymeja e disertacionit

Në kuadër të studimeve të doktoraturës në fushën e Shkencave të Komunikimit dhe të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në këtë studim shkencor të disertacionit është trajtuar tema me titull: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”. Ky disertacion i miratuar nga të gjitha organet e Universitetit, është bazuar në hulumtime të thella shkencore, punë origjinale dhe në rezultate konkrete, të cilat do të japin një kontribut të madh në fushën e studimeve të komunikimit dhe të gazetarisë.

Rezultatet e këtij punimi do të kenë interes të madh në fushën e studimit të gazetarisë, për studiuesit e kësaj fushe, si dhe për vetë gazetarët, të cilët do të përfitojnë shumë nga ky rast studimi. Mediet në vendet e lira janë një pushtet i fuqishëm, prandaj rezultatet e këtij studimi do të kontribuojnë, që gjatë raportimit të medieve për trazirat në të ardhmen, të jenë më të përgatitura profesionalisht dhe më të gatshme për t’u ballafaquar me situata të tilla. Po ashtu, rezultatet e këtij disertacioni do të japin përgjigje konkrete sesi ka raportuar shtypi ditor për Trazirat e Marsit të vitit 2004, ngjarje e cila ka qenë ndër më të dhunshmet në Kosovë. Deri më tani kjo ngjarje nuk ka marrë epilog përfundimtar, si në aspektin e përgjigjes shkencore, po ashtu edhe në atë të sistemit të drejtësisë. Ky punim shkencor është fokusuar në tre komponentë, të cilët do të ndihmojnë në arritjen e rezultateve konkrete. Brenda strukturës së tij përfshihen shtatë kapituj, që trajtojnë aspektin teorik, historik, dokumentues, hulumtues dhe përfundimet konkrete.

Në pjesën e parë është paraqitur hyrja e punimit, metodologjia dhe hipotezat e ngritura. Në hyrje janë paraqitur elementet kryesore të punimit, të cilët i paraprijnë hulumtimit të tërësishëm shkencor.

Metodologjia në çdo studim është pjesë e rëndësishme e një hulumtimi shkencor. Prandaj, në këtë punim janë përzgjedhur metodat adekuate, të cilat do të ndihmojnë në nxjerrjen e rezultateve të matshme shkencore, si: metoda e analizës së përmbajtjes, metoda e sintezës, metoda e abstraksionit, metoda e konkretizimit, metoda e gjeneralizimit, metoda induktive, metoda deduktive, metoda komparative (e krahasimit), metoda historike, metoda statistikore, metoda e studimit të rasteve, metoda deskriptive, metoda e analizës së diskut, etj.

Hipotezat do të testohen hap pas hapi, gjatë hulumtimit të punimit shkencor, ndërsa metodat adekuate të përzgjedhura, do të përdoren në kapituj të ndryshëm dhe në pjesë të ndryshme të rastit studimor. Prandaj, brenda këtij punimi të doktoraturës me titull: “Analizë kritike e

raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”, nisur nga paragjykimet, supozimet apo siç e quan sociologu Antoni Gidens, hamendjet, do të paraqesim hipotezën kryesore dhe dy hipoteza tjera, të cilat do të testohen gjatë këtij hulumtimit shkencor.

Trazirat e dhunshme të marsit 2004, janë ngjarja më e rëndë në Kosovën e pasluftës, epilogu i së cilës kishte përfunduar me dhjetëra viktima, mijëra të plagosur dhe rrezikim të përgjithshëm të sigurisë nacionale. Gjykimet dhe kritikën mbi mënyrën e raportimit të shtypit ditor për këtë ngjarje, e kanë orientuar këtë rast studimor në tri hipoteza, ku hipoteza kryesore i paragjykon mediet se kanë ndikuar drejtpërdrejt në nxitjen e Trazirave të Marsit 2004, dhe si të tilla, ato kanë përgjegjësi në eskalimin e situatës së dhunshme.

Në kapitullin e parë është paraqitur sfondi teorik i cili trajton studimet shkencore në fushën e medieeve. Shkolla e Frankfurtit, e njohur me qasjen e saj kritike, sidomos në fushën e sociologjisë dhe të komunikimit, përbën pjesën e parë të këtij kapitulli, mbi të cilin është mbështetur hulumtimi i rastit studimor. Ndërkaq, për të argumentuar dhe për t’i dhënë shtrirje teorike këtij punimi janë trajtuar katër teoritë kryesore të shtypit: autoritare, liberale, e përgjegjësisë sociale dhe teoria e shtypit sipas qasjes sovjetike.

Për ta kuptuar rolin e shtypit dhe zhvillimin e tij, është shumë e rëndësishme që një punim shkencor të ketë edhe dimensionin historik. Prandaj, duke u bazuar në metodën historike në kapitullin e dytë, është trajtuar historia e gazetarisë shqiptare e bazuar në studimet e historisë së medieeve, dokumenteve, artikujve të ndryshëm e monografive. Tutje në këtë kapitull është trajtuar teoria e zhanrit, mbi të cilën është mbështetur rasti studimor, për të analizuar strukturën dhe standardet profesionale të raportimit.

Kapitulli i radhës përbën rastin studimor. Brenda këtij kapitulli të zgjeruar janë testuar hipotezat e ngritura në këtë studim shkencor, rezultatet e të cilave janë bazuar në metoda të ndryshme e të kombinuara brenda këtij hulumtimi shkencor, duke sjellë rezultate konkrete dhe të matshme shkencore. Në pjesën e parë, përmes metodës së studimit të rasteve, është analizuar gjerësisht konteksti i rrethanave të rastit, përmes të cilit janë verifikuar elementet e përgjithshme diskruptive që ndërlikohen me rastin studimor. Gjetjet e kontekstit studimor janë mbështetur edhe në metodën induktive, sipas të cilës, nga analizimi i fakteve të veçanta, vihet deri në përfundime të përgjithshme. Gjithashtu në këtë kapitull, në një pjesë të veçantë të hulumtimit është përdorur metoda deskriptive, për të paraqitur zhvillimin e ngjarjeve në formë kronologjike.

Kapitulli i katërt, përbën pjesën kryesore të analizës. Duke u bazuar në metodën e analizës së përmbajtjes, në kuadër të këtij disertacioni, në këtë pjesë të hulumtimit janë paraqitur rezultate konkrete. Në këtë pjesë është bërë analizimi i teksteve të botuara në gazeta për Trazirat e Marsit 2004. Përveç raporteve gazetareske, në këtë pjesë janë analizuar edhe editorialet, opinionet dhe komentet e botuara në shtyp. Përmes analizimit të tyre janë nxjerrë rezultate konkrete që në esencë paraqesin gjykimin editorial, diskursin dhe agjendën e shtypit gjatë ditëve të dhunës ndëretnike. Duke filluar nga “Koha Ditore”, “Epoka e re”, “Bota Sot”, “Kosova Sot” dhe “Zëri”, janë analizuar qëndrimet e redaksive, të cilat ndërlidhen me hulumtimin e këtij rasti studimor. Në pikën njëmbëdhjetë të kapitullit të katërt, janë paraqitur përfundime konkrete për përdorimin e gjuhës së urrejtjes në shtypin ditor. Duke u bazuar në metodën e analizës së tekstit, në këtë pjesë, për secilën gazetë janë bërë matje dhe gjetje konkrete, mbi evidentimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, nxitjes dhe mosdurimit etnik. Nga këto gjetje janë paraqitur përfundime për nxitjen e urrejtjes ndëretnike. Përdorimi i pamjeve filmike dhe fotografive në gazetari paraqet një përmbushje profesionale për mediet, për t’i argumentuar dhe dokumentuar ngjarjet. Prandaj, në kuadër të këtij kapitulli, është bërë analizimi i fotografive të botuara në shtypin ditor për Trazirat e Marsit 2004. Rezultatet e dala nga kjo pjesë e analizës, e kanë plotësuar pjesën e përgjithshme të analizës kritike të shtypit ditor, dhe kanë ndihmuar në plotësimin e përfundimeve konkrete. Duke e përdorur metodën kuantitative, janë identifikuar gjetje të rezultate konkrete për hapësirën që shtypi i ka kushtuar trazirave të muajit mars, dhe numrin e teksteve që ka botuar gjatë kësaj periudhe. Kjo matje kuantitative në këtë pjesë të studimit ndihmon në paraqitjen konkrete të rezultateve të reja shkencore, politikat editoriale të shtypit ditor, agjendave të tij, dhe në krijimin e opinionit publik, gjatë ditëve të dhunshme të marsit 2004.

Në kapitullin e gjashtë, është bërë analizë krahasuese mes shtypit ditor dhe televizioneve për mënyrën e mbulueshmërisë së ngjarjeve të dhunshme ndëretnike. Duke u bazuar në metodën krahasuese, në këtë kapitull janë paraqitur rezultate konkrete të ndërvarësisë së këtyre dy formave të medieve dhe rolit të tyre në formimin e opinionit publik, gjegjësisht në nxitjen e Trazirave të Marsit 2004. Ndër të tjera, në këtë kapitull janë analizuar dhe krahasuar agjendat në mes shtypit dhe televizioneve, dhe varësinë e njëra-tjetrës në mbulueshmërinë e kësaj ngjarje të rëndë. Gjithashtu janë analizuar raportet e publikuara të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, për rolin e medieve në Trazirat e Marsit 2004. Duke e përdorur metodën e analizës së diskut, janë nxjerrë rezultate konkrete nga raporti i RTK-së, raporti i KPM-së dhe ai i OSBE-së, për rolin e

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

medieve në këtë ngjarje të dhunshme ndëretnike, masave të ndërmarra dhe rekomandimeve konkrete.

Në kapitullin e shtatë janë paraqitur përfundimet shkencore të dala nga rasti studimor dhe rekomandimet konkrete, të mbështetura në metodën e gjeneralizimit.

Summary

Within the doctoral studies in the field of Communication Sciences and Journalism at the University of Prishtina "Hasan Prishtina", in this dissertation study is addressed the topic with the title "Critical Analysis of Albanian Daily Newspapers Reporting for March 2004 Riots". This dissertation approved by all University bodies is based on profound scientific research, original work and concrete results that will make a major contribution to the field of Communication and Journalism studies.

The result of this paper will be of great interest in the field of study of Journalism, scholars in this field as well as for the media that would benefit greatly from this case study. Media, in a free country has a strong power, so the truth of this case study will contribute to the media and scholars to be more prepared in case of dealing with such situations.

In addition, the result of this paper will provide a concrete response to the role of the press in the March 2004 riots, which has been one of the most violent event in Kosovo. So far, this issue is still unfinished in the scientific and in the sense of justice, as well. This paper is focused on three components, which will help in achieving concrete results. Within its structure, nine chapters are included, focusing on theoretical, historical, documentary, research and concrete conclusions. The first part presents the introduction of the paper, the methodology and the hypotheses. In the introduction are presented the main elements of the work, which precede the full scientific research.

Methodology remains an important part of a scientific research. Therefore, in this dissertation, adequate methods have been selected that will help to produce measurable scientific results such as: content analysis method, synthesis method, abstraction method, concretization method, generalization method, inductive method, deductive method , comparative methods, historical methods, statistical methods, case study methods, descriptive methods, method and analysis desk. Hypotheses will be tested step by step during scientific research, where appropriate methods selected for this dissertation will be used in different chapters and in different parts of the case study. Therefore, within this dissertation entitled "Critical Analysis of Reporting of Albanian Daily Newspapers for March 2004 Riots", based on prejudices, assumptions or, as the sociologist Anthony Giddens described as guilty, we will present a main hypothesis and two other hypotheses, which will be tested during this scientific research.

The March 2004 violent riots are the worst event in post-war Kosovo, the epilogue of which ended with dozens of victims, thousands of injured, general risk of national security, and judgments and criticisms on how press reported for this event have focused this case study on three hypotheses. Each hypothesis is dealt with during the research, meanwhile, the main research base is focused on the main hypothesis, which prejudices the way of newspapers reporting, and encouraging through reporting to an inter-ethnic clash in March 2004.

The second chapter introduces the theoretical review of literature, which is related to the sciences and theories of the media. The Frankfurt School, well known with its critical approach, especially in the field of social and communication, has been the model of critical approach within this case study. While arguing and giving theoretical scope to this study, four main theories of the press, authoritarian, liberal, social responsibility and press theory with the Soviet approach, were addressed within the work.

To understand the role of the press and its development, it is extremely important for a dissertation study to have the historical dimension as well. Hence, based on the historical method in the third chapter, the history of Albanian journalism has been treated, based on media history studies in general, documents and articles, monographs, and so on. Historical development of Albanian journalism will be defined in this section of the paper and serves to study social phenomena and media phenomena according to their historical development, from the past to the present. In this chapter is addressed the theory of the genre, on which we will base the press research on the professional standards of reporting, and in its genre analysis. The next chapter is the case study. Within this extended chapter, the hypotheses raised in this scientific study have been tested, whose results are mainly based on various combined methods within this scientific research that have yielded concrete and measurable scientific results. In the first part, through the case study method, the context of the case is widely analyzed, through which the general disruptive elements related to the case study were verified. The findings of the study context have also been based on the inductive method, which, from the analysis of particular facts, leads to general conclusions. Also in this chapter, in a separate part of the study, descriptive methods will be used, which will help us construct the flow of events before the outbreak of the most serious interethnic conflict in Kosovo.

The fourth chapter is the main part of the general critical analysis of press reporting in Kosovo for March 2004 riots. Through the content analysis method, in this scientific research of

this dissertation, concrete results has been achieved for the role of the press in the March 2004 riots. Undoubtedly, editorials, opinions and comments published in the newspapers, both typologically and editorial aspect, published in the press, are an important part of the public opinion formation. Editorials published have presented at the same time the editorial policies of editorial collegiums and as such, through their analysis, concrete results have emerged, which in essence represent the judgment, discourse and attitude of editorial agendas during the days of violence in Kosovo. Within this association are also included comments and opinions, which the press publishes mainly when they match their agendas and editorial policies. Starting from "Koha Ditore", "Epoka e Re", "Bota Sot", "Kosova Sot" and "Zëri", the editorial positions that are related to the subject of the case study are analyzed. At eleventh point of chapter six, based on the method of text analyzing, all the reports that are related to the March riots have been analyzed to reach concrete results for hate speech within them. Even at this part, for each newspaper, concrete measurements and findings have been made on evidencing the use of this language, which naturally also reflects on the prompting of interethnic violence. Photography plays an important role in journalism as well. Various media, such as press, online media and even less visual ones, cannot even imagine their reports without documenting the images or the photography. Therefore, in this section of the study, all photos used in texts that are directly related to the violent inter-ethnic unrest of March 2004 have been analyzed. The results of journalistic photography have helped to clearly reflect the concrete conclusions of this research scientific. By using the quantitative method are presented graphs that reflect the space given to the March events in each newspaper. This quantitative measure reflects the placement of the agenda within the editorial policies as well as the impact of this agenda setting in creating a public opinion.

In the fifth chapter, through a comparative approach, a comparative measure has been made between daily press and television to produce concrete results on the coverage of the violent event and the role of these media in general. So, the comparisons also served to identify the role of press and television in the March events, their editorial agendas, the respect of professional standards, and the dependence of these media on each other.

In the sixth chapter through the analysis of the desk, the various domestic and international reports emerging after the March 2004 riots will be analyzed. In this part of the study, RTK report, KPM report and OSCE report will be analyzed, as well as administrative measures taken against the media.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

In the seventh chapter, conclusions will be drawn from the case study, and the recommendations, based also on the method of generalization.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Fjalët kyçe

Trazira, shtyp, raportim, ndëretnike, shqiptarë, serbë

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET E PËRDORURA.....	21
LISTA E FOTOGRAFIVE	22
LISTA E GRAFIKAVE	22
HYRJE.....	23
Metodologjia.....	36
Hipotezat.....	41
Objektivat.....	42
KAPITULLI I	
SFONDI TEORIK	44
1.1 Shkenca dhe qasjet teorike të medieve	44
1.2 Teoria kritike-kulturore/medieve	45
1.3 Zanafilla e shtypit dhe qasjet teorike	48
1.3.1 Teoria autoritare.....	50
1.3.2 Teoria liberale	52
1.3.3 Teoria e përgjegjësisë sociale	54
1.3.4 Teoria sovjetike komuniste	55
1.4 Mediet dhe gazetaria	56
1.5 Teoria e zhanrit	58
1.5.1 Lajmi	60
1.5.2 Vlera dhe kriteret e lajmit	63
1.5.3 Kreu i lajmit	66
1.5.4 Llojet e kreut	67
1.5.5 Pyetjet themelore në gazetari	68
1.5.6 Raporti-Lajmi i zgjeruar	69
1.5.7 Piramida e përmbysur	70

1.5.8 Titulli i raportit.....	72
-------------------------------	----

1.5.9 Përdorimi i citimeve në raport	73
--	----

KAPITULLI II

SHTYPI SHQIPTAR: HISTORIA E GAZETARISË SHQIPTARE NGA RILINDJA

KOMBËTARE DERI MË SOT.....	76
-----------------------------------	-----------

2.1 Mediet në periudhën e Rilindjes Kombëtare	76
---	----

2.2 Mediet në Kosovë në periudhën e Rilindjes Kombëtare	78
---	----

2.3 Mediet në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.....	79
---	----

2.4 Mediet në Kosovë pas çlirimit	82
---	----

KAPITULLI III

RASTI STUDIMOR: “ANALIZË KRITIKE E RAPORTIMIT TË GAZETAVE DITORE SHQIPE PËR TRAZIRAT E MARSIT 2004”.....

85

3.1 Kompilimi i Trazirave të Marsit 2004	85
--	----

3.2 Konteksti studimor i ngjarjes së Trazirave të Marsit 2004.....	86
--	----

3.3 Trazirat e Marsit 2004 një ngjarje që edhe sot ka impakt.....	89
---	----

3.4 Rrethanat politike në Kosovë.....	91
---------------------------------------	----

3.5 Raportimi i shtypit para Trazirave të Marsit 2004 dhe pasqyrimi i situatës së përgjithshme (10-17 mars 2004).....	95
---	----

3.6 Raportimi në media për shkaktarët e organizimit të trazirave	103
--	-----

3.7 Raportet medie-UNMIK	107
--------------------------------	-----

3.8 Përfundimet e kontekstit analizues studimor të ngjarjeve të Trazirave të Marsit 2004.....	109
---	-----

KAPITULLI IV

ANALIZË KRITIKE E RAPORTIMIT TË GAZETAVE DITORE PËR TRAZIRAT E MARSIT 2004.....

111

4.1 Analizë kritike e raportimit të shtypit në ditën e Trazirave të Marsit.....	111
---	-----

4.2 Gazeta “Koha Ditore” 17 mars 2004	111
---	-----

4.3 Gazeta “Epoka e re” 17 mars 2004.....	115
---	-----

4.4 Gazeta “Zëri” 17 mars 2004	118
4.5. Gazeta“Bota Sot” 17 mars 2004	120
4.6 Gazeta “Kosova Sot” 17 mars 2004.....	122
4.7 Analizë e tërësishme kritike e raportimit të shtypit për Trazirat e Marsit	123
4.8 Reagimet politike dhe mbulueshmëria nga ana e shtypit.....	130
4.9 Raportimi i shtypit për ditën e dytë të trazirave.....	134
4.10 Ngjarjet e marsit sipas editorialeve, opinioneve dhe komenteve të botuara në shtypin ditor	138
4.11 Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në shtyp gjatë raportimit për Trazirat e Marsit 2004	147
4.11.1 Koha Ditore.....	149
4.11.2 Epoka e re	151
4.11.3 Bota Sot.....	153
4.11.4 Kosova Sot.....	155
4.12 Analizimi i Trazirave të Marsit 2004 në shtypit ditor përmes fotografisë.....	156
4.12.1 Koha Ditore.....	157
4.12.2 Epoka e re	159
4.12.3 Bota Sot.....	161
4.12.4 Kosova Sot.....	163
4.12.5 Zëri.....	166
4.13 Hapësira që i ka dhënë shtypti ngjarjeve të dhunshme ndëretnike të marsit sipas matjes kuantitative.....	167

KAPITULLI V

ANALIZË KRAHASUESE MES MEDIEVE TË SHKRUARA DHE ATYRE

ELEKTRONIKE PËR TRAZIRAT E MARSIT.....171

5.1 Radio Televizioni i Kosovës (RTK)	171
5.2 Kohavizioni (KTV)	176
5.3 Televizioni 21	176
5.4 Analizë krahasuese mes shtypit dhe televizioneve për ngjarjen tragjike të Çabrës.....	177

KAPITULLI VI

MASAT ADMINISTRATIVE NDAJ MEDIEVE (Pas ngjarjeve të marsit)179

6.1 Analizë e raporteve vendore dhe ndërkombëtare për Trazirat e Marsit 2004.....179

6.2 Analizë e raportit të OSBE-së për Trazirat e Marsit 2004.....179

6.3 Analizë e raportit të KPM-së për Trazirat e Marsit 2004183

6.4 Analizë e raportit të RTK-së për Trazirat e Marsit 2004188

KAPITULLI VII

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....192

7.1 Përfundime192

7.2 Rekomandime197

LITERATURA198

SHKURTIMET E PËRDORURA

1244	Rezolutë që e përcakton statusin politik të Kosovë si protektorat të OKB-së
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
KFOR	Misioni i NATO-s në Kosovë
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut
KMShK	Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës
KPM	Komisioni i Përkohshëm për Media
KS	Këshilli i Sigurimit
KTV	Kohavision
RTV21	Radio Televizioni 21
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LKÇK	Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OVL	Organizata e Veteranëve të Luftës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QUINT	Pesë vendeve kryesore perëndimore, ShBA, Francës, Gjermanisë, Italisë dhe Mbretëria e Bashkuar
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
ShVL	Shoqatat e Veteranëve të Luftës së UÇK-së
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Kulturë, Shkencë dhe Arsim
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

LISTA E FOTOGRAFIVE

Fotografia 1. Ballina e gazetës “Koha Ditore”, 18 mars 2004	111
Fotografia 2. Ballina e gazetës “Epoka e re”, 18 mars 2004	115
Fotografia 3. Ballina e gazetës “Zëri”, 18 mars 2004	119
Fotografia 4. Ballina e gazetës “Bota Sot”, 18 mars 2004	120
Fotografia 5. Ballina e gazetës “Kosova Sot”, 18 mars 2004.....	122
Fotografia 6. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Koha Ditore”, më 18 mars 2004.....	158
Fotografia 7. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Epoka e re”, më 18 mars 2004	159
Fotografia 8. “Epoka e re”, 20 mars 2004. Fotografia e ceremonisë së vrrimit të tre fëmijëve shqiptarë, të cilët humbën jetën në mënyrë tragjike në fshatin Çabër të Mitrovicës. Kjo ngjarje shënon edhe fillimin e Trazirave të marsit 2004.....	160
Fotografia 9. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Bota Sot”, më 18 mars 2004.....	161
Fotografia 10. “Bota Sot”, 19 mars 2004, kjo e përditshme i ka publikuar një seri fotografish në këtë numër të saj të titulluar “Fotografitë që flasin vetë”	162
Fotografia 11. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Kosova Sot”, më 18 mars 2004.....	164
Fotografia 12. “Kosova Sot”, më 18 mars 2004, në faqet e mesit publikon njëzet fotografi të trazirave të dhunshme ndëretnike nga pjesë të ndryshme të Kosovës	165
Fotografia 13. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Zëri”, më 18 mars 2004.....	165

LISTA E GRAFIKAVE

Grafika 1. Shtypi ditor: 18 mars 2004.....	167
Grafika 2. Shtypi ditor: 19 mars 2004.....	168
Grafika 3. Shtypi ditor: 20 mars 2004.....	169
Grafika 4. Shtypi ditor: 21 mars 2004.....	169

HYRJE

Studimet mbi komunikimin dhe gazetarinë gjithnjë mbetën të veçanta, si për nga natyra e studimit, ashtu edhe për nga natyra e shtrirjes së objektivave brenda kësaj shkence. Përmes këtij disertacioni të doktoraturës në fushën e Shkencave të Komunikimit dhe të Gazetarisë, do të trajtojmë temën me titull: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”. Kjo temë e disertacionit, e miratuar nga të gjitha organet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, do të jetë një hulumtim shkencor, punë origjinale dhe rezultate konkrete në fushën e studimeve të gazetarisë. Ky punim shkencor është fokusuar në tre komponentë të cilat do të ndihmojnë në arritjen e rezultateve konkrete. Pra, komponenti i parë ka të bëjë me shtrirjen teorike të këtij studimi, i dyti fokusohet në hulumtimin shkencor të rastit studimor, ndërkaq përmes komponentit të tretë, do të nxjerrim rezultatet konkrete të punimit. Ky studim është i ndarë në shtatë kapituj, ku secili nga ta do të kontribuojë në unifikimin e tërësisë së tij, dhe nxjerrjen e rezultateve konkrete.

Mirëpo, një punim shkencor, për ta arsyetuar temën e tij të studimit duhet t’i ketë hipotezat e tij, të cilat përmes trajtimit shkencor do të gjejnë mbështetje apo verifikim ose do të na argumentohet një gjetje e re brenda rastit studimor. Hipoteza kryesore në këtë temë të disertacionit është bazuar mbi paragjykimin se mediet shqipe në Kosovë, që gjatë raportimit kanë ndikuar drejtpërdrejt në nxitjen e trazirave ndëretnike të marsit 2004. Përveç kësaj, ky rast studimor mbështetet edhe në hipotezat e tjera, të cilat janë të trajtuara më detajisht në pjesën në vazhdim të këtij studimi.

Por, për t’i arritur synimet dhe objektivat shkencore, secili rast studimor duhet t’i përzgjedhë metodat adekuate të cilat shërbejnë dhe e mbështesin hulumtimin shkencor drejt objektivave të tij. Prandaj, në këtë punim janë përzgjedhur metodat adekuate të cilat do të ndihmojnë në nxjerrjen e rezultateve konkrete të këtij studimi shkencor, si: metoda e analizës së përmbajtjes, metoda e sintezës, metoda e abstraksionit, metoda e konkretizimit, metoda e gjeneralizimit, metoda induktive, metoda deduktive, metoda komparative (e krahasimit), metoda historike, metoda statistikore, metoda e studimit të rasteve, metoda deskriptive, metoda e analizës së diskut. Të gjitha këto metoda, për të cilat detajisht do të diskutohet në pjesën e metodologjisë, janë përdorur në pjesë të ndryshme të rastit studimor dhe hulumtimit të temës për të ndihmuar në realizimin e përfundimeve konkrete në formën sa më objektive. Përveç këtyre dy elementeve të

theksuara më lartë, pra hipotezës dhe metodologjisë, gjatë këtij punimi shkencor janë vendosur edhe objektivat apo pritshmëria e tij në këtë fushë studimi. Objektivi kryesor është përgjigjja shkencore e hipotezave të ngritura dhe kontributi i këtyre gjetjeve në zhvillimin e mëtejshëm në shkencat e gazetarisë dhe të komunikimit, e përmes kësaj, edhe në ngritjen e standardeve profesionale të raportimit profesional nga trazirat e dhunshme.

Kapitulli i dytë i këtij punimi të doktoraturës trajton sfondin teorik, i cili është ndarë në disa fusha shkencore, të cilat do të japin mbështetjen kryesore të rastit studimor. Në fillim të këtij kapitulli shkencor është trajtuar teoria kritike-kulturore e medieeve, e fokusuar në idetë kryesore të studiuesve të Shkollës së Frankfurtit. Filozofia e tyre për mediet dhe qasja e trajtimit të problemeve dhe fenomeneve do të ndihmojë në analizën kritike të këtij disertacioni. Studimet e tyre filozofike dhe gjetjet e tyre metodologjike për shekuj me radhë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në kulturën mediale, sidomos gjatë shekullit të kaluar, kur u vendosën themelet e saj.

Teoritë e shtypit janë një trajtim tjetër shkencor brenda këtij kapitulli, teori, të cilat sipas studiuesve, e kanë dominuar botën me dekada. Teoria e parë e shtypit e cila është trajtuar, është ajo autoritare, e cila sipas studiuesve të saj, ka gjetur zbatim në vendet ku shtypi është i kontrolluar nga pushteti. Teoria liberale është e dyta e trajtuar, sipas të cilës shtypi është i lirë dhe i pakontrolluar nga pushteti. Pra, mbetet e kundërt me qasjen e teorisë së parë. Mbi këtë teori liberale, do e mbështesim edhe trajtimin e këtij punimi të disertacionit dhe hulumtimin e rastit studimor. E treta është teoria e përgjegjësisë sociale, e cila për nga natyra e veprimit mbetet e përafërt me teorinë liberale. Pra, sipas studiuesve të kësaj qasje, shtypi ka të drejtë që t'i kritikojë pushtetet dhe qeveritë, mirëpo duhet të ketë kujdes në përgjegjësinë sociale dhe në ruajtjen e demokracisë. Ndërkaq, teoria sovjetike-komuniste është teoria e fundit e shtypit e trajtuar, studiuesit e së cilës kanë theksuar se mbetet ndër qasjet më të kontrolluara të sistemit. Trajtimi i teorive të shtypit mbetet i rëndësishëm në këtë rast studimi, për të nxjerrë rezultate konkrete dhe të bazuara edhe në këtë këndvështrim teorik.

Teoria e zhanrit është pjesa tjetër teorike mbi të cilin do të mbështetet ky rast studimor. Mbështetja e rastit studimor në aspektin zhanror, do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e rezultateve konkrete, në aspektin profesional të raportimit të shtypit për Trazirat e Marsit 2004.

Kapitulli i radhës brenda këtij studimi është pjesa historike, e cila trajton shqytin shqiptar në periudha të ndryshme historike. Gjatë këtij trajtimi historik, përmes metodës së historisë, i është kushtuar rëndësi historisë së gazetarisë nga periudha e Rilindjes Kombëtare. Në këtë pjesë të

studimit theks i veçantë u është kushtuar personaliteteve historike e publicistike, të cilët kanë pasur një rol të jashtëzakonshëm në afirmimin dhe zhvillimin e shtypit shqiptar. Sipas studiuesve të historisë së gazetarisë shqiptare, krahas zhvillimit të mendimit intelektual, bëhet edhe ngritja e një numri të madh revistash e gazetash të ndryshme, të cilat bëjnë një kthesë të madhe në historinë e gazetarisë shqiptare. Gjithashtu, brenda këtij zhvillimi historik të shtypit, i është kushtuar një rëndësi e veçantë zhvillimit të shtypit dhe revistave në mërgatë dhe rolit të këtyre medieve në afirmimin e vlerave dhe identitetit kombëtar. Sipas studiuesve, ideologët kryesorë të cilët kanë promovuar gazetarinë shqiptare gjatë kësaj periudhe kanë qenë: Jeronim De Rada, Pashko Vasa, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Zef Skrioi, Naim Frashëri, Faik Konica, Fan Noli, Filip Shiroka, Ndoc Nikaj, Mihal Grameno, etj. Një rol i veçantë në këtë pjesë të këtij disertacioni i është dhënë shtypit shqiptar në Kosovë, nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në pavarësimin e Kosovës. Edhe shtypi në Kosovë gjatë kësaj periudhe historike i ka pasur zhvillimet e tij, të cilat janë ndarë si: mediet në Kosovë në periudhën e Rilindjes Kombëtare, mediet në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, mediet pas çlirimit, si dhe shtypi në Kosovë pas pavarësisë së saj.

Rasti studimor është njëra nga pjesët në të cilin fillon trajtimi i hulumtimit shkencor. Kjo pjesë e studimit është e ndarë në fragmente të ndryshme të cilat ndihmojnë në zgjerimin e hulumtimit dhe në trajtimin e tij, nga pikëpamje të ndryshme hulumtuese shkencore. Kompilimi i Trazirave të Marsit 2004, është elementi i parë i rastit studimor i cili nis trajtimin e hulumtimit mbi analizën kritike të raportimit për Trazirat e Marsit. Në këtë pjesë të disertacionit, nëpërmjet metodës së kompilacionit, janë paraqitur të gjeturat e studimeve paraprake që lidhen me këtë ngjarje të rëndë të dhunës ndëretnike. Brenda këtij kompilimi janë nxjerrë gjetjet dhe interpretimet e autorëve të ndryshëm, të cilët i kanë parë nga afër zhvillimet dramatike të Marsit 2004. Pas kompilimit është trajtuar konteksti studimor i ngjarjes së trazirave të dhunshme të Marsit 2004, të cilat konsiderohen si ngjarja më e rëndë ndëretnike në Kosovë. Siç edhe theksohet në këtë pjesë të punimit, trazira e 17 marsit ishte ngjarja më e rëndë në Kosovën e pasluftës. Në këtë ngjarje sipas raportit të UNMIK-ut të prezantuar në Këshillin e Përgjithshëm të OKB-së, humbën jetën 19 persona, nga të cilët 11 shqiptarë dhe 8 serbë si dhe 954 persona u plagosën gjatë përleshjes. Prandaj, duke u bazuar në përdorimin e metodës e studimit të rasteve, në këtë fazë është trajtuar gjerësisht kjo ngjarje në të cilën, përveç viktimave, u dëmtua rëndë procesi i statusit të Kosovës. Ajo ka vënë në dyshim edhe suksesin dhe punën e misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut. Konteksti i ngjarjes është bazuar në dokumente dhe raporte zyrtare të misionëve ndërkombëtare, të cilat kanë

përmbledhur brenda tyre fakte dhe faktorë që shtynë në shpërthimin e dhunës ndëretnike. Në kuadër të kësaj, brenda analizimit të këtyre dokumenteve janë evidentuar pjesët të cilat flasin për rolin e medieve në këtë ngjarje të dhunshme ndëretnike, duke e vlerësuar punën e tyre si joprofesionale, sensacionale dhe të njëanshme. Por, konkluzione të tilla ishin kundërshtuar ashpër. Megjithatë, këto konkluzione të raportit të UNMIK-ut, të prezantuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, janë kundërshtuar me këmbëngulje nëpërmjet organizatave joqeveritare, asociacioneve të medieve dhe redaksive, të cilat e kanë vlerësuar punën e tyre si profesionale dhe brenda standardeve të raportimit.

Mirëpo, pavarësisht këtyre akuzave nga ana e misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, në raportin e tij të fundit para trazirave, nuk kishte evidentuar ndonjë vërejtje në drejtim të medieve, por, përkundër kësaj, e kishte konsideruar si të qetë situatën në përgjithësi në Kosovë. Tjetër element i rëndësishëm i cili është trajtuar në këtë pjesë të kontekstit të ngjarjes ka të bëjë me rrethanat politike, ekonomike, sociale e të sigurisë në Kosovë. Në fillim të marsit ishte raportuar për vendosje të pajisjeve shpërthyes pranë ndërtesës së UNMIK-ut në Prishtinë. Gjatë këtij muaji, më 12 mars, një granatë dore kishte shpërthyer në rezidencën e presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova, sulm nga i cili nuk kishte pasur të vdekur dhe të plagosur. Më datën 15 mars, një i ri serb ishte vrarë në fshatin Çagllavicë afër Prishtinës, ku më pas serbët lokal kishin bllokuar rrugën e qarkullimit për automjete Prishtinë-Shkup. Më 16 mars, Shoqatat e Veteranëve të Luftës (ShVL), kishin organizuar protestë gjithpopullore për ta kundërshtuar arrestimin e katër ish-luftëtarëve të UÇK-së, njëherësh pjesëtarë të TMK-së, nga ana e policëve të UNMIK-ut, me ç'rast ishin sulmuar disa zyre rajonale të këtij misioni. Gjithashtu, gjatë këtyre ditëve ishte planifikuar dhe organizuar një demonstratë paqësore, si shenjë kundërshtimi për sulmin ndaj rezidencës së presidentit Ibrahim Rugova. Një problem shqetësues dhe permanent si për institucionet e Kosovës, ashtu edhe për misionin ndërkombëtar, ishte situata në veriun e Kosovës e cila vazhdimisht ishte e brishtë dhe e paqëndrueshme. Pra, të gjitha këto ngjarje janë analizuar në kontekstin rrethor të ngjarjes në kapitullin e pestë, të cilat pasqyrojnë gjendjen reale të kohës.

Ndër të tjera, në këtë pjesë të rastit studimor është ritheksuar se dhuna ndëretnike është një ngjarje e cila pas një dekade e ca vazhdon të jetë kohë pas kohe si ngjarje e cila trajtohet dhe konsiderohet se ende nuk është e mbyllur, përkundër disa gjykimeve që janë bërë për këtë rast të rëndë të dhunës. Pra, gjatë vitit 2017, prokurori Danilo Cecareli, i një misioni tjetër ndërkombëtar në Kosovë, i atij evropian të EULEX-it, ka pretenduar se pas analizimit të provave të UNMIK-ut,

ka ardhur në përfundim konkret për sa i përket shkaktarëve të trazirave. Mirëpo, kjo ngjarje ka qenë gjithnjë pikë e nxehtë e mospajtimeve në mes të institucioneve ndërkombëtare të cilët pretendojnë në provat e tyre dhe kundërshtimeve të institucioneve, si dhe politikanëve vendorë të cilët pretendojnë se interpretimet për këtë ngjarje janë politike. Ndër të tjera, brenda këtij kapitulli i cili trajton konkretisht rastin studimor, janë trajtuar edhe rrethanat politike në Kosovë dhe ndikimi i këtyre politikave në realitetin social. Kosova gjatë kësaj periudhe përmes Rezolutës 1244 është vendosur nën administrimin ndërkombëtar.

Administrata Ndërkombëtare në Kosovë, kishte për obligim t'i krijonte institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, dhe pas një mandati katërvjeçar të fillonte përgatitjen për statusin final të Kosovës, duke u bazuar edhe në marrëveshjen e Rambujesë. Ndërkaq, në Kosovë kishte edhe një numër të madh të organizatave të tjera ndërkombëtare të cilat ishin përfshirë në Kosovë me misione të ndryshme. Një pakënaqësi dhe pasiguri te shumica shqiptare ishte edhe mosfillimi i diskutimit për definimin e statusit final të Kosovës. Disa vite pas administrimit ndërkombëtar, Kosova mbetej ende një vend i lirë, por i pa definuar për të ardhmen, që për qytetarët e saj do të thoshte pakënaqësi dhe brengosje. Pos të tjerash, gjatë kësaj periudhe shihet një pakënaqësi e theksuar ekonomike sipas raportimeve në media, me ç'rast Kosova vazhdonte të mbetej një vend i pazhvilluar, ndërkohë sindikatat e punëtorëve kishin rritur presionin ndaj UNMIK-ut, kundër mënyrës së privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Duke i analizuar raportet e prezantuara të UNMIK-ut për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, shihet një rritje e pakënaqësisë së qytetarëve ndaj këtij misioni, kjo, sepse, sipas raportimeve në media, UNMIK-u nuk po punonte për t'i ndryshuar gjërat në favor të qytetarëve. Pra, këtu janë paraqitur vetëm disa nga shkaktarët e rrethanave politike, të cilët trajtohen më gjerësisht në kapitullin e pestë të këtij punimi të disertacionit.

Në pikën e pestë të kapitullit të pestë, është bërë analiza e raportimit të shtypit ditor, një javë para fillimit të trazirave, me ç'rast janë analizuar indikatorët që kanë mundur ta tërheqin opinionin publik rreth një reagimi të dhunshëm. Në kuadër të shtypit ditor janë analizuar gazetat ditore: "Koha Ditore", "Epoka e re", "Bota Sot", "Kosova Sot" dhe "Zëri", nga data 10 deri më 17 mars. Në këtë pjesë të studimit për të arritur pritshmërinë është përdorur metoda deduktive, përmes së cilës, në secilën gazetë janë analizuar ngjarjet e raportuara gjatë një jave. Shtypi ditor gjatë kësaj periudhe ka raportuar dhe i ka mbuluar të gjitha aktivitetet ditore, duke mos anashkaluar edhe temat e trajtuara, të cilat qoftë se janë ndërlidhur me aktualitetin e kohës, apo edhe kanë qenë të

trajtuara e ndërtuara nga politika editoriale. Shtypi pra, nga 10 deri më 17 mars të vitit 2004, kryesisht në fokus ka pasur ngjarjet dhe zhvillimet politike, për të cilat ka raportuar dhe iu ka kushtuar pjesën më të madhe të hapësirës së tij. Në kuadër të kësaj, një pjesë e madhe e gazetave është fokusuar në interpretimin e ngjarjeve kryesore të ndodhura gjatë ditës, duke i ofruar publikut detaje të reja dhe informacione shtesë për zhvillimet që kanë qenë relevante për publikun. Natyrisht, që pjesë e rëndësishme e raportimit të shtypit ishin të ndërlidhura edhe me sektorë të tjerë si: ekonomik, social, arsimor e kulturor. Gjatë analizës të raportimit të këtyre gazetave ditore, ka pasur nga to që kanë dhënë kritika ndaj misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, duke e kritikuar atë për sjellje të njëanshme dhe të pabarabartë në raport me etnitë brenda Kosovës, e kritika më e madhe i është bërë për mos përfillje të mjaftueshme të shumicës shqiptare në Kosovë. Ndërkaq, gjatë analizimit të shtypit, gjithashtu janë evidentuar edhe politikat editoriale, të cilat kanë reflektuar edhe në nuancat brenda teksteve.

E përditshmja “Koha Ditore”, në raportimin e saj gjatë kësaj periudhe kishte raportuar kryesisht për ngjarjet relevante të cilat kishin ndodhur dhe ishin trajtuar gjatë kësaj periudhe. Tekstet e botuara kanë qenë brenda standardeve profesionale të raportimit, si për nga struktura ashtu edhe për nga përmbajtja. Tema kryesore e trajtuar në ditën e parë ka qenë e ndërlidhur me fatin e të zhdukurve në luftën e fundit në Kosovë, për fatin e të cilëve ende nuk dihej asgjë dhe se askush nuk kishte dhënë informacione për këtë problem. Ky kryeartikull i botuar në këtë të përditshme, ka ardhur si rezultat i aktiviteteve ditore, pra nuk është ngritur nga ana e politikave editoriale të gazetës, e cila më pas do të mund të konsiderohej edhe si temë që do të mund të konsiderohej si mjaft provokuese në raportet ndëretnike. Edhe tekstet e tjera të trajtuara brenda këtij numri janë kryesisht tema profesionale që paraqesin aktualitetin e ditës. Raportimet e bëra për komunitetin serb janë kryesisht tema ditore, të bazuara kryesisht në reagimet dhe deklaratimet e tyre. Pra, gazeta “Koha Ditore”, gjatë kësaj periudhe kishte trajtuar vazhdimisht tema të cilat i plotësojnë kriteret e raportimit. Natyrisht që gjatë kësaj periudhe zhvillimet politike, ekonomike e sociale, duke mos i përjetuar edhe ndasitë e theksuara ndëretnike, kanë qenë brenda një brishtësie, intensiteti i të cilave është shtuar kohë pas kohe.

Edhe në të përditshmen “Epoka e re”, raportimi gjatë periudhës njëjavore para dhunës ndëretnike, në shumicën e rasteve ka raportuar brenda standardeve profesionale, duke i trajtuar temat aktuale, të cilat i plotësojnë vlerat dhe kriteret e raportimit. Edhe pse kjo e përditshme është vlerësuar për nga forma e raportimit si gazetë nacionale, gjatë raportimit të përditshëm ka qenë

profesionale në raport me trajtimin e komuniteteve të tjera, ndërsa përmes disa teksteve ka qenë kritike e ashpër ndaj profesionalizmit të UNMIK-ut, dhe një gjë e tillë theksohet më së shumti në editorialet dhe opinionet në gazetë, për të cilat do të diskutohet në një kapitull tjetër. Temat kryesore të trajtuara në gazetën “Epoka e re”, kanë qenë ngjarje relevante, të cilat sipas kriterëve dhe vlerave të lajmit e kanë pasur brenda saj hapësirën kryesore.

E përditshmja tjetër gazeta “Zëri”, gjatë kësaj periudhe, e deri në ditën e trazirave ka raportuar brenda standardeve profesionale, duke i respektuar rregullat e raportimit dhe duke paraqitur në anën tjetër një politikë të balancuar editoriale, në raport me ngjarjet gjatë këtyre ditëve, e sidomos me ato që mund të sillnin tensione.

Gazeta “Bota Sot”, gjatë asaj jave të analizës ka theksuar një mënyrë të veçantë të raportimit. Politika editoriale e kësaj gazete e cila reflektohet qartë në tekstet e analizuara në përgjithësi, e sidomos në kryeartikujt, shihet një politikë mbështetëse ndaj presidentit Rugova dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Edhe kryeartikujt e trajtuar në shumicën e rasteve gjatë këtyre ditëve të analizës janë joaktuale.

Më tutje gjatë këtij punimi shkencor, në pjesën e gjashtë të kapitullit të pestë është trajtuar analizimi i raporteve të cilat shtjellojnë temën e organizatorëve të Trazirave të Marsit. Përmes metodës induktive të përdorur në këtë pjesë të rastit të studimit është trajtuar nga një këndvështrim tjetër epilogu i Trazirave të Marsit 2004, me ç’rast përfaqësuesit ndërkombëtarë i ngritin dilemat e tyre gjatë deklarimeve mediale, po ashtu edhe njohësit e zhvillimeve politike, si dhe intervista e njërit nga të akuzuarit për këtë çështje. Prandaj, duke u bazuar në deklaratat e vazhdueshme të zyrtarëve të lartë të bashkësisë ndërkombëtare, të cilët u referohen burimeve të sigurta, shihet qartë se sipas tyre, dhuna ndëretnike sado që mund të shihej si spontane në fillim, grupet politike apo para politike, ishin të përfshirë në dinamikën e saj. Përveç kësaj, në këtë pjesë të studimit janë analizuar edhe fakte të tjera të cilët po ashtu, e shohin si pjesë të organizimit të Trazirave të Marsit edhe një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare.

Në pjesën në vazhdim të rastit studimor janë analizuar reagimi i medieve karshi akuzave për nxitje të trazirave të marsit. Përfaqësuesit e medieve i kanë akuzuar misionet ndërkombëtare për mbyllje hermetike të zyrave të tyre të komunikimit në ditët kritike të trazirave. Prandaj, si rezultat i mosdhënies së informacionit përmes organeve kompetente, është theksuar se mediet janë detyruar të raportojnë me gjysmë informatat që i kanë poseduar, dhe në këtë rast ato kanë bërë shkelje profesionale në njërën anë, dhe në anën tjetër spontanisht janë përfshirë në agjenda të

ndryshme, të cilat mund të kenë pasur për qëllim shkaktimin e dhunës. Përfaqësuesit institucional, juridikisht, janë të obliguar që të jenë përgjegjës para qytetarëve, dhe t'i mbajnë ata të informuar për punën e tyre. Përveç kësaj, në situata të tilla jo vetëm që do të duhej që zyrat për informim të jenë transparente, por edhe të punonin pa orar, në mënyrë që t'i jepnin informacione zyrtare medieve, duke iu ndihmuar që të mos operonin me gjysmë informacione apo informacione rrethanore në terren dhe të pa konfirmuara zyrtarisht. Te përfundimet e rastit studimor janë nxjerrë konkluzione të cilat i identifikojnë disa nga faktorët të cilët do të kenë mundur të ndikojnë apo ndihmojnë në brishtësinë e situatës së krijuar në terren.

Kapitulli i gjashtë përfshin analizën kritike të raportimit të shtypit për Trazirat e Marsit 2004. Në këtë kapitull janë testuar në mënyrë të drejtpërdrejtë hipotezat e ngritura në këtë studim, të cilat lidhen në analizën kritike të shtypit, dhe rolin e saj në trazirat e dhunshme ndëretnike të marsit, ngjarje e cila mund të vlerësohet si më e rënda në Kosovën e pasluftës.

Analiza e parë në këtë kapitull është ajo e gazetës “Koha Ditore”, brenda cilës janë analizuar tekstet të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me trazirat ndëretnike. Duke u bazuar si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë të standardeve profesionale të raportimit, kritikën më të mëdha për shtypin janë bërë për raportimin që kanë bërë ato për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, ku në lumin Ibër humbën jetën tre fëmijë shqiptarë. Kjo ngjarje, e cila brenda saj kishte të bënte me elemente ndëretnike u konsiderua edhe nga vetë mediet më pas se ishte vendimtare në fillimin e trazirave. Duke nisur nga mbititulli, titulli, paragrafi i parë, burimet, citatat, kryeartikulli, në këtë tekst është hasur në probleme profesionale gjatë raportimit, të cilat bien në kundërshtim me teoricienët e shtypit dhe të tipologjisë së zhanrit. Titulli i tekstit kryesor i cili thekson se tre fëmijë shqiptarë mbyten në lumin Ibër duke ikur nga serbët, është paragjykes, nxitës i raporteve ndëretnik, dhe që nuk përputhet me kreun e raportit. I gjithë teksti për këtë ngjarje është analizuar në çdo paragraf për të nxjerrë rezultate sa më konkrete, të mbështetura në analizën e përmbajtjes dhe hulumtime shkencore. Gjithashtu, gjatë kësaj dite, sipas analizës kritike, në brendësinë e ballinës së saj kjo e përditshme e ka vendosur për fotolajm një automjet me xham të thyer, ndërsa në tekstin e kësaj fotografie shfaqen elemente të një përplasje ndëretnike. Për disa ditë me radhë janë analizuar tekstet të cilat kanë qenë të ndërlidhura me këtë ngjarje, duke nxjerrë më parë përfundime konkrete dhe gjetje të cilat kanë dalë gjatë analizimit të këtij hulumtimi.

Edhe e përditshmja “Epoka e re” është analizuar me të njëjtën metodologji, me ç’rast janë paraqitur gjetje konkrete dhe përfundime për mënyrën e raportimit. Kjo e përditshme i ka mbuluar vazhdimisht ngjarjet kryesore të cilat kanë ndodhur gjatë këtyre ditëve, por në disa raste janë gjetur edhe përfundime konkrete të cilat ndërlidhen me rolin e saj në trazirat ndëretnike. Edhe në këtë rast janë nxjerrë konkluzione konkrete rreth të gjitha çështjeve të ngritura gjatë këtyre ditëve të dhunshme, ku mediet kanë pasur një rol kyç në informimin e opinionit publik dhe në formimin e opinionit publik.

Janë bërë gjetje dhe konstatime krejt ndryshe gjatë analizës në të përditshmen e radhës “Zëri”. Raportimi i kësaj të përditshmeje për rastin e humbjes së jetës së fëmijëve në lumin Ibër, në fshatin Çabër të Mitrovicës, ka qenë jashtëzakonisht profesional, i bazuar në fakte, pa gjykim e vlerësim editorial, gjë që reflekton edhe në strukturën e këtij raporti kaq të ndjeshëm. Gazetari nuk ngutet të japë vlerësime për ngjarjen, nuk e vendos dëshmitarin (fëmijën) në planin e parë dhe përpiqet që gjatë strukturës së tekstit të mos bëjë ndonjë provokim ndëretnik. Gazeta “Zëri”, është analizuar për disa ditë sa kanë zgjatur trazirat e dhunshme ndëretnike, dhe janë përmbledhur përfundime konkrete për këtë ngjarje në tërësi.

Ndryshe nga “Zëri”, gjetje krejt më ndryshe janë konstatuar gjatë analizës kritike të raporteve të së përditshmes së radhës “Bota Sot”. Në kapitullin e gjashtë janë theksuar gjetjet në formë të detajizuar për këtë të përditshme, brenda së cilës janë analizuar edhe politikat editoriale të saja, të cilat natyrisht janë reflektuar edhe në formën edhe në mënyrën e raportimit. Gjetjet dhe konkluzionet gjatë analizimit të raporteve të kësaj të përditshme janë konkrete, të cilat ndihmojnë në testimin e hipotezave.

Gjithashtu, në këtë kapitull është bërë edhe analizë kritike e teksteve të së përditshmes së fundit “Kosova Sot”, e cila i ka kushtuar një rëndësi të madhe raportimit për Trazirat e Marsit. Sikurse gazetat e theksuara më lartë, e përditshmja “Kosova Sot”, ka nxjerrë rezultate dhe përfundime konkrete për formën e raportimit, gjykimin editorial, por edhe rolin e saj në trazirat e dhunshme ndëretnike të marsit 2004. Pothuajse sikurse edhe gazetat e tjera, edhe për këtë të përditshme janë bërë gjetje dhe konkluzione të veçanta të cilat e kanë karakterizuar edhe politikën editoriale të saj. Shtypi ditor gjatë këtyre ditëve i kishte mobilizuar ekipet e raportimit, për t’i mbuluar këto ngjarje të dhunshme ndëretnike të cilat e kishin përfshirë të gjithë vendin. Tekstet e ballinave në të gjitha gazetat ishin të mbuluara me raportime për dhunën nga zona të ndryshme të vendit, të shoqëruara me fotografi nga vendi i ngjarjes, ndërsa i gjithë shtypi në ballinë, lajmin

kryesor e ndërlidh me numrin e të vdekurve gjatë përleshjeve. Shtypi ditor shpërthimin e dhunës ndëretnike në gjithë Kosovën, sipas raportimit, fillimisht e kishin ndërlidhur me tre fëmijët shqiptarë të zhdukur në lumin Ibër. Një pjesë e madhe e medieeve dhe e gazetarëve ndoshta mund të kenë pasur mungesë të përvojës në raportime të tilla, të cilat prodhojnë dhunë ndëretnike, mirëpo për dallim prej raportimit për zhdukjen e tre fëmijëve, raportimi për shpërthimin e dhunës ishte më përmbajtjesor në aspektin e raportimit profesional.

Në ndarjen e tetë të kapitullit të gjashtë të rastit studimor, një analizë shtypit i është bërë për hapësirën që i është dhënë reagimeve dhe deklarimeve politike në raport me zhvillimet në terren. Shtypi ditor gjatë ditëve të trazirave, reagimet institucionale politike të administratës ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës për nga hapësira, i kishte vendosur në plan të dytë, me ç'rast, më tepër mund të shihen dhe gjykohen si mesazhe dëshpërimi karshi zhvillimeve dhe përshkallëzimit të dhunës në gjithë vendin. Megjithatë, në bazë të gjetjeve gjatë raportimeve të shtypit, reagimet politike karshi zhvillimeve dramatike në vend janë të pakta dhe me qëndrime të zbehta politike. Prandaj, parë nga konteksti i raportimit të shtypit për reagimet dhe deklaratimet politike rreth Trazirave të Marsit 2004, shihet qartë polarizimi politik dhe reflektimi i këtij polarizimi në situatën e përgjithshme të trazirave ndëretnike. Pavarësisht dhjetëra të vrarëve dhe të plagosurve, mesazhet politike janë simbolike, dhe më tepër ngjajnë në reagime të obligimeve etike, duke mos paraqitur në asnjërin reagim, përgjegjësinë e tyre karshi obligimeve ndaj qytetarëve të Kosovës.

Në këtë kapitull të hulumtimit të këtij disertacioni, për të nxjerrë rezultate sa më konkrete janë analizuar editorialet, opinionet dhe komentet e botuara në shtypin ditor. Krahas interpretimit të ngjarjeve në këto rubrika, janë shprehur edhe politikat editoriale të gazetave. Në shumicën e gazetave vlen të theksohet se opinionbërësit janë të përzgjedhur, tekstet të cilat ata i shkruajnë paraqesin qëndrime që përputhen me politikat editoriale të tyre. Editorialet, opinionet dhe komentet e botuara në shtyp gjatë kësaj periudhe të trazirave të dhunshme ndëretnike paraqesin edhe analizimin kontekstual të trazirave, të zhvillimeve politike, dhe të faktorëve, të cilët, sipas tyre mund ta kenë shkaktuar një valë të dhunshme në gjithë vendin. Gjithashtu, këto editoriale, opinione, analiza e vështrime do të na bëjnë të kuptojmë nga këndvështrime të ndryshme rrethanat që nxitën dhunën e Trazirave të Marsit 2004.

Rezultate konkrete në kapitullin e gjashtë janë paraqitur edhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Është analizuar raportimi në secilën gazetë ditore për përdorimin e gjuhës së urrejtjes,

me ç'rast në disa prej raporteve është evidentuar përdorimi i kësaj gjuhe, pavarësisht që përmes rregulloreve të UNMIK-ut, ka qenë e sanksionuar një gjë e tillë. Natyrisht, që përdorimi i gjuhës së urrejtjes shkakton nxitje të urrejtjes ndëretnike, probleme dhe çrregullime sociale. Në këtë kapitull, gjithashtu, janë analizuar Trazirat e Marsit 2004 përmes fotografive të cilat janë publikuar në shtypin ditor gjatë trazirave të dhunshme. Me përjashtim të gazetave “Koha Ditore” dhe “Zëri”, pjesa tjetër e shtypit i ka dhënë një hapësirë të madhe përdorimit të fotografisë gazetareske, duke i dokumentuar nga afër zhvillimet dramatike. Në disa raste shtypi ditor ka përdorur fotografi të cilat bien në kundërshtim me etikën profesionale, sepse nga publikimi i tyre janë prodhuar momente emocionale dhe shkelje të etikës profesionale të raportimit. Shumica e fotografive të përdorura nga shtypi kanë ofruar përmbajtje të dhunës dhe imazhe dramatike, pamje të dhunës, dhe gjendje emocionale të pjesëmarrësve në ngjarje. Për të qenë sa më i thellë ky rast studimor, përmes metodës kuantitative është bërë matja e hapësirës që i ka kushtuar kësaj ngjarje shtypi. Në bazë të kësaj analize shihet qartë se shumica e gazetave i kanë dhënë hapësirë të madhe raportimit për trazirat e dhunshme, rezultatet konkrete të së cilës janë paraqitur gjerësisht në brendi të studimit.

Më tutje në këtë disertacion, janë analizuar format e raportimit të shtypit, në raport me televizionet për ngjarjen e lartcekur. Pa dyshim që televizionet me gjithë zhvillimet e teknologjisë mbeten pjesë e rëndësishme e mjeteve të informimit. Publiku, vazhdon të jetë besnik i marrjes së informacionit këtë formë tradicionale. Mirëpo, në ngjarjet e dhunshme ndëretnike të vitit 2004, televizionet kishin një rol edhe më të madh, sepse, revolucioni teknologjik i mjeteve të reja të komunikimit dhe rrjetet sociale ende nuk paraqitnin një trend të ri të teknologjisë informative. Brenda këtij hulumtimi shkencor janë paraqitur gjetjet e tri televizionet me frekuencë nacionale: Radio Televizioni i Kosovës (RTK), Kohavisioni (KTV) dhe Radiotelevizioni 21 (RTV21). RTK-ja ishte njëri nga mediumet i cili i kishte kushtuar më së shumti vëmendje zhvillimeve tragjike në fshatin Çabër.

Në këtë studim janë analizuar raporti i OSBE-së, raporti i KPM-së dhe raporti i RTK-së, ku përmes metodës së analizës së diskut, janë paraqitur gjetje dhe rezultate konkrete. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), kishte hartuar pak ditë pas trazirave të dhunshme një raport të titulluar: “Roli i medieve në ngjarjet e marsit në Kosovë”, prej tetëmbëdhjetë faqesh, në të cilin e ka përshkruar rolin e medieve ditëve të dhunshme në Kosovë, dhe kujdesin që duhet të kenë mediet në tërësi, kur ngjarjet janë të ndjeshme dhe kur situata në terren është e brishtë.

OSBE-ja në raportin e saj ishte fokusuar kryesisht në ngjarjen tragjike të mbrëmjes së 16 marsit, natën kur në fshatin Çabër të Mitrovicës, kishte ndodhur një ngjarje tragjike. Në këtë raport të OSBE-së, theksohet se raportimi për mbytjen fatale të fëmijëve në fshatin Çabër, nuk është trajtuar profesionalisht dhe se nuk ka qenë e trajtuar me idenë e ndjenjës së shmangies së dhunës. Prandaj, sipas gjetjeve të raportit, raportimi në mbrëmjen e 16 marsit në tri televizionet kryesore kosovare, në mënyrë të veçantë meriton kritikën më të ashpër të mundshme. Në përmbledhjen zyrtare të këtij raporti të OSBE-së, në fund të gjetjeve të përmbledhjes zyrtare, theksohet si përfundim i veçantë se ngjarjet e mesit të marsit ishin kriza e parë serioze që hasen mediet në Kosovë, sidomos ato elektronike që besohet se mund të jenë një nga arsyet e shkaktimit të trazirave të dhunshme të marsit.

Shumë kritika për këtë ngjarje ishin vendosur edhe në raportin e Komisionarit të Përkohshëm për Media (KPM), i cili kishte kritikuar ashpër kryesisht televizionet për mënyrën e raportimit për Trazirat e Marsit 2004, me theks të veçantë Transmetuesin Publik. Ky raport është ndarë në tri pjesë, ku në secilën prej tyre ka paraqitur, sipas autorëve të tij, fakte dhe rekomandime për televizionet me frekuencë nacionale (RTK, KTV dhe RTV21), ndërkaq në fund, përmes një shtojce i ka transkriptuar të gjitha edicionet informative, edicionet speciale të lajmeve në këto televizione për datën 16 dhe 17 mars 2004. Raporti i KPM-së, përmes gjetjeve të publikuara i ka cilësuar si joprofesionale mediet për mënyrën e raportimit, në natën tragjike në mes të 16 dhe 17 marsit. Edhe pse kritikën më të ashpër i kishte bërë për Televizionin Publik, kritika në raport ishin adresuar edhe ndaj dy televizioneve të tjera me frekuencë nacionale, të cilat, sipas raportit kanë bërë shkelje etike dhe të standardeve të raportimit. Analizimi i raportit të KPM-së, është trajtuar gjerësisht në kapitullin e gjashtë. Më tutje, ndërkaq, brenda këtij kapitulli është trajtuar edhe raporti i Bordit të Drejtorëve të RTK-së, i cili pas gjithë asaj që kishte ndodhur e kishte ftuar në takim menaxhmentin e lartë të këtij mediumi, për të diskutuar për rolin dhe mënyrën e raportimit të RTK-së gjatë trazirave të dhunshme ndëretnike. Duke e përdorur analizën e diskutimit, janë trajtuar në këtë pjesë gjetjet kryesore dhe diskutimet në mes të Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit, prej të cilëve është mësuar më tepër nga një këndvështrim tjetër, për rolin dhe sfidat e RTK-së, pas trazirave. Siç janë analizuar në kapitullin e shtatë të këtij studimi, Bordi dhe Menaxhmenti i kishin rishikuar edhe materialet e trazirave të marsit dhe respektimin e kriterëve profesionale të raportimit.

Në kapitullin e shtatë janë përmbledhur përfundimet e këtij rasti studimor. Në kuadër të këtij kapitulli janë paraqitur rezultatet e nxjerra të hulumtimit shkencor, të cilat kanë dalë nga analiza kritike e shtypit për Trazirat e Marsit 2004. Në këtë pjesë gjithashtu është dhënë përfundimi mbi dyshimet e ngritura nëpërmjet hipotezave, duke paraqitur gjetje konkrete. Shtrirja e përfundimeve është bërë në disa pjesë të cilat identifikojnë pjesë konkrete të studimit. Gjetja e parë te përfundimet e këtij studimi shkencor ka të bëjë me identifikimin e indikatorëve të cilët në forma të ndryshme ndërlidhen me këtë rast studimor, të cilët në formë indirekte kanë kontribuar në nxitjen e trazirave. Në këtë pjesë është bërë analizimi i kontekstit të ngjarjes, ku janë hulumtuar rrethanat politike, ekonomike, sociale, kulturore si dhe roli i faktorit ndërkombëtar, e sidomos i misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Gjithashtu, në kuadër të këtij konteksti janë analizuar raporte të ndryshme ndërkombëtare, rregullore të këtyre institucioneve si dhe roli i tyre në ndërtimin e kapaciteteve të një shoqërie të dalë nga lufta. Po ashtu, në këtë pjesë të përfundimeve janë përfshirë edhe rezultatet konkrete, pasi është bërë analizimi i raportimit të shtypit për periudhën para trazirave, përmes së cilës janë nxjerrë gjetje konkrete për ndikimin apo jo të shtypit në krijimin e një klime të nxitjes së urrejtjes ndëretnike.

Në gjetjen e dytë te përfundimet janë paraqitur rezultate konkrete pas analizimit të tërësishëm të raportimit të shtypit, përgjatë gjithë periudhës së trazirave. Në këtë pjesë janë paraqitur rezultate konkrete për secilën gazetë dhe për rolin që ato kanë pasur gjatë raportimit për këtë ngjarje, ndër më të rëndat në Kosovën e pasluftës, nga e cila kanë mbetur dhjetëra të vrarë dhe mijëra të plagosur. Një pjesë e rëndësishme e analizës kritike është fokusuar fillimisht në ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, ngjarje e cila shënon fillimin e trazirave. Pas këtij rasti, në mënyrë të detajizuar janë paraqitur përfundime të dala nga analizimi për ngjarjet e trazirave të marsit si tërësi. Gjithashtu, brenda kësaj pjese janë prezantuar edhe përfundime konkrete të cilat ndërlidhen me politikat editoriale të shtypit. Një gjetje tjetër tek përfundimet ka dalë nga analizimi i gjuhës së urrejtjes të përdorur nga ana e shtypit, gjetje nga analizimi i përdorimit të fotografisë, si dhe gjetje nga matja kuantitative e hapësirës që mediet e shkruara ia kanë kushtuar ngjarjes së trazirave të marsit. Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli, janë paraqitur rekomandime të dala si rezultat i gjetjeve në këtë hulumtim shkencor. Krejt në fund, është paraqitur lista e gjerë e literaturës së përdorur si dhe aneksi i cili pasqyron tekstet e analizuara.

Metodologjia

Krahas trajtimit teorik, identifikimit të rastit studimor, që një punim shkencor ta arrijë pritshmërinë e tij, duhet ta ndjekë edhe rrugën metodologjike. Pra, metodologjia si shkencë e metodave për çdo fushë të ndryshme të studimeve i analizon dhe i përshtat metodat dhe teknikat e duhura. Studiues të ndryshëm të metodologjisë janë të bindur se shekujt e kaluar shkencën nuk e ka konsideruar si të rëndësishme metodologjinë dhe metodat shkencore, mirëpo sot, një punim shkencor pa metoda dhe teknika empirike nuk mund të ketë përfundime të pritshme. Po e fillojmë këtë pjesë të metodologjisë me një mendim filozofik të filozofit dhe studiuesit Karl Poper, i cili thekson në studimin e tij se të gjitha shkencat natyrore, por edhe sociale nisen gjithmonë nga problemet; nisen, sipas tij nga diçka që ngjall habinë tonë. “Për zgjidhjen e këtyre problemeve shkencat përdorin parimisht të njëjtën metodë që e përdor edhe mendja e shëndoshë njerëzore: Metodën e sprovës dhe gabimit. E shprehur më saktë: Është metoda që harton zgjidhjen me anë të sprovave për problemin tonë dhe që i eliminon pastaj zgjidhjet e pasakta si të gabuara”¹, - thekson Poper, duke shtuar se kjo metodë presupozon se ne do të punojmë me një numër të madh sprovash për zgjidhjen e problemeve.

Studiuesja e metodologjisë Katherine Douson në studimin e saj, thekson se pasi ta keni menduar mirë projektin kërkimor, gjëja e parë që duhet të bëni është të mendohet për metodologjinë e hulumtimit. “Gjëja e parë që duhet të bëni është të mendoni për metodologjinë tuaj kërkimore. Kjo është filozofia ose parimi i përgjithshëm i cili do të udhëheqë hulumtimin tuaj. Kjo është qasja e përgjithshme për të studiuar temën tuaj dhe përfshin çështjet që duhet të mendoni për të tilla, si: kufizimet, dilemat dhe zgjedhjet etike brenda hulumtimit tuaj”² - thuhet në studimin e Dauson, e cila thekson se ndarja e parë e cila duhet të jetë brenda një hulumtimi, është ajo mes kuantitatives dhe kualitatives. Studiuesi britanik Xhudit Bell, në studimin e tij “Si veprohet në një projekt shkencor”, thekson se një projekt shkencor mund të përbëhet prej një game të gjerë metodash, të cilat do të japin të dhënat e plota të kërkuesit për një hulumtim të plotë. “Duhet vendosur së pari për metodat që janë më të mira për synime të posaçme dhe pastaj duhen caktuar mjetet e përshtatshme për mbledhjen e të dhënave”³. Por, çfarë është metodologjia dhe çfarë janë

¹Karl R. Popper “Për filozofinë dhe shkencën”, (Tiranë: Shtëpia Botuese “Fan Noli”, 2009), fq.90

²Catharine Dawson, “Practical Research Methods”, (United Kingdom: Oxford OX4 1RE, 2002), fq.25

³Judith Bell, “Si veprohet në një projekt kërkimor”, (Tiranë: Dudaj, 2008), fq.145

metodat? Studiuesi i sociologjisë Antoni Gidens thekson se metodologjia ka të bëjë me anën e interpretimit logjik, ndërsa metoda ka të bëjë me teknikat faktike. “Metodologjia e studimit ka të bëjë me logjikën e interpretimit të rezultateve dhe analizës së gjetjeve. Metodat e studimit përbëhen nga teknikat faktike të hulumtimit që përdoren për të studiuar botën sociale”.⁴

Pra, sipas studiuesve të metodologjisë, metodat i shërbejnë një punimi shkencor për ta parë, analizuar dhe studiuar nga këndvështrime të ndryshme atë rast studimor. Gjatë këtij punimi të disertacionit të doktoraturës me titull: “Analizë kritike e raportimit të gazetave shqipe për Trazirat e Marsit 2004”, për të arritur deri te rezultatet e hulumtimit shkencor, do të përdoret një metodologji e qartë e punës shkencore, duke u bazuar në disa metoda të cilat do të na ndihmojnë për t’i testuar hipotezat e ngritura brenda punimit. Studiuesit e metodologjisë kanë theksuar gjatë studimeve të tyre për një mozaik të gjerë të metodave të cilat me ndarjet e tyre i përshtaten fushës dhe natyrës së hulumtimit. Prandaj, në këtë punim janë përzgjedhur metodat adekuate të cilat do të ndihmojnë në nxjerrjen e rezultateve të matshme shkencore si: metoda e analizës së përmbajtjes, metoda e sintezës, metoda e abstraksionit, metoda e konkretizimit, metoda e gjeneralizimit, metoda induktive, metoda deduktive, metoda komparative (e krahasimit), metoda historike, metoda statistikore, metoda e studimit të rasteve, metoda deskriptive, metodës së analizës së diskut.

Metoda induktive – Sipas studimeve të metodologjisë, përmes kësaj metode gjatë analizimit të fakteve të veçanta vihet deri në përfundime të përgjithshme. “Induksioni përfaqëson një proces arsyetimi në të cilin kalohet nga faktet e veçanta në përfundime të përgjithshme”.⁵ Sipas studiuesit Lekë Sokoli, induksioni nuk është një arsyetim rigoroz, megjithëse përfaqëson një metodë universale dhe qëndron në themel të gjitha zbulimeve të mendjes.

Metoda deduktive – E cila ka kuptimin e nxjerrjes së përfundimit, bazuar në studimet metodologjike dhe është e kundërta e induktives, është kalimi nga e përgjithshmja në të veçantën. “Deduksioni përfaqëson një metodë studimi e arsyetimi që nisët nga teza, ide ose konkluzione të përgjithshme dhe nxjerr prej tyre ide dhe konkluzione të veçanta. Pra termi deduksion ka të bëjë me një përfundim të nxjerrë nga një mendim i përgjithshëm”⁶ - thekson studiuesi i metodologjisë

⁴Anthony Giddens, “Sociologjia”, (Tiranë: Cabej, 2007), fq.632

⁵Lekë Sokoli, “Metodat e kërkimit”, (Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2011), fq.44

⁶Lekë Sokoli, “Metodat e kërkimit”, (Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2011), fq.45

Sokoli, duke shtuar se kjo metodë përdoret atëherë kur është grumbulluar materiali i pasur faktik, prej të cilit nxirren konkluzione të veçanta.

Metoda e analizës së përmbajtjes – Kjo metodë sipas studiuesit Ali Jakupi, është qasje e kërkimit shkencor dhe e shpjegimit të së vërtetës nëpërmjet zbërthimit të krijimeve mendore të ndërlikuara. “...është qasje e kërkimit shkencor dhe e shpjegimit të së vërtetës nëpërmjet zbërthimit të krijimeve mendore të ndërlikuara (kuptimet, gjykimet, konkluzionet) në elemente më të thjeshta dhe një pjesë përbërëse të çdo veprë kërkimore si dhe pjesëve që kanë ndërlidhshmëri me njëra-tjetrën”.⁷ Ndërkaq studiuesi tjetër i metodologjisë, Xhudit Bell, thekson se sidomos në fushën e medieve, analiza e përmbajtjes është përdorur shumë për t’i analizuar përmbajtjet e lajmeve. “Analiza e përmbajtjes është përdorur për të analizuar paragjykimet në raportimin e lajmeve, në përmbajtjen e gazetave, në shtrirjen e stereotipive seksuale ose raciale në tekstet e librave, në ndryshimet mes këngëve lirike popullore të zezakëve dhe të bardhëve dhe në paragjykimet nacionaliste në tekstet e historisë”.⁸ Ndër të tjera sipas tij, kjo metodë mund të shërbejë edhe për llogaritjen e numrit të herëve që janë përdorur termat të veçantë, burimet e përzgjedhura, numrin e rreshtave që i kushtohet një subjekti në një gazetë apo numrin e fotografive në një botim.

Metoda e sintezës – Sipas studiuesit Sokoli, sinteza përfaqëson përmbledhjen e elementeve të një objekti të studimit. “Ajo shkrin idetë e veçanta në një ide të re, përmbledhëse, përgjithësuese”⁹ - thekson ai, duke shtuar se pa analizë të përmbajtjes nuk mund të ketë sintezë, ndërkaq pa analizë, sinteza nuk do të kishte kuptim.

Metoda e abstraksionit – Sipas studiuesve të metodologjisë, abstraksion do të thotë ndarje kuptimi a një karakteristike, veçorie të asaj që studiohet dhe vëzhgohet, ndërsa lihen anash karakteristikat e tjera, thekson studiuesi i metodologjisë Ali Jakupi. Sipas tij, abstraksioni ka domethënien e ndarjes së qenësore nga joqenësorja.

Metoda e konkretizimit – Kjo metodë është e kundërta e abstraksionit. Sipas Jakupit, është sinteza e të përgjithshmes abstrakte dhe zakonisht përdoret në koordinim me metodën e abstraksionit.

⁷Ali Jakupi, “Metodologjia e punës shkencore kërkimore”, Ligjërata të autorizuara, (Prishtinë, 2005), fq.24

⁸Judith Bell, “Si veprohet në një project kërkimor”, (Tiranë: Dudaj, 2008), fq.159

⁹Lekë Sokoli, “Metodat e kërkimit”, (Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2011), fq.46

Metoda e gjeneralizimit – Për shumë studiues të metodologjisë, kjo metodë përdoret për ta analizuar hulumtimin nga një kuptim i veçantë drejt një shpjegimi të përgjithësuar. “Metoda e gjeneralizimit është qasje e të kuptuarit të përgjithësimit, me çka një kuptim i veçantë vjen deri te përgjithësimi, gjeneralizimi. Në bazë të vrojtimeve të ndara, të veçanta, ekzekutohen, definohen përfundimet (konkluzionet) e përgjithshme...”¹⁰

Metoda komparative (e krahasimit) – Metoda krahasuese është njëra ndër metodat më të rëndësishme në hulumtimet shkencor, ndërkaq sipas studiuesve, me anë të kësaj metode mund të arrihet deri te rezultatet konkrete. “Nëse zgjerohemi në domethënie e kësaj metode mund të kuptojmë se metoda komparative paraqet procedurë të krahasimit të faktorëve, të dukurive, të proceseve dhe raporteve të njëjta ose tepër të ngjashme, për t’i identifikuar ngjashmëritë në mes tyre si dhe diferencat në mes tyre”, - thekson metodologu Jakupi, duke shtuar se përmes kësaj metode, së pari bëhet analizimi i dukurive të njëpasnjëshme, ku së pari vërtetohen veçoritë e përbashkëta, e më pas ato dalluese.

Metoda historike - Sipas studiuesve, kjo metodë shërben për t’i studiuar dukuritë shoqërore sipas zhvillimit të tyre historik, duke filluar nga e kaluara deri tek e tashmja. Sipas metodologëve në këtë metodë kryesisht përdoren tekste, dokumente, mbetje historike për të studiuar ngjarjet dhe idetë e së kaluarës.

Metoda e studimit të rasteve – Kjo është një metodë e veçantë sipas studiuesve të metodologjisë, qasja e së cilës është përcaktimi i rasteve në lëmenj të caktuar kohor. Sipas studiuesit Judith Bell, studimi i rastit të veçuar mund të shërbejë për të identifikuar çështjet kyçe, që meritojnë hetim të mëtejshëm.

Metoda deskriptive - Kjo metodë që ndryshe njihet edhe si metodë përshkruese, e cila, sipas studiuesve, bën përshkrimin e një narracioni, të një lidhjeje të raporteve empirike, por pa trajtim dhe shpjegim shkencor. “Me këtë nënkuptohet se qëllimi elementar i punës shkencore kërkimore është deskripcioni ose përshkrimi i objekteve dhe dukurive që hulumtohen”.¹¹

Hipotezat do të testohen hap pas hapi gjatë hulumtimit të punimit shkencor, ndërsa metodat adekuate të përzgjedhura për këtë punim do të përdoren në kapituj të ndryshëm të punimit dhe në pjesë të ndryshme të rastit studimor.

¹⁰Ali Jakupi, “Metodologjia e punës shkencore kërkimore”, Ligjërata të autorizuara, (Prishtinë, 2005), fq.28

¹¹Po aty, fq.38

Për të arritur deri te rezultatet konkrete shkencore, si dhe për t'i testuar hipotezat e ngritura në këtë rast studimor, punimi do të ndahet në disa kapituj.

Në pjesën e parë të punimit do të jetë hyrja, brenda së cilës gjerësisht do të përshkruhen detajet strukturore të punimit. Kapitulli i dytë do të përfshijë rishikimin e literaturës teorike. Në këtë kapitull do të përfshihen qasjet teorike, teoritë e shtypit dhe të zhanrit. Po ashtu, në këtë kapitull do trajtohen konceptet themelore të shkencave të komunikimit dhe të medieve tradicionale, duke u fokusuar në qasjen kryesore kritike të Shkollës së Frankfurtit.

Në kapitullin e tretë do të trajtohet historia e gazetarisë shqiptare, duke u bazuar në studimet e historisë së medieve në përgjithësi, dokumente dhe artikuj, monografi, etj. Zhvillimi historik i gazetarisë shqiptare do të definohet në këtë pjesë të punimit duke u bazuar në metodën historike, e cila shërben për t'i studiuar dukuritë shoqërore sipas zhvillimit të tyre historik, duke filluar nga e kaluara deri tek e tashmja.

Në kapitullin e katërt i cili përmban rastin studimor, studimi do të jetë më i zgjeruar. Gjatë këtij kapitulli, brenda të cilit do të fillojnë të testohen edhe hipotezat e ngritura, do të përdoren disa metoda për të nxjerrë rezultate sa më të matshme. Në pjesën e parë përmes metodës së studimit të rasteve, do të analizohet gjerësisht konteksti rrethanor i rastit, brenda të cilit do të analizohen zhvillimet e përgjithshme të cilat i paraprinë dhunës ndëretnike. Kjo pjesë do të realizohet duke u mbështetur edhe në metodën induktive, sipas të cilës gjatë analizimit të fakteve të veçanta vihet deri në përfundime të përgjithshme. Gjithashtu në këtë kapitull, në një pjesë të veçantë të studimit do të përdoret metoda deskriptive, e cila do të na ndihmojë në konstruktimin e rrjedhës së ngjarjeve para shpërthimit të konfliktit më të rëndë ndëretnik në Kosovë.

Kapitulli i pestë do të jetë pjesa kryesore e analizës së përgjithshme kritike të raportimit të shtypit në Kosovë, për Trazirat e Marsit 2004. Në këtë kapitull, përmes metodës së analizës së përmbajtjes do të zërthehen kuptimet, gjykimet, konkluzionet brenda raporteve gazetareske, në shtypin ditor, të cilat kanë lidhshmëri të drejtpërdrejtë me Trazirat e Marsit 2004. Pra, duke u bazuar në këtë metodë, do ta testojmë një pjesë të rëndësishme të hipotezës sonë, e cila do të ndihmojë në nxjerrjen e rezultateve konkrete. Në këtë kapitull do të përdoret edhe metoda shkencore e sintezës.

Në kapitullin e gjashtë, duke e futur në përdorim metodën statistikore, do të bëjmë një matje të artikujve, të cilët ndërliken me rastin studimor, për ta pasqyruar nga një këndvështrim tjetër, shtypin dhe hapësirën që i ka dedikuar trazirave të marsit, ku natyrisht duke parë rezultatin

e kësaj metode, do ta shohim shtypin ditor dhe ndërlidhjen e tij me këtë ngjarje. Për secilën gazetë do të ofrohet interpretim grafik i shoqëruar nga interpretimet e gjetjeve.

Më tutje do të bëhet analizë krahasuese në mes shtypit ditor dhe medie vizuale, për të parë nga dy këndvështrime të ndryshme mbulueshmërinë mediale të ngjarjes së dhunshme ndëretnike. Metoda komparative do të na shërbejë për ta identifikuar rolin e shtypit dhe të televizioneve në ngjarjet e marsit, agjendat e tyre redaksionale, respektimin e standardeve profesionale dhe varësinë e këtyre medie ndaj njëra-tjetrës. Sipas metodës së analizës së diskut, do të analizohen raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të dala pas ngjarjes së dhunshme të marsit. Në këtë pjesë të studimit do të analizohet raporti i RTK-së, raporti i KPM-së dhe ai i OSBE-së, si dhe do të analizohen masat administrative të ndërmarra ndaj medie.

Në fund do të paraqiten përfundimet e dala nga rasti studimor dhe rekomandimet, duke u bazuar edhe në metodën e gjeneralizimit.

Hipotezat

Hipoteza apo paramendimi i temës siç e quajnë disa autorë, është hapi i parë i një hulumtimi shkencor. Me anë të hipotezave paraqitet një paragjykim, supozim për një çështje apo fenomen i cili ende nuk ka marr përgjigje shkencore, theksojnë shumë studiues të cilët i kanë dhënë idetë e tyre për hipotezat apo siç e quan studiuesi Xhudit Bell, një premisë të pasigurt. “Një premisë e pasigurt është subjekt i vërtetimit nëpërmjet hulumtimit të mëvonshëm. Ajo mund të shikohet edhe si një udhëzues për hulumtuesin, përderisa e paraqet dhe e përshkruan metodën që duhet ndjekur për studimin e problemit”¹², thekson Bell, duke shtuar se në shumë raste hipotezat janë dyshime që ka hulumtuesi mbi ekzistencën e lidhjeve midis ndryshoreve. Pra, nëpërmjet hipotezave të ngritura të supozuara, fillon procesi i një hulumtimi kërkimor për t’i testuar ato dhe për të nxjerrë një përgjigje adekuate shkencore. Prandaj, brenda këtij punimi të disertacionit me titull: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”, nisur nga paragjykimet, supozimet apo siç dëshiron ta quajë Gidensi, hamendjen, do ta paraqesim një hipotezë kryesore dhe dy hipoteza tjera, të cilat do të testohen gjatë këtij hulumtimi shkencor. Marr parasysht trazirat e dhunshme ndëretnike të marsit 2004, numrin e madh të viktimave dhe të plagosurve, rrezikimin

¹²Judith Bell, “Si veprohet në një projekt kërkimor”, (Tiranë: Dudaj, 2008), fq.52

e përgjithshëm të sigurisë nacionale dhe mënyrës së raportimit të shtypit për këtë ngjarje, të cilësuar si më të rëndën në Kosovën e pasluftës, hipoteza kryesore e punimit do të jetë:

I. *Hipoteza kryesore* – Mediet shqipe në Kosovë, gjatë raportimit të tyre kanë ndikuar drejtpërdrejt në nxitjen e trazirave të marsit 2004. Si të tilla, ato kanë përgjegjësi në eskalimin e situatës.

II. *Hipoteza e dytë* – Raportimi i medieve të shkruara shqipe në Kosovë, lidhur me ngjarjet e marsit 2004, nuk ka qenë raportim profesional dhe si i tillë mund të vlerësohet si njëri prej faktorëve në tensionimin e raporteve ndëretnike.

III. *Hipoteza e tretë* – Politikat editoriale të medieve nuk kanë qenë në përputhje me interesat e publikut dhe si rezultat i këtyre politikave ka pasur edhe shkelje të standardeve profesionale.

Gjatë trajtimit të këtij studimi të disertacionit të doktoraturës, duke u bazuar në aspektin teorik, metodologjik dhe hulumtues, do t'i testojmë të tri hipotezat e ngritura, duke nxjerrë veç e veç për secilën përgjigje shkencore.

Objektivat

Brenda këtij studimi të disertacionit të doktoraturës, qëllimet apo objektivat kryesore do të jenë vërtetimi apo testimi i hipotezave të ngritura brenda këtij punimi. Për t'i arritur këto synime do të bazohemi në sfondin teorik, metodologjik dhe hulumtues të rastit studimor. Përmes këtij disertacioni shkencor me titull: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”, do të jepet përgjigje shkencore për rolin dhe përfshirjen e shtypit në këtë ngjarje të rëndë ndëretnike dhe ndikimit të tij në nxitjen e trazirave.

Rezultati i këtij punimi do të kishte një interes të madh në fushën e gazetarisë për studiuesit e rinj të kësaj fushe. Po ashtu, gjetjet në këtë punim do të kontribuojnë që gazetarët dhe studiuesit e rinj të mësojnë më tepër për rolin e medieve në Trazirat e Marsit të vitit 2004, si dhe për trajtimin sa më profesional të llojit të këtyre ngjarjeve në të ardhmen, mbulueshmëria e të cilave vazhdimisht ka qenë dhe mbetet sfidë për mediet në përgjithësi. E vërteta e këtyre ngjarjeve do të kishte impakt edhe te publiku sepse deri më tani, përveçse nuk është thënë e vërteta për ngjarjen më të rëndë ndëretnike, ajo ende mbetet e papërfunduar edhe në aspektin e drejtësisë. Punimet e tilla shkencore kanë një rëndësi të veçantë të trajtimit, sepse të gjeturat shkencore ndihmojnë në krijimin e

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

përvojave dhe mësimëve të reja në fushën e raportimit, por, edhe ndikojnë në rritjen e demokracisë, sigurisë nacionale dhe forcimit të demokracisë në vend. Gjetjet brenda këtij punimi shkencor, po ashtu do t'i çlirojnë mediet nga faji i përgjegjesisë, i cili u është hedhur atyre nga raporte të ndryshme ndërkombëtare.

KAPITULLI I

1. SFONDI TEORIK

1.1 SHKENCA DHE QASJET TEORIKE TË MEDIEVE

Pothuajse në gjitha fushat e studimeve, shkenca përmes teorive të saj ka arritur t'i japë përgjigje shumë fenomeneve dhe preokupimeve sociale. Megjithatë, shumë nga to me kalimin e viteve kanë arritur të zhvillohen më tutje, të plotësohen, mirëpo në mesin e tyre ka pasur edhe mendime shkencore të cilat kanë qenë jashtë praktikave kohore. Zhvillime të tilla shkencore kanë ndodhur edhe në fushën e studimit të medieve dhe komunikimit, mirëpo zanafilla e gjitha këtyre lidhet nga shumë faktorë, por më kryesori mbetet ai sociologjik.

Por, çfarë është shkenca dhe cili është synimi i saj?

Njëri nga mendimtarët dhe filozofët më të mirë të shekullit të kaluar Karl Popper, thekson se shkenca është një sistem, produkt i ideve njerëzore, e cila u krijua nëpërmjet shpikjes së diskutimit kritik. Sipas tij, shkenca lidhet me skemën tre-shkallësh e cila është e zbatuar në shkencë. “Shkalla e parë e skemës sonë është problemi. Problemi lind kur shfaqet ndonjë çrregullim...; shkalla e dytë e skemës tonë janë sprovat e zgjidhjes, pra prova për ta zgjidhur problemin...; shkalla e tretë është eliminimi, pra është mohuese: eliminimi është në thelb, eliminimi i gabimeve...”.¹³ Prandaj, sipas Popperit, logjika e shkencës apo shkenca si sistem i dijes, gjithmonë nisat aty nga ku shfaqet një problem, i cili e vë në sprovë shkencën apo teorinë e shkencës dhe eliminimit duke ardhur drejt një zgjidhjeje apo përfundimi.

Në kuadër të këtyre skemave të shkencës apo teorisë së shkencës veprojnë edhe teoritë apo qasjet të cilat merren me studimin e medieve. Gjatë kësaj pjese teorike do të fokusohemi në disa qasje të ndryshme teorike të medieve, të ndara sipas qasjeve kanonike. Pra, do të paraqesim qasje të ndryshme nga shkolla e Çikagos, Kolumbias, Torontos, mirëpo fokusi kryesor do të mbetet te Shkolla e Frankfurtit dhe qasjen e saj kritike-kulturore, një qasje e cila mbetet më e përafërt me natyrën e hulumtimit të rastit studimor.

¹³Karl R. Popper “Për filozofinë dhe shkencën”, (Tiranë: Shtëpia Botuese “Fan Noli”, 2009), fq.91-92

1.2 Teoria kritike-kulturore e medieve

Shumica e studiuesve teorinë kritike-kulturore e ndërlidhin me Shkollën e Frankfurtit të viteve '30-të, të shekullit të kaluar. Sipas tyre, i pari i cili kishte hedhur idenë e një qasjeje kritike përmes një eseje të botuar ishte Maks Horkhajmer, i cili kishte paraqitur nevojën e ndryshimit të dijes. Në vitin 1937, Horkhajmer botoi një ese të famshme të titulluar: “Teoria tradicionale dhe kritike”¹⁴, në të cilën përshkroi një ndryshim të nevojshëm në kërkimin shkencor të dijes. Në një studim të përbashkët, Littlejohn dhe Fos, theksuan se njëri nga themeluesit e Shkollës së Frankfurtit, Maks Horkhajmer, iu kishte bërë thirrje kolegëve të tij që t’i bashkojnë energjitë e teorisë së re, duke përdorur teorinë marksiste, por jo ortodokse dhe ideologjike, e cila tani njihet si neo-marksizëm. Pra, në bazë të kësaj, mendimi i qartë i themeluesve të këtij mendimi të ri shkencor ishte adaptimi i ideve filozofike të Karl Marksit, duke mos lejuar që brenda teorisë së tyre të re të përfshihen mendime politike dhe ideologjike të Marksit.

Studiuesi Xhozef Domenik, duke e analizuar qasjen kritike të Shkollës së Frankfurtit, thekson se themelet e saj u vendosën nga filozofia e Karl Marksit, por jo nga sistemi programor politik. “Anëtarët e Shkollës së Frankfurtit i shtrinë analizat e Marksit në jetën kulturore të shoqërisë. Ata vunë në dukje se pikërisht kur firmat e mëdha kontrollojnë prodhimin e të mirave materiale, kompani të tjera të mëdha kontrollojnë prodhimin e të mirave kulturore”,¹⁵ thekson ky studiues duke shtuar se në këtë kontekst, industria e radios, studiot e filmave, botuesit e gazetave e revistave dhe më vonë biznesi i televizionit, të gjitha përshtaten me modelin kapitalist brenda prodhimeve mediale. Prandaj, parë nga ky këndvështrim i tyre teorik, shqetësimi kryesor i këtyre studiuesve mbetet kapitalizmi, me ç’rast një grup i vogël i njerëzve të cilët i kontrollojnë industrinë e mëdha në këtë modernizëm të ri, e kanë zhvendosur nga tradicionalja edhe kulturën, duke ngritur një kulturë jashtë një sistemi të vlerave. Shqetësim tjetër i tyre mbetet edhe kontrollimi i tërësishëm i shtypit dhe medieve në përgjithësi dhe vendosja e tij në shërbim të tyre.

Pavarësisht që idenë themelore anëtarët e Shkollës së Frankfurtit e kishin bazuar në teorinë e Marksit, sipas Littlejohn dhe Fos, teoria e këtyre intelektualëve të rinj ishte zhvilluar në

¹⁴Stephan W Littlejohn & Foss A. Karen, “Encyclopedia of communication theory”, (Londër: SAGE, 2009), fq.237

¹⁵Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET Press 2010), fq.89

dimensionet e sociologjisë dhe psikanalizës nga ana e studiuesit Erik From. Ndërkaq, një grup studiuesish të teksteve kanonike, duke analizuar teorinë kritike të ndërtuar nga pjesëtarët e Shkollës së Frankfurtit, kryesisht emigrantë të ikur në ShBA, theksuan se Horkhajmer dhe Adorno, dy liderë të kësaj shkolle kthyen teorinë Marksiste me kokë poshtë. “Duke hedhur poshtë idenë e kulturës popullore si një refleksion të thjeshtë mbi bazën ekonomike të shoqërisë, ata e perceptuan kulturën amerikane si një industri me një linjë montimi për prodhimin e mesazheve të ndërgjegjes së rreme”.¹⁶ Këta themelues të teorisë kritike i kushtuan rëndësi të madhe aspektit kulturor, e sidomos kritikës kapitaliste e cila sipas tyre prodhon dhe kontrollon identitete kulturore të rreme. Autorët e kësaj teorie ishin kritik edhe në raport me mediet, të cilat përmes produkteve mediale po e zhvendosnin kulturën nga shtrati tradicional drejt një degradimi dhe krijimi të një modeli të rrejshëm të individit.

Dy studiuesit kryesorë të këtij drejtimi, Maks Horkhajmer dhe Teodor Adorno në studimin e tyre “Industria e kulturës - Iluminizmi si mashtrim masiv”, theksuan se ideja sociologjike, sipas të cilës humbja e besimit fetar objektiv, dhe shpërbërja e mbeturinave të fundit parakapitaliste si dhe diferencimi shoqëror e kanë çuar kulturën drejt një kaosi. “Kultura vulos gjithçka me të njëjtën monedhë sot, ku filmi, radioja, revistat përbëjnë pjesët e të njëjtit sistem”,¹⁷ kanë theksuar Horkhajmer dhe Adorno, sipas të cilëve, tashmë çdo kulturë masive po shndërrohet në monopol; madje as kinemaja dhe radioja më nuk mund të shiten si art, sepse në kapitalizëm çdo gjë ka kaluar në biznes. Kritika kryesore e tyre brenda këtij studimi qëndron në faktin se me kapitalizmin, korporatat dhe individët janë ata të cilët e kontrollojnë çdo sferë publike, duke përfshirë këtu edhe atë kulturore, produktet mediale, si dhe: teatrin, muzikën, artin, revistat, radion, filmat, televizionet, gazetat. Sipas Horkhajmer dhe Adornos, kontrolli nga brendësia e çdo përmbajtjeje të ndërtuar përmes mashtrimit masiv, ka sjellë në botën kapitaliste vetëm përfitime materiale dhe kontrollim e mashtrim të masës. “Gjithçka që del në publik, kësajoh është vulosur tejprtej nga ky pushtet, saqë asgjë e re nuk mund të ofrohet e cila paraprakisht të mos bartë brenda saj gjurmën e zhargonit dhe që të mos miratohet në shikim të parë”.¹⁸ Pra, sipas kësaj qasje teorike kritike të Shkollës së Frankfurtit, kapitalizmi e kishte futur nën kontroll të gjithë industrinë e kulturës dhe përmes këtij kontrolli të përgjithshëm masiv, ka vënë në shërbim të promovimit kapitalizmin si

¹⁶Elihu Katz, Xhon Durham Peters, Tamar Leibes dhe Avril Orloff, “Tekste kanonike të kërkimit në media”, (Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2009), fq.99

¹⁷Max Horkheimer dhe Theodor W. Adorno “Dialektika dhe Iluminizmi”, (Tiranë: ISP&DRITA, 2000), fq.196

¹⁸Po aty, fq.207-208

koncept. Këta dy studiues duke u bazuar në dialektikën e tyre e argumentojnë iluminizmin i cili ka arritur t'i fusë nën kontroll të gjitha fushat që ndërlidhen me kulturën e masës, duke arritur ta tjetërsojë një shoqëri të tërë, duke e zhbërë dhe tjetërsuar edhe mënyrën e mendimit të çdo individi. “Në industrinë e kulturës individi ushqen iluzione dhe jo thjesht për shkak të standardizimit të mënyrës së prodhimit. Ky individ tolerohet pasi identiteti i tij fund e krye përkon me të përgjithshmen”¹⁹. Pra, tjetërsimi i individit apo shpërlaja e trurit ndodh si rezultat i ndikimit të masmediave tek ai, kontrollimit të të gjitha produkteve mediale dhe kontrollimit të vet medieve përmes grupeve të ndryshme kapitaliste.

Në lidhje me këtë çështje, në studimin e tyre Daglas M. Kellner dhe Menakshi Gigi Duram, theksojnë se industria e kulturës nuk është asgjë tjetër veçse ideologji që përdoret për t'i legjitimuar gjepurat e tyre. “Ata e quajnë veten industri dhe shifrat e publikuara për të ardhurat e drejtuesve të tyre hedhin dyshime rreth domosdoshmërisë sociale të produkteve të tyre të gatshme. Grupet e interesuara duan të shpjegojnë industrinë e kulturës në aspektin teknologjik”.²⁰ Ndërkaq sipas studiuesit Eric Meigret, themeluesit e Shkollës së Frankfurtit, Horkhajmer dhe Adorno, përveç krijimit e zhvillimit të teorisë kritike dhe estetike në përgjithësi, sipas tij, ata arritën që t'i bëjnë të aplikueshme mendimet e tyre teorike e filozofike edhe në fushën e studimeve për mediet. “Nga ky këndvështrim, Teoria Kritike e zbatuar nga Horkhajmer dhe Adorno nuk paraqet interes për saktësinë e saj por për faktin që ajo sistemon dhe radikalizon kritikën ndaj asaj që shpesh perceptohet si një kulturë e degraduar dhe degraduese...”.²¹

Pas këtyre dy kokave të teorisë kritike, Shkolla e Frankfurtit vazhdoi me qasjen e njëjtë kritike edhe nga pasardhësit e tyre, Benjamin, Fromin, Markiz, etj. të cilët zhvilluan edhe më tutje këtë qasje teorike. Sipas studiuesve, në dekadat e ardhshme, pas Horkhajmer dhe Adornos, kjo teori gjeti mbështetje edhe në Angli nga studiues të asaj periudhe, ndërsa nga vitet '70-ta, edhe në ShBA. Teoria kritike-kulturore sot ka një rol të rëndësishëm në trajtimin e problemeve që shfaqen në fushën e gazetarisë dhe të komunikimit masiv. Aplikimi i kësaj teorie në këto fusha ka ndikuar dhe ndihmon në trajtimin e fenomeneve dhe problemeve të kulturës masive. Krahas zhvillimit të teorisë kritike, studiues dhe teoricien të tjerë, kryesisht amerikanë, të cilët në fillim kishin dyshime në metodologjinë dhe rezultatin e kritikëve të Shkollës së Frankfurtit, sidomos në të gjeturat në

¹⁹Max Horkheimer dhe Theodor W. Adorno “Dialektika dhe Iluminizmi”, (Tiranë: ISP&DRITA, 2000), fq 245

²⁰Douglas M. Kellner dhe Meenakshi Gigi Durham, “Media and Cultural Studies”, (USA: Blackwell Publishing Ltd, 2001), fq.41

²¹Eric Maigret, “Sociologjia e komunikimit dhe e mediave”, (Tiranë: UET/Press & Papyrusi, 2010), fq.73

fushën dhe kulturën e masës, filluan të bëjnë matje empirike për t'i testuar rezultatet apo përfundimet e kësaj fryme kritike. “Kjo traditë e përfshirë më herët në debatet në lidhjen me marrëdhëniet midis ‘komunikimit masiv’ dhe ‘shoqërisë masive’, por këto shqetësime të “Shkollës së Frankfurtit” ishin përpunuar tërësisht nga metodologjitë e hulumtimit empirik amerikan të një lloji kryesisht sasior, bazuar në metodën e vëzhgimit të audiencës, analizës sasiore të përmbajtjes”,²² ku gjetjet e tyre konstatuan se mediumi është një forcë e madhe kulturore dhe ideologjike.

Edhe studiuesit britanikë të Birmingemit përmes Qendrës për Studime Kulturore Bashkëkohore, konstatuan se mediet janë të prira të prodhojnë fushën e ideologjisë dhe strukturën e saj të dominimit. Drejtuesi i kësaj Qendre, Stjuart Hall, të cilin teoricieni Eric Meigret në studimin e tij e quan Marksizmi i ri, kishte theksuar në studimin e tij se bota e medieve që varet nga klasa drejtuese është jehonë e çarjeve të brendshme dhe për më tepër zotëron autonominë e saj të funksionimit. “Hall kreu revolucion teorik që pritej në gjirin e marksizmit britanik. Ai pranon idenë se dominimi kapitalist kalon njëkohësisht nëpërmjet punës dhe kulturës si e vë në dukje ideologjia gjermane dhe se ideologjia e dominuesve tejçohet nëpërmjet edukimit dhe medieve, me anë të universit të shenjave, gjë që e ka kuptuar mirë semiotika e Barthes-it dhe Eco-s”.²³

1.3 Zanafilla e shtypit dhe qasjet teorike

Mediet në përgjithësi dhe ato të shkruarat si më të vjetrat në veçanti, kanë qenë përcaktuese dhe determinuese të zhvillimeve të gazetarisë së shkruar, nga fillet e para e deri te një konsolidim bashkëkohor. Mirëpo, sipas studiuesve gazetaria dhe shtypi kanë kaluar nëpër faza të ndryshme të historisë, duke qenë gjithnjë të ndërvarura me zhvillimet politike dhe ideologjitë politike, sidomos gjatë shek. XVII, menjëherë pas daljes së gazetës së parë në Boston, në vitin 1690, botues e së cilës ishte Benjamin Harris. Në shumicën e rasteve politika me ideologjitë e saj kanë vënë kontroll të plotë mbi shtypin përmes censurimeve të ndryshme, por, kur politika ka qenë më liberale, i tillë ka qenë edhe shtypi, i cili ka vepruar si i lirë, pluralist dhe në shërbim të publikut. Para se të doktrinoheshin katër teoritë e shtypit të cilat edhe sot janë pikë reference, shtypi pati ngritje dhe

²²Stuart Hall, Dorothy Hobson, Andrew Lowy and Paul Willis “Cultura, Media, Language”, (Londër: Taylor & Francis, 2005), fq.104

²³ Eric Maigret, “Sociologjia e komunikimit dhe e mediave”, (Tiranë: UET/Press & Papyrusi, 2010), fq.169

rënie të ndryshme në zanafillën e tij, kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britaninë e Madhe, në të cilat shtypi kishte vënë themelet e tij.

Teoricieni Xhozef R. Domenik, duke folur për shtypin, siç e cilëson ai në Amerikën e vjetër, flet për veçoritë dhe sfidat që ishin shfaqur që në fillimin e gazetave të para. “Ishin pak gazeta, botuesit dhe drejtuesit e postave realizuan shumicën e botimeve të hershme, lajmi nuk ishte aq koherent në kohë sa sot, ideja e shtypit të lirë nuk favorizohej prej autoriteteve koloniale”.²⁴ Pra, po flasim për një periudhë në të cilën nuk ekzistonin norma juridike që do ta garantonin dhe rregullonin mënyrën e funksionimit të shtypit, kjo është një periudhë në të cilën standardet profesionale nuk ekzistonin siç janë sot, por bëhet fjalë për një shtyp i cili po i vendoste themelet e tij. Shtypi apo gazetat sipas Domenik, në filllet e tij mund të mbyllej vetëm pas një numri të publikuar, në qoftë se ai nuk vlerësohej nga autoritetet koloniale dhe nuk e kishte bekimin dhe autorizimin mbretëror. Prandaj, sipas tij, në këtë fazë të zhvillimit të shtypit as që mund të diskutohej për një shtyp të lirë, të mbrojtur me dispozita ligjore. Përplasjet mes kolonive dhe botuesve, siç thekson ky studiues, e kishin sjellë shtypin deri në pikat kritike të mbylljes dhe të burgosjeve të botuesve, në qoftë se ata nuk ishin brenda hierarkisë së tyre, deri sa nuk kishte shpërthyer revolucioni. Prandaj, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), pakënaqësia e kolonive me shtypin kishte arritur në një pikë kritike saqë ishin të padurueshme njëra me tjetrën.

Sipas teorisë së Domenik, fitorja e Revolucionit i kishte vetëdijësuar kolonialistët se pa një shtyp të lirë nuk do të ketë as gazeta të shkruara e të mirëfillta. Prandaj, përkundër kundërshtimeve të antikolonialistëve, Kongresi Amerikan në amendamentin e tij të parë, siç e thekson ky studim, kishte futur brenda Kushtetutës, lirinë e shprehjes. “Amendamenti i Parë urdhëronte që: ‘Kongresi nuk do të hartojë asnjë ligj... që kufizon të drejtën e fjalës ose shtypit’. Megjithatë, ideja e një shtypi të lirë që doli në sipërfaqe gjatë Luftës Revolucionare, u bë pjesë e ligjit të kombit të ri kur Kongresi e ratifikoi amendamentin në vitin 1791”.²⁵ Vendosja e këtij amendamenti në Kushtetutën e ShBA-ve, kishte ndikuar në shekujt në vazhdim që shtypi përgjithmonë të shkëputej fillimisht nga hierarkia kolonialiste e më pas edhe nga pushtetet dominuese në vazhdim. Shtypi në ShBA dhe liria e garantuar e medieve u bë themel fundamental dhe model i zhvillimit të tij në shekujt e ardhshëm. Pas këtij amendamenti kushtetues, arsimimit të masës apo mësim-leximit dhe krijimit

²⁴Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET press, 2010), fq 144

²⁵ Po aty, fq.146

të shtypit të qindarkës, shtypi sipas historianëve të medias u fuqizua dhe kaloi në një stad tjetër të zhvillimit. Pra, çlirimi i ShBA-ve, deklarimi i Pavarësisë së tyre përfundimisht nga Britania i kishte shtyrë politikanët dhe intelektualët e asaj kohe që të mendojnë për një gjë kaq fundamentale në demokracitë liberale, atë të lirisë së shtypit dhe lirisë së shprehjes. Natyrisht, garantimi i këtyre dy gjërave kaq sublime, përveçqë e ka krijuar një standard, ka ndihmuar edhe në formësimin e një demokracie me vlera dhe shembuj për kombet tjera.

Edhe Evropa, gjegjësisht ishulli britanik po ballafaqohej me problemet e shtypit. Xhejms Karan, në studimin e tij të sociologjisë së shtypit, ngriti dy qasje kontradiktore, të konfrontuara mes tyre: atë liberale dhe radikale apo agjent që vepron “nga poshtë lart” dhe “nga lart poshtë”. “Sipas ortodoksisë liberale shtypi në kapitalizëm është institucion autonom i cili ‘pushtetëzon’ popullin. Ky botëkuptim optimist gjendet në vetë zemrën e historisë konvencionale liberale të shtypit”.²⁶ Pra, sipas këtij autori, në këtë qasje shtypi duhet të jetë i lirë dhe në shërbim të popullit, duke anashkaluar ndikimet dhe ndërhyrjet e pushtetit. Ndërkaq, sa i përket qasjes radikale, e cila ishte kundërta e liberales, Karan thekson se mediet dhe shtypi janë të kontrolluara, madje ato kanë kontroll shumëpalësh. “Këto prognoza, kritikët i hedhin poshtë si naive. Sipas këtij këndvështrimi alternativ, edhe qasja liberale e edhe ajo post-moderne mbitheksojnë fuqinë e faktorit njerëzor, sepse nuk arrijnë të shpjegojnë mënyrën si është strukturuar zgjedhja personale e konsumatorit nën ndikimin e formateve standarde, normave organizative dhe lojërave të fuqisë”.²⁷ Prandaj nga ky këndvështrim, fuqinë e pronarit e plotësojnë reklamuesit dhe shteti kapitalist.

1.3.1 Teoria autoritare

Pas shumë dekadave të konsolidimit të shtypit dhe ndryshimeve politike, teoricienët e medieve të shkruara kanë ardhur në përfundim të katër teorive kryesore të cilat ndërlihen kryesisht me ideologjitë dhe sistemet politike. Teoricienë dhe filozofë, që nga shek. XVI janë munduar t’i përshkruajnë raportet në mes pushtetit dhe medias, duke përmbledhur krejt në fund katër prej tyre si më të rëndësishmet: teoria autoritare, teoria liberale, teoria e përgjegjësisë sociale dhe teoria sovjetike komuniste. Këto katër teori të shtypit kanë dominuar gjatë gjithë këtyre

²⁶James Curran, “Sociologjia e shtypit”, Revista kërkimore “MEDIA”, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009), fq.9

²⁷Po aty, fq.12

dekadave, dhe natyrisht, që dominimi i njërës apo tjetrës është ndërlidhur gjithnjë në bazë të zhvillimit politik, kryesisht të sistemeve të cilat i kanë imponuar vendet me ndikim apo këto qasje teorike kanë gjetur përshtatje në ideologjitë e ndryshme politike. Përderisa bota perëndimore ka zgjedhur problemin e shtypit, duke i garantuar atij liri dhe veprime të pavarura, shtypi nuk ka qenë i tillë shekuj me radhë.

Ndërsa, krejt ndryshe këto qasje shihen kryesisht në ish-vendet komuniste, diktatoriale dhe monarkike. Këto qasje të shtypit, siç mund të studiohen në faza të ndryshme të historisë së medieeve, e kanë brenda tyre shtrirjen gjeografike të veprimit. Në mesin e shekullit të kaluar teoricienët Fred Sibert, Teodor Peterson and Uilber Shram, krijuan katër teori të shtypit të cilat sipas tyre kanë dominuar në botë për vite me radhë. Sipas tyre, dyqind vite pas krijimit të shtypit në botën perëndimore, dominues ishte shtypi i qasjes autoritare. “Për pothuajse dyqind vjet pas përhapjes së shtypit në botën perëndimore, teoria autoritare dha bazën ekskluzive për përcaktimin e funksionit dhe marrëdhënieve të shtypit popullor me shoqërinë bashkëkohore... në të vërtetë, praktikisht, e gjithë Evropa Perëndimore ... përdori parimet themelore të autoritarizmit si themelin teorik për sistemet e tyre të kontrollit të shtypit”.²⁸ Pra, sipas këtyre teoricienëve, shtypi përmes qasjes autoritare ishte i kontrolluar nga pushteti dhe rrjedhimisht ishte nën ndikimin, censurimin dhe kontrollimin e plotë të politikave editoriale. Brenda kësaj qasje, pothuajse elementi më i theksuar ka qenë vendosja e politikave editoriale në shërbim të pushtetit dhe përmes kësaj, në krijimin e deformuar të opinionit publik, përmes propagandës së tij. Shtypi, për nga mënyra e funksionimit është vendosur sipas hierarkisë nga lart-poshtë, kanë theksuar më tutje ky grup i studiuesve të medias, duke shtuar se është dashur të kalohet kohë e gjatë dhe përpjekje të mëdha qytetare për të arritur deri në ndonjë ndryshim pozitiv, që nënkupton krijimin e mekanizmave për një shtyp të lirë e liberal. “Kështu që e vërteta u mendua të ishte e përqendruar afër qendrës së pushtetit. Shtypi funksiononte nga lart poshtë”.²⁹ Pra, gjithçka që është shkruar, temat të cilat janë zgjedhur, agjendat editoriale, të gjitha e kanë pasur një kontroll të plotë dhe të mbikëqyrur nga organet e pushtetit.

Ndërkaq teoricieni Xhozef R. Domenik, në studimin e tij për teorinë e shtypit, shkon edhe më tej duke shtuar se, megjithatë shtypi është gjendur kryesisht në mes të dy qasjeve të cilat kanë

²⁸Fred Siebert, Peterson Theodore dhe Schramm Wilbur “Four theories of the press”, (Chicago: University of Illinois Press, 1956), fq 9

²⁹Po aty, fq.2

qenë të pozicionuara në dy ekstreme të kundërta; e para që ndërlidhet, sipas tij, me masën e kontrollit të qeverisë mbi mediet, dhe e dyta që shkon në ekstremin tjetër, atë të qasjes liberale apo medie të lira. “Në sistemin autoritarist, mendimi mbizotërues ishte se elita drejtuese duhet të drejtojë masat, aftësitë intelektuale e të cilave vlerësoheshin pak. Mospajtimi dhe kritika publike konsideroheshin të dëmshme si ndaj qeverisë, ashtu edhe ndaj njerëzve dhe nuk toleroheshin”.³⁰ Sipas qasjes autoritare pushtetet përdornin forma të ndryshme politike për t’ia arritur që t’i ndalnin, censuronin dhe t’i kontrollonin informacionet para se ato të bëhen publike.

Pra, qasja autoritare ndaj shtypit ka qenë e baraspeshuar me pushtetin politik të atyre vendeve në të cilat sistemi qeverisës ka qenë autoritar, me ç’rast pushteti krahas kontrollimit të përgjithshëm të sistemit, i ka kontrolluar dhe censuruar edhe mediet duke i vënë ato në shërbim të interesave dhe politikave të tyre. Në këtë formë, ku shtypi ka qenë i censuruar, sipas teoricienëve publiku ka qenë i manipuluar me informacionet e marra nga shtypi. Pra, qasja teorike autoritare si e tillë, sot, nuk është e pranuar në botën demokratike e as në Kosovë, dhe ka shërbyer e shërben për të krijuar rehatinë e pushteteve të cilat, sot, bota moderne i sheh dhe kryesisht i vlerëson si sisteme diktatoriale, të cilat në opinionin publik i plasojnë vetëm idetë e tyre, qofshin edhe të gabuara. Pra, ky sistem qeverisës, duke kontrolluar politikën editoriale, ka instaluar apo vendosur agjendat e tyre dhe i ka mbyllur apo censuruar të gjitha ato medime të cilat do të frymonin ndryshe, apo do të synonin që të nxisnin gjykim kritik të publiku.

1.3.2 Teoria liberale

Qasja liberale është e kundërta e qasjes autoritare, këtu shtypi dhe mediet janë të lira nga kontrolli i pushtetit, apo nga sistemi politik. Sipas kësaj qasje, shtypi duhet të jetë i lirë dhe pluralist, me ç’rast publiku mund të përzgjedhë informacionet, duke u bazuar në konkurrencën e tregut të lirë të informacionit. Kjo qasje i garanton shtypit liri të plotë të garantuar dhe të mbrojtur me norma kushtetuese, duke heq dorë nga censura dhe kontrolli ndaj botuesve dhe kryeredaktorëve. Grupi i studiuesve të cilët identifikuan dhe formësuan një qasje të tillë si: Fred Sibert, Teodor Peterson dhe Uilber Shram, theksojnë në përfundimet e tyre se njeriu nuk duhet të konsiderohej si qenie e varur që udhëhiqet e drejtohet, por të krijohen mundësi që vetë ai të dallojë,

³⁰Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET Press 2010), fq. 629

të gjykojë dhe të kuptojë të vërtetën nga gënjeshtër. “Teoria liberale e kundërshton pozicionin relativ të njeriut dhe të shtetit siç e pamë në teorinë autoritare. Njeriu nuk konsiderohet si një qenie e varur që të udhëhiqet dhe drejtohet por më tepër si racionale që mund të dallojë midis të vërtetës dhe gënjeshtërës, midis një alternative më të mirë dhe një tjetër më të keqe, kur ballafaqohet me prova kontradiktore dhe zgjedhje alternative”.³¹

Kjo qasje që sot është dominuese në vendet demokratike, ka ndikuar që pesha e shtypit të ndikojë në agjendat politike të pushteteve demokratike, të cilat janë në dobi të qytetarëve. Në kuptimin e plotë, mund të konsiderojmë se sot shtypi liberal është njëra nga shtyllat kryesore të një informimi të drejtë dhe të ruajtjes së demokracisë qytetare. Pra, për dallim nga qasja autoritare, ku shtypi konsiderohej si një vegël e zgjatur e pushtetit, te qasja liberale shtypi është opozita kryesore e pushtetit dhe aleat i publikut. Edhe teoricieni Xhejms Karan, në teorinë e tij të qasjes liberale ka theksuar se vetëm duke qenë shtypi i lirë, ai në të njëjtën kohë do të bëhet edhe i pavarur. “Vetëm duke ancoruar median në tregun e lirë në këtë këndvështrim është e mundur të sigurohet pavarësia e plotë e medias nga qeveria”.³² Ndërsa Domenik, vazhdon edhe më tutje duke i dhënë rendësi të theksuar kontekstit human të individit, ndaj të cilit është në shërbim pushteti dhe shtypi i lirë. “Teoria liberaliste është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me autoritarizmin. Liberalistët mendojnë se qeniet njerëzore janë me arsye dhe të afta të marrin vetë vendime dhe se qeveritë ekzistojnë për t’i shërbyer individët. Liberalistët mendojnë se një qytetar i thjeshtë ka të drejtë t’i dëgjojë të gjitha anët e një çështje në mënyrë që të dallojë të vërtetën nga e gabuara”.³³

Sot, nuk mund të imagjinohet që në vendet të cilat kanë sistem demokratik të qeverisjes, shtypi dhe fjala e lirë të jenë të censuruara. Në këto sisteme qeverisjeje janë krijuar mekanizma dhe norma shtesë të cilat e sigurojnë dhe e garantojnë shtypin që të jetë i lirë dhe i pavarur dhe si i tillë të jetë aleat dhe në shërbim të publikut. Pra, në qoftë se vendosim paralele dhe krahasim mes qasjes së parë autoritare dhe liberale, mund të ritheksojmë se modelet apo sistemet politike të qeverisjes së një vendi, janë përcaktuese për frymën dhe mënyrën e veprimit të shtypit. Pushteti i shtypit dhe medieve gjithnjë ka qenë një pikë e fortë e formësimit të demokracisë, kur ai ka qenë

³¹ Fred Siebert, Peterson Theodore and Schramm Wilbur “Four theories of the press”, (Chicago: University of Illinois Press, 1956), fq.3

³²James Curran dhe Michael Gurevitch (red.) “Mass Media and Society”, Edicioni i katërt, (New York: Oxford University Press, 2005), fq.122

³³Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET Press 2010), fq 629

i lirë, por edhe një pikë e fortë e formësimit të propagandës së pushtetit, kur ai ka qenë i kontrolluar.

1.3.3 Teoria e përgjegjesisë sociale

Edhe qasja e përgjegjesisë sociale që është e treta për nga trajtimi, për nga veprimet e saj është më e përafërt me atë liberale. Por, dallimi substancial me teorinë liberale qëndron te ngritja e kultit të individit, i cili duke besuar në të drejtën e tij morale, sipas teoricienëve, arrin t'i dallojë, t'i arsyetojë dhe t'i shprehë mendimet e tij për shtypin. “E drejta e individit për shprehje të lirë lidhet me aftësinë e tij ose të saj për të arsyetuar dhe udhëhiqet nga mendimet të cilat besohet të jenë një e drejtë morale dhe e domosdoshme për të mbështetur dhe jo për t'ia dorëzuar kontrollit të jashtëm”.³⁴ Sipas studiuesve Sibert, Peterson dhe Shram, idetë dhe institucionet dominuese të çdo shoqërie janë idetë dhe institucionet e klasës ekonomike dominuese, dhe si të tilla, ato duhet të vlerësohen.

Ndërkaq, Domenik lidhur me teorinë e përgjegjesisë sociale, thekson se shtypi ka të drejtë që ta kritikojë qeverinë dhe institucionet e tjera, mirëpo në anën tjetër i ka përgjegjësitë sociale për ta ruajtur demokracinë, duke e informuar shoqërinë në mënyrën e duhur dhe duke iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë. Përveç shtypit, sipas këtij studiuesi, demokracinë dhe përgjegjësinë ndaj publikut e ka edhe sistemi qeverisës i cili nxjerr norma ligjore dhe rregullore për mbrojtën e interesave të tij. “Qeveria mund të angazhohet në veprimet e medias, duke nxjerrë rregulla nëse nuk po i shërbehet mirë publikut”.³⁵ Vitet e fundit kryesisht shtetet perëndimore dhe ato që kanë një demokraci të zhvilluar janë ithtarë të kësaj teorie, të cilat përveçqë garantojnë liri të plotë të fjalës dhe të shtypit të lirë, janë të përfshira drejtpërdrejt në vendosjen e standardeve dhe dispozitave ligjore, të cilat do të ishin në funksion të mbrojtjes së pavarësisë editoriale, por edhe të mbrojtjes së publikut përmes informimit të drejtë, të balancuar dhe duke i respektuar standardet profesionale të raportimit. Edhe rajoni i Ballkanit, edhe Kosova vazhdimisht janë të angazhuara që të ndërtojnë mekanizma ligjorë dhe të ndërtojnë ambient në të cilin shtypi do të jetë i lirë.

³⁴Fred Siebert, Peterson Theodore dhe Schramm Wilbur “Four theories of the press”, (Chicago: University of Illinois Press, 1956), fq.96

³⁵ Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET Press 2010), fq.630

1.3.4 Teoria sovjetike komuniste

Teoria sovjetike komuniste është njëra nga teoritë e shtypit të cilën studiuesit e kanë vlerësuar si qasjen më të kontrolluar nga sistemi. Bazë e funksionimit të kësaj teorie është ideologjia, me theks të veçantë ideologjia sovjetike, e cila sipas studiuesve është e bazuar kryesisht në doktrinën e ideologjisë marksiste, baza kryesore e të cilës ka vepruar në Federatën e Rusisë, Evropën Lindore deri në vitet '90, por në disa vende vepron edhe sot. Sipas kësaj qasje teorike, shtypi duhet t'i mbështesë pa ndonjë kusht idetë marksiste të pushtetit, të cilat janë të dobishme për shoqërinë. Teoricieni Xhozef R. Domenik, thekson se ky sistem i shtypit ka funksionuar në shoqëritë e mbyllura dhe të kontrolluara nga sistemi. “Kjo teori është një variant i skemës komuniste. Mediet ‘zotërohen’ nga njerëzit, ashtu siç përfaqësohen nga shteti. Qëllimi i tyre është ta mbështesin sistemin marksist, si dhe të përmbushin qëllimet e shtetit, ashtu siç shprehen me anë të partisë komuniste”.³⁶ Qasja sovjetike komuniste si e tillë ka funksionuar kryesisht në vendet me regjime të tilla, duke pasur një shtrirje kryesore përveç Federatës Ruse dhe Evropës Lindore në gjysmën e shek. XIX, edhe në Kinë, Korenë e Veriut, ku përveç shtypit i cili ka qenë i kontrolluar, i tillë ka qenë edhe mendimi publik. Pra, nuk mund të imagjinohet ndikimi i shtypit përmes kësaj qasje, sepse ai ka qenë vetëm një letër propaganduese e sistemeve komuniste, qëllimi kryesor i të cilit ka qenë që të kontrollohet çdo cep i shoqërisë.

Natyrisht që përveç këtyre teorive të cilat konsiderohen kryesore dhe dominuese, ka edhe teori të tjera të shtypit, si: teoria e zhvillimit dhe teoria e demokracisë, me ç'rast njëri nga studiuesit e tyre, Denis Mikuell, thekson se shteti ka të drejtë të ndërhyjë në media, kur vihen në konsideratë interesat sociale dhe zhvillimi i shtetit dhe i shoqërisë. “Në interes të zhvillimit, shteti ka të drejtë të ndërhyjë ose të kufizojë veprimet e medias, dhe mekanizmat dhe kontrolli i drejtpërdrejtë mund të arsyetohen”.³⁷ Ndërkaq, sipas tij, teoria e demokracisë ka qasje kryesisht kundër komercializmit dhe monopolizimit të shtypit, si dhe burokratizimit të institucioneve publike të transmetimit.

³⁶Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET Press 2010), fq.630

³⁷ Denis Mc Quail “Mass communication theory: An introduction” (London: Sage, 1983), fq.96

1.4 Mediet dhe gazetaria

Që nga krijimi i gazetarisë dhe medias, teoricienë të ndryshëm janë munduar të japin përkufizimet më të sakta për të. Mirëpo, megjithëse janë dhënë e janë thënë dhjetëra definicione, edhe sot gazetaria po ndryshon, mediet po i përshtaten ndryshimeve sociale e teknologjike dhe po zhvillohen e transformohen bashkë me shoqëritë bashkëkohore. Derisa për teoricienin Marshall McLuhan media është mesazh dhe zgjatim i njeriut, për Dejvid Randall ka vetëm gazetari të mirë e të keqe, ndërkaq, për studiuesin gjerman Mol, jo gjithçka që ofrojnë mediet është gazetari. Kjo e tregon më së miri laramanin e mendimeve dhe koncepteve teorike e profesionale për medien dhe gazetarinë. Teoricienët që i dhanë një zhvillim të hovshëm zhanreve dhe elementeve të gazetarisë, fitues të shumëfishtë të çmimeve për gazetari, në mesin e tyre edhe të çmimit “Goldsmith Book Prize”, i Universitetit të Harvardit, Bill Kovaç dhe Tom Rosensil, në teorinë e tyre për gazetarinë, theksuan se njeriu ka nevojë për informacionin që ta jetojë jetën, ka nevojë që ta mbrojë veten, të krijojë lidhje me shoqërinë, të pikasë miqtë nga armiqtë. Kjo e pasqyron më së miri nevojën e njeriut për informacion, për ngjarje të cilat ndodhin në vendin e tij, për ngjarje të cilat janë të rëndësishme për vendin e tij, për vendimet që merren, e të cilat janë në interesin e tij, për ta njohur dhe për t’u informuar për botën e cila na rrethon. Sipas tyre, gazetaria është thjesht sistem i krijuar nga shoqëritë për t’i dhënë këto informacione. “Ja përse shqetësohemi për llojin e informacionit dhe të gazetarisë që kemi: informacioni ndikon në cilësinë e jetës sonë, në mendimet dhe kulturën tonë”.³⁸ Studiuesi dhe profesori i gazetarisë Uilliam F. Eadi thekson se shkrimi i një raporti të mirë është zemra dhe shpirti i gazetarisë, megjithatë, sipas tij, nuk mund ta ndash me lexuesin atë pa i respektuar parimet dhe pa mbledhur informacione për të, që e përbëjnë një pjesë të rëndësishme të profesionit. “Identifikimi i çështjeve dhe ngjarjeve të rëndësishme e interesante për të raportuar është një pjesë kritike e procesit të raportimit”.³⁹

Studimet për gazetarinë dhe për profesionalizmin e saj, të ushtruar përmes medieve, janë konceptuar në mënyra të ndryshme nga teoricienë të cilët zhvillimet e saj i kanë ndërlidhur me elementet përbërëse të gazetarisë dhe zhvillimet teknologjike. Sipas autorëve Frederik Barbier dhe Katerina Berto Luvenir, mediet lidhen drejtpërdrejt me sistemet e komunikimit. “Me media

³⁸Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel “Elementët e Gazetarisë”, (Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2009), fq.7

³⁹ William F. Eadie “21 century Communication A reference handbook”, volume 1&2, (Los Angeles: SAGE, 2009), fq.600

kuptojmë çdo sistem komunikimi që i lejon një shoqërie të përmbushë të gjithë, ose një pjesë të tre funksioneve thelbësore të ruajtjes, të komunikimit në distancë, të mesazheve dhe të dijeve, të rinovimit të praktikave kulturore e politike”.⁴⁰ Pra, sipas këtyre autorëve, historikisht gazetaria ka qenë e ndërlidhur me komunikimin dhe bartjen e mesazheve të saj, qoftë kulturore apo politike, apo të ndonjë fushe tjetër, e cila ka qenë e rëndësishme për publikun. Ndërkaq, teoricieni, Stefan Rus Mol, konstaton se gazetaria gjithmonë duhet të bëjë përpjekje që veprimtaria e saj ta arrijë pritshmërinë e publikut, sepse kjo do të kishte efekt vetëm nëse arrihet. “Në qoftë se gazetarët përmbushin funksionin e tyre profesional, ata ndihmojnë që mediet të kenë sukses komercial dhe që gazetaria ta plotësojë detyrën e saj shoqërore”.⁴¹

Pra, mediet në periudhën bashkëkohore janë ndër të tjera biznese të fuqishme të cilat sigurojnë përmes të hyrave të tyre funksionimin, por edhe ruajtjen e pavarësisë editoriale. Sipas studiuesve, mediet kanë një ndikim më të fuqishëm, sesa, që e mendojnë shpeshherë gazetarët, e se ç’ mund të kenë menduar teoricienët, mendimet e të cilëve kanë qenë të kristalta dhjetë vite më parë. Se gazetaria po ndryshon, po zhvillohet dhe po tjetërsohet, thekson në studimin e tij universitar, profesori Milazim Krasniqi, sipas të cilit, gazetaria nën presionin e aleatëve të saj dhe zhvillimeve të hovshme teknologjike po transformohet me shpejtësi të madhe. “Gazetaria e kohës sonë po transformohet me shpejtësi, në një ndërvarësi pothuajse të dhunshme me zhvillimin teknologjik të medias e bashkë me këtë edhe me ndryshimin psikologjik e kulturor të publikut”.⁴² Pra, sipas Krasniqit, ky zhvillim i hovshëm po ndikon në konceptimin e funksionit të gazetarisë, në stilin e shkrimit dhe në ndryshimin psikologjik e kulturor në nivel përtej kufijve. Pra, mediet falë ndryshimeve të vazhdueshme teknologjike dhe mundësisë së veprimit të tyre në platformat online, krijimit të identiteteve të tyre dhe rrjetet sociale apo medieve sociale, ka ndryshuar stilin e strukturën e raportimit dhe marrjen e informacionit në përgjithësi. Në këtë studim theksohet se media është një zbulim nga e cila njeriu ka krijuar akordi dhe varshmëri ndaj saj. “Prandaj, mund të themi se media është një zbulim në të cilin është gjetur akordi i mjetit të informacionit me natyrën e trazuar e shumë komplekse të njeriut, duke ia sfiduar kureshtjen e pa frenuar, mundësitë intelektuale e në të njëjtën kohë, duke ia kënaqur edhe disa nevoja praktike”.⁴³ Megjithëkëtë,

⁴⁰Frederik Barbier dhe Chatherina Bertho Lavenir, “Historia e Medias nga Dideroi tek Interneti”, (Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2004), fq.7

⁴¹Stephan Russ-Mohl, “Gazetaria-tekst didaktik dhe praktik”, (Tiranë: K&B, 2010), fq.17

⁴²Milazim Krasniqi, “Gazetaria nën trysinë e aleatëve të saj – teknologjisë dhe publikut). Revista kërkimore “MEDIA”, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2013/14), fq.9

⁴³Milazim Krasniqi, “Hyrije në gazetari”, (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.16

pikëpamja e teoricienit Dajvid Randall, i qëndron besnik faktit se ka vetëm dy lloje të gazetarisë, të cilat klasifikohen në gazetarinë e mirë dhe e keqe. “Nuk mund të ketë as gazetari liberale, republikane, nacionaliste, reformiste, socialiste, separatiste, federaliste, ateiste, feministe apo materialiste. Për sa kohë që gazetarët bëjnë një punë që u shërben këtyre kauzave, ose ndonjë kauze tjetër, ata nuk janë gazetarë por propagandistë. Ka vetëm gazetari të mirë dhe të keqe”.⁴⁴

Gazetaria edhe në të ardhmen do të mbetet një nga profesionet më atraktive, i cili do zhvillohet dhe do të ndryshojë, varësisht prej ndryshimeve teknologjike, transformimeve sociale dhe zhvillimeve bashkëkohore të shoqërisë moderne. Si e tillë, misioni i saj, gjithnjë dhe i përhershëm, do të jetë që të grumbullojë dhe shpërndajë informacione për publikun si aleatin e saj të vetëm.

1.5 Teoria e zhanrit

Krahas përpjekjeve të saj për t’u çliruar nga kontrolli dhe ideologjitë politike, krahas përpjekjeve të saja historike për të krijuar norma mbrojtëse ligjore që sigurojnë e garantojnë veprimin e saj të pavarur, gazetaria ka arritur të zhvillojë aspektin profesional të saj, duke i ngritur standardet profesionale të raportimit. Që nga epoka e zbulimit të shkrimit artificial nga ana e Johanesh Gutenberg, revolucionet e ndryshme në krye me atë Borgjez Francez, shpikjes së internetit, u bë e domosdoshme dhe e nevojshme përpjekja për ndryshimin strukturor të zhanreve të gazetarisë. Këto ndryshme zhanresh dhe të standardeve profesionale të raportimit u bënë të nevojshme dhe të domosdoshme për të ruajtur, siç thekson, Randall, kualitetin, besueshmërinë dhe publikun. “Shtypi që perceptohet si i kontrolluar nga qeveria, ose që vuan nga mungesa e cilësisë a etikës, mund ta ulë kërkesën”.⁴⁵

Por, çfarë është tipologjia e zhanrit?

Studiuesi i gazetarisë Bajram Kosumi, në teorinë e tij të zhanrit konsideron se gazetaria, si edhe çdo fushë tjetër shkencore e ka krijuar tipologjinë e saj zhanërore. Në studimin e tij, ai thekson se ekzistojnë disa analogji të dallueshme midis tipave e llojeve të ndryshme të gazetarisë: “...janë krijuar disa forma të tekstit gazetar (p.sh. ndryshe shkruhet lajmi për gazetën ditore nga lajmi për gazetën apo revistën javore, e krejt ndryshe për televizionin e portalin digjital), pastaj një fiksion i

⁴⁴David Randall, “Gazetaria universale” (Tiranë: Instituti Shqiptar i medias, 2003), fq.9

⁴⁵Po aty, fq.235

disa formave tekstore dhe i disa strukturave tematike (p.sh. forma e tekstore e editorialit dhe e kryeartikullit; struktura tematike e lajmit dhe e analizës, etj.)... Pra, janë krijuar një varg veçantish të gazetarisë e të cilat e mundësojnë tipologjinë e saj”,⁴⁶ Pra, tipologjia e zhanrit në gazetari ndahet në disa lloje të saj, tipologjia e gazetarisë së shkruar, brenda së cilës kemi disa lloje të zhanreve; tipologjia e gazetarisë elektronike në krye me televizionin dhe tipologjia e zhanreve e medieve online, e cila është bërë forma kryesore e shpërndarjes së informacionit deri te publiku. Sipas këtij studimi, tipologjia në gazetari ndahet në dy faktorë kryesorë: atë të jashtëm dhe të brendshëm. Këta dy faktorë, siç theksohet në këtë studim të zhanrit, janë fundamentalë për ndarjen e informacionit në llojin apo tipologjinë e mediumit në të cilin transmetohet dhe në strukturën e brendshme të ndërtimit të artikullit, brenda këtij lloji të tipologjisë mediale. “Radioja dhe televizioni janë medime, mirëpo gazetaria që zhvillohet në këto dy medime është tipizuar si zhanër i veçantë dhe quhet gazetari e radiotelevizionit, përkatësisht, radio-gazetari dhe gazetari-televizive. Po ashtu, quhet gazetari e digjitalizuar, e shtypur, etj., të cilat janë faktorë të jashtëm që kanë ndikuar në tipologjinë e gazetarisë”,⁴⁷ thekson Kosumi, duke dalluar se çka është faktor tipologjik i brendshëm: “Ndërsa lajmi i gazetës së shtypur dhe një editorial i po asaj gazete janë të ndryshëm, por tash për shkak të një faktori të brendshëm, struktura tekstore e lajmit është e ndryshme nga struktura tekstore e editorialit, e ky fakt i bën ata tërësisht të ndryshëm nga aspekti tipologjik”.⁴⁸ Përveç tipologjisë, sipas këtij studimi, gazetaria ndahet edhe në katër zhanre kryesore të saj, si: gazetarinë informative, gazetarinë analitike, gazetarinë publicistike dhe gazetarinë argëtuese. Meqenëse rasti ynë i studimit ndërlidhet drejtpërdrejt me gazetarinë informative, objekt teorik do të jetë vetëm ky zhanër me të gjitha nënlojet e tij.

1.5.1 Lajmi

Lajmi është historia të cilën ne e jetojmë. Dikur edhe ngjarjet që mësohen e studiohen në fushën e historisë ishin lajme ditore. Lajmi është e dëgjuara e një informacioni për herë të parë; lajmi për individin dhe shoqërinë është i nevojshëm po aq sa oksigjeni, sepse njeriu sikurse për ajrin, ka nevojë për informacionin. Lajmi sipas shumë definicioneve është ai i cili ne na mban të

⁴⁶Bajram Kosumi, “Tipologji dhe zhanër” (Prishtinë: OLYMP, 2013), fq.24

⁴⁷Po aty, fq.24

⁴⁸Po aty, fq.24

informuar për ngjarjet që na rrethojnë, e të cilat lidhen me jetën tonë, na bën më të sigurt, më të përgatitur për jetë, më të përgjegjshëm brenda shoqërisë dhe më pjesëmarrës në sistemet demokratike qeverisëse. Sot, lajmi është më i përhapur se kurrë, informacionet dhe ngjarjet janë globalizuar, ndërsa numri i medie, sidomos i atyre online është rritur shumë. Teoricieni britanik, Brajan Minair, thekson se sot në tregun botëror lajmi në të gjitha zhanret e tij është zhvilluar shumë, falë mbulueshmërisë financiare. “Në shekullin XXI prodhimi i lajmeve në të gjitha llojet e gazetarisë është shndërruar në një biznes të madh në rritje... Sipas një raporti të vitit 2007 të Shoqatës Botërore të Gazetave, ekzistojnë më shumë se 10,000 tituj gazetash, brenda tyre të punësuar rreth dy milionë njerëz, të cilat gjenerojnë 180 miliardë dollarë amerikanë të ardhurash”.⁴⁹

Ky numër kaq i madh i gazetave, gazetarëve, lajmeve të prodhuara brenda ditës, tregon më së mirë për rolin e lajmit dhe nevojën e njeriut për informacion nga çdo zhanër i tij. Pra, ky shekull ka sjellë një industri globale të informacionit dhe një industri të fuqishme të gjenerimit të të hyrave të cilat i ndihmojnë mediet të jenë të lira. Por, cilat janë definicionet, konceptet për lajmin? Çfarë është ajo strukturë që e bënë të tillë? Sipas teoricienëve ka aq shumë definicione për lajmin, sa që ende askush nuk ia ka vendosur pikën, sepse, sipas tyre, definicioni për lajmin nuk është një shkencë ekzakte. Gjëja më e sikletshme që mund të përjetojë një gazetar është pyetja e më e rëndomtë e profesionit të tij: ta pyesësh çka është lajmi? Jo pse ai nuk di se çka është, por ka aq shumë botëkuptime për të dhe aq shumë elemente shpjeguese. Po e nisim me njërin nga teoricienët kryesor të fushës së sociologjisë së medie Marshall Mekluan, i cili duke folur për lajmin thekson se që në filllet e tij definicioni i lajmit kuptohej si verifikimi dhe korigjimi i thashethemeve dhe se gazetarët dhe gazetat e para në fillim nuk e kërkonin lajmin por prisnin që ai të vinte i gatshëm në redaksi, dhe lajmi konsiderohej si një frazë tejet e paqartë. “Pa kaluar shumë kohë gazetat filluan ta kuptonin se nuk duhej thjesht të raportonin lajmet, por duhej edhe t’i mblidhnin, dhe pse jo, edhe t’i fabrikonin ato. Ajo që futej në gazetë ishte lajm. Të tjerat s’ishin lajm”,⁵⁰ ka theksuar në teorinë e tij Mekluan, duke shtuar se: “gazeta është një veprim imagjinar e përditshme e përbërë nga çdo gjë që ekziston në komunitet”.⁵¹ Pra, fillimisht qysh edhe e thekson sociologu i medie, lajmi ishte ai cili i verifikonte përmes botimit në gazeta informacionet të cilat ishin të paverifikuara

⁴⁹Brain Mc Nair, “News and Journalism in the UK”, (Londër: Routledge, 2009), fq.16

⁵⁰Marshall McLuhan, “Instrumentat e Komunikimit-Media si një zgjatim i njeriut”, (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2008), fq.235

⁵¹Po aty, fq.235

apo mbi perceptimin e thashethemeve, dhe si të tilla, ato në këtë periudhë konsideroheshin si lajme, edhe pse, nëse gjykojmë nga këndvështrimi i sotëm, lajmi ka elemente dhe kritere tjera të verifikimit.

Ndërkaq, për studiuesin J. R. Domenik, lajmi nuk është një shkencë ekzakte, sepse brenda tij ka shumë elemente që duhet pasur parasysh. Mjafton sipas tij, të vendosësh për ta mbuluar një ngjarje nga mesi i shumë ngjarjeve që ndodhin dhe do ta kuptosh sesa e vështirë është të vish deri te vlerësimi sa më konkret i një ngjarjeje apo lajmi. “Vlerat e lajmit janë formësuar nga tradita, nga politika redaksionale, nga faktori ekonomik dhe tani së fundmi edhe nga revolucioni digjital. Megjithatë, shumica e gazetarëve janë akoma të një mendjeje kur bie fjala për pesë elementet thelbësore që e karakterizojnë një ngjarje që përbën lajm”.⁵² Duke u nisur nga ky fakt, lirshëm mund të theksojmë se përkundër shumë kritereve, elementeve dhe standardeve për ta përcaktuar lajmin, ende mbeten dilema te gazetarët kur e bëjnë përzgjedhjen dhe mbulimin e një ngjarjeje. Autori Milazim Krasniqi, përkufizimin e definicionit të lajmit e lidh drejtpërdrejt me vlerën e një ngjarjeje, e cila, sipas tij, përkufizohet nga gazetarët dhe redaktorët. “Gazetarët dhe reaktorët e bëjnë vlerësimin e ngjarjeve në bazë të njohurive dhe përvojave të tyre, duke pasur gjithnjë parasysh interesin dhe dobinë e medias, të harmonizuar edhe me interesin dhe dobinë e publikut”.⁵³ Prandaj, sipas kësaj qasje, përvoja e gjatë në fushën e raportimit i ndihmon mediet edhe gazetarët që sa më lehtë të kuptojnë vlerën e një lajmi dhe rëndësinë e mbulueshmërisë së asaj ngjarjeje. Natyrisht, që në kohët e sotme, kur ka kaq shumë mundësi të komunikimit dhe leximit, falë edhe zhvillimit të teknologjisë dhe rrjeteve sociale të cilat botën e kanë shndërruar në një fshat global, një gjë e tillë bëhet edhe më e vështirë. Autorët dhe studiuesit britanik Uinford Hiks, Selli Adams, Harriet Gilbert dhe Tim Holms, në përpjekjen e tyre për ta nxjerrë një definicion për lajmin theksuan se lajmi është diçka i lehtë për t’u identifikuar, edhe pse është vështirë që të nxjerret një definicion. “Lajmet janë të lehta për t’u definuar. Për të qenë lajme, diçka duhet të jetë faktike, e re dhe interesante. Duhet të ketë fakte për të raportuar, pa këto elemente nuk mund të ketë lajm. Faktet duhet të jenë të reja për lexuesit”.⁵⁴ Sipas tyre, gazetarët dhe mediet duhet të identifikojnë

⁵²Joseph R. Dominick, “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET press, 2010), fq.452

⁵³Milazim Krasniqi “Hyrje në gazetari”, (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.55

⁵⁴Wynford Hicks, Sally Adams, Harriett Gilbert dhe Tim Holmes “Writing for Journalists”, edicioni i dytë, (Londër: Routledge, 2008), fq.10

se çfarë i intereson lexuesit dhe çfarë është në interes për ta, në mënyrë që ky informacion të jetë lajm.

Në anën tjetër Randall, kur është në pyetje përkufizimi i lajmit, ai shkon edhe më thellë në përgjithësimin e definicionit të lajmit. “Sipas atij, më të zakonshmit në Britani, lajm është kur njeriu kafshon qenin, jo kur qeni kafshon njeriun. Kjo na kujton edhe një herë se lajmi është diçka e pazakonshme ose interesante. Por, nuk kufizohet me kaq. Lajmi është edhe diçka e re që njerëzit nuk e kanë ditur më parë. Megjithatë, jo të gjitha informacionet e kësaj kategorie janë lajm”.⁵⁵ Sikundër dy elementeve apo kritereve të cilat ofrohen për përcaktimin e lajmit, ende ka gjëra kontradiktore brenda tyre dhe, si të tilla, nuk e shpjegojnë aq sa duhet edhe përkufizimin e plotë të lajmit, është thënë më tutje në studimin e Randallit. Sipas këtij studimi, lajmi duhet të përkufizohet në një shpjegim më të gjerë në mënyrë që të kuptohet sa më mirë kuptimi i tij. “Përkufizimi më i gjerë për lajmin është ky: Një informacion i ri dhe i pazakonshëm për një subjekt me interes për të gjithë, që më parë nuk ka qenë i njohur”,⁵⁶ shprehet Randall, prapë duke nxjerrë përfundime se as ky definicion nuk e jep përgjigjen e plotë të emërimit se çka është lajmi. Edhe teoricienët e Misuri Grupit, studiues dhe profesorë të gazetarisë Brajan S. Bruks, Xhorxh Kenedi, Daril R. Mon dhe Don Ranli, në studimin e tyre universitar, kur flasin për përkufizimin e lajmit fokusohen te kriteret, konteksti dhe gazetari. “Disa gjëra nuk ndryshojnë asnjëherë. Një prej këtyre konstanteve është vetë përkufizimi i lajmeve prej gazetarëve. Një tjetër është rëndësia, saktësia dhe paanshmëria. Më themeloria është vazhdimësia e rolit qendror të gazetarisë në një shoqëri demokratike”.⁵⁷ Prandaj, nga përkufizimit e teoricienëve të ndryshëm, po e kuptojmë se secili nga ta, duke përkufizuar konceptin e lajmit, ka elemente të ndryshme të cilat paraqiten brenda një përkufizimi të përgjithshëm të emërimit dhe përkufizimit të lajmit. Në anën tjetër, studiuesi gjerman Stefan Rus Mol, vjen në përfundim se lajmi është lloji më i rëndësishëm i tekstit në gazetari. “Shumë gjëra mund të bëhen lajm, pothuajse gjithçka që është e jashtëzakonshme, aktuale dhe jo e përditshme...”.⁵⁸

Ndërkaq, profesori i zhanreve të gazetarisë Bajram Kosumi, në studimin e tij universitar thekson se pa lajmin nuk do të ekzistonte as gazetaria. Sipas tij, lajmi është i lidhur mes dy faktorëve: dhënësit në njërin anë dhe marrësit në anën tjetër. “Lajmi jep një informacion të ri,

⁵⁵David Randall, “Gazetaria universale” (Tiranë: Instituti Shqiptar i medias, 2003), fq.34

⁵⁶Po aty, fq.34

⁵⁷Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve” (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.12

⁵⁸Stephan Russ-Mohl “Gazetaria-tekst didaktik dhe praktik”, (Tiranë, K&B, 2010), fq.48

lajmi kumton diçka e cila është interesante edhe për dhënësin, edhe për marrësin. “Ky është rrethi i parë social e logjik që e krijon lajmi: dhënësi dhe marrësi janë të lidhur midis tyre me interesin e përbashkët, për të kumtuar dhe për të mësuar një të re”,⁵⁹ ka theksuar Kosumi, duke shtuar më tej se gazetaria moderne rri mbi lajmin.

1.5.2 Vlera dhe kriteret e lajmit

Meqenëse brenda ditës në vend, rajon dhe botë ndodhin mijëra ngjarje, gazetarët, redaktorët dhe mediet në përgjithësi janë ato të cilat vendosin se cilat nga ato ngjarje duhet të mbulohen. Për të arritur më sigurt deri tek identifikimi dhe përzgjedhja e këtyre ngjarjeve, teoricienët i kanë ndërtuar parametrat apo vlerat të cilët duhet t’i përmbushë një ngjarje. Në librin e tij universitar, Milazim Krasniqi, thekson se secila ngjarje është e rëndësishme për publikun, mirëpo disa nga to kanë rëndësi më të madhe, sepse kanë rëndësi më të madhe për publikun, pasi që ndikojnë mbi jetën e tyre. Prandaj, sipas tij, lajmi duhet të ketë vlerat e tij. “Relevanca ka të bëjë me rëndësinë që ka një ngjarje për interesimin e publikut... Dobia shihet nga ajo se sa informacionet e publikuara u ndihmojnë lexuesve/publikut për përmirësimin e kualitetit të jetës së tyre... Ndërsa në aspektin e interesit të ngjarjeve, kënaqin kureshtjen e publikut, prandaj si të tilla ato përfshihen në edicione, më shumë me synim që ta argëtojnë publikun”.⁶⁰

Pra, tre janë faktorët e parë kryesorë, të cilët secili gazetar apo redaktor duhet t’i ketë në konsideratë, kur vendos për mbulimin e një ngjarjeje. Edhe teoricienët: Brajan S. Bruks, Xhorxh Kenedi, Daril R. Mon dhe Don Ranli, arritën në përfundime se kur flitet për lajmin, secili gazetar apo redaktor duhet t’i mendojë tri fjalë. “Relevanca, Dobia, Interesi”. Këto kritere vlejné në përgjithësi, por çdo gazetar dhe organizatë lajmesh i përdor ato në një kontekst specifik që u jep atyre një kuptim të veçantë. Konteksti përcaktohet nga publiku”.⁶¹ Prandaj, shumica e teoricienëve pajtohen në përfundimet e tyre kur flasin për vlerën e lajmit. Sipas tyre relevanca, dobia dhe interesi janë vlera të pakontestueshme të cilat na mundësojnë t’i identifikojmë ngjarjet më të rëndësishme.

⁵⁹Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.95

⁶⁰Milazim Krasniqi “Hyrje në gazetari”, (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.55-56

⁶¹Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve”, (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.12

Studiuesi i medieeve, Dejvid Randall, e vazhdon edhe më tutje studimin e tij për vlerën e lajmit, duke u bazuar tashmë në faktorët kyç të tij. “Subjekti-është kategori e përgjithshme, ku futet ngjarja-krimi, mjedisi, shëndeti, diplomacia, ekonomia, konsumatori, ushtria, politika..., Zhvillimi tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë sa e pazakonshme është një dukuri e veçantë..., Burimi - forca ndikuese ose vlera e një zhvillimi varet pjesërisht nga burimi prej të cilit merret..., Dijenia - kjo lidhet me numrin e personave që kanë dijeni për një zhvillim të caktuar... koha e botimit, lexuesit dhe konteksti”.⁶² Prandaj, derisa vlera e lajmit për gazetarët dhe mediet flet më tepër për ngjarjet në raport me publikun, kriteret e lajmit janë ato që i fusin brenda tekstit vetë gazetarët dhe redaktorët për të respektuar elemente apo kritere tjera, që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e tekstit.

Edhe studiuesit Brajan S. Bruks, Xhorxh Kenedi, Daril R. Mon dhe Don Ranli, në teorinë e tyre pas përfundimeve se relevanca, dobia dhe interesi janë vetëm orientuese të përgjithshme, për ta gjykuar vlerën e lajmit, theksojnë se, gazetarët për ta plotësuar standardin e tyre, kërkojnë elemente të tjera specifike. Sipas tyre, ndikimi apo impakti, konflikti, risia, fama, afërsia dhe kohësia janë elemente kryesore. “Ndikimi-kjo është një mënyrë tjetër, për ta matur relevancën dhe dobinë... Konflikti - kjo është tema e pranishme në çdo lloj rrëfimi, qoftë kur historitë tregohen në gazetari, letërsi apo dramë..., Risia - ky është element tjetër i zakonit për gazetarinë dhe llojet e tjera të tregimtarisë... Fama - emrat përbëjnë lajm... Afërsia - përgjithësisht njerëzit janë më të interesuar dhe të shqetësuar rreth ngjarjeve që ndodhin pranë shtëpisë së tyre... Kohësia - lajmet supozohet të jenë të freskëta. Nëse një lajm duhet të jetë relevant dhe i dobishëm, ai duhet të mbërrijë me kohë”.⁶³ Pra, edhe siç është cekur në studimin e teoricienëve të Misuri Grup, lajmi përveç elementeve të para që duhet t’i ketë për t’i sinjalizuar gazetarët për vlerat e tij, ai profesionalisht duhet t’i plotësojë edhe elementet shtesë për të qenë koherent dhe brenda standardeve profesionale. Lidhur me vlerën dhe kriteret e lajmit.

Studiuesi J. R. Domenik, ka thënë se janë pesë elemente thelbësore që i karakterizojnë ngjarjet: “Aktualiteti, aftësia, spikatja, ndikimi dhe interesi njerëzor janë faktorët thelbësor për ta karakterizuar një lajm”.⁶⁴ Prandaj, përveç shumë faktorëve të tjerë që ndërlidhen tërthorazi apo drejtpërdrejt me gazetarin dhe profesionin e tij, lajmi përveç shumë këndvështrimeve dhe

⁶²David Randall, “Gazetaria universale” (Tiranë: Instituti Shqiptar i medias, 2003), fq.38-39

⁶³Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve”, (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.13

⁶⁴Joseph Dominick R. “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET press, 2010), fq.452

pikëpamjeve të autorëve, për të arritur deri te një definicion, ekzistojnë edhe një shumësi e vlerave dhe elementeve të cilat ndërthurën për ta plotësuar atë definicion dhe për ta mbështetur profesionalisht atë.

Përveç relevancës dhe faktorëve, lajmi, ndër të tjera, është edhe tekst subjektiv, dhe si i tillë, ai varet edhe nga vetë gazetari i cili duhet të ketë vlera morale dhe profesionale, siç edhe shkruan në teorinë e tij, studiuesi Milazim Krasniqi. Sipas tij, janë një grumbull vlerash të cilat duhet t'i ketë një gazetar për të qenë i suksesshëm në profesionin e tij. "Gazetari i standardeve të larta profesionale, në kohën tonë është në të njëjtën kohë profesionist por edhe intelektual, person që është i preokupuar me prodhimin e ideve dhe të zgjidhjeve për problemet e shoqërisë së cilës i takon, por edhe të njerëzimit. Prandaj, gazetari i këtyre standardeve duhet të jetë i mbrojtur me një sërë vlerash, në mënyrë që ta përballojë peshën e rëndësisë së profesionit të vet".⁶⁵ Në këtë studim të Krasniqit, më tutje theksohet se janë disa nga vlerat që duhet t'i plotësojë çdo gazetar: ndershmëria, formimi intelektual si themel i profesionalizimit, guximi, korrektësia, kreativiteti, saktësia (në kohë e në premtime), përkushtimi ndaj profesionit, mësimi i vazhdueshëm, ndjenja e shërbimit dhe e përgjegjësisë.

1.5.3 Kreu i lajmit

Njëri nga elementet kryesor të një teksti në gazetari është kreu i lajmit. Kreu i lajmit është paragrafi kryesor i tekstit para vendosjes të së cilit, gazetari duhet të ketë parasysh disa faktorë. Ai duhet së pari që ta identifikojë rëndësinë e asaj ngjarjeje, tregimin kryesor të saj dhe duhet t'i përshtatet politikave redaksionale, tematikës së ngjarjes dhe peshës së tij, karshi lexuesit e publikut. Studiuesi, Milazim Krasniqi, në studimin e tij universitar në lidhje me kreun e lajmit, thekson se, nëse kreu i lajmit shkruhet mirë, shanset që ai të jetë i suksesshëm, janë shumë të mëdha, dhe një gjë të tillë, më së mirë dinë ta vlerësojnë gazetarët më përvojë. "Gazetarët me përvojë i kushtojnë shumë rëndësi fillimit të tekstit sepse e dinë që prej tij varet se a do ta ndjekë lexuesi tekstin e tij deri në fund, apo do ta ndërpresë leximin e tij. Me gazetarët e papërvojë të pashkolluar ndodh krejt e kundërta: ata mundohen që argumentet kryesore t'i lënë për fund të tekstit, që ta 'fuqizojnë' mesazhin e tij".⁶⁶ Gazetarët me përvojë janë ata të cilët zakonisht kanë rol

⁶⁵Milazim Krasniqi, "Hyrie në gazetari", (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.20

⁶⁶Po aty, fq.67

të jashtëzakonshëm në shoqëri, sepse ata përveç se dinë të trajtojnë tema relevante, aktuale dhe të rëndësishme për komunitetin dhe shoqërinë, dinë që ta ndërtojnë kreun e tekstit në mënyrë që lexuesi që në fillim ta ketë informatën kryesore, të shkruar sipas standardeve profesionale.

Edhe për teoricienin e zhanreve të gazetarisë Bajram Kosumi, paragrafi i parë është elementi themelor, i cili duhet të përmbledhë temën kryesore të lajmit. “Kreu e jep thelbin e lajmit. Ai duhet të shkruhet në atë mënyrë që t’i theksojë të gjitha elementet themelore të një lajmi. Kreu, pra, duke përmbajtur informacionin kryesor të lajmit, i përshtatet detyrimisht ngjarjes lajmore, apo temës së lajmit: nëse tema e lajmit është një zjarr, zjarri duhet të jetë në kreun e lajmit; por nëse në atë zjarr është rrënuar shtëpia e një familjeje, atëherë rrënimi i shtëpisë nga zjarri duhet të jetë në kreun e lajmit; por, nëse zjarri dhe rrënimi kanë mbytur një njëri, vdekja e tij duhet të jetë në krye”⁶⁷. Shumë herë brenda një ngjarje apo teme të trajtuar mund të hasim në dy apo tri lajme brenda tij, prandaj gazetarët dhe redaktorët e përgatitur, sidomos ata të specializuar, e kanë aftësinë e tyre profesionale dhe intelektuale që ta identifikojnë tregimin kryesor të asaj ngjarjeje, në mënyrë që ta vendosin në paragrafin e parë apo te kreu. Shumica e teoricienëve i kanë të kristalizuara idetë e tyre kur është në pyetje kreu i lajmit, të gjithë i kanë nxjerrë përfundimet se kreu i lajmit është elementi më i rëndësishëm brenda tekstit gazetaresk. Mirëpo, edhe kreu i tekstit ndahet në disa krerë të cilët gazetarët i përdorin, për t’iu përshtatur lajmit. Varësisht nga ngjarjet për të cilat raportojnë, gazetarët dhe redaktorët i demonstrojnë krerët e lajmit, duke i përshtatur ata në mënyrën më profesionale për lexuesin. Mund të theksojmë se, sot, si asnjëherë më parë në periudha historike, kreu i lajmit duhet që të ketë rëndësi të veçantë, sepse ndër të tjera, ai duhet që, sot, t’ua kursejë edhe kohën lexuesve. Pra, kreu, sot, duhet të japë informacionin kryesor në fillim edhe për faktin se publiku ka nevojë që t’i kursehet koha në njërën anë, dhe të jetë i informuar në anën tjetër.

1.5.4 Llojet e kreut

Teoricienët e Misuri Grup Brajan S. Bruks, Xhorxh Kenedi, Daril R. Mon dhe Don Ranli, në studimin e tyre të strukturës së shkrimit të lajmit i kanë identifikuar si më të rëndësishmit kreun tradicional të lajmit dhe kreun narrativ.

“Kreu tradicional i lajmit shpjegon kush, çfarë, kur, ku, pse dhe si. I jep formë shkrimit. Mbyllet me informacione më pak të rëndësishme, jo me përfundimin, përmbledhjen ose me paragrafin që

⁶⁷Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.120

korion lidhje me fillimin... Kreu narrativ përshkruan një pikë dramatike të ngjarjes. Shkrimi kombinon elemente të piramidës së përmbysur dhe formatet e kronologjisë duke vendosur theksin ose te lajmi, ose te narracioni”.⁶⁸ Pra, kjo qasje e teoricienëve të Misuri Grupit, përveç këtyre dy lloj krerësh nuk paraqet alternativa të tjera, apo lloje të tjera të krerëve të cilët shumë autorë, i vlerësojnë si më të rëndësishmit.

Edhe autori, Milazim Krasniqi, thekson se kryesore janë dy krerët e lajmit: ai i drejtpërdrejtë dhe i vonuar, si dhe tipologjia e detajuar mes disa llojeve të kreut të tekstit gazetaresk, si: rezymues, përshkruar, narrativ dhe alternativ. “I drejtpërdrejtë”- ky lloj kreu i tregon menjëherë lexuesit ose dëgjuesit aspektin më të rëndësishëm të tregimit. Zakonisht ai përdoret në lajmet që pasqyrojnë ngjarje të reja. “I vonuar”: - ky lloj kreu i tërheq lexuesin ose dëgjuesin në brendësi të tregimit, duke e nënkuptuar përmbajtjen e tij. Zakonisht ai përdoret në tregime të veçanta, ndonëse gjithmonë e më shumë po gjen vend edhe në tregimet e lajmeve”.⁶⁹ Pra, nisur nga këto dy lloj krerësh kryesore dhe disa tipologji të tij, mund të konkludojmë se gazetarët dhe redaktorët kanë mundësi ta përshtatin lajmin apo raportin e tyre me lloje të ndryshme të kreut. Sipas Krasniqit, ndër krerët më të përhapur është kreu rezymues, në të cilin bëhet rezymimi apo përmbledhja e ngjarjes në paragrafët kryesorë, ndërkaq, kur flet për kreun përshkruar, autori e shpjegon këtë, duke e përmbledhur si një kokë, e cila ka parasysh imagjinatën e lexuesit. Sa i përket kreut narrativ, autori e përshkruan atë si një përpjekje të gazetarit, për të futur brenda elemente të cilat e nxisin dramaticitetin e ngjarjes, ndërsa e përmyll me kreun alternativ, kur informatat kryesore gazetari i fut brenda tekstit, duke e nisur kreun e saj me elemente dytësore.

1.5.5 Pyetjet themelore në gazetari

Nga ajo që është theksuar më lart, si në aspektin teorik dhe tipologjik, lajmi ka qenë gjithmonë në përpjekje të studiuesve, për t’i arritur standardet profesionale, në mënyrë që të jetë sa më i lehtë, i kuptueshëm për publikun lexues, shikues e dëgjues. Në të kaluarën kur shkencat e komunikimit dhe të gazetarisë ende nuk kishin arritur standardet bashkëkohore të lajmit, për gazetarët dhe redaktorët kreu i lajmit shihej si diçka që duhej të zbulohet në fund, duke e mbajtur

⁶⁸Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve” (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.164

⁶⁹Milazim Krasniqi, “Hyrye në gazetari” (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.71

të lidhur në këtë mënyrë lexuesin me lajmin. Mirëpo, një gjë e tillë, sot, shihet krejt si e kaluar dhe që nuk mund të imagjinohet një lajm ta ketë një strukturë të tillë.

Mirëpo, siç e cek në studimin e tij Krasniqi, kreu i lajmit filloi të marrë vëmendje dhe t'i përgjigjet pyetjeve themelore të lajmit, edhe për shkaqe teknike, të një teknologjie me pak mundësi që ishte më parë. "Pse ka mbetur kjo praktikë? Thuhet se kjo praktikë është ngulitur për shkak se radhitja bëhej me shkronja plumbi dhe nëse teksti duhej shkurtuar, ishte më e lehtë që shkurtimi të bëhej në fund të tekstit, sesa në fillim. Në fakt, një këso nevojë të shkurtimeve të teksteve, madje edhe në shtypshkronjë, para se faqet të filmoheshin, e kam pasur edhe vetë si kryeredaktor i revistës 'Fjala', në vitet 1990-1993. Kur ishte e pashmangshme që të bëhej shkurtimi i teksteve, (meqë gjatë thyerjes teknike nuk ishte planifikuar mirë hapësira që kërkonte një tekst), situata ishte mjaft e sikletshme".⁷⁰ Pra, në të kaluarën ndër të tjera, ishin çështjet teknike ato që gazetarët dhe redaktorët i bënë të mendojnë për kreun e lajmit, duke i dhënë përgjigje pyetjeve të lajmit. Ndërsa, sot fillimi i kreut me lajm, duke i dhënë përgjigje pyetjeve të lajmit bëhet, për t'ua kursyer kohën lexuesve në një kohë shumë dinamike. Shumica absolute e teoricienëve dhe studiuesve të medieeve, kanë shprehur konsensus në gjashtë pyetjet themelore të lajmit. "Shkrimi gazetaresk, veçmas lajmi dhe raporti, që synojnë informimin e publikut për ngjarje konkrete që ndodhin, tashmë kanë një strukturë të stabilizuar, të cilat mundësojnë të vlerësohet, kur janë të shkruara mirë, e kur nuk janë. Kriteri themelor është bërë përgjigjja sa më adekuate ndaj gjashtë pyetjeve themelore: kush, çka, kur, ku, pse dhe si".⁷¹ Përgjigjja në pyetjet e lajmit ka rëndësi të madhe edhe për autorët Uinford Hiks, Salli Adams, Harriet Gilbert dhe Tim Holms, sipas të cilëve, secili gazetar duhet që, pasi, ta përfundojë lajmin, ta rishikojë a i ka përgjigjet e të gjitha pyetjeve. "Pra, gjashtë pyetjet duhet të mbahen si një listë kontrolluese. Kur ke shkruar një lajm, kontrolloni nëse keni dështuar t'i përgjigjeni njërës prej pyetjeve".⁷² Pra, sidomos në zhanrin informativ, përgjigja e pyetjeve të lajmit në kreun e saj është e patjetërsueshme. Prandaj, lexuesi i sotshëm kërkon përgjigjet e pyetjeve në kreun e lajmit, dhe si rezultat i një kreu, një lajm apo raport varet se a do të lexohet nga publiku.

Edhe studiuesja e medieeve të shkruara Sandra Pesmen, thekson se gazetarët dhe redaktorët kohë më parë zbuluan mënyrën më të mirë, për ta shkruar një lajm, duke i dhënë përgjigje pyetjeve

⁷⁰Milazim Krasniqi, "Hyrje në gazetari" (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.77

⁷¹Po aty, fq.77

⁷²Wynford Hicks, Sally Adams, Harriett Gilbert dhe Tim Holmes "Writing for Journalists", edicioni i dytë, (Londër: Routledge, 2008), fq.13

të tij. Sipas saj, qëllimi themelor i fillimit të lajmit në këtë formë është kursimi i kohës për lexuesin dhe mënyra më e lehtë, për ta kuptuar ngjarjen. “Qëllimi i tyre për të bërë këtë është që lexuesi të marrë të gjithë informacionin e duhur shpejt dhe të ketë leximin në mënyrën më të lehtë”.⁷³ Prandaj, gjashtë pyetjet e lajmit mbeten bazike për fillimin e një lajmi të qartë dhe të kuptuar, pavarësisht ndryshimeve teknologjike dhe teknikave të raportimit.

1.5.6 Raporti - Lajmi i zgjeruar

Studiuesi i tipologjisë së zhanrit, Bajram Kosumi, në studimin e tij universitar thekson se raporti është aq i afërt me lajmin, sa që mund të konsiderohet si lajm i zgjeruar. “Në fakt raporti është një hap më shumë se lajmi. Pra, ai është një lloj i tekstit gazetar më i gjerë se lajmi. Të gjitha rregullat që janë caktuar për shkrimin e një lajmi vlejnë edhe për raportin”.⁷⁴ Lajmi i cili brenda tij përmban vlera, kritere dhe u përgjigjet pyetjeve themelore dhe se qëllimi themelor i tij është që të informojë, raporti konsiderohet si lajm i zgjeruar i cili e shpjegon ngjarjen, komenton edhe faktet dhe jep detaje për kontekstin e ngjarjes. Ndërkaq, raporti më i zgjeruar dhe i përdorur në gazetari është ai i stilit të piramidës së përmbytur. Edhe studiuesi i medieeve, Hamit Boriqi, në studimin e tij thekson se për dallim nga lajmi, raporti është një prej llojeve të shkrimit informativ në të cilin lëvrohet ngjarja më gjerësisht. “Raporti paraqet njohuri më të gjera se kronika e lajmit; i pasqyron ngjarjet, veprimtaritë politike, ekonomike e shoqërore deri në detaje, në imtësi; bën disi edhe interpretimin e fakteve e të dukurive që janë objekt pasqyrimi”.⁷⁵

1.5.7 Piramida e përmbytur

Studiuesja amerikane, Ana Mekan, në teorinë e saj të medieeve, stilin gazetaresk të piramidës së përmbytur dhe zanafillën e saj e lidh me dy situata; një të cilën e cila ka të bëjë me strukturën kronologjike, dhe tjetrën me poezinë epike të antikës. Sipas saj, poeti latin Horac, i kishte këshilluar poetet e rinj që kur ta shkruajnë një poezi epike, ata duhet ta fillojnë atë me një moment dramatik. Ajo mendon se, ndër të tjera, ai do të mund të ketë qenë duke i mësuar shkrimin

⁷³Sandra Pesmen, “Writing for the Media”, (Illinois: NTC Contemporary, 1983), fq.32

⁷⁴Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.151

⁷⁵Hamit Boriqi, “Gazetaria 2”, (Tiranë: Shblu, 2004), fq. 167

e lajmeve, ngaqë edhe poezia epike ka të bëjë me ngjarje të mëdha. Ndërkaq, studiuesi, Milazim Krasniqi, thekson se praktika e piramidës së përmbysur ka ardhur si rezultat i përdorimit të shkronjave të plumbit në fillim, ku, nëse, lajmi nuk vendosej në fillim, ai rrezikonte të mos lexohej fare, ngaqë teksti për shkak të hapësirës së kufizuar shumë herë shkëputej në fund. Sipas këtij studiuesi, stili i piramidës së përmbysur mbetet i rëndësishëm edhe në kohët e sotme, sepse përmes përdorimit të këtij stili, u kursehet koha lexuesve. “Stili më i përhapur i shkrimit në gazetari është ai ku informatat kryesore për një ngjarje përfshihen në fillimin e tekstit, ndërsa pjesët më pak të rëndësishme lihen në fund të tij”.⁷⁶ Pra, piramida e përmbysur ndahet në tri pjesë kryesore të strukturës së saj: kreun, trupin dhe përfundimin apo sfondin.

Lidhur me piramidën e përmbysur grupi i studiuesve të shkollës së Misurit, theksojnë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), mbi 80 për qind të shkrimeve të gazetave dhe 100 për qind e shkrimeve në shërbime të lajmeve për një publik të shënjestruar, shkruhen apo ndërtohen sipas piramidës së përmbysur. Sipas tyre, për kundër rasteve dhe diagnostifikimeve se ky lloj i shkrimit gazetaresk është në prag të vdekjes, piramida ka treguar se një gjë e tillë as pritet të ndodhë ndonjëherë, sepse është njëri nga stilet i cili kërkohet edhe nga lexuesit e gazetarët, për shkak të kohës. “Piramida e përmbysur u kursen lexuesve kohën dhe redaktoreve hapësirën. U kursen kohë, sepse u lejon lexuesve të kapin së pari pjesën më të rëndësishme të lajmit; kulmin e një ngjarjeje, temën e një fjalimi, gjetjen kryesore të një hetimi. Ajo kursen hapësirë sepse u lejon redaktorëve të shkruajnë tregimet duke i prerë ato në fund”.⁷⁷ Ky stil gazetar i cili dikur u krijua për ta lehtësuar punën teknike të gazetarit dhe redaktorit, sot, mbetet po kaq i rëndësishëm sa më parë, pikërisht, për kohën që ua kursen kohën lexuesve. Në qoftë se gazetarët nuk do ta përdornin këtë stil të raportimit dhe do të bënin përpjekje për ta fshehur temën kryesore të ngjarjes për fund, atëherë shumë lexues nuk do të arrinin që ta kuptonin atë tregim, për shkak të kohës.

Ndërkaq, Kosumi, kur flet për piramidën e përmbysur thekson se ky në fakt është kreu i drejtpërdrejtë i lajmit, ku gazetari i vendos të gjitha informacionet kryesore, ndërsa te pjesët e tjera të saj janë vetëm sqaruese të asaj fjalie apo atij lajmi. “Kjo strukturë e lajmit është e përshtatshme në një prej parimeve më të njohura në gazetari, parimin e piramidës së përmbysur. “Kjo do të thotë: baza e piramidës nuk është në fund, por në krye, e që ka kuptimin se informatat me peshë shkojnë në krye, e ato me pak peshë në fund të lajmit, d.m.th lajmi shkon në krye, e materiali tjetër më

⁷⁶Milazim Krasniqi, “Hyrye në gazetari” (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.77

⁷⁷Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve” (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.129

pas”.⁷⁸ Sipas kësaj, çdo lloj lajmi apo raporti i ndërtuar sipas stilit të piramidës së përmbysur, ia krijon mundësinë lexuesit, që pas çdo paragrafi të lexuar, ta ndërpresë atë dhe në të njëjtën kohë të marrë edhe informacionin kryesor. Prandaj, sot, shumica e lexuesve për arsye të dinamikës së kohës, për shkak të globalizimit të informacionit, nuk arrijnë që raportet e botuara apo të publikuara t’i lexojnë deri në fund.

Në studimin e tyre për gazetarinë, Bredli Uilson, Donald L. Ferguson dhe Xhim Paten, theksojnë se piramida e përmbysur është njëri nga stilet tradicionale që e tërheq më së shumti vëmendjen e lexuesit, dhe ka shumë arsye pse duhet të përdoret gjatë raportimit ky stil i shkrimit. “Para së gjithash, është një mënyrë e natyrshme për të treguar një tregim. Nëse doni t’i tregoni një miku për një lojë futboll, filloni duke treguar se kush ka fituar; Ju nuk filloni me vënien e topit në lojë. Rezultati final, pra shkon në pjesën më të gjerë në krye të tregimit. Së dyti, stili i përmbysur piramidial i mundëson një lexuesi me nxitim për të marrë informacionin thelbësor pa e lexuar gjithë tregimin. Së treti, piramida e përmbysur është një ndihmë për të shkruar titullin e tregimit. Shumica e titujve bazohen në informacionin që gjendet në paragrafin e parë, prandaj faktet më të rëndësishme duhet të jenë në paragrafin e parë”.⁷⁹ Nisur nga ky koncept, mund të përfundojmë se stili i piramidës së përmbysur, përveçqë ndihmon lexuesin që ta ketë informatën në paragrafin e parë, ai i lehtëson edhe gazetarët dhe redaktorët që edhe titullin e raportit ta nxjerrin nga ky paragraf, i cili është kryesori brenda atij raporti.

1.5.8 Titulli i raportit

Shumë herë titulli i një raporti e bën një raport gazetaresk më të lexuar, më të kërkuar dhe më të shitur. Mirëpo, kur ai vendoset drejt dhe bart informacion brenda tij, fiton besueshmërinë e lexuesit, ndërsa në rastet kur titujt janë enigmatik, pa informacion dhe jashtë ngjarjes të cilën e trajton raporti, ai mund të jetë i bezdisshëm për lexuesin. Grupi i teoricienëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në studimin e tyre “Gazetaria sot”, theksojnë se, secilin titull, gazetari duhet ta vendosë në koordinim me redaktorin e tij përgjegjës, sepse ai është i vetmi që e di peshën e ngjarjes dhe e di se çfarë hapësire mund të ketë ai në brendësi të një gazete apo edicioni të lajmeve. Sipas tyre, sa më e rëndësishme që të jetë një ngjarje e trajtuar, aq i rëndësishëm është

⁷⁸Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.124

⁷⁹Bradley Wilson, Donald L. Ferguson dhe Jim Patten, “Journalism Today”, (USA: Glencoe, 2005), fq.128

edhe titulli brenda atij teksti. Prandaj, duhet pasur kujdes edhe në aktualitetin e ngjarjes. “Titujt janë, gjithashtu, të shkruar në kohën e tashme për t’u dhënë lexuesve një ndjenjë të menjëhershme”.⁸⁰ Në këtë studim theksohet se shumica e gazetarëve preferojnë që të mos përdorin tituj infinitiv dhe me emra. Në raportimin e sotëm, sidomos në mediet online, loja me titujt është bërë njëra prej sfidave më të mëdha për gazetarët dhe lexuesit.

Përderisa, kjo gazetari bashkëkohore përmes titullit e synon shfletimin online, për lexuesin, titujt e tillë, që në shumë raste nuk ndërlidhen me ngjarjen dhe janë bërë irritim i përditshëm. Lidhur me këtë çështje, Krasniqi, në studimin e tij “Hyrye në gazetari”, thekson se titulli paraqet zakonisht pikën e parë në të cilën ngulitet vëmendja e lexuesit, prandaj gazetarët duhet të jenë të vëmendshëm në këtë drejtim. “Gazetari që raporton për një ngjarje, krahas koncentrimin në gjetjen e elementeve më të rëndësishme të asaj ngjarjeje, krahas përpjekjeve për të identifikuar pjesët më esenciale të civateve, krahas strukturimit në mendje të tërë materialit, duhet të mendojë edhe për gjetjen e një titulli sa më domethënës e interesant”.⁸¹ Zakonisht në zhanret informative titujt brenda tyre bartin edhe informacion, janë të ndërlidhur drejtpërdrejt me tregimin kryesor të ngjarjes dhe duhet të ndërlidhen me paragrafin e parë, i cili është zakonisht paragrafi kryesor.

Qëndrim të ngjashëm me autorët e tjerë, sa i përket titullit të lajmit, ka edhe Kosumi, në studimin universitar “Zhanret e gazetarisë”, sipas të cilit, titulli i tekstit të lajmit apo raportit është pika kulmore e shkrimit. “Titulli është i rëndësishëm sepse në katër-pesë fjalë duhet të përmbledhet tema e lajmit dhe, po ashtu, titulli përmban edhe tonin e shkrimit. Po ashtu, vendi i titullit dhe gjerësia e tij e paragjykojnë edhe rëndësinë që redaksia e gazetës i jep shkrimit, e kjo ndikon te lexuesi”.⁸² Pra, zakonisht titulli është ai i cili e preokupon më së shumti gazetarin, pasi që brenda pak fjalësh, ai duhet të nxjerrë një informacion i cili e mban lexuesin të lidhur me ngjarjen e trajtuar.

Më poshtë do t’i pasqyrojmë disa lloje të titujve të lajmeve, të ilustruara me shembuj konkret në librin “Zhanret e gazetarisë”, të profesorit universitar, Bajram Kosumi.

- Titulli informativ - është titulli më i shpeshtë dhe më i praktikuar në zhanrin informativ (Zjarr në një shtëpi në lagjen Mat të Prishtinës);
- Titulli vlerësues - (Fitore e madhe e Kosovës);

⁸⁰Bradley Wilson, Donald L. Ferguson dhe Jim Patten, “Journalism Today”, (USA: Glencoe, 2005), fq.172

⁸¹Milazim Krasniqi, “Hyrye në gazetari” (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.88

⁸²Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.117

- Titull numërues - (Një viktimë dhe tre të lënduar);
- Titull mohues - (Thaçi: Askush tjetër s'do ta marr mandatin për qeverinë);
- Titull alternativ - (Shkupi mes qeverisë kalimtare dhe zgjedhjeve të përgjithshme);
- Titull komentues - (Dallaveret me mobil).⁸³

Këto janë llojet e titujve që zakonisht gazetarët dhe redaktorët duhet t'i kenë parasysh përpara se të vendosin se, cilin nga to, do ta përdorin në raportin e tyre gazetaresk.

1.5.9 Përdorimi i citimeve në raport

Kujdesi më i madh të cilin duhet ta ketë një gazetar gjatë ndërtimit të raportit të tij është përdorimi i citimeve. Një citim i përdorur në mënyrë të gabuar e ndryshon komplet përmbajtjen e raportit, nxit reagimet e palëve të përfshira në atë raport dhe në të njëjtën kohë pasojat i bartë publiku, i cili mund ta ketë lexuar një raport të deformuar. Ka raste kur gazetarët nxjerrin citime nga konteksti për hir të sensacionit të lajmit, për t'i përshtatur ato me politikën editoriale dhe për të interpretuar lajmin në mënyrën e tij, duke mos përjashtuar këtu edhe gabimet teknike që mund të ndodhin pa dashje. Prandaj, një gazetar për të arritur suksese në profesionin e tij duhet të përmbajë virtyte të larta morale e profesionale, siç e thekson në librin e tij autori Milazim Krasniqi, ku ndër tjera thekson se korrektësia është njëri nga kriteret themelore për suksesin e një gazetari. Sipas tij, citatet janë dëshmia më fortë se raportimi që i ofrohet publikut është i mbështetur në të dhëna të marra nga vendi i ngjarjes. “Citatet e forcojnë besueshmërinë e raportimit, sepse ato nxjerrin në plan të parë dëshminë e akterëve për një ngjarje, e jo impresionin e gazetarit. Si të tilla, citatet janë pjesë e domosdoshme e raportimit profesional gazetaresk”,⁸⁴ ka theksuar Krasniqi, duke qartësuar se citimi në gazetari nuk mund të bëhet me fusnota.

Shpeshherë gjatë raportimit të tyre, gazetarët edhe përkundër përdorimit me korrektësi të citimeve, mund të ketë reagime të palëve të përfshira në atë raport. Kjo ngaqë shumë herë palët e përfshira nuk e kanë të qartë atë se çfarë kanë deklaruar apo pas publikimit të raportit, ata nuk e përballojnë presionin e publikut, andaj reagojnë ndaj deklaratave të tyre. Prandaj, gazetarët gjithmonë duhet t'i ruajnë incizimet e tyre si dëshmi dhe masë të korrektësisë ndaj deklaratave që

⁸³Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.119-20

⁸⁴Milazim Krasniqi, “Hyrje në gazetari” (Prishtinë: Rozafa, 2008), fq.81

mund t'i kenë thënë këta persona. Për grupin e studiuesve nga Misuri, citimet e drejtpërdrejta i shtojnë ngjyrim dhe besueshmëri shkrimit të lajmit, duke krijuar edhe përshtypjen e lexuesit se po i vendos në kontakt të drejtpërdrejt me folësin. “Citimet e duhura, të zgjedhura dhe të paraqitura me kujdes, e gjallërojnë dhe i japin fytyrë njerëzore një shkrimi dhe ndihmojnë ta bëjnë atë më të qartë, të besueshëm, të menjëhershëm dhe dramatik. Prapëseprapë, shumë citime në gazetari janë të plogëta, të përsëritura, të frazuara keq, me gabime gramatikore, pa kuptim, i shërbejnë thjesht qëllimit të shkrimit ose janë thjesht pa tru”.⁸⁵ Prandaj përdorimi i drejtë i citimit është një sfidë për gazetarët të cilët duhet të kenë shumë kujdes gjatë përdorimit. Jo rrallë herë gazetarët mund të kenë qenë në situata të vështira ndaj reagimeve që mund t'iu kenë ardhur si rezultat i citimit të drejtpërdrejtë. Prandaj, korrektësia, përdorimi i drejtë i gjuhës, përkushtimi ndaj asaj që është thënë, etj., janë vetëm disa nga përmbushjet profesionale të cilat duhet t'i synojë secili gazetar.

Ndërkaq, për Kosumin, derisa lajmi ka të bëjë me njerëz të tjerë, atëherë citimet janë pjesë e rëndësishme e raportit teknik të shkrimit. “Citimi nuk është tregim i gazetarit apo mesazh i gazetarit për marrësin por është tregim i vet akterëve apo dëshmitarëve të lajmit, është mesazh i drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësues. Si i tillë, ai është më i besueshëm se çdo tregim i gazetarit”.⁸⁶ Pra, çdo tekst gazetaresk që shkruhet brenda tij e bart subjektivitetin e gazetarit, andaj për ta maksimalizuar besueshmërinë e tekstit, brenda tij duhet të ketë citime të drejtpërdrejta. Sipas tij, citimi përbëhet prej dy formave: asaj të drejtpërdrejtë dhe të përfolur.

⁸⁵Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve” (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005), fq.62

⁸⁶Bajram Kosumi, “Zhanret e Gazetarisë”, (Prishtinë: UBT, 2015), fq.131

KAPITULLI II

SHTYPI SHQIPTAR: HISTORIA E GAZETARISË SHQIPTARE NGA RILINDJA KOMBËTARE DERI MË SOT

2.1 Mediet në periudhën e Rilindjes Kombëtare

Pas shkrimit të parë të gjuhës shqipe, fillim-fundit të Perandorisë Osmane, vizatimeve të vijave kufitare në Evropë, kongreseve të rëndësishme ndërkombëtare në të cilat vendosej për popujt e vegjël e të pafuqishëm, ngritjes së vetëdijes kombëtare, fillojnë të shfaqen intelektualë, shkrimtarë e publicistë të cilët duan zgjimin nga gjumi të kombit shqiptar dhe marrjen në duar të fatit të tyre. Brenda këtyre përpjekjeve krijohet Rilindja Kombëtare e cila krahas zhvillimit të mendimit intelektual, bëhet edhe ngritja e një numri të madh revistash e gazetash të ndryshme, të cilat bëjnë një kthesë të madhe në historinë e gazetarisë shqiptare. Për këtë periudhë të historisë së gazetarisë, Boriqi e Marku e çmojnë jashtëzakonisht shumë, ku sipas tyre, kah fundi i Perandorisë Osmane ishin mobilizuar si asnjëherë më parë energjitë e intelektualeve shqiptarë. “Si pasojë e këtyre krizave u bë e qartë se Perandoria Osmane mund të shembej dhe një pjesë e kombeve që ishin përfshirë në gjirin e kësaj perandorie filluan të projektonin shtetet e pavarura... Sa më shumë thellohej kriza e Perandorisë dhe sa më e mundshme bëhej shpërbërja e saj, aq më e fortë bëhej nevoja e një organizimi kombëtar të shqiptarëve. Pikërisht është kjo elitë që e merr përsipër një gjë të tillë”.⁸⁷ Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët përmes elitave të krijuara dhe të arsimuara, kryesisht jashtë truallit të saj, filluan t’i bashkojnë forcat dhe të marrin përgjegjësi kombëtare, që më pas do të rezultonin me një varg ngjarjesh. Por, këta intelektualë, sipas këtij studimi, përveç përgjegjësisë kombëtare, ata kishin marrë mbi supe edhe përgjegjësi të tjera. “Kjo elitë ushtron njëherësh edhe veprimtari politike, edhe kulturore, edhe publicistike. Kjo është arsyeja pse, pikërisht, shkrimtarët më të mëdhenj të Letërsisë Shqipe: De Rada, Naim Frashëri, Fishta, Konica, Noli, etj. janë njëkohësisht edhe themeluesit e organeve më të rëndësishme të shtypit shqiptar, si: “Flamuri i Arbërit”, “Drita”, “Albania”, “Hylli i Dritës” apo “Dielli”.⁸⁸

Pra, këta intelektualë të Rilindjes Kombëtare, duke pasur parasysh që mendimit dhe veprimtari politik i duhej edhe mbështetje e shtypit, themeluan gazeta, kryesisht revista, për të ndihmuar në ngritjen e vetëdijes kombëtare, si dhe për t’i dërguar mesazhet e tyre politike në

⁸⁷Hamit Boriqi & Mark Marku, “Historia e shtypit shqiptar 1”, (Tiranë: Ufo University Press, 2007), fq.14

⁸⁸ Po aty, fq.14

qendrat e fuqive të mëdha botërore, aty ku vendosej për fatin e popujve dhe kombeve. Studiuesi Milazim Krasniqi, në studimin e tij universitar për historinë e shtypit shqiptar, vlerëson se përkrah programit politik dhe ideologjik të dalë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në periudhën e Rilindjes Kombëtare, në të njëjtën frymë ishin edhe mediet, të cilat kishin vendosur në agjendat e tyre interesin kombëtar. “Pra, janë media dhe është një shtyp, i cili e ndjek në masën më të madhe këtë ide kombëtare të formimit të kombit dhe të shtetit mbi parimet e gjuhës, historisë, prejardhjes së përbashkët dhe vlerave që i kanë formuar Lidhja e Prizrenit dhe ideologjitë e saj”.⁸⁹

Të gjendur në një situatë të shthurur në Ballkan, pas fillim-fundit të Perandorisë Osmane, popujt e Ballkanit kishin nisur organizimet e tyre nacionale, duke thurur projektet e tyre pavarësisë. Elitat intelektuale shqiptare të asaj periudhe kishin filluar projektin e tyre kombëtar të Pavarësisë së Shqipërisë, të mbajtur në Prizren. Prandaj, krahas hartimit dhe platformës politike, këta intelektualë e panë si të domosdoshme që kërkesat e tyre dhe mesazhet politike t’i promovojnë përmes shtypit në qendrat e ndryshme botërore, si: në Stamboll, Itali, Greqi, Rumani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. Si rezultat i kësaj, këta intelektualë themeluan shumë gazeta e revista në këto qendra botërore, të cilat ishin në mbështetje të kësaj kauze. Duke parë se brenda hapësirave shqiptare nuk kishte kapacitete të mjaftueshme dhe se vendi ishte i kërcënuar dhe i shthurur politikisht, shumica e këtyre redaksive vepruan jashtë territoreve shqiptare. “Aktivizimi i medieve nëpër shumë ngulime shqiptare gjithandej botës është tregues i një aktivizimi i cili e solli Rilindjen Kombëtare, brenda së cilës shumë individë dhe grupe e ndjenë të nevojshëm të angazhoheshin për të afirmuar kërkesat e kombit të vet”.⁹⁰ Shtypi i cili i kishte prirë disa dekada më herët Rilindjes Kombëtare, e deri te Pavarësia e Shqipërisë, i cili kishte ushtruar veprimtarinë e tij, kryesisht, në mërgatë, dy autorët: Boriqi dhe Marku e ndajnë në pesë faza të ndryshme. Sipas tyre, ndër autorët dhe ideologët kryesorë që promovuan gazetarinë shqiptare në këtë periudhë të historisë janë: Jeronim De Rada, Pashko Vasa, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Zef Skrioi, Naim Frashëri, Faik Konica, Fan Noli, Filip Shiroka, Ndoc Nikaj, Mihal Grameno dhe Anastas Byku. Ndërkaq, autori Milazim Krasniqi, në studimin e tij “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, thekson se këto revista promovuan dhe shpërndanë aktivitetet kulturore shqiptare nga viti 1848 deri në vitin 1912.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe cungimit territorial të saj, ku pjesa më e madhe e territorit të saj kishte mbetur jashtë kufijve të njohur ndërkombëtarë, brenda pjesës së

⁸⁹Milazim Krasniqi “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, (Prishtinë: Rozafa, 2016), fq.101

⁹⁰Po aty, fq.105

pavarur kishte pasur çrregullime politike të vazhdueshme. Deri në Luftën e Dytë Botërore edhe brenda atij shteti shqiptar kishte vazhdimisht rrëzime pushtetesh, ndërrime qeverish dhe probleme të shumta të konsolidimit, situata që kishin ndikuar në çrregullimin e vazhdueshëm të shtypit. Ndarja e kombit shqiptar në mënyrë të panatyrshme dhe reflektimi i kësaj gjendje nga elitat intelektuale e deri te mediet e kishte krijuar situatën, sipas Krasniqit, i kishte sjellë shqiptarët deri te lufta për ekzistencë fizike, si rezultat i Luftës Ballkanike e Luftës së Parë Botërore, dhe, në anën tjetër, të armiqve të përhershëm të shqiptarëve, si serbët dhe grekët. “Megjithatë, pati disa media si “Kalendari Kombiar”, “Dielli”, “Koha”, “Trumbeta e Krujës”, “Hyulli i Dritës”, etj., që vazhduan të afirmojnë identitetin kulturor dhe idealet shqiptare”.⁹¹

2.2 Mediet në Kosovë në periudhën e Rilindjes Kombëtare

Përkundër një zhvillimi të hovshëm të medieeve në gjuhën shqipe gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, kryesisht në hapësirën e gjeografisë së sotme të Shqipërisë, Kosova ishte e përjashtuar medietikisht, edhe përkundër faktit që Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte mbajtur në hapësirën territoriale të Kosovës së sotme. Edhe ato pak revista që dilnin në atë kohë në Vilajetin e Kosovës, ishin në gjuhën turke dhe serbe. Siç e thekson në studimin e tij autori, Milazim Krasniqi, ato nuk botoheshin në gjuhën shqipe por në gjuhën turke, që njëkohësisht edhe mund të arsyetoheshin për shkak se ishte gjuhë administrative, por nuk duhej të ishin në gjuhën serbe. “Mospërfshirja e Kosovës në rrjetin e medieeve dhe të komunikimit në gjuhën shqipe me frymën e Rilindjes Kombëtare, do të ketë pasoja të rënda për fatet e saj në periudhat që pasuan”⁹² - thekson Krasniqi, duke shtuar se nuk mjaftonte vetëm organizmi me armë, pa pasur edhe një propagandë mediale. Pra, edhe përkundër faktit që kongreset ndërkombëtare: i Londrës dhe i Berlinit ende nuk ishin mbajtur, me ç’rast do të vizatoheshin edhe kufijtë e Ballkanit, kombi shqiptar pothuajse nuk i kishte të unifikuara qëndrimet publicistike e mediatike të kombit si tërësi.

Historianët, Hamit Boriqi dhe Mark Marku, theksojnë se këto dy revista, edhe pse jo në gjuhën shqipe, ishin ndër të parat pas mëse 400 viteve nën Perandorinë Osmane. “Tre organet e shtypit mbi Shqipërinë e viteve ’70 - ’80-të, të shek. XIX: gazeta ‘Prizreni’ (1871-1874), e përjavshmja ‘Kosova’ (1871-1888) dhe vjetari ‘Salname-i Vilayet-i Kosova’ (1878-1888), janë të

⁹¹Milazim Krasniqi “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, (Prishtinë: Rozafa, 2016), fq.125

⁹²Po aty, fq.112

parat të përkohshme në këtë trevë, ku banonte dhe banon rreth 90 për qind e popullsisë shqiptare autoktone; u drejtoheshin atyre, auditorit shqiptar edhe pse në gjuhën turke, me shkronja arabe, gjuhë e detyruar edhe për shqiptarët”.⁹³ Kjo mund të konsiderohet sipas tyre edhe periudha kur janë vendosur themelet e para të gazetarisë në Kosovë.

E përjavshmeja “Prizreni” botohej në gjuhën turke dhe serbe në shtypshkronjën e Vilajetit, theksojnë Boriqi e Marku, duke shtuar se botimet në këtë të përjavshme, kryesisht, lidhen me shkrime të natyrës juridike, administrative, urdhëresa, akte zyrtare, dekrete, vendime ligjore e udhëzime, shkrime kulturore, arsimore e fetare. Ndërsa e përjavshmeja “Kosova”, e cila me urdhër të lartë nga Stambolli botohej në gjuhën serbe, mirëpo sipas këtij studimi historik të shtypit, kjo e përjavshme nuk pati një jetë të gjatë, për shkak të numrit të paktë të lexuesve, të cilët natyrisht ishin pakicë serbe, por që botohej në këtë gjuhë me presionin ndërkombëtar. Ndërsa revista e tretë “Salname-i Vilayet-i Kosova”, sipas tyre, merrej kryesisht deri në detaje me problemet kryesore të jetës së Vilajetit.

2.3 Mediet në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore

Njëra nga gazetat e cila la më së tepërmi gjurmë në gjuhën shqipe në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), është gazeta “Rilindja”, e cila, përkundër faktit që, ishte organ dhe kontrollohej nga Lidhja Komuniste (LK), ishte e vetmja dritare në gjuhën shqipe për më se gjysmë shekulli. Megjithatë, para kësaj gazete ishin disa gazeta në gjuhën shqipe të cilat u botuan vetëm në disa numra dhe të cilat ishin themeluar kryesisht për qëllime të mbështetjes dhe mobilizimit të Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ). Përkundër faktit që, në shtyp kishte dalë revista e nxënësve “Hylli”, në Prizren gjatë viteve 1941, shtypi i vërtetë në gjuhën shqipe në Kosovë, sipas Monografisë⁹⁴ së “Rilindjes”, fillon me revistën “Liria”, më pas me “Zani i popullit” dhe “Zani”. “Mirëpo, vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe Revolucionit Popullor në Luftën e Dytë Botërore, me shfaqjen e shkrimeve, traktateve dhe gazetave e revistave të para në gjuhën shqipe

⁹³Hamit Boriqi dhe Mark Marku, “Historia e shtypit shqiptar 1”, (Tiranë: Ufo University Press, 2007), fq.95

⁹⁴Shënim: Në mbledhjen e Këshillit unik botues të OPGBG “Rilindja”, të mbajtur më 17 shtator 1984, ku u trajtua përgatitjet për krenimin e 40-vjetorit të “Rilindjes”, si dhe propozimi i programit të krenimit, u vendos që të botohet MONOGRAFIA e “Rilindjes”. Me këtë rast u formua edhe Këshilli për Monografi: *Maksut Shehu, Rexhai Surroi, Mustafa Rushiti, Ali Sutaj, Ali Rexha, Zenun Celaj, Adem Shkreli, Ekrem Pasholli, Misha Jovici, Haki Hoxha, Sedat Dida, Ismail Kastrati, Milovan Vitkoviq, Qani Mehmedi, Qamil Batalli, Vehap Shita, Shemsi Mehmeti, Mustafa Shala e Nehat Islami*

në Kosovë (Liria, Zani i popullit, Zani, etj), fillon jetën e vet të vërtetë edhe shtypi në gjuhën shqipe, që do të marrë formën e përpjesëtimit të vetëm pas çlirimit të vendit, kur filluan të krijohen edhe kushtet objektive për zhvillimin e tij”.⁹⁵

Sipas Monografisë së “Rilindjes”, revistat e botuara në këtë periudhë: “Zani”, “Liria”, “Zani i popullit”, ishin themelet e publicistikës dhe gazetarisë socialiste në Kosovë, shkrimet publicistike të së cilave ishin proklamuese dhe propagandistike për përhapjen, popullarizimin dhe depërtimin e ideve dhe koncepteve komuniste. Natyrisht që gazeta më e rëndësishme nga viti 1945 deri në vitet 1990-të, ishte “Rilindja”, numri i parë i së cilës ishte botuar më 12 shkurt të vitit 1945, që përbëhej prej 4 faqesh. “Rilindja” e cila sipas monografisë së saj konsiderohej si politike, në numrin e parë të saj katërfaqëshe kishte vetëm opinione të themeluesve të saj, në kryeartikullin “T’i përveshmi punës...” , me autor Fadil Hoxha, dhe numri i parë i saj kishte rreth 3 mijë ekzemplar. Megjithatë, botimi i gazetave dhe revistave të cekura më lart, gjatë kësaj periudhe ishin, kryesisht, pjesë e agjendave dhe propagandave politike, të fokusuara nga qarqet e jashtme antishqiptare. Një pjesë e këtij shtypi gjatë kësaj periudhe janë themeluar në gjuhën shqipe si rezultat i propagandës, mobilizimit dhe manipulimit me masën për ngjarje të caktuara historike në të cilat ka kaluar Kosova dhe Ballkani. Fjala vjen, revistat “Zani”, “Iliria” dhe “Zani i popullit”, kryekëput ishin të krijuara për mobilizimin e masës në Luftën Nacionalçlirimtare.

Më vonë, në vitin 1972 themelohet edhe gazeta “Kosova”, e cila është botuar me rastin e manovrave. Po ashtu, këto gazeta kritikuan me gjuhë të ashpër gazetat e themeluara në gjuhën shqipe që kishin projekte nacionale. “Gjatë okupacionit, kuislingët shqiptarë nën hijen dhe përkrahjen e okupatorëve fashistë nxjerrin në Kosovë gazetat: ‘Lidhja e Dytë e Prizrenit’ dhe ‘Kosova’, ku botohen materiale që fare pak kanë lidhje me letërsinë, e që janë më shumë pamflete plot helm shovinist”.⁹⁶ Ndërkohë, nga vitet 1950-70, në Kosovë konsolidohen një numër i gazetave dhe revistave. “Prej atëherë filluan të dalin me radhë, kryesisht, në gjuhën shqipe disa gazeta e revista: gazeta për të rinjtë ‘Zani i rinisë’, e cila më vonë, në vitin 1952 u shndërrua në revistë të ilustruar për të rinjtë, pastaj ‘Gazeta e pionierëve’ e cila më 1949 u shndërrua në revistë letrare për fëmijë, ‘Pionieri’, më 1946 revista për çështje shoqërore kulturore ‘Përparimi’, e cila prej 1955 del si revistë për kulturë; revista letrare ‘Jeta e re’, pastaj revista për arsimin shëndetësor ‘Shëndeti’ e

⁹⁵Monografia “Rilidja 1945-1985” (Tekste për monografi), (Prishtinë: Rilindja, 1985), fq.10

⁹⁶Po aty, fq.12

të tjera, që kohë pas kohe paraqiteshin ose shuheshin si ‘Ndërtuesi’, gazetë për punëtorë, ‘Agimi’, organ i Frontit Antifashist të Grave, ‘Bujku i ri’, ‘Fiskulturisti i Kosovës’, etj’.⁹⁷

Pakënaqësitë sociale, padrejtësitë e vazhdueshme etnike dhe fillim-fundi i rënies së komunizmit në botë, e kishte kthyer Federatën e Jugosllavisë drejt një shpërbërje të përgjakshme në fillim të viteve ’90-ta. Pa dyshim që ndër pakënaqësitë më të mëdha në Jugosllavinë e asaj kohe ishin nga populli shqiptar brenda federatës, të cilat shumë herë kishin shpërthyer me revolta e demonstrata gjithë popullore. Si rezultat i një situatë të brishtë, sipas studiuesve të historisë së gazetarisë, shteti i serb i heq autonominë Kosovës dhe i mbyll të gjitha mediet në gjuhën shqipe: Televizionin e Prishtinës - me 5 korrik 1990, më pas e mbyll gazetën “Rilindja” dhe në këto rrethana Kosova futet në një terr informativ, edhe pse këto medime ishin pjesë e pushtetit komunist dhe kontrolloheshin nga mekanizmat shtetëror. Mirëpo, sipas autorit Milazim Krasniqi, mbyllja e këtyre medimeve dhe nevoja për informim në rrethana të brishta në Kosovë, i kishte mobilizuar qytetarët e Kosovës që të krijojnë medie nacionale me agjendë shqiptare. “Prej kësaj kohe fillon procesi i pavarësimit të medieve shqipe në Kosovë. Procesi i pavarësimit fillon me daljen si gazeta ditore, pa lejen e autoriteteve, të revistave ‘Fjala’, ‘Zëri’, ‘Shkëndija’ e ‘Kosovarja’ si gazeta ditore, si zëvendësim për gazetën e kaluar, punën që vazhdoi deri në vitin 1993”.⁹⁸ Krijimi i këtyre gazetave ditore, edhe pse në rrethana të vështira, kishte ndikuar në afirmimin e vendit dhe informimin e pavarur dhe korrekt për ngjarjet në të cilat kishte kaluar vendi.

Mirëpo, sipas Krasniqit, në vitin 1993, gazetarët në Kosovë ishin futur në grevë, e cila kishte sjellë më pas edhe hapje të tjera të medieve të shkruara. “Pas grevës së gazetarëve të majit 1993, revista ‘Bujku’, mori atributin e gazetës ‘Rilindja’, me të njëjtin personel e në të njëjtat objekte. Ndërsa revistat dëboheshin nga objektet e veta, ato vazhdojnë botimin si revistat jashtë sistemit. Filloi edhe botimi i disa revistave private, si ‘Forumi’ dhe ‘Koha’, e cila më vonë u shndërruan në gazeta ditore”.⁹⁹ Krasniqi, në përfundimet e tij thekson se në mënyrë paradokse okupimi klasik i vitit 1990, kishte sjellë çlirimin e medias nga kontrolli shtetëror serb e jugosllavë. Në rrethana të vështira, me kushte të pafavorshme dhe të rrezikshme, këto media të shtypura kishin arritur që ta mbajnë të informuar opinionin publik deri në fillimin e luftës në Kosovë, duke vepruar brenda territorit të Kosovës, e më pas duke ushtruar veprimtarinë e tyre gjatë luftës jashtë kufijve

⁹⁷Monografia “Rilidja 1945-1985” (Tekste për monografi), (Prishtinë: Rilindja, 1985), fq.12

⁹⁸Milazim Krasniqi “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, (Prishtinë: Rozafa, 2016), fq.137

⁹⁹Milazim Krasniqi “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, (Prishtinë: Rozafa, 2016), fq.137

të Kosovës. Në këtë studim të historisë së shtypit, vlerëson lart kontributin e medieve të viteve '90-të, sidomos në mbrojtjen e interesit nacional të shqiptarëve dhe mbajtjen gjallë të informimit deri në përfundim të luftës në Kosovë, në vitin 1999. “Prandaj gazetaria e viteve '90-të të shek. XX meriton që të njihet e të respektohet, paçka se në planin profesional shumë gjëra në atë periudhë nuk kanë qenë në nivelin më të lartë”.¹⁰⁰

Gazetat dhe revistat e viteve '90-të, të botuara në Kosovë, sipas studimit të “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, janë si në vijim:

- Agjencia e lajmeve “Qendra Informative e Kosovës” (QIK),
- Gazeta “Bota Sot”,
- Gazetë e mbrëmjes “Informatori”,
- Televizioni Publik Shqiptar “TVSH”, dy orë emision për Kosovën,
- Gazeta “Koha Ditore”,
- Gazeta “Kosova Sot”,
- Revista “Bota e re” - revistë studentore
- Gazeta “Gazeta shqiptare”
- Gazeta “Kombi”.

2.4 Mediet në Kosovë pas çlirimit

Pas çlirimit, në vitin 1999 në Kosovë, vendoset administrata ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara me mision në Kosovë, me kompetenca qeverisëse. Administrata Ndërkombëtare në kuadër të funksionimit të saj, menjëherë kishte ndërmarrë masa administrative ndaj medieve, ku sipas studimit të “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, ky mision ndërkombëtar përveç masave administrative, kishte bërë edhe mbylljen përfundimtare të gazetës “Rilindja” dhe “Televizionit të Prishtinës”. Misioni i UNMIK-ut, kishte paraparë në rregulloret e miratuara për mediet e shkruara masa të rrepta ndëshkimi pa të drejtë ankese ndaj gjitha atyre gazetave që nuk i përfillin rregullat e caktuara nga ai. “2.1 Komisari i përkohshëm i medieve mund t’ua imponojë një ose më shumë masa të mëposhtme ndëshkuese pronarëve, udhëheqësve të ndërmarrjeve, botuesve, kryeredaktorëve dhe personave të cilët kanë kontrollin kryesor dhe përfundimtar në redaktimin e publikimeve që botohen dhe shpërndahen brenda Kosovës, e të cilët punojnë në kundërshtim me

¹⁰⁰Po aty, fq.140

ligjin në fuqi dhe me kodeksin apo rregullat e sjelljes, të cilat dalin nga neni 1.2 dhe 4.1 i kësaj Rregulloreje, siç janë: (a) vërejtje; (b) kërkesa për ta botuar përgjigjen, përmirësimin ose faljen; (c) gjoba jo më e ulët se 1.000 DM dhe jo më e lartë se 100.000 DM; (d) konfiskimi i pajisjeve dhe i materialit të shtypur, (e) pezullimi ose ndalimi i punës”¹⁰¹. Në kuadër të këtyre rregullave ndëshkuese, ky mision mbyll të përditshmen “Dita”.

Një vit më vonë misioni i UNMIK-ut, nxjerr një dokument, sipas të cilit, themelohet Radio Televizioni Publik i Kosovës (RTK), duke e mohuar në këtë formë vazhdimësinë e Televizionit të Prishtinës dhe përmes neneve të dokumentit “Mbi themelimin e Radio Televizionit të Kosovës”, nxjerr përkufizime dhe specifika të veçanta që duhet t’i përfillë transmetuesi publik. “Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB 1244) të datës 10 qershor 1999, duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/36 mbi Licencimin dhe rregullimin e medieve elektronike në Kosovë, të datës 17 qershor 2000, me qëllim të themelimit të Radio Televizionit të Kosovës si shërbim i transmetimeve publike në Kosovë”¹⁰². Presioni mbi mediet elektronike dhe të shkruara kishte vazhduar sidomos gjatë Trazirave të Marsit 2004, ku misioni i UNMIK-ut, bashkë me atë të OSBE-së, i kishin fajësuar mediet për raportimin e tyre. Prandaj, qëllimi themelor i UNMIK-ut, nuk ishte promovimi i vlerave perëndimore, mbrojtja e fjalës së lirë dhe avancimi i shtypit, por shkëputja historike e tij, shkëputja kulturore dhe krijimi i identiteteve të reja. Përpjekja e këtij misioni për ta kontrolluar shtypin përmes rregulloreve dhe urdhëresave të tij pati tendencë deri në periudhën e ndryshimit të statutit final të Kosovës.

Pas Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, fillon një fazë e re e pluralizmit medial. Përmes akteve më të larta juridike, mediet janë të mbrojtura dhe iu garantohet liria e tyre me ligj. Sot, në Kosovë, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është medium i vetëm publik, ndërsa

¹⁰¹UNMIK, RREGULLORE NR.2000/37 “MBI SJELLJEN E MEDIAVE TË SHKRUARA NË KOSOVË”, UNMIK/REG/2000/37, 17 qershor 2000,

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_37.htm, (18.08.2017)

¹⁰²UNMIK, RREGULLORE NR. 2001/13 “MBI THEMELIMIN E RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS”, UNMIK/REG/2001/13, 15 qershor 2001

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_13.htm, (18.08.2017)

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Radiotelevizioni 21 (RTV21) dhe Kohavision (KTV), janë televizione me frekuencë nacionale. Gjithashtu në tregun medial në Kosovë ka dhjetëra televizione lokale, dhjetëra radiostacione dhe qindra portale apo gazeta online. Ndërkaq, sa i përket shtypit, aktuale janë gazetat: “Koha Ditore”, “Kosova Sot”, “Epoka e re”, “Zëri”, “Bota Sot”, “Bota Press” si dhe dhjetëra revista të ndryshme të profileve të ndryshme profesionale. Sot mediet në Kosovë kanë rol të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore, politike e shtetërore.

KAPITULLI III

RASTI STUDIMOR: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”

3.1 Kompilimi i Trazirave të Marsit 2004

Trazirat e Marsit të vitit 2004, përveçqë konsiderohen si ngjarjet më të rëndë ndëretnike në Kosovë, për shumë studiues kjo ngjarje konsiderohet si vazhdimësi e problemeve të vazhdueshëm shekullore në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Njëri nga figurat më të rëndësishme politike të viteve ‘90-ta, njohës i politikës shqiptaro-serbe, anëtar bordi në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) në kohën e trazirave, Milazim Krasniqi, në librin “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, publikon një studim për Trazirat e Marsit të vitit 2004 me titull: “Lufta Ballkanike e filluar në vitin 1912 nuk ka përfunduar ende”. Në këtë pjesë të këtij punimi të disertacionit, nëpërmjet metodës së kompilacionit, do të paraqesim të gjeturat e studimeve që lidhen me këtë ngjarje të rëndë ndëretnike. Sipas Krasniqit, këto ngjarje e rikthyen vëmendjen e institucioneve ndërkombëtare, duke ua rikujtuar atyre se ‘status quo-ja’ e imponuar ndaj qytetarëve të Kosovës nuk mund të mbahet për një kohë të gjatë. “Drejtimi i sulmeve të protestuesve shqiptarë ndaj personelit dhe ndaj pasurisë së UNMIK-ut, u shndërrua në përgjigje ndaj një tendence të ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës dhe të kthimit të saj në një çështje që mund të zhagitet pafundësisht dhe që ndoshta duhet të kërkojë zgjidhje në një kuadër me bashkësinë serbo-malazeze”.¹⁰³ Pra kjo situatë, sipas tij, është krijuar pas deklaratave të shpeshtuara, kryesisht nga vendet e Bashkimi Evropian (BE), se çështja e Kosovës duhet rikthyer si ‘problem të brendshëm të Serbisë’. Ndërkaq, në studim paraqiten një mori faktesh të cilat e bëjnë të papërfunduar problemin në mes të shqiptarëve dhe serbëve që nga viti i largët 1912. Sipas këtij studimi, padrejtësitë e mëdha ndaj shqiptarëve në konferencat dhe traktatet ndërkombëtare gjatë shek. XX, ndarja e tokave shqiptare në dysh, torturat, masakrat dhe dëbimet e vazhdueshme ndaj shqiptarëve të Kosovës për vite me radhë nga ana e shtetit serb, si dhe mosrespektimi i shqiptarëve as në nënshkrime të marrëveshjeve, kanë ngritur në shkallë të lartë urrejtjen dhe kjo ‘status quo’, brenda misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut në Kosovë, e ka bërë këtë luftë mes shqiptarëve dhe serbëve të papërfunduar. Një çështje tjetër e cila theksohet në këtë studim është ajo e falsifikimit të historisë nga ana serbe, që nga periudha

¹⁰³Milazim Krasniqi, “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, (Prishtinë: Zëri ynë, 2011), fq.31

e Betejës së Kosovës, shenjtërimit të saj. Kjo e theksuar në këtë studim po e mban lart urrejtjen në mes të dy popujve, paqen dhe të ardhmen evropiane të tyre.

Sipas tij, statusi i pa definuar i Kosovës e ritheksoi se vetëm me trupat ndërkombëtare në terren nuk mund të ketë stabilitet rajonal. “Por, nga trazirat e marsit 2004 u bë e qartë se çështja e Kosovës nuk mund të zgjidhet as vetëm si çështje e sigurisë me prezencën masive të trupave të NATO-s, sepse edhe kjo po konsumohet me shpejtësi”,¹⁰⁴ thekson Krasniqi duke shtuar se e vetmja zgjidhje do të mbetet Pavarësia e Kosovës. Edhe publicisti Belul Beqaj, në një studim të tij për Trazirat e Marsit 2004, thekson se krahas disa arritjeve, misioni ndërkombëtar në Kosovë kishte dështuar në disa çështje konkrete. “Krahas krijimit mjaft të qëndrueshëm të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, ishin të pranishme edhe dështimet evidente të misionit ndërkombëtar në Kosovë, veçmas në fushën e funksionalizimit të drejtësisë dhe sigurisë sikurse edhe të integritetit të minoriteteve në institucionet e përkohshme”.¹⁰⁵ Sipas këtij studimi, misionet ndërkombëtare arsyetojnë veten e vet duke fajësuar mediet, dhe duke i realizuar qëllimet e tyre për t’i vënë nën kontroll mediet në Kosovë. Sipas Beqajt, edhe pse kanë kaluar tetë vite nga paslufta nën administrimin e përkohshëm civil e ndërkombëtar, mjerisht kjo kohë ka kaluar dhe nuk ka shërbyer në përgatitjen dhe aftësimin e institucioneve të Kosovës.

3.2 Konteksti studimor i ngjarjes së Trazirave të Marsit 2004

Trazirat e 17 marsit të vitit 2004, ishte ngjarja më e rëndë në Kosovën e pas luftës. Në këtë ngjarje sipas raportit ndërkombëtar të prezantuar në Këshillin e Përgjithshme të OKB-së, humbën jetën 19 persona, nga të cilët 11 shqiptarë dhe 8 serbë si dhe 954 persona u plagosën gjatë përleshjeve. Gjithashtu, të plagosur sipas këtij raporti kanë mbetur 65 oficerë ndërkombëtarë, 58 pjesëtarë të policisë së Kosovës, si dhe 61 pjesëtarë të KFOR-it. Përveç dëmeve në njerëz rreth 730 shtëpi kanë mbetur të dëmtuara, si dhe dhjetëra objekte të trashëgimisë kulturore e fetare. Në këtë raport theksohet se në këto trazira që kishin ndodhur për rreth një javë, kishte rezultuar me sulme ndaj pjesëtarëve të misioneve ndërkombëtare, me ç’rast një pjesëtar ndërkombëtar i policisë dhe një pjesëtar i policisë së Kosovës kishin vdekur nga një sulm i organizuar.

¹⁰⁴Milazim Krasniqi, “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, (Prishtinë: Zëri ynë, 2011), fq.36

¹⁰⁵Belul Beqaj, “Çfarë ishte roli i RTK-së në trazirat e marsit 2004”, (Prishtinë: N.Sh. “Studio Forma”, 2007), fq.48

Duke u bazuar në metodën e studimit të rastit, do të trajtohen ngjarje që kishin zgjatur disa ditë, që përveç viktimave, ato dëmtuan rëndë procesin e statusit të Kosovës dhe vënë në dyshim suksesin dhe punën e misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut. Në raportin zyrtar të këtij misioni, të publikuar pas trazirave, ky mision, duke mos marrë përgjegjësinë për atë që kishte ndodhur në terren, një pjesë të konsideruar të fajit e hedh në drejtim të medieve, të cilat i akuzon për nxitje të trazirave. “Efekti grumbullues i këtyre incidenteve erdhi si rezultat i raportimit të keq mediatic, të njëanshëm dhe nxitës. Demonstratat të cilat në fillim dukeshin spontane, shpejt morën elemente të organizuara dhe grumbulluese”.¹⁰⁶ Më tutje në këtë raport ishte theksuar se mediet elektronike gjatë dy ditëve të para të trazirave ishin të prira për një gazetari të pasaktë, nxitëse, të njëanshme dhe sensacionale, ndërsa gazetat, sipas këtij raporti, të afërta me partitë politike, kishin ndjekur modelin e kapjes së ngjarjeve duke raportuar me qasje ‘antiserbe’.

Megjithatë, këto konkluzione në raport me mediet ishin kundërshtuar ashpër nga përfaqësuesit e organizatave të gazetarëve dhe redaksitë mediale, duke e vlerësuar punën e tyre profesionale dhe brenda standardeve të raportimit. Gjithashtu, ky mision qysh në vitin 2001, përmes një rregulloreje, kishte paraparë masa të rënda disiplinore ndaj medieve të cilat do të vepronin në nxitje të urrejtjes ndëretnike dhe ndërftare. Prandaj, në qoftë se mediet, që sipas UNMIK-ut kanë raportuar njëanshëm dhe kanë bërë nxitje të trazirave, atëherë pse ky mision i cili ka krijuar rregulla të ashpra për mediet në këto raste, nuk ka ndërmarrë ndonjë masë para se të ndodhnin trazirat. Edhe në raportin e publikuar para ngjarjeve të marsit, në fund të janarit 2004, gjendjen e sigurisë në Kosovë e konsideronte të qetë, me gjithë disa incidente të kufizuara.

Pra, ky mision ndërkombëtar nuk kishte paraparë sinjale të një eskalimi të situatës, apo shfaqjes së pakënaqësive përmes trazirave. Po ashtu, në këtë raport i cili ishte i fundit para trazirave, përfaqësuesit e UNMIK-ut, nuk kishin shënuar brenda këtij raporti madje asnjë paragraf, përmes të cilit në Këshillin e Sigurimit do t’iu tërhiqej vërejtje medieve në përgjithësi, se po bënin nxitje të urrejtjes ndëretnike dhe raportim joprofesional. Por, cilat ishin agjendat e medieve dhe ngjarjet kryesore gjatë muajit mars dhe a kishte elemente apo tendenca të një rritjeje për destabilizim dhe shpërthim të pakontrolluar të dhunës ndëretnike në formë të organizuar? Në fillim të marsit ishte raportuar për vendosjen e pajisjeve shpërthyes pranë ndërtesës së UNMIK-ut në

¹⁰⁶UNMIK, Security Council “Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo”, 30 april 2004, fq. 2, https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/S-2004-348.pdf, (19.08.2017)

Prishtinë. Gjatë këtij muaji, me 12 mars, një granat dore kishte shpërthyer në rezidencën e presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, sulm nga i cili nuk kishte shkaktuar të vdekur dhe të plagosur. Më datën 15 mars një i ri serb ishte vrarë në fshatin Çagllavicë afër Prishtinës, ku më pas serbët lokal kishin bllokuar rrugën e qarkullimit për automjete Prishtinë-Shkup. Më 16 mars Shoqatat e Veteranëve të Luftës (ShVL), kishin organizuar protestë gjithpopullore për ta kundërshtuar arrestimin e katër ish-luftëtarëve të UÇK-së, njëherësh pjesëtarë të TMK-së, nga ana e policëve të UNMIK-ut, me ç'rast ishin sulmuar disa zyre rajonale të këtij misioni. Gjithashtu, gjatë këtyre ditëve ishte planifikuar dhe organizuar një demonstratë paqësore, si shenjë kundërshtimi për sulmin ndaj rezidencës së presidentit Ibrahim Rugova. Një problem shqetësues dhe permanent si për institucionet e Kosovës, ashtu edhe për misionin ndërkombëtar ishte situata në veriun e Kosovës e cila vazhdimisht ishte e brishtë dhe e paqëndrueshme.

Në kontekstin e kësaj, ngjarja e fundit para fillimit të trazirave ishte ajo e 16 marsit, me ç'rast në lumin Ibër kishin humbur jetën tre fëmijë shqiptarë, që sipas raportimeve kishin qenë duke ikur nga një grup serbësh. Nisur nga rezymeja e këtyre ngjarjeve të zhvilluara gjatë pjesës së parë të muajit mars, nuk paraqiten indikacione që mund të ishin shenjë paralajmëruese për trazira spontane e të dhunshme ndëretnike, edhe pse situata e tensionuar shihej në çdo embrion social. Në shumicën e këtyre ngjarjeve që ishin temat qendrore të ditës, sipas analizës së bërë brenda shtypit të kësaj periudhe, nuk raportohet dhe nuk kishte indikacione për nxitje të trazirave ndëretnike, apo tema që trajtonin raportet në mes shqiptarëve dhe serbëve. Përkundrazi, nga ngjarjet e zhvilluara dhe raportimet e medieve më tepër shihej një pakënaqësi e rritur ndaj institucioneve ndërkombëtare, kryesisht, misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, ndaj të cilit kishte pasur sulme me bomba dhe protesta masive. Megjithatë, kjo ngjarje përfundimisht mbeti një enigmë më vete, përkundër akuzave dhe fajësimeve që iu mëveshën medieve. Edhe sot, pas katërmëdhjetë viteve ende shkruhet dhe raportohet për trazirat e dhunshme të vitit 2004, dhe ende mbetet i paqartë epilogu dhe e vërteta përfundimtare. Prandaj, gjatë këtij punimi shkencor, duke i testuar hipotezat e ngritura më lartë, dhe analizës së raportimit të shtypit nëpërmjet qasjes kritike, do të japim një përgjigje shkencore e profesionale të përgjegjësisë së medieve të shkruara dhe mënyrës së raportimit të tyre për këtë valë dhune.

Impakti i kësaj ngjarje rezulton me dëme njerëzore dhe materiale, me një imazh të brishtë të Kosovës në agjendën ndërkombëtare, me vonesë dhe shtyrje të statusit përfundimtar të Kosovës, shpenzime milionëshe për kompensimin e dëmeve të shkaktuara, me rritje të ndasive dhe

përçarjeve ndëretnike në Kosovë si dhe me një disavantazh të Kosovës në agjendat e saja ndërkombëtare, ku vlen të theksohet propaganda serbe kundër kërkesës së Kosovës për anëtarësim në UNESCO, në fund të vitit 2015, me ç’rast pamjet e trazirave të vitit 2004 ishin mjeti më i fortë i përdorur nga propaganda e shtetit serb.

3.3 Trazirat e Marsit 2004 një ngjarje që edhe sot ka impakt

Edhe pse kanë kaluar më tepër se katërmbëdhjetë vite nga trazirat e marsit të vitit 2004, kjo ngjarje ende vazhdon të mbetet një çështje e pambyllur, pa përgjegjësi politike dhe pa verdikt të drejtësisë. Pikërisht, gjatë viti 2017, prokurori italian Danilo Cecareli, i një misioni tjetër ndërkombëtar në Kosovë, atij evropian të EULEX-it, ka pretenduar se pas analizimit të provave të UNMIK-ut, ka ardhur në përfundim se Trazirat e Marsit të 2004-ës janë organizuar nga ish-struktura të UÇK-së. “Hetimet e kryera nga prokurori italian tentojnë të ofrojnë prova se grupi ishte në mesin e zbatuesve të planit për trazirat e marsit 2004, të cilët shkaktuan dhjetëra të vrarë dhe dëme të mëdha në imazhin e vendit. Grupi ishte pjesa qendrore e organizimit dhe ekzekutimit të Trazirave të Marsit në mes datave 17 mars dhe 19 marsit”,¹⁰⁷ është thënë në dokumentin që e ka ofruar prokurori Cecareli, duke theksuar më tej se ky grup kishte armë dhe municione, dhjetëra kallashnikovë, pushkë të tjera martalozë 12.7 mm, dhjetëra granata të cilat ishin blerë në Shqipëri, e të cilat supozohet se do përdreshin në rast se trazirat do të shkonin keq. Prandaj, sipas pretendimeve të këtij prokurori, grupi i cili përbëhej kryesisht nga Bedri Krasniqi, Alban Dezdari, Bajram Kiqmari dhe Faik Shaqiri, kishte qenë përgjegjës për vrasjen e një pjesëtari të policisë së UNMIK-ut dhe një pjesëtari të policisë së Kosovës.

Pretendimet e Cecarelit i kanë vënë në lëvizje mekanizmat e drejtësisë të cilët kanë arrestuar dy persona të cilët lidhen drejtpërdrejt me ngjarjet e Trazirave të Marsit 2004. “Prokuroria e Shtetit konfirmoi se dy persona janë arrestuar, një tjetër pritët të ekstradohet ndërsa persona të tjerë mbeten në kërkim për një rast të vrasjes së dy zyrtarëve të UNMIK-ut të vitit 2004 dhe tentim vrasjen ndaj dy të tjerëve”.¹⁰⁸ Mirëpo, njëjtë sikurse në vitin 2004, përfaqësuesit politikë i

¹⁰⁷Labinot Leposhtica, “Dosja e EULEX për Trazirat e Marsit 2004, Urdhra nga Struktura të Larta të UÇK-së”, Kallxo.com, Prishtinë, 6 korrik 2017, <https://kallxo.com/dosja-e-eulex-per-trazirat-e-marsit-2004-urdhra-nga-struktura-te-larta-te-uck-se/> (21.08.2017)

¹⁰⁸Përparim Isufi, “Dy të Arrestuar për Vrasjen Dy Zyrtarëve të UNMIK-ut më 2004”, Kallxo.com, Prishtinë, 5 korrik 2017, <http://kallxo.com/dy-te-arrestuar-per-vrasjen-dy-zyrtareve-te-unmik-ut-me-2004/>, (21.08.2017)

kundërshtojnë pretendimet e prokurorit të EULEX-it, dhe gjetjet e tij për trazirat e marsit, duke i quajtur krejt këto si pretendime me motive politike. Njëri nga ish pjesëtarët e UÇK-së, njëherësh ish-ministër në periudhën e trazirave, Jakup Kransiqi, e ka quajtur politike këtë aktakuzë, duke thënë se sikur të ekzistonin faktet, kjo punë do të kryhej shumë më përpara. “Tash duhet me pa ma shumë këtë aktakuzë. Unë mendoj që ajo është dashtë të bëhet me kohë. Kjo që del tash më shumë është politikë sesa drejtësi”.¹⁰⁹ Në ndërkohë, misioni i EULEX-it, ka lëshuar një deklaratë lidhur me këtë rast, duke theksuar se ky rast nuk ka të bëjë asgjë me Gjykatën Speciale.¹¹⁰

Në anën tjetër ish-këshilltari i kryetarit të Kuvendit, Ramush Tahiri, këtë rast e quan krejtësisht politik. “Aktakuza duhet me qenë faktike sepse na gjyqet politike i kemi hequr me ish Jugosllavinë. Këto që thuhet se është organizuar nga struktura të larta të UÇK-së, UÇK-ja në atë kohë s’ka ekzistuar, UÇK-ja është demobilizuar herët dhe janë krijuar strukturat tjera”.¹¹¹ Ai thekson se askush nuk i ka vuajtur pasojat e kësaj ngjarje më tepër se vetë qytetarët e Kosovës. “Sa e di unë dhe sa mund të flas unë me kompetencë, përfitime politike askush s’ka pas por vetëm dame. Serbia e ka shfrytëzuar ma shumë sepse e ka nxjerrë më vonë Ligjin për decentralizmin dhe për mbrojtjen e monumenteve kulturore-historike”.¹¹² Prandaj, ngjarjet e dhunshme të marsit mbeten edhe më tutje një pikë mospajtimi në mes të përfaqësuesve politikë shqiptarë dhe atyre të misionit ndërkombëtarë. Nëse shikohen raportet ndërkombëtare të paraqitura në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), nga ana e përfaqësuesve të saj në Kosovë, shihet qartë se përgjegjësinë e fajit e hedhin vetëm në kurrizin e shqiptarëve, duke pretenduar se përmes trazirave të dhunshme, në ngjarjet e marsit është provokuar një spastrim etnik. Mirëpo, ndërkombëtarët asnjëherë nuk e kanë ngritur çështjen se përse në këto trazira ndëretnike shumica e viktimave janë shqiptarë, apo t’i thellonin hetimet e tyre se kush i vrau këta qytetarë të Kosovës.

¹⁰⁹Taulant Osmani, “Kosovarët Nuk Pajtohen me Prokurorin e EULEX-it për Trazirat e Marsit 2004”, Kallxo.com, Prishtinë, 9 korrik 2017, <http://kallxo.com/kosovaret-nuk-pajtohen-prokurorin-e-eulex-per-trazirat-e-marsit-2004> (21.08.2017)

¹¹⁰**Sqarim:** Më 3 gusht 2015, deputetët e Kuvendit të Kosovës më 82 vota pro, kanë votuar Amendamentin për ndryshimin e Kushtetutës, që mundëson themelimin e Gjykatës Speciale, e cila do të merret me dyshimet për krime të luftës. (Më shumë: <http://www.dw.com/sq/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-votoi-pro-themelimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-speciale/a-18624966> (3 mars 2018))

¹¹¹Taulant Osmani, “Kosovarët Nuk Pajtohen me Prokurorin e EULEX-it për Trazirat e Marsit 2004”, Kallxo.com, Prishtinë, 9 korrik 2017, <http://kallxo.com/kosovaret-nuk-pajtohen-prokurorin-e-eulex-per-trazirat-e-marsit-2004> (21.08.2017)

¹¹²Po aty.

Kjo ngjarje pothuajse çdo vit përkujtohet si ngjarja më e rëndë e pasluftës dhe vazhdimisht kërkohet nga ana e organizatave të ndryshme vendore e ndërkombëtare që të zbardhet e vërteta e saj, dhe dikush të japë përgjegjësi për viktimat, dëmet dhe imazhin e keq që i kanë shkaktuar Kosovës.

3.4 Rrethanat politike në Kosovë

Lufta në Kosovë gjatë viti 1998-99, gjenocidi serb ndaj shqiptarëve, spastrimet etnike të mbi një milion qytetarëve të Kosovës të dëbuar jashtë kufijve të saj, e kishte detyruar faktorin ndërkombëtar në krye me aleancën e NATO-s, që të fillonin bombardimet ndaj ish-Jugosllavisë për 78 ditë, deri te dorëzimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes së paqes. Marrëveshja e cila ndalon luftën në Kosovë, ishte marrëveshja “Military Technical Agreement”¹¹³ (Marrëveshja Tekniko-Ushtarake), e nënshkruar në Kumanovë, në mes të Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë e Republikës së Serbisë, më datën 9 qershor 1999. Sipas kësaj Marrëveshje, të dy palët rikonfirmuan pajtimin rreth dokumentit të presidentit Ahtisaari, të paraqitur para presidentit të Jugosllavisë Milosheviç dhe të miratuar nga Parlamenti serb dhe qeveria Federale me 3 qershor 1999, për përfshirjen e Kosovës nën mbikëqyrjen e OKB-së, me prezencën ndërkombëtare civile dhe të sigurisë.

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e autorizoi Sekretarin i Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave tjera ndërkombëtare të përgatisë misionin civil ndërkombëtar në Kosovë. “Autorizon Sekretarin e Përgjithshëm që me ndihmën e organizatave të tjera relevante ndërkombëtare, ta krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të vendosë një administratë të përkohshme për Kosovën, nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbajtjesore në kuadër të RFJ-së dhe e cila do të sigurojë administrim kalimtar gjersa themelon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës”.¹¹⁴ Me kalimin e Rezolutës 1244 në Këshillin e Sigurimit (KS),

¹¹³Kumanovo Military Technical Agreement (NATO) June 1999, https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/Kumanovo%20Military%20Technical%20Agreement%20%28NATO%29%20June%201999.pdf (24 gusht 2017)

¹¹⁴UNMIK, Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara, Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999. <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara> (24.08.2017)

të miratuar nga shtetet më të fuqishme botërore, Kosova edhe zyrtarisht kalon nën qeverisjen ekzekutive dhe mbikëqyrjen ushtarake ndërkombëtare. Pra, në Kosovë edhe zyrtarisht vendoset administrata ekzekutive ndërkombëtare e njohur me shkurtesën UNMIK, e cila kishte për detyrë që të krijonte administratë funksionale dhe t'i krijonte institucionet vetëqeverisëse në Kosovë, brenda një autonomie Jugosllave. Misioni i UNMIK-ut, i autorizuar nga Këshilli i Sigurimit, përveçqë obligohej të raportonte për situatën në Kosovë, çdo tre muaj, duhej ta përgatiste Kosovën për një fazë tjetër politike. “11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë: a) Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysht aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648); b) Kryerjen e funksioneve themelore civile administrative, aty ku ka nevojë dhe për aq kohë sa kërkohet; c) Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve; d) Bajtjen e përgjegjësisë të veta administrative institucioneve që do të themelohen, duke mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes; e) Të ndihmohet një proces politik me qëllim të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysht marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648); f) Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike; g) Përkrahjen për rindërtimin e infrastrukturës kyçe dhe për rindërtimin tjetër ekonomik; h) Përkrahjen, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare humanitare, për ndihmën humanitare dhe ndihmën në raste të fatkeqësive; i) Ruajtjen e ligjit dhe të rendit, përfshirë këtu themelimin e forcave policore lokale dhe ndërkohë përmes vendosjes së personelit policor ndërkombëtar që të shërbejë në Kosovë; j) Mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut; k) Garantimin e kthimit të shpejtë dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë”.¹¹⁵

Pra, nisur nga këto pika të nxjerra nga ana e Këshillit të Sigurimit, dhe duke u bazuar në metodën e gjeneralisimit do të paraqesim një shpjegim të zgjeruar të kësaj pjese të kontekstit të këtij studimi. Pra, misioni i UNMIK-ut, që kishte statusin neutral karshi Kosovës, ishte i obliguar

¹¹⁵UNMIK, Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara, Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999. <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara> (24.08.2017)

që brenda një periudhe tri vjeçare, duke u bazuar në aneksin e dokumentit të Rambujesë, e nënshkruar nga pala ndërkombëtare, shqiptare, dhe e refuzuar nga ajo serbe që ta përgatiste Kosovën për një proces tjetër politik, atë të statusit të saj final. Marrëveshja e Rambujesë në Francë, e cila ishte nënshkruar nga pala shqiptare, përveç formës së vetëqeverisjes, në fund të saj, në paragrafin e tretë parashihet që pas tri viteve nën administrimin ndërkombëtar, qytetarët e Kosovës, të kenë të drejtën e vetëvendosjes, deklarimit të tyre për të ardhmen e vendit. “3. Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, do të mbledhet një takim ndërkombëtar, për të përcaktuar një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, opinioneve të autoriteteve përkatëse, përpjekjet e secilës palë lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Aktit Final të Helsinkit dhe që të ndërmerren vlerësimet e përgjithshme mbi implementimin e kësaj Marrëveshjeje, duke i konsideruar propozimet nga cilado palë për masat shtesë”.¹¹⁶ Prandaj, nisur nga këto marrëveshje ndërkombëtare për Kosovën, të cilat kanë varshmëri dhe ndërlidhje njëra me tjetrën, do të duhej që deri në vitin 2002 eventualisht 2003, të diskutohej për statusin final të Kosovës.

Edhe pse ishte vendosur në vitin 1999, administrata e UNMIK-ut, e cila ishte e autorizuar, tek në fund të vitit 2001, arriti të organizojë zgjedhje të lira në Kosovë, ndërsa t’i krijojë institucionet në gjysmën e parë të vitit 2002. Katër vite pas çlirimit situata politike dhe sociale në vend ishte e brishtë. Pjesa veriore e Mitrovicës kishte mbetur në një gjendje krize, mosbashkëpunimi politik i faktorit vendor dhe politikat neutrale të UNMIK-ut, karshi statutit të Kosovës, privilegji karshi pakicave e në veçanti pakicave serbe, gjendja e rëndë ekonomike, arrestimi i disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), pakënaqësia ndaj të pagjeturve, kishte krijuar në përgjithësi një situatë të brishtë në Kosovë. Qëndrimi i UNMIK-ut karshi situatës në veriun e Kosovës, njëzet vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës, dhjetë për serbët dhe dhjetë për pakicat e tjera, ndërtimi i shtëpive për komunitetin serb dhe kthimi i tyre në Kosovë, dhe takimi me përfaqësues të Beogradit, kishte krijuar perceptim te shqiptarët se politikat e UNMIK-ut ishin në kundërshtim me interesat e shqiptarëve në Kosovë.

Këto pakënaqësi shumë herë kishin rezultuar me protesta e sulme kundër UNMIK-ut. Pakënaqësitë dhe sulmet ndaj këtij misioni, i dërguari special i OKB-së i kishte raportuar

¹¹⁶OKB, Këshilli i Sigurimit, “Annex Rambouillet Accords- Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo”, 18.03.1999, fq.85,
http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf (24.08.2017)

vazhdimisht në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të OKB-së, seancat për Kosovën. Edhe në raportin e parë të vitit 2002, ishin paraqitur dhe evidentuar sulme dhe pakënaqësi kundër administratës së përgjithshme ndërkombëtare në Kosovë, atë të UNMIK-ut, në një incident të tillë të shënuar më 7 janar. Në raportin e dytë të prezantuar në mbledhjen e përgjithshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në muajin prill, Përfaqësuesi Special paraqet shqetësimet e tij për pakënaqësitë e shtuara ndaj UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke theksuar për një fushatë të medieve kundër tyre. “Një shqetësim i ri ka qenë rritja e vazhdueshme kundër KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut, si dhe anëtarë të tjerë të UNMIK-ut dhe zyrtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës. Një nga incidentet më të këqija të një dhune të tillë erdhi pas arrestimit në fund të janarit të tre ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nën akuzat për krime kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë 1998 dhe 1999. Protestat e zemëruara kulmuan me lëndimin e disa policëve të UNMIK-ut në Prishtinë me 8 shkurt si dhe dëmtimi i disa automjeteve të UNMIK-ut, dhe një fushatë mediatike anti-UNMIK-u”.¹¹⁷

Gjithashtu gjatë vitit pasues pothuajse raportet janë të ngjashme. Në vitin 2003, përfaqësuesi i UNMIK-u raporton në Këshillin e Sigurimit, të OKB-së për pakënaqësinë ndaj UNMIK-ut, si dhe vazhdimin e arrestimit dhe dënimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Një pakënaqësi dhe pasiguri te shumica shqiptare ishte mosfillimi i diskutimit për definicionin e statusit final të Kosovës. Disa vite pas një administrimi ndërkombëtar, Kosova mbetej ende një vend i lirë, por i pa definuar, që për qytetarët e saj do të thoshte pakënaqësi dhe brengosje. Ndër të tjera, gjatë kësaj periudhe shihet një pakënaqësi e theksuar ekonomike, sipas raportimeve ditore të shtypit, ku Kosova vazhdonte të mbetej një vend i pazhvilluar, ndërkohë sindikatat e punëtorëve e kishin rritur presionin ndaj UNMIK-ut duke kundërshtuar mënyrën së privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Duke analizuar raportet e prezantuara të UNMIK-ut për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, shihet një rritje e pakënaqësisë së qytetarëve ndaj këtij misioni, kjo sepse, sipas raportimeve në medie, UNMIK-u nuk po punonte për t’i ndryshuar gjërat në favor të qytetarëve. Ky mision në vend që t’i krijonte modelin e bashkëjetesës, paraqitej i njëanshëm dhe jo integruar. Kjo i kishte rritur pakënaqësitë dhe ndasitë edhe më shumë brenda komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

¹¹⁷OKB, Këshilli i Sigurimit, Report of the secretary-General on the United Nation Interim Administration Mission in Kosovo, 22 aprill 2002, (https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/S-2002-436.pdf) (25.08.2017)

Edhe pse kishin kaluar pesë vite nga mbarimi i luftës, ndasitë mes shumicës shqiptare dhe asaj serbe ende ishin të thelluara, e temat e trajtuara për çështjet etnike paraqisnin shumë ndjeshmëri. Qëndrimet e UNMIK-ut, puna e tij, dhe mostransparenca e këtij misioni ishte kritikuar nga organizatat joqeveritare, të cilat në tryeza të ndryshme dhe në takime me ndërkombëtarët e kishin kritikuar këtë mision për mosbashkëpunim të mjaftueshëm.

3.5 Raportimi i shtypit para Trazirave të Marsit 2004 dhe pasqyrimi i situatës së përgjithshme (10-17 mars 2004)

Pas paraqitjes së kontekstit të ngjarjes së Trazirave të Marsit 2004, në këtë pjesë të këtij rasti studimor është bërë analizë mbi mënyrën e raportimit të shtypit, për periudhën para fillimit të trazirave, për të nxjerrë rezultate konkrete për përfshirjen e shtypit në ngritjen e tensioneve ndëretnike. Padyshim që, kur shfaqen zhvillime të tensionuara, dhe kur situata e përgjithshme ka brishtësi shumëdimensionale, roli i shtypit dhe kërkesat e publikut për t'u informuar rritën, dhe bashkë me to edhe formimi i opinionit publik. Se roli i shtypit ndryshon në kontekste të ndryshme, thekson në studimin për media studiuesi Dominick, sipas të cilit, konteksti përbën një pjesë të rëndësishme dhe të veçantë të medieeve. “Duhet të theksojmë se nuk është vetëm përmbajtja e medias që përcakton përdorimin nga ana e audiencës, por edhe konteksti social, në kuadër të të cilit shfaqet përmbajtja mediatike”¹¹⁸ - ka theksuar ai, duke ofruar shembuj nga raste të tjera kontekstuale sesi telefilmata, komeditë, revistat e filmave, etj., përbëjnë materiale të cilat, sipas tij, mund të përdoren me qëllim që të tërheqin vëmendjen nga diçka.

Në mars të vitit 2004, Kosova përjetoi ngjarjen më të rëndë ndëretnike, ngjarje e cila konsiderohet si më e rënda që nga koha e hyrjes së KFOR-it në Kosovë, në qershor të vitit 1999. Në këtë pjesë të studimit, bazuar në metodën e analizës deduktive, do të shohim sesi ka raportuar shtypi për një javë rresht deri në ditën e trazirave. Shtypi ditor gjatë kësaj periudhe kishte raportuar dhe mbuluar të gjitha aktivitetet ditore, duke i dhënë prioritetin kryesor ngjarjeve të cilat kanë pasur relevancë për publikun. Shtypi, pra, nga 10 deri më 17 mars të vitit 2004, në agjendën kryesore i ka pasur ngjarjet dhe zhvillimet politike, për të cilat ka raportuar dhe i ka kushtuar pjesën më të madhe të hapësirës së tij. Në kuadër të kësaj, një pjesë e madhe e gazetave është fokusuar në interpretimin e ngjarjeve kryesore, duke i ofruar publikut detaje të reja dhe informacione shtesë

¹¹⁸Joseph R. Dominick “Dinamika e komunikimit masiv/Media në periudhën digjitale”, (Tiranë: UET press, 2010), fq. 88

për zhvillimet kryesore në vend. Natyrisht që, mediet i kanë mbuluar, gjithashtu, ngjarjet nga fushat e tjera të rëndësishme si: në fushën e ekonomisë, trajtimin e temave sociale, arsimore, kulturore, sportive etj.

Mediet konsiderohen pushteti i katërt në vendet demokratike, ato trajtojnë tema dhe ngritin çështje të cilat janë në interes të publikut. Me gjithë pakënaqësitë e UNMIK-ut, shtypi ka qenë kohë pas kohe kritik ndaj këtij misioni, por edhe ndaj politikës vendore, por, gjithnjë duke trajtuar profesionalisht tema relevante për publikun dhe shoqërinë. Mirëpo, ka pasur gazeta të cilat e kanë kritikuar UNMIK-un për sjellje të njëanshme dhe të pabarabartë në raport me etnitë brenda Kosovës, ku, edhe është kritikuar për mospërfillje të mjaftueshme ndaj shumicës shqiptare në Kosovë. Natyrisht, gjatë analizës kritike të teksteve në shtypin ditor për këtë periudhë janë evidentuar politika editoriale, të cilat kanë reflektuar brenda nuancave të teksteve. Do të fillojmë me një kronologji të raportimit për të parë rolin e shtypit në kontekstin e trazirave të mesit të marsit 2004.

E përditshmja “Koha Ditore”, me datën 10 mars, kishte trajtuar temën kryesore të ditës për fatin e të zhdukurve dhe takimin e parë të grupit punues për të zhdukurit në mes Prishtinës dhe Beogradit, me ndërmjetësimin e UNMIK-ut. Natyrisht që, temat e tilla kanë ndjeshmëri të veçantë për publikun, duke pasur parasysh numrin e madh të të zhdukurve në luftën e fundit, për fatin e të cilëve ende nuk dihej, mirëpo në asnjë rrethanë një gjë e tillë nuk mund të konsiderohet si provokim ndëretnik, apo raportim i parëndësishëm. “Takimi i parë për të zhdukurit nuk zbardhi gjë”.¹¹⁹ Gjatë raportimit për ngjarje të ndjeshme, gazetarët duhet të kenë kujdes të veçantë dhe profesionalizëm të lartë, sepse këto tema janë të ndjeshme për publikun dhe kanë lexueshmëri të madhe. Mbititulli, titulli dhe nëntitulli në këtë tekst është informues, i drejtpërdrejtë, brenda të cilit ishin dhënë informacione nga puna e grupit punues. Teksti i ndërtuar sipas stilit të piramidës së përmbysur, me kreun e drejtpërdrejtë, i mbështetur në citate dhe i balancuar sipas standardeve profesionale të raportimit. Pra, ky tekst për nga mënyra e trajtimit është profesional, i bazuar në standarde profesionale dhe me relevancë të madhe, i cili s’mund të mos ishte edhe teksti kryesor i ditës. Edhe tekstet e tjera të trajtuara brenda këtij numri janë kryesisht tema profesionale, të cilat lidhen me aktualitetin e ditës si dhe me ngjarjet kryesore të cilat ishin në kuadër të zhvillimeve politike. Edhe raportimet, të cilat lidhen me komunitetin serb, janë kryesisht tema ditore, të bazuara kryesisht në reagimet dhe deklaratimet e tyre, siç është teksti: “Serbët nuk do të marrin pjesë në sesionet e

¹¹⁹Arben Rugova, “Takimi i parë për të zhdukurit nuk zbardhi gjë”, *Koha Ditore*, 10 mars 2004, fq.1

Kuvendit - shqyrtojnë tërheqjen nga komisionet e Kryesia”.¹²⁰ Pakicat serbe kishin reaguar ndaj pikturave të vendosura në hollin e Kuvendit të Kosovës, kur ishte bërë renovimi i tij, duke i cilësuar ato si nacionaliste shqiptare dhe pa përmbajtje artistike. Prandaj, ata kishin kërcënuar me largim nga punimet e Kuvendit, nëse ato nuk largohen dhe nuk mbulojnë. Kjo temë e cila me të drejtë ishte trajtuar nga shtypi, assesi nuk mund të konsiderohet si diçka e pazakontë, joprofesionale apo me elemente të nxitjes ndëretnike. Mirëpo, brenda kësaj ngjarje shihet edhe njëherë pafuqia e shumicës në raport me pakicën serbe, të cilët kishin mbështetje të madhe të UNMIK-ut. Padyshim, kjo temë tregon edhe njëherë ndasitë e mëdha që ekzistojnë ndërmjet shumicës shqiptare dhe, në këtë rast, pakicës serbe.

Ditë më vonë Kuvendi i Kosovës i kishte mbuluar muralet, pas takimeve me përfaqësuesit e UNMIK-ut, gjë që në opinionin publik ishte pritur me mjaft shqetësime. Prandaj, kritikën në adresë të UNMIK-ut, nuk do të duhej të llogariten si tendencioze dhe joprofesionale, sepse mediet vetëm kanë raportuar për një ngjarje, e cila në esencë te publiku ka prodhuar frustrim ndaj këtij misioni ndërkombëtar. Më 11 mars, gazeta “Koha Ditore”, në ballinën e saj, temë kryesore të ditës ka nxjerrë takimin në mes UNMIK-ut dhe shteteve të Kuintit, tema kryesore e secilës ndërlidhej me dialogun me Serbinë, privatizimin dhe standardet para statusit. Nisur nga fuqia politike, kjo temë ka relevancë për publikun. “Dialogu, privatizimi, standardet në rrugë të duhur”.¹²¹ Mirëpo, përkundër kësaj, gjatë kësaj dite raportohet për një përplasje politike në mes institucioneve ndërkombëtare, përfaqësuesve politikë shqiptarë dhe pakicës serbe për çështjen e muraleve. Shefi i UNMIK-ut, Harri Holker, e kishte takuar kreun e Kuvendit të Kosovës, për t’i bërë preson për largimin e muraleve të cilat i konsideronte me motive nacionale shqiptare, ndërkohë që, serbët e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, nën përkrahjen e UNMIK-ut, kishin kërcënuar me bojkot të këtij institucioni dhe me bojkot në zgjedhjet lokale të caktuara për në tetor, nëse s’do të laroheshin muralet me motive shqiptare. Këto zhvillime, natyrisht që, për publikun vazhdojnë të ngjallin pakënaqësi ndaj UNMIK-ut, dhe ndaj kërkesave të pakicës serbe, sepse shqiptarët sikurse edhe popujt e tjerë, simbolet kombëtare i bëjnë të ndjeshëm dhe reagues. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur edhe tri shpërthime me granata në lagje të ndryshme të Prishtinës, ku njëra nga to afër selisë së UNMIK-ut, në Prishtinë. Megjithatë, ky lajm është publikuar në faqen tre, me strukturë dhe korrektësi brenda standardeve profesionale, i bazuar në deklaratatë të përfaqësuesve dhe

¹²⁰Po aty, fq.3

¹²¹Arben Rugova, “Dialogu, privatizimi, standardet në rrugë të duhur”, *Koha Ditore*, 11 mars 2004, Prishtinë, fq.1

zyrtarëve të sigurisë. “Shtimi i patrullave të policisë së UNMIK-ut dhe atyre të SHPK-së, policët e veshur me rroba civile që vëzhgojnë rrugët e kryeqytetit, policët e vendosur nëpër pullaze të ndërtesave dhe të institucioneve të UNMIK-ut, qeverisë, etj., janë disa nga masat që janë ndërmarrë pas shpërthimit të fundit në Prishtinë si dhe me rastin e vizitës së zyrtarit të OKB-së, Jean Marie Guehno, të mërkurën në Kosovë”.¹²² Pra, gjatë këtyre ditëve “Koha Ditore” kishte raportuar vazhdimisht për zhvillimet kryesore, mirëpo përkundër deklaramit nga ana e KFOR-it, për një situatë të qetë dhe stabile, zhvillimet në terren flasin për shpërthime me granata dore dhe masa të shtuara të sigurisë. Se situata politike dhe e sigurisë në Kosovë është e brishtë e në veçanti në pjesën veriore të saj, e thekson shefja e UNMIK-ut, për veriun e Mitrovicës, Mina Jarranpa, duke e cilësuar situatën atje të pikëlluar dhe të trishtuar. “... ky qytet vazhdon të jetë një qytet i pikëlluar dhe i trishtuar, me plot probleme për herë të parë prej se është ndarë, ka pasur rastin të ndeshet me një propozim politik dhe ekonomik konkret si dhe të dalë nga kriza që e ka mbërthyer”,¹²³ kishte theksuar shefja e UNMIK-ut për Mitrovicën veriore, gjatë një takimi në Bruksel, në të cilin kishte marrë pjesë edhe ish-kryeministri i Kosovës dhe përfaqësuesit serbë të veriut. Të shtunën më 13 mars 2004, është sulmuar rezidenca e presidentit Ibrahim Rugova. Kjo e dëshmon situatën e paqëndrueshme politike dhe të sigurisë. Ndërsa gazeta “Koha Ditore” i jep rëndësi kësaj ngjarje të rëndësishme për publikun, të detajuar me informacione dhe deklarata zyrtare. “Një pjesëtar i sigurimit i rezidencës në ‘Velani’ lëndohet në sulmin me granatë dore - Sulmohet rezidenca e Rugovës, LDK-ja paralajmëron protesta në Prishtinë - Sulmi ndaj rezidencës së kryetarit Rugova është një akt kriminal ndaj institucionit më të lartë të Kosovës. Policia e UNMIK-ut dhe ShPK-ja duhet të tregohen më efikase pasi ka shumë sharlatanizëm. Këtu veprojnë 150 qendra të sigurimit të Serbisë, të udhëhequr nga kriminelë të kërkuar nga Gjykata e Hagës. Kështu është shprehur pas vizitës që i bëri kryetarit Rugova, kryeparlamentari, Nexhat Daci”.¹²⁴

Pra, vetëm një ditë pas tri granatave të hedhura në Prishtinë që kishte rezultuar me shtimin e masave të sigurisë nga ana e UNMIK-ut dhe ShPK-së (Shërbimit Policor të Kosovës), të nesërmen ishte sulmuar Presidenti i Kosovës. Në anën tjetër, kryeparlamentari, Nexhat Daci, udhëheqës i njërës nga tri institucionet më të rëndësishme në vend, përveçqë e dënon sulmin, ai,

¹²²Arben Rugova, “Dialogu, privatizimi, standardet në rrugë të duhur“, *Koha Ditore*, 11 mars 2004, Prishtinë, fq.3

¹²³Po aty, fq.3

¹²⁴Po aty, fq.3

pothuajse, gjykon sulmuesit e tij, të cilët i ndërlihd drejtpërdrejt me pushtetin në Serbi dhe e vlerëson një gjë të tillë si hap të destabilizimit të Kosovës.

Nga kjo situatë e brishtë në vend nuk ishin kursyer as gazetarët të cilët po ndiheshin të rrezikuar nga situata e krijuar, dhe pengimin e kryerjen e punës profesionale. Gjatë një tryeze të mbajtur nga gazetarët, ishte diskutuar për rritjen e sulmeve ndaj tyre, ata kishin theksuar se vazhdimisht po ndihen të kërcënuar si rezultat i punës së tyre profesionale. “Petrit Musolli bashkë me kameramanin e RTK-së, në protestën e 4 marsit të organizuar nga LPK-ja dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, duke filmuar është goditur me tullë në kokë nga disa persona, të cilët veçmas, përpos, protestimit hidhnin gurë drejt dyqaneve përreth”,¹²⁵ ndërsa në takim paraqiten raste të tjera dhe pengesa të krijuara për gazetarët, madje edhe nga përfaqësues të institucioneve, për shkak të temave që i trajtojnë brenda redaksive të tyre. Sulmet me granata ndaj institucioneve vendore e ndërkombëtare ishin kthyer në një përditshmëri. Pas sulmit në rezidencën e presidentit Rugova, një ditë më pas shtypi raporton për një sulm tjetër me granatë në selinë e UNMIK-ut në Mitrovicë, me ç’rast gazeta “Koha Ditore”, duke e vlerësuar këtë ngjarje e vendos me të drejtë në ballinë. “Shpërthimi ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të së shtunës, afër selisë së UNMIK-ut në Mitrovicë. Zyrtarët e policisë thanë se shpërthimi ka ndodhur rreth orës 02:00 dhe gjithashtu njoftuan se nuk ka pasur të lënduar apo dëme materiale”.¹²⁶ Pra, gazeta “Koha Ditore” gjatë kësaj periudhe kishte trajtuar vazhdimisht tema të cilat i plotësojnë kriteret e raportimit.

Edhe në të përditshmen “Epoka e re”, raportimi gjatë periudhës njëjavore para dhunës ndëretnike, në shumicën e rasteve ka raportuar brenda standardeve profesionale, duke i trajtuar temat aktuale, të cilat i plotësojnë vlerat dhe kriteret e raportimit. “Pas Prishtinës, dialogu shkon në Beograd”,¹²⁷ ky ka qenë lajmi kryesor, i cili flet për takimin në mes delegacionit shqiptar dhe serb të ndërmjetësuar nga përfaqësues ndërkombëtarë, për çështjen e fatit të të pagjeturve. Duke analizuar aspektin profesional, ky lajm brenda të cilit paraqiten palë me mendime dhe gjykime diametralisht të kundërta, teksti është jashtëzakonisht i balancuar dhe nuk paraqet ndonjë njëanshmëri apo ndonjë element i cili do të ndikonte në tensione ndëretnike.

Edhe pse konsiderohet për nga mënyra e raportimit “Epoka e re” si gazetë nacionale, ajo gjatë raportimit të përditshëm të saj, ka qenë profesionale në raport me trajtimin e komuniteteve të

¹²⁵Gjergj Filipaj, “Gazetarët tregojnë rrëfimet për sulmet ndaj tyre”, *Koha Ditore*, 13 mars 2004, fq.4

¹²⁶Koha Ditore, “Shpërthim para selisë së UNMIK-ut në Mitrovicë”, 14 mars 2004, fq.1

¹²⁷Jeton Musliu, “Pas Prishtinës, dialogu shkon në Beograd”, *Epoka e re*, 10 mars 2004, fq.1

tjera, ndërsa, përmes disa teksteve ka qenë kritike e ashpër profesionale e UNMIK-ut, me ç'rast një gjë tillë theksohet më së shumti në editorialet dhe opinionet e botuara në këtë të përditshme, për të cilat do të diskutohet në një kapitull tjetër. Në datën 12 mars në ballinën e kësaj gazete paraqiten dy tekste kritike ndaj misionëve ndërkombëtare. Në njërin tekst flet veprimtari Adem Demaçi, i cili në një intervistë ekskluzive i kritikon delegacionin shqiptar në Rambuje për nënshkrimin e marrëveshjes. “Demaçi: Nuk dua të festoj me ata që thonë se ishin ushtarë të Adem Jasharit, ndërsa pranuan Rambujenë, Rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese. UNMIK-ut e Serbisë u duhen liderë me bisht të zënë me derë”,¹²⁸ ndërsa në tekstin e dytë kritikohet një gazetë e cila po financohej nga OSBE-ja, dhe që politikën editoriale të saj ishin kundër Kosovës. “OSBE-ja vazhdon të ndajë mjete të konsiderueshme për botimin e gazetës së çoroditur ‘shqipe’ ‘Kasneci i ri’”. Kjo farë gazete boton artikuj nga katër komunat e Rrafshit të Dukagjinit. Për të mbajtur në jetë fondacionet aty lejohen të botohen edhe tekste fyese deri në atë shkallë saqë Shtëpia e Kulturës në Burim “Adem Jashari”, ende u quajtka “Sveti Sava”, kurse Burimi, jo Istog siç i pëlqen LDK-së, por ngul serbisht, Istok, siç shkruhet në faqen 7 të asaj “novine”.¹²⁹

Pra, nga këto dy tekste të trajtuara shihet qartë edhe politika editoriale, e cila reflekton në tekstet e kësaj të përditshme, mirëpo trajtimi i ngjarjeve është i bazuar dhe argumentuar në fakte dhe deklaratat konkrete. Natyrisht që, kur situatat dhe zhvillimet janë drejt tensioneve edhe tekste të tilla kanë efektin e tyre te publiku. Misioni i UNMIK-ut, në disa raste në raportet e rregullta, të paraqitura në Këshillin e Përgjithshëm të OKB-së, i kishte akuzuar disa media, të cilat sipas këtij misioni me politikën editoriale të raportimit janë anti UNMIK. Mirëpo, raportimi kritik ndaj këtij misioni nuk mund të cilësohet si joprofesional, sepse gjatë analizimit të teksteve është vërejtur se raportet janë ndërtuar, duke u bazuar në standardet profesionale të raportimit. Në numrin e 15 marsit, kjo gazetë kishte kritikuar UNMIK-un dhe OKB-në, për krijimin e enklavave serbe në Kosovë. Përmes një teksti kritik ndaj vizitës në Istog të nënkryetarit të OKB-së, Zhan-Mari Gueheno, i cili kishte vizituar serbët e kthyer në atë komunë. “Ka pikëpamje në Burim se UNMIK-u, duke anashkaluar pushtetet vendore në Kosovë, kur janë në pyetje serbët, po e ndihmon me të madhe enklavizimin e mëtejme të pakicës serbe në Kosovë, siç bëri kësaj here me vizitën e fundit,

¹²⁸Jeton Musliu, “Pas Prishtinës, dialogu shkon në Beograd”, *Epoka e re*, 10 mars 2004, fq.1

¹²⁹Epoka e re, “‘Kasneci i ri’, Sveti Sava, Istoku, riserbizimi i Kosovës”, 12 mars 2004, fq.6

Guehenos në Llukavc të Thatë të Burimit”,¹³⁰ tekst i cili përfundon me një kritikë të ashpër ndaj këtij misioni, i cili mund të duket edhe si raportim i njëanshëm nga ana e UNMIK-ut.

Në këtë të përditshme kritikën ndaj misionit ndërkombëtar të OKB-së janë shtuar pas arrestimeve të disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me ç’rast në këtë gazetë, po në këtë numër publikohet një intervistë me drejtorin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Bexhet Shala, i cili akuzon misionet ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të njeriut. “Shala: Shkelësi kryesor i të drejtave të njeriut është UNMIK-u, e pastaj KFOR-i”,¹³¹ citohet Shala, i cili kishte dhënë një intervistë për “Epokën e re”, ku kishte folur edhe për shumë tema të tjera dhe zhvillime politike.

Ndërsa, duke u nisur nga zhvillimet politike, ekonomike e sociale, kjo gazetë i ka kushtuar një hapësirë të veçantë me datën 16 mars, protestës gjithpopullore, të Shoqatave të Luftës së UÇK-së, kundër arrestimeve të ish-pjesëtarëve të saj. “UNMIK-u dhe gjithë ata që janë kundër Pavarësisë së Kosovës, po mundohen me gjithë forcat që luftën tonë ta krahasojnë me luftën gjenocidiale të armikut. Nëse kjo arrihet do të kthehem në gjendjen okupuese, siç ishim dikur”.¹³² Sipas analizës së përgjithshme të këtyre teksteve, kjo e përditshme i jep një rëndësi të veçantë vlerave nacionale, me ç’rast, përveç raportimeve ditore, janë trajtuar tema që ndërlidhen me vlerat e luftës. Natyrisht, ky raportim i cili ka synim mbrojtjen e vlerave, gjithnjë brenda raportimit profesional, ka rënë në kundërshtim me politikën e UNMIK-ut dhe në këtë mënyrë në rritjen e pakënaqësisë ndaj UNMIK-ut, por edhe në brishtësinë të përgjithshme në Kosovë.

E përditshmja tjetër, gazeta “Zëri”, gjatë kësaj periudhe deri në ditën e trazirave ka raportuar brenda standardeve profesionale, duke i respektuar edhe rregullat e shkrimit të teksteve dhe duke paraqitur në anën tjetër një politikë të balancuar editoriale në raport me ngjarjet gjatë këtyre ditëve, e sidomos me ato që mund të sillnin tensione. Raportimi në këtë të përditshme i ka trajtuar të gjitha temat aktuale relevante të misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, dhe ka treguar një profesionalizëm edhe karshi ngjarjeve politike vendore, si rastit të sulmit me granata ndaj rezidencës së presidentit Rugova, sulmeve me granata ndaj misionit të UNMIK-ut, apo edhe ndaj protestave të organizatave të veteranëve të UÇK-së. “Më thirrje kundër politikës së Administratës Ndërkombëtare në Kosovë, posaçërisht kundër atyre veprimeve që u cilësuan kundër vlerave të

¹³⁰Rifat Sadikaj, “Kështu po krijohet enklava e re në Burim”, *Epoka e re*, 15 mars 2004, fq.2

¹³¹Rifat Sadikaj, “Kështu po krijohet enklava e re në Burim”, *Epoka e re*, 15 mars 2004, fq.5

¹³²Epoka e re, “Ngritet në këmbë gati e gjithë Kosova”, 16 mars 2004, fq.4

luftës çlirimtare, mijëra protestues në 27 komuna të Kosovës iu kanë bërë të martën thirrje institucioneve vendore, dhe në veçanti administratës së UNMIK-ut që ta rishqyrtojnë në tërësi politikën ndaj Kosovës dhe ndaj luftës së drejtë të UÇK-së”.¹³³ Ky paragraf i kreut i shoqëruar në ballinë me një foto të protestës e pasqyron të gjithë ngjarjen nëpërmjet një rezymeje të asaj që ka ndodhur gjatë protestës dhe kërkesave të dala nga aty, pa paragjykuar as motivet e protestës e as motivet e misionit ndërkombëtar.

Ndërkaq e përditshmja “Bota Sot” gjatë këtyre ditëve është shquar për një mënyrë të veçantë të raportimit. Politika editoriale e kësaj gazete e cila reflekton qartë në tekstet e analizuara në përgjithësi e sidomos në kryeartikuj, shihet një politikë mbështetëse ndaj presidentit Rugova dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Edhe kryeartikujt e trajtuar në shumicën e rasteve gjatë këtyre ditëve të analizës janë joaktuale. Për nga mënyra e raportimit, duke u bazuar në analizën e teksteve shihet se mënyra e raportimit dhe politikat editoriale janë antipodi i raportimit të së përditshmes tjetër të analizuar më lartë, gazetës “Epoka e re”. Kjo ilustron edhe në shembullin e mëposhtëm: “Kur janë takuar së bashku presidenti i Kosovës dr. Ibrahim Rugova me Komandantin Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhjetë vjet më parë, disa falsifikator të sotëm të fotografive dhe të historisë nuk kanë qenë fare në Kosovë ose nuk kanë dëgjuar fare për Adem Jasharin, as për rezistencën e armatosur të popullit shqiptar të Kosovës kundër okupatorit serb. Hashim Thaçi e Adem Jashari nuk janë takuar e as nuk janë fotografuar së bashku në uniformë të UÇK-së”.¹³⁴ Pra, ky është kreu përmbledhës i komentuar brenda një fotografie të arkivës, i cili përveçse nuk bazohet në tregim, është një gjykim editorial i gazetës, me ç’rast gazetari shpreh opinionin e tij ndaj një çështje në esencë të ndjeshme për publikun. Gjithashtu, kjo temë nuk e kishte relevancën e kohës. Një tekst, i dyti për nga rëndësia në ballinë, po aq gjykues sa i pari, është botuar në të njëjtin numër të shtypur me titull nxitës. “‘Koha Ditore’, si një konkiubinë e Beogradit që tregon histori konspirative me Brukselin për ndarjen e Kosovës”.¹³⁵ Një hapësirë të veçantë kjo e përditshme ia kushton zhvillimeve në Shqipëri, dhe vazhdimisht ka tekste nga atje që paraqesin, kryesisht, zhvillimet politike. Për t’i pasqyruar politikat editoriale më qartë në këtë të përditshme mund të shohim edhe në analizën e teksteve kryesore të datës 12 mars, meç’rast në këtë të përditshme lajmi kryesor është një ngjarje protokollare e takimit të presidentit të Kosovës

¹³³F.Hoti, E. Musa, “Protestuesit i bënë thirrje UNMIK-ut që ta rishqyrtojë politikën ndaj UÇK-së”, *Zëri*, 17 mars 2004, fq.4

¹³⁴Bajrush Morina, “Fotografia origjinale dhe falsifikatorët e historisë”, *Bota Sot*, 10 mars 2004, fq.4

¹³⁵Po aty, fq.4

Ibrahim Rugova, me nënsekretarin e OKB-së Zhan Mari Gueno, ndërsa në plan të dytë është deklarata e ambasadorit amerikan Hollbruk, i cili gjatë një takimi me shqiptarët në Amerikë ka deklaruar se: “Kosova do të jetë e pavarur me ose pa pëlqimin e Serbisë”.¹³⁶ Pra, në vitin 2004, ka pasur pak politikanë të cilët e kanë paragjykuar statusin final të Kosovës, e aq më tepër ndonjë përfaqësues ndërkombëtar në Kosovë, ndërkaq ky raport i ofrohet lexuesit në faqen nëntë. Prandaj, nisur nga mënyra e raportimit dhe politika editoriale e kësaj të përditshme, mund të theksojmë se në kuadër të të gjitha zhvillimeve dhe brishtësisë në Kosovë, ka ndikuar në polarizimin e shoqërisë.

3.6 Raportimi në media për shkaktarët e organizimit të trazirave

Sa herë që ndodhin trazira, protesta masive dhe çrregullime sociale, përveç analizimit faktik, gjithnjë ngrihen dilema dhe pyetje se: Kush qëndron prapa këtyre reagimeve? Kush e orkestroi masën? Kush e manipuloi publikun? Këto dilema dhe enigma shtohen edhe më tepër në vendet me demokraci të brishtë dhe me pafuqi për t’i menaxhuar situatat e tilla, me status të pa definuar, me pushtet të dyfishtë politik, dhe me probleme të tjera sociale të cilat janë të paraqitura brenda kontekstit. Përmes metodës induktive, të përdorur në këtë pjesë të rastit të studimit, do të trajtojmë nga një këndvështrim tjetër epilogun e Trazirave të Marsit 2004. Përveç përfundimeve të bëra publike, mospajtimeve dhe kundërthënive, në këtë pjesë do të paraqesim një kontekst tjetër të kësaj ngjarjeje.

Trazirat e Marsit 2004 janë të organizuara. Ky ishte konkluzioni i parë i ardhur nga një diplomat i fuqishëm evropian, Javier Solana, përfaqësues i lartë i BE-së për Politika të Jashtme dhe Siguri, i cili i referohet shërbimeve sekrete të zbulimit. “Kemi shumë informacion nga shërbimet e zbulimit dhe gjitha informatat që kemi na çojnë në konkludimin se dhuna e javës së shkuar ishte e organizuar, prandaj edhe liderët duhet ta dinë se ne e dimë këtë”,¹³⁷ thekson Solana në një intervistë ekskluzive për gazetën e përditshme “Koha Ditore”, duke shtuar se dhuna në Kosovë nuk ishte spontane, por e organizuar. Nëse e shohim nga konteksti i tij, përmes kësaj deklarate, Solana në njëfarë forme përgjegjës për organizimin e dhunës i bën liderët politikë, të cilëve iu bënë me dije se vendet perëndimore e dinë një gjë të tillë. Diplomati i BE-së, Javier

¹³⁶B. S., “Kosova do të jetë e pavarur me ose pa pëlqimin e Serbisë”, *Bota Sot*, 12 mars 2004, fq.7

¹³⁷Augustin Palokaj, “Është mëkat që kosovarë t vetëm 5 vjet pasi u ndihmuan nga ushtarët ndërkombëtarë t’i sulmojnë ata”, *Koha Ditore*, 24 mars 2004, fq. 2

Solana i cili një ditë pas deklaratës së cekur më lart e vizitoi Kosovën, pothuajse përsëri i akuzoi përfaqësuesit politikë për orkestrim të trazirave, pas takimit që kishte me kryeministrin e asaj kohe, Bajram Rexhepi. “Nuk mjaftojnë vetëm deklaratat publike, ndërkohë që në anën tjetër, tjetër gjë në jetën private”¹³⁸ kishte theksuar gjatë një konference për gazetarë Solana, pas takimit me kryeministrin.

Në linjë të njëjtë me diplomatin evropian, paraqiten edhe zyrtarët ushtarakë të NATO-s, të cilët trazirat i konsiderojnë të orkestruara, duke dhënë zotime për arrestimin e organizatorëve. “Fokusi i NATO-s në Kosovë tash është të identifikojë, arrestojë dhe dënojnë nxitësit dhe organizatorët e dhunës së javës së shkuar dhe të krijohen kushte për kthimin e të zhvendosurve”,¹³⁹ ishte shprehur para gazetarëve një ushtarak nga komanda SHAPE, i cili kishte theksuar më tutje se është e qartë se niveli i organizimit të dhunës ka qenë i lartë. Ndërkaq, edhe në ditën e tretë radhazi, Javier Solana, kishte shprehur përsëri qëndrimin e tij se dhuna në Kosovë ishte e organizuar, por kësaj here ai e kishte adresuar atë drejt partive politike. “Dhuna nuk ishte tërësisht spontane, ajo në një mënyrë kishte filluar spontanisht, por më vonë dolën disa njerëz që ishin organizuar për ta shfrytëzuar këtë spontanitet, dhe organizuan këtë që është shumë serioze. Këta njerëz me siguri u takojnë partive politike, dhe liderët e këtyre partive duhet të dalin dhe të thonë shumë qartë se kjo nuk mund të tolerohet”.¹⁴⁰ Prandaj, duke u bazuar në deklaratat e vazhdueshme të një zyrtari të lartë të Bashkimit Evropian, i cili u referohet burimeve të sigurta, shihet qartë se sipas tij, dhuna ndëretnike sado që mund të shihej si spontane në fillim, grupet, politika apo parapolitika ishin të përfshirë në dinamikën e saj.

Se trazirat ndëretnike të marsit 2004 mund të jenë të organizuara dhe të orkestruara, kishte theksuar në një studim të tij, autori Milazim Krasniqi, që sipas tij, kishin qëllime politike dhe gjeopolitike. “Provokimet serbe në Çabër dhe në Çagllavicë dhe përgjigjja e shqiptarëve me protesta të dhunshme jashtë parashikimeve më ogurzeza që kanë mundur të bëhen, sugjerojnë se mund të ketë ekzistuar një skenar i destabilizimit të Kosovës për një qëllim më të thellë politik e gjeopolitik”,¹⁴¹ thekson Krasniqi, duke shtuar se orientimi i protestave të dhunshme kundër objekteve fetare serbe, kundër mjeteve të motorizuara të UNMIK-ut dhe kundër pjesëtarëve të

¹³⁸Blerim Xhemajli, “Solana: Dhuna e fundit e ka kthyer Kosovën me vite prapa”, *Koha Ditore*, 25 mars 2004, fq.1

¹³⁹ Augustin Palokaj, “NATO thotë se nxitësit dhe organizatorët e dhunës do të dënohen”, *Koha Ditore*, 25 mars 2004, fq.3

¹⁴⁰ Augustin Palokaj, “Solana thotë se organizatorët e dhunës në Kosovë kanë lidhje me partitë politike”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004, fq.3

¹⁴¹ Milazim Krasniqi, “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, (Prishtinë: Zëri ynë, 2011), fq.145

KFOR-it, janë elemente sugjeruese të një dëshmie të tillë. Sipas këtij studimi, plagosja e një të riu serb pati funksionin e provokimit të reagimeve serbe, të cilët reagues me bllokadë të rrugëve dhe mbytyja e tre fëmijëve shqiptarë në Çabër të Mitrovicës, pati ndikimin e provokimit të revoltës dhe të protestave të shqiptarët. Prandaj, duke u referuar më tutje në studim, këto dy ngjarje krijuan baraspeshën e revoltës dhe gatishmërinë për një përballje ndëretnike, ashtu siç edhe ndodhi. Duke iu referuar një dëshmitari të ngjarjes së transmetuar në Televizionin Publik të Serbisë, Krasniqi arrin të ngritë dyshime në përfshirjen e ndërkombëtarëve dhe UNMIK-ut në orkestrimin e Trazirave. “Një dëshmitar serb me mbiemrin Vuckoviç, në një deklaratë që e transmetoi RTS më 20 mars 2004, në rubrikën ‘Kosovo-terror-Svet’ (Kosova-Terrori-Bota), ka deklaruar se kur kafeneja që ishte në pronësi të Vuckoviçëve po digjej, një polic ndërkombëtar me armë në dorë i ka penguar që ta shuanin zjarrin. Ai u ka thënë se ‘kjo duhet të digjet sonte’,¹⁴² thuhet në pjesën e analizës që mban titullin: “Cisterna me ujë, cisterna me benzinë”. Më tutje, sipas këtij dëshmitari të cituar në këtë analizë, ka ardhur një cisternë dhe ata janë gëzuar që do të shuhej zjarri, mirëpo sipas tij, ajo nuk kishte ujë, po benzinë, e cila është hedhur për ta finalizuar djegien. Prandaj, dilemat që ngriten me të drejtë në këtë analizë janë se cili ka qenë roli i strukturave të sigurisë në krijimin e “baraspeshës së revoltës” dhe në menaxhimin e shpërthimit të saj? Cili ka qenë roli i misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut? Prandaj në këtë studim na paraqiten dy qëllime kryesore që do të fshiheshin prapa Trazirave të Marsit 2004: e para ka të bëjë me spastrimin etnik të shqiptarëve, i cili do t’i paraprinte një ndarje të Kosovës. Një gjë mund të konsiderohet e sigurt se misioni i UNMIK-ut në Kosovë, përfaqësuar nga dhjetëra shtete brenda, sigurisht që i ka krijuar kushtet e veprimit edhe të dhjetëra shërbimeve inteligjente, të cilat natyrisht se i shtyjnë para agjendat e tyre. Për t’i dhënë kuptim dhe argumentim faktit se Trazirat e Marsit janë orkestruar, shfaqen elemente të tjera.

Kryetari i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) Fatmir Humolli, në një intervistë për gazetën “Koha Ditore”, pak ditë pas trazirave të marsit, kishte theksuar se partia të cilën ai e drejton ishte munduar që ta kanalizojnë protestën, për t’i artikuluar qartë disa kërkesa politike, si dhe nuk e mohonte mundësinë e pjesëmarrjes së anëtarëve të saj në trazirat e dhunshme. “Edhe anëtarët e LKÇK-së janë pjesë e popullatës dhe nuk kanë mundur të jenë imunë ndaj daljes në protestë. Qëllimi i protestës ka qenë thjeshtë një reagim spontan dhe nuk ka pasur një artikulum

¹⁴²Milazim Krasniqi, “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, (Prishtinë: Zëri ynë, 2011), fq.147

të qartë politik. Kjo ka mundur të bëhet në proces e sipër”,¹⁴³ theksoi Humolli, për të shtuar se qëllimi kryesor i tyre ka qenë që përmes protestave të realizojnë politikat e tyre. “Ne kemi bërë përpjekje që dal nga dalë ta kanalizojmë për qëllime politike”.¹⁴⁴ Mirëpo, edhe pse kanë kaluar shumë vite nga dhuna ndëretnike, ende kjo ngjarje llogaritet si e papërfunduar. Drejtësia nuk e ka thënë fjalën e saj, përkundër faktit që në atë ngjarje ka pasur dhjetëra të vrarë e qindra të plagosur, dëme të mëdha materiale dhe mbi të gjitha një provokim të rëndë për sigurinë e përgjithshme të qytetarëve dhe një dëmtim të imazhit shqiptarëve dhe të Kosovës.

Pas rreth katërbëdhjetë viteve, televizioni “Klan Kosova” sjell një intervistë ekskluzive me të burgosurin Shkumbin Mehmeti,¹⁴⁵ i cili po e vuan burgun për vrasjen e tre policëve në vitin 2004. Mehmeti tregon se grupi të cilit ai i ka takuar ka pasur përkrahje politike nga të gjitha partitë politike të dala nga lufta, për t’i organizuar trazirat ndëretnike të marsit, të cilat kanë pasur për synim çlirimin e veriut të Kosovës. Sipas tij, i gjithë grupi të cilin gjatë intervistës në emisionin “Zona e Debatit”, në Klan Kosova, e quan kriminel, kanë marrë premtime nga subjektet politike, që pas këtyre ngjarjeve, do të kenë amnisti si dhe do t’iu krijohen favore të ndryshme. “Ne kemi shkuar në fillim të janarit [2004] dhe jemi stacionuar në Mitrovicë, kemi bërë plane, kemi bërë takime me persona të ndryshëm dhe kemi filluar t’i organizojmë Trazirat e marsit [2004]”, pohon Mehmeti gjatë intervistës, duke shtuar se qëllimi kryesor i planit ka qenë që veriu i Kosovës të sulmohet nga tri pjesë të ndryshme; përballë urës në Mitrovicës dhe dy anët e qytetit, nga ana e majtë dhe e djathtë. Sipas tij, grupi, pjesëtar i të cilit ka qenë edhe ai, ka dështuar që ta kryejë misionin me sukses, sepse njëri nga pjesëtarët e grupit i ka tradhtuar ata, sipas tij, duke bashkëpunuar me përfaqësuesit e KFOR-it francez. “Një person, fytyrë eminente që vije nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), na ka tradhtuar me KFOR-in francez. Ka pasur takime me

¹⁴³Berat Buzhala dhe Arbana Xharra, “Humolli: Do të ketë protesta sa të ketë UNMIK dhe KFOR”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004, fq.4

¹⁴⁴ Berat Buzhala dhe Arbana Xharra, “Humolli: Do të ketë protesta sa të ketë UNMIK dhe KFOR”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004, fq. 4

¹⁴⁵ **Shkumbin Mehmeti**, i dënuar për vrasjen e tre policëve në vitin 2004, dëshmitar i mbrojtur i Prokurisë Speciale të Kosovës. Gjatë intervistës, pranon se ka qenë pjesëtar i një grupi kriminel i cili ka kryer krime të shumta të pasluftës, përfshirë edhe vrasje politike. Ai thekson disa herë se grupi, pjesëtar i të cilit ka qenë edhe ai, i ka organizuar Trazirat e Marsit 2004. Intervista është trasmetuar në televisionin “Klan Kosova”, më 11 janar 2018, në emisionin “Zona e Debatit”, nga ora 21:00. Kjo intervistë gjendet në kanalën zyrtar të këtij televizioni në Youtube. Nga minuta 44:50 deri 48:40, i intervistuari Shkumbin Mehmeti flet për temën “Si dështoi plani për Trazirat e Marsit 2004?”. Intervistën mund të gjeni në linkun: (<https://www.youtube.com/watch?v=s7H1CpfP6vc>). Pjesë të intervistës të cilat janë shkëputur për punim janë marr në kanalën youtube, më 21 janar 2018.

të gjatë natës, sa ne kemi ec rrugës për të dalë në anën e djathtë në Mitrovicë. Aty ka ndodhë një incident, kemi qenë duke u vrarë mes vete edhe na është dashtë të tërhiqemi prej Mitrovicës”, ka deklaruar Mehmeti, duke e përshkruar natën e Trazirave të Marsit 2004. I burgosuri për vrasjen e tre policëve gjatë vitit 2004, në rrëfimin e tij thekson se pas dështimit për ta marrë veriun e Mitrovicës, grupi e ka humbur mbështetjen dhe fuqinë politike të cilën e ka pasur deri në atë kohë, mbështetje e cila ka qenë prej njerëzve dhe figurave të njohura politike.

3.7 Raportet medie-UNMIK

Ndër shumë funksione që kanë mediet, kryesori nga to është informimi. Këtë e konstaton edhe Stefan Rus Mol, në studimin e tij të gazetarisë. Prandaj, misioni i tyre është që të jenë aty ku ka ndodhur diçka, të informojnë publikun për ngjarjet që i rrethojnë, të informojnë publikun për ta përmbushur këtë funksion dhe këtë mision. Një javë pas Trazirave të Marsit 2004, “Klubi Republikan” kishte organizuar një tryezë me temën “UNMIK-u dhe mediet në ngjarjet e marsit”, në të cilën kishin marrë pjesë përfaqësues të medieve kryesore të vendit. Përfaqësuesit e medieve elektronike, por edhe të shtypit në mënyrë unanime e kishin akuzuar misionin ndërkombëtar të UNMIK-ut, për mostransparencë gjatë ditëve kritike të trazirave. “Të gjithë përfaqësuesit e medieve, qoftë elektronike, qoftë të shkruara, raporti me UNMIK-un gjatë ngjarjeve të marsit i sollli në një emërues të përbashkët: UNMIK-u, i mbylli dyert e informacionit për mediet kosovare në ditët kritike”.¹⁴⁶

Përfaqësuesi i Radio Televizionit të Kosovës Liridon Cahani, gjatë diskutimit e kishte akuzuar UNMIK-un për vështirësitë e krijuara në raportim, si rezultat i mbylljes për medie të zyrtare të informimit. “Me gjithë insistimet tona, nuk kemi mundur të marrim konfirmime nga ana e zyrtarëve të UNMIK-ut dhe KFOR-it për atë se çfarë po ndodhte në Mitrovicë dhe në qytetet e tjera të Kosovës, gjë që na vështirësonte punën tonë profesionale për t’iu shmangur gjysmë informatave”,¹⁴⁷ mendim i cili ishte mbështetur edhe nga përfaqësuesit e dy televizioneve të tjera me frekuencë nacionale (RTV 21 dhe KTV).

Ndërsa gazetari i gazetës “Koha Ditore”, Lundrim Aliu, kishte theksuar se mos transparenca e zyrtarëve për informim të UNMIK-ut dhe KFOR-it nuk mund të cilësohet ndryshe

¹⁴⁶ Agron Halitaj, “UNMIK-u dhe mediat në ngjarjet e marsit”, *Koha Ditore*, 27 mars 2004, fq.6

¹⁴⁷ Po aty, fq.6

përveçse një dështim i zyrtarëve kompetentë për ta kryer punën e tyre në mënyrë profesionale. Siç raporton gazeta “Koha Ditore”, mendim ndryshe kishte paraqitur Komisionari për Media, mirëpo, përkundër prezencës së përfaqësuesit të OSBE-së dhe UNMIK-ut, asnjëri nuk ishte inkuadruar në debat. Prandaj, mospërfshirja e përfaqësuesit të UNMIK-ut në këtë debat, përkundër akuzave në drejtim të tyre, lë të kuptohet se mostransparencën dhe mbylljen për medie e kanë pasur të planifikuar. Si rezultat i mosdhënies së informacionit përmes organeve kompetente, mund të konsiderojmë se mediet janë detyruar të raportojnë me gjysmë informatat që i kanë poseduar dhe në këtë rast ato kanë bërë shkelje profesionale, në njërën anë, dhe në anën tjetër, spontanisht janë përfshirë në agjendat të ndryshme, të cilat mund të kenë pasur për qëllim nxitjen e trazirave. Prandaj, përfaqësuesit institucionalë juridikisht janë të obliguar që të jenë përgjegjës para qytetarëve dhe t’i mbajnë ata të informuar për punën e tyre publike. Përveç kësaj, në situata të tilla, jo vetëm që do të duhej që zyrat për informim të jenë transparente, por edhe të punonin pa orar në mënyrë që t’i informonin mediet në formë zyrtare, duke iu ndihmuar që të mos operonin me gjysmë informacione apo informacione rrethore në terren, dhe të pa konfirmuara zyrtarisht. Po ashtu, në situata krizash institucionet janë ato të cilat krijojnë shtabe krizash, të cilat ndihmojnë në grumbullimet e plota të informacioneve, por edhe për operimet në terren dhe janë përgjegjës të situatave të krijuara, por asnjëherë nuk mund të diskutohet për mbyllje hermetike dhe ikje të përgjegjësive apo obligimeve.

Mungesën e komunikimit zyrtar mes UNMIK-ut dhe medieve e rithekson në raportin e saj edhe OSBE-ja, e cila këtë moskomunikim e quan si mungesë të besueshmërisë së ndërsjellë. “Ngjarjet po ashtu treguan qartë se ka mungesë të theksuar besimi midis zyrtarëve të Informacionit Publik të UNMIK-ut dhe gazetarëve lokalë”,¹⁴⁸ thuhet në këtë raport, duke u tentuar të shfaqësohen me çdo kusht organizatat ndërkombëtare të cilat ishin të mandatuara për ngritjen dhe cilësinë e medieve në Kosovë. “Do të ishte e pamatur dhe e padrejtë të thuhej se përpjekjet për zhvillimin e medieve nga misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) dhe donatorë të tjerë kanë dështuar. Duhet pranuar se koncepti “media e lirë” është risi në Kosovë. OMIK, Komisioneri i Përkohshëm për Media (KPM), donatorët dhe përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medieve duhet të forcojnë përpjekjet e tyre në përmirësimin e cilësisë dhe llogaridhënies së transmetuesve në Kosovë”,¹⁴⁹ thuhet ndër të tjera në raportin e dalë nga OSBE-ja, pas trazirave të marsit 2004.

¹⁴⁸OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vienë, 2004, fq.2

¹⁴⁹Po aty, fq.2

3.8 Përfundimet e kontekstit analizues studimor të ngjarjeve të Trazirave të Marsit 2004

Si përfundim i gjithë këtij konteksti të këtij rasti studimor për Trazirat e Marsit 2004, mund të vijmë në disa konkluzione të dala nga analizimi i raporteve ndërkombëtare të UNMIK-ut, nga zhvillimet politike në Kosovë, nga analiza kritike e mënyrës së raportimit të shtypit gjatë periudhës 10-17 mars 2004 dhe akuzave për organizim dhe mostransparencës së UNMIK-ut.

E para: Misioni Ndërkombëtar në Kosovë, i mandatar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, duke u bazuar në Rezolutën 1244, e detyrimisht edhe në Marrëveshjen e Rambujesë, e kishte për obligim që ta përgatiste në mënyrë institucionale Kosovën dhe të krijonte kushte që brenda tri viteve të hapë diskutimi për statusin final të Kosovës. Kjo nuk kishte ndodhur. Me krijimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë ishin krijuar dy pushtete politike, ku natyrisht promotor i fuqisë ekzekutive ishte UNMIK-u, mbështetur në një numër të organizatave të tjera ndërkombëtare, dhe, në anën tjetër, institucionet vetëqeverisëse të Kosovës, si: Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, fuqia e të cilave ishte e kufizuar, ndërsa puna e tyre vazhdimisht e monitoruar. Ndërsa, siguria e përgjithshme mbështetej nga Forca e Sigurisë Ndërkombëtare - KFOR-i, nga Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK), shërbim, i cili, sikurse, ai politik ishte pa kompetenca dhe i monitoruar nga Policia e UNMIK-ut. Ky mision me veprimet dhe arrestimet ndaj disa ish-pjesëtarëve të UÇK-së, që nga ana e tyre shihej si veprim politik, me qëndrimin neutral ndaj statusit të Kosovës, me “favorizimin”, ndaj pakicës serbe, me vonesën dhe neglizhencën për plotësimin e standardeve për statusin final dhe me kritikën e marra nga shtypi, kishte humbur besimin dhe mbështetjen e qytetarëve. Si rezultat, pakënaqësitë ndaj misionit ndërkombëtar, kishin filluar të shfaqen publikisht reagimet publike, madje, duke organizuar edhe protesta kundër tyre.

E dyta: Problemi i ndarjes së Mitrovicës, muralet në Kuvendin e Kosovës, bllokimet e rrugëve, problemi me fatin e personave të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë (1999), lejimi i ndërhyrjes së Beogradit në Kosovë dhe arrestimet ndaj disa ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe mënyra kritike e raportimit në disa gazeta të shkruara, i kishin rritur dhe promovuar ndasitë ndëretnike, tensione të cilat kishin ngritur nacionalizimin nga të dy anët.

E treta: Nisur nga zhvillimet në Kosovë, të pasqyruara përmes shtypit, shihet qartë një brishtësi e përgjithshme e cila paraqitet në disa dimensione të ndryshme. Disa raste të regjistruara të granatave të hedhura, në mesin e tyre dy në selitë e UNMIK-ut dhe njëra në rezidencën e

presidentit të vendit Ibrahim Rugova, arrestimet, protestat e LDK-së, protestat OVL-së, protestat kundër privatizimit, kundër UNMIK-ut, tensionet në Mitrovicë, dhe bllokimi i rrugëve magjistrale Prishtinë-Gjilan dhe Prishtinë-Shkup, kishin rritur pakënaqësinë e përgjithshme. Gjithashtu, gjendja e përgjithshme e rënduar politike, ekonomike, sociale e kulturore dhe mosfillimin e zgjedhjes së statusit final të Kosovës, pas pesë viteve të qeverisjes së UNMIK-ut, dhe rritjes së pakënaqësisë ndaj tij, mund të përfundojmë se situata në përgjithësi ishte e brishtë dhe pranë një shpërthimi të dhunës.

E fundit: Pika e fundit e cila është radhitur te konteksti i ngjarjes, por jo më pak e rëndësishme, është çështja e përfshirjes politike, apo ta quajmë parapolitike, në nxitjen e dhunës. Në këtë rast, patjetër duhet të renditet një numër i indikatorëve të cilët mund të jenë të përfshirë në këtë ngjarje. Grupet politike, në bazë të analizës së bërë më lart, rezultojnë se një pjesë e tyre ishin të përfshirë në nxitjen e trazirave. UNMIK-u, si mision politik ndërkombëtar e ka rolin e tij në këto zhvillime, sepse duke u bazuar në analizën e cekur më lartë, rezultojnë që një pjesë e tij, të jetë e përfshirë në trazirat e dhunshme. Gjithashtu, mund të konstatojmë se ky mision i është shmangur përgjegjësisë së tij, sidomos gjatë ditëve kritike të trazirave. Një gjë e tillë është konstatuar dhe gjykuar edhe nga mediet në përgjithësi. Brishtësinë e kësaj situatë, natyrisht që, e kanë shfrytëzuar për qëllime edhe grupe tjera, e sidomos shërbime inteligjente, të cilat e kanë shfrytëzuar kontekstin e krijuar.

KAPITULLI IV

ANALIZË KRITIKE E RAPORTIMIT TË GAZETAVE DITORE PËR TRAZIRAT E MARSIT 2004

4.1 Analizë kritike e raportimit shtypit në ditën e Trazirave të Marsit

Misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut përmes pushtetit të tij absolut kishte miratuar rregullore të veçantë për mediet ndaj të cilave parashihte rregulla dhe ndëshkime të rënda për ato medie të cilat do guxonin të nxisnin gjuhë të urrejtës apo do të nxisnin urrejtje ndëretnike në Kosovë. Prandaj, mediet në përgjithësi kanë qenë të kujdesshme në raportimet e tyre edhe për faktin se rregulloret dhe dënimet e administratës së UNMIK-ut, mund të ishin fatale për to.

Për të filluar testimin hipotezës e parë, do të analizojmë raportimin e shtypit në ditën e parë të trazirave, sepse kjo do të ndihmonte që të shihej roli i shtypit në fillimin e nxitjes së dhunës ndëretnike. Pra, ngjarjet për të cilat ka raportuar shtypi për ditën e parë të trazirave janë të botuara në numrin e 17 mars, që nënkupton se ato kanë raportuar për mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër.

4.2 Gazeta “Koha Ditore”, 17 mars 2004

Gazeta “Koha Ditore”, në ditën e fillimit të Trazirave të Marsit 2004, ngjarjes më të rëndë ndëretnike në Kosovën e pasluftës, dy tekstet kryesore të ballinës ia kishte kushtuar pikërisht raportimeve të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt në ngritjen e tensioneve ndëretnike. Të dyja tekstet kryesore të trajtuara janë tema që ndërlidhen me raportet në mes të shqiptarëve dhe serbëve, dhe natyrisht që bazuar në situatën e përgjithshme në Kosovë, këto teste kanë



Fotografia 1. Ballina e gazetës “Koha Ditore”, 18 mars 2004

pasur impaktin e tyre në krijimin e opinionit publik. Në bazë të rrjedhave të ngjarjes gjatë periudhës së marsit, në bazë të qëndrimeve politike të UNMIK-ut dhe në bazë të sjelljes së pakicës serbe, shihet vazhdimisht një provokim i shumicës shqiptare.

Kryeartikulli në këtë numër të gazetës trajton një përplasje ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve, të ndodhur në fshatin Çabër të Zubin Potokut, një zonë me ndasi të thella ndëretnike, dhe një konflikt të ngrirë në mes shqiptarëve dhe serbëve, që pas ndërhyrjes së forcave paqeruajtëse ndërkombëtare. Për dallim prej një raportimi të analizuar më parë dhe të cilësuar profesional, teksti kryesor në Kohën Ditore, më 17 mars 2004 shpërfill këto norma profesionale të raportimit, duke botuar si rrallë herë lajmin e saj kryesor të plotë vetëm në ballinë. Duke nisur nga mbititulli, titulli, paragrafi i parë, burimet, citatet, kryeartikulli në këtë tekst ka hasur në probleme profesionale të cilat bien në kundërshtim me studimet e teoricienëve të shtypit dhe të tipologjisë së zhanrit. Titulli i tekstit kryesor është paragjykes dhe nxitës i raporteve ndëretnik, i cili nuk përputhet me kreun e raportit. “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”.¹⁵⁰ Ky titull përveç një provokimi dhe nxitje të urrejtjes ndëretnike, nuk përputhet me kreun e lajmit e as me deklaratat e fëmijës dëshmitar. Në këtë rast përmes këtij teksti kjo e përditshme jep konstatim për vdekjen e tre fëmijëve shqiptarë, edhe pse vetëm për njërin ishte konfirmuar zyrtarisht vdekja, ndërsa për fatin e të tjerëve dhe gjendjen e tyre ende nuk kishte informacione zyrtare. “Tre fëmijë të moshës 9, 11 dhe 12 vjetarë janë zhdukur në valët e Ibërit, ndërsa ekipet e shpëtimit të TMK-së, të cilat janë thirrur me vonesë në vendin e ngjarjes, kanë gjetur trupin e njërit prej tyre diku pas mesnatë”.¹⁵¹ Prandaj, tek kreu i lajmit i cili sipas teorisë zhanrit duhet ta ketë informacionin kryesor, kemi të konfirmuar vetëm vdekjen e njërit nga tre fëmijët të cilët i kishte rrëmbyer lumi Ibër. Pra, profesionalisht titulli dhe kreu i lajmit kanë një shpërputhje të interpretimit të fakteve. Më tutje në tekst bëhet interpretimi i ngjarjes nga ana e redaksisë, duke përshkruar atë përmes një situatë hipotetike, të konstruktuar nga brenda paragrafit të dytë dhe të tretë. “Fëmijët kanë kërcyer në lum për të gjetur shpëtim por ishin rrëmbyer nga valët e lumit Ibër dhe vetëm njëri prej tyre u ka shpëtuar valëve dhe ka dalë i gjallë në breg”.¹⁵² Këtu kemi një interpretim të ngjarjes nga ana e redaksisë e cila nuk referohet në ndonjë burim zyrtar, i cili do ta përshkruante dhe konstruktonte ngjarjen, gjithnjë sipas kompetencës. Duke anashkaluar burimet zyrtare, në paragrafin e katërt, në

¹⁵⁰Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, fq.1

¹⁵¹Po aty, fq.1

¹⁵²Po aty, fq.1

tregim shfaqet fëmija dëshmitar i cili kishte arritur të shpëtonte nga fatkeqësia e ndodhur. Mirëpo, teoricienët e përjashtojnë çdo mundësi të vendosjes në fillim të lajmit deklaratën e dëshmitarit okular, e aq më pak të atyre dëshmitarëve të cilët janë pjesë e asaj ngjare. Kjo, sepse sipas tyre, ata mund të japin deklaratat të njëanshme, mund të jenë nën ndikimin e fuqishëm të emocioneve dhe mund të provokojnë emocion tek masa. Në raste të tilla, shumica e teoricienëve të medieeve janë të mendimit se dëshmitarët të mos përfshihen fare në raport. Pra, në këtë rast në asnjë rrethanë nuk do të duhej të vendoset deklarata e një dëshmitari të mitur, para deklaratave zyrtare, të institucioneve kompetente, të cilat merren me trajtimin e këtyre ngjarjeve. Më pas e kemi deklaratën zyrtare të policisë së UNMIK-ut lidhur me ngjarjen, e cili brenda citatit të përfolur nga ana e redaksisë, deklaroi se është marrë me rezerva dëshmia e fëmijës dhe se janë duke punuar për zbardhjen e fatit të fëmijëve të zhdukur, pa e deklaruar zyrtarisht dhe pa e konstatuar vdekjen e asnjërit nga fëmijët. “Tracy Backer, zëdhënëse e policisë së UNMIK-ut, bazuar në deklaratat që i ka dhënë Fitimi, fëmija i mbijetuar, ka thënë se policia deklarimet e tij për momentin i merr me rezerva dhe se tani është i angazhuar në gjetjen sa më të shpejtë të fëmijëve, ndërsa hetimet do të vazhdojnë pas zbardhjes së fatit të tyre”.¹⁵³ Pas kësaj deklaratë zyrtare, teksti kthehet prapë tek dëshmitari i mitur i ngjarjes, duke i nxjerrë nga konteksti deklaratat e tij.

Përderisa në deklarimin e përfolur të të riut, gazeta thekson se të rinjtë janë sulmuar nga serbët më të moshuar që iu kishin ndërsyer edhe qenin, vet i fëmija i mitur Fitimi deklaroi ndryshe në citimin e drejtpërdrejtë. “Ne ishim duke shëtitur në anën tjetër të lumit, nja 500 metra larg nga shtëpitë tona, kur dy serbë kanë ndërsyer qenin drejt nesh dhe kanë filluar të na shajnë”.¹⁵⁴ Pra, në asnjë moment i mituri nuk e pohoi në deklarimin e drejtpërdrejtë se janë sulmuar fizikisht nga serbët dhe si rezultat i kësaj, del që edhe titulli nuk është i bazuar në deklarimet e dëshmitarit i cili ishte i përfshirë në ngjarje. Prandaj, edhe kjo pjesë bie në kundërshtim me teorinë e zhanrit dhe standardeve profesionale të raportimit, sepse sipas teoricienëve në asnjë rrethanë gazetarët dhe redaksitë nuk guxojnë që të nxjerrin nga konteksti deklaratat e njerëzve të përfshirë në atë ngjarje. Përveçse kësaj, ngjarjes redaksia i jep epitetin e tragjedisë, dhe duke i ngritur shqetësimet dhe drojën e një revolte të qytetarëve. Duke përdorur ligjëratën e zhdrejtë, redaksia e vlerëson edhe mendimin dhe drojën e zëdhënëses së policisë së UNMIK-ut. “Shqetësimi për revoltë të mundshme të banorëve shqiptar kishte prekur në orët e mbrëmjes dhe zyrtarët e policisë së

¹⁵³Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, fq.1

¹⁵⁴Po aty, fq.1

UNMIK-ut,”¹⁵⁵ mbyllet paragrafi i cili citon në formë të drejtpërdrejtë deklaratën e zëdhënësës së policisë së UNMIK-ut, duke i bërë thirrje qytetarëve që të jenë të qetë dhe të përmbajtur nga emocionet.

Në ballinën e gazetës është vendosur gjithashtu një fotolajm e një automjeti me xham të thyer, ndërsa në tekstin e kësaj fotografie shfaqen elemente të një përplasje ndëretnike. “Bllokada që serbët ua kanë bërë rrugëve Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Gjilan prej të hënës mbrëma, ka rezultuar edhe me disa shqiptarë të lënduar, kalimtar të rastit dhe dëme të konsiderueshme materiale në veturat e tyre (më gjerësisht në faqen e tretë)”,¹⁵⁶ mbyllet komentimi i kësaj fotografie duke i dhënë hapësirë më të madhe kësaj ngjarje në faqen e tretë. Në ditën kur në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës po mbahej protestë gjithpopullore kundër burgosjes së ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe kundër UNMIK-ut dhe brishtësisë së krijuar në gjithë vendin, në faqe të tretë kjo e përditshme sjellë edhe një tekst tjetër, i cili ndërlidhet drejtpërdrejt me përshkallëzimin e raporteve ndëretnike. Përveç imponimit të opinioneve të shumta nga ana e gazetarit, brenda tekstit ka shumë pak burime zyrtare të informacionit, të cilat do të jepnin vlerësimin e saktë të ngjarjes në terren. Prandaj, sikurse edhe në kryeartikullin e këtij numri, ku pjesa kryesore e tregimit bazohet në dëshmitarë të cilët nuk janë kompetentë për vlerësimin e ngjarjes. Interpretimi i ngjarjeve nga ana e gazetarëve dhe përdorimi i dëshmitarëve si burim kryesor në tekst, sipas studiuesve të zhanrit, paraqet shkelje profesionale, etike dhe paraqet deformim të opinionit publik. “Rreth dyqind-treqind serbë të Çagllavicës dhe Graçanicës kanë vazhduar t’i mbajnë të bllokuara rrugët Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Gjilan, pas plagosjes së një serbi në fshatin Çagllavicë në orët e mbrëmjes të së hënës. Gjatë rebelimit të tyre, kundër kësaj plagosje që ende ka mbetur enigmatike e që ka rrezikuar jetën e këtij të riu serb, protestuesit serb, me paragjykimin se sulmuesit kanë qenë shqiptarë, kanë demoluar disa automjete dhe kanë lënduar disa kalimtarë”,¹⁵⁷ Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me vlerësimin e ngjarjes, imponimin e opinionit të redaksisë, ndërkaq kreu i lajmit nuk mbështetet në fakte dhe burime zyrtare të përfaqësuesve të institucioneve gjegjëse.

Edhe në tekstin i cili flet për katër të plagosur, përveç referimit të institucionit shëndetësor të QKUK-së, gazetari në raportin e tij nuk ka deklaratë zyrtare që do të fliste qoftë për numrin e të lënduarve, qoftë për gjendjen shëndetësore të tyre. Ndërsa e gjithë pesha e kësaj ngjarje bazohet

¹⁵⁵Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, fq.1

¹⁵⁶Blerim Xhemajli dhe Zija Miftari, “Serbët bllokojnë rrugët nga Prishtina për në Shkup dhe Gjilan, sulmojnë kalimtarët”, *Koha Ditore*, 17 mars 2004, fq.3

¹⁵⁷Po aty, fq.3

në deklaratën e një taksisti dëshmitar, i cili rrëfen për sulmin që i kanë bërë serbët dhe mos ndihmën nga ana e pjesëtarëve të policisë vendore e ndërkombëtare. I vetmi burim zyrtar i përfshirë në këtë raport është zëdhënësi i Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), i cili në deklarinimin e tij paraqitet mjaft i kujdesshëm. Ky raport brenda tij paraqet edhe konflikte ndëretnike, brenda së cilës pasqyrohen dhe paraqiten shkëndijat e para të një përplasje të dhunshme ndëretnike. Nxitja e gjuhës së urrejtjes, mos durimin nacional, fetar e propagandues, është e dënueshme nga rregullorja për media e vendosur nga UNMIK-u, sepse këto elemente paraqesin ndjeshmëri të madhe tek publiku, ngaqë trajtimi i këtyre temave zakonisht ka shkaktuar protesta e trazira.

Dy tekstet kryesore të gazetës “Koha Ditore”, të datës 17 mars kanë bërë pasqyrim dhe mbulim të njëanshëm të raportimit, ku mungon balancimi i lajmit, mungojnë burimet zyrtare dhe mungojnë elemente të tjera të raportit, që e bëjnë këtë raportim jo profesional. Tekstet e trajtuara në ditën e trazirave e reflektojnë më së miri gjendjen e brishtë dhe të tensionuar në aspektin e raporteve ndëretnike dhe ndikojnë në formimin e opinionin publik në frymën e nxitjes ndëretnike.

4.3 Gazeta “Epoka e re”, 17 mars 2004

Ngjashëm me gazetën “Koha Ditore”, e përditshmja tjetër “Epoka e re”, në lajmin kryesor të ballinës trajton ngjarjen e rëndë të ndodhur në fshatin Çabër, të rajonit të Mitrovicës. Titulli dhe nëntitulli janë të ndërtuar në atë formë që tek publiku të

provokojnë dhe prodhojnë gjendje emocionale. Sikurse gjatë analizimit të gazetës “Koha Ditore”, konstatimi për vdekjen e tre fëmijëve vijë duke mos u bazuar në burime zyrtare, gjë që paraqet



Fotografia 2. Ballina e gazetës “Epoka e re”, 18 mars 2004

shkelje të standardeve profesionale të raportimit dhe shkelje të etikës profesionale. “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë”.¹⁵⁸

Pra, situata e përgjithshme delikate në Kosovë, duke mos përjashtuar këtu edhe shkënditë e tensioneve ndëretnike, kanë krijuar situatën e një nxitje ndëretnike, duke mos përjashtuar këtu edhe njëanshmërinë e UNMIK-ut. Prandaj, një titull i tillë në aspektin e raportimit dhe krijimit të opinionit publik, provokon në mënyrë të hapur gjendjen emocionale të masës, dhe tensionimin e situatës së përgjithshme në Kosovë, e sidomos pas arrestimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, dhe protestave gjithpopullore që kishin shpërthyer në gjithë vendin. Nxitja ndëretnike brenda këtij raporti theksohet edhe në nëntitulli i këtij kryeartikulli të vendosur në ballinë. “Sipas fëmijës që ka mbijetuar, Fitim Veseli, një grup serbësh i kanë sharë fëmijët shqiptarë, i kanë sulmuar dhe më pas iu kanë vërsulur qenin. Në përpjekje për të shpëtuar, fëmijët janë futur në lumin Ibër, por nuk kanë dalë më të gjallë. Ndërkaq, të hënën në mbrëmje në Kodrën e Minatorëve është djegur tenda e Sadri Pecit, me të gjitha orenditë që ishin brenda saj. Aty jetonte familja 12 anëtarësh e Sadri Pecit. Serbët anembanë Kosovës por krijojnë probleme dhe destabilitet”.¹⁵⁹ As për tekstin i cili flet për vdekja e tre fëmijëve, e as teksti i cili trajton incidentin ndëretnik në “Kodrën e Minatorëve” në Mitrovicë, nuk janë ndërtuar duke u bazuar në deklaratimet zyrtare dhe brenda standardeve profesionale të raportimit. Përkundrazi i gjithë teksti për këtë ngjarje është ndërtuar pa deklarata zyrtare, përveç një deklaratë të përfolur, pa asnjë citim të drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, as në kreun e tij, e as në pjesën tjetër strukturore nuk është konfirmuara numri i të vdekurve, i ngjarjes tragjike të ndodhur në fshatin Çabër. Një problem tjetër brenda këtij teksti shfaqet në besueshmërinë e tij. Brenda tij, mungojnë përdorimet e citateve, që në esencë e fuqizojnë dhe e ngritin besueshmërinë e tij. Gjithashtu, brenda këtij teksti është evident imponimi i mendimit të autorit të tij, gjë e cila e vë në dyshim kredibilitetin e përmbajtjes. Po ashtu, raportimi për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër, e cila konsiderohet si pikënisje e përplasjeve ndëretnike, nuk ka autorësi, as në të përditshmen “Epoka e re”, e as në “Koha Ditore”, por bartë vetëm firmën e redaksisë. Edhe tekstet e tjera të botuara në këtë numër të së përditshmes “Epoka e re”, përkundër se janë ngjarje për të cilat duhet të raportohet, ato në esencë brenda tyre përbëjnë elemente të nxitjes dhe urrejtjes ndëretnike. “Serbët bllokojnë rrugët në Çagllavicë, sulmojnë shqiptarët në Graçanicë”, “Serbët sulmojnë Ramiz Bytyçin”, “Pjesëtarët e ShPK-së, s’çajnë kokën”, “Nxënësit serbë përleshën me

¹⁵⁸Epoka e re, “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004, fq.1

¹⁵⁹Po aty, fq.1

policinë e UNMIK-ut”, “Rugova dhe Rexhepi dënojnë sulmet e serbëve”.¹⁶⁰ Ky raport i zgjeruar, i shoqëruar edhe me dy fotografi nga vendi i ngjarjes, është vazhdimësi e raportimit për problemet dhe tensionet ndëretnike të krijuara ditët e fundit, në këtë rast nga vet pakicat serbe. Kreu i lajmit në këtë raport e argumenton përmes burimeve zyrtare të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), bllokadën e rrugës Prishtinë-Gjilan, të shkaktuar nga serbët, ndërkaq nëntitujt ndërliiden drejtpërdrejt me përshkallëzimin e situatës ndëretnike. Në anën tjetër raportimi për vdekjen e tre fëmijëve shqiptarë; protestat e shqiptarëve kundër misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut; për arrestimin e disa ish-pjesëtarëve të UÇK-së, e ka shkaktuar zemërim tek shumica shqiptare, gjë të cilën e kishin shprehur edhe në protestën e mbajtur në të gjitha qytetet e Kosovës. Kjo situatë e krijuar përmes raportimit, tek shumica shqiptare e ka ngritur dozën e nacionalizmit, të cilën e kanë shprehur publikisht në disa raste si dhe kanë prodhuar gjendje emocionale tek publiku. Kryefjala për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ishte jehonë e protestës në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës. Këta protestues paralajmëruan përshkallëzim të situatës, në qoftë se sipas tyre, UNMIK-u se ndërron politikën e saj karshi vlerave të luftës. “Neokolonistët e ashtuquajtur UNMIK me këto veprime, sipas Klinakut, kanë dalë tërësisht në përkrahje të krimit të organizuar dhe janë duke vazhduar po me të njëjtën politikë që ndiqte Serbia fashiste... Ai i ka bërë thirrje UNMIK-ut të rishikojë politikën e vet karshi Kosovës, posaçërisht ndaj luftës së drejtë që bëri UÇK-ja, në të kundërtën, ai ka thënë se pakënaqësia e akumuluar në popull dhe te luftëtarët ka arritur kulminacionin dhe do të jetë vështirë të kontrollohen veprimet e mëtutjeshme, që mund të jenë me pasoja për tërë rajonin”.¹⁶¹ Pra, këto deklarata të shkëputura të protestës të cilat paraqesin dhe paralajmërojnë eskalim të situatës.

Ndërsa një tekst tjetër i referohet protestave në rajonin e Dukagjinit, me ç’rast kolegji i politikave editoriale të gazetës, vendos për titull njërin nga mbishkrimet e parullave të protestuesve. “Edhe kështu u brohorit: UNMIK mos u ngut - UÇK-ja t’ kallë barut”.¹⁶² Pra, një titull pa informacion, me tekst të zgjeruar e të ilustruar me fotografi nga vendi i ngjarjes, brenda të cilit shprehet pakënaqësi e theksuar kundër misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut. Në vazhdim të këtij raporti ndaj misionit të UNMIK-ut ka mesazhe të drejtpërdrejta, që tërthorazi i bëjnë thirrje

¹⁶⁰Epoka e re, “Serbët bllokojnë në Çagllavicë, sulmojnë shqiptarët në Graçanicë”, 17 mars 2004, fq.2

¹⁶¹Burim Etemaj, “Protestuesit kërkojnë nga UNMIK-u që ta rishikoj politikën e vet ndaj Kosovës”, *Epoka e re*, 17 mars 2004, fq.5

¹⁶² Epoka e re, “Edhe kështu u brohorit: “UNMIK mos u ngut – UÇK-ja t’kallë barut”, 17 mars 2004, fq.5

për kujdes në raport me shqiptarët. “Sa herë rrezikohet Kosova, populli do të lindë Adem Jashara”.¹⁶³

Pra, duke rezymuar kontekstin e ngjarjeve të raportuara të 16 marsit, kemi realisht brenda raportimit situata të cilat ndikojnë në nxitjen e reagimit të masës. Pra, pikërisht një ditë para shpërthimit të dhunës në gjithë vendin, nacionalizmi shqiptarë ishte ngritur në raport me UNMIK-un, prandaj ky mision do të duhej t’i rishikonte dhe analizonte politikat e saj, në raport me situatën e krijuar dhe me faktorët që kanë shkaktuar ngritjen e këtyre tensioneve. Pra, ky misioni ndërkombëtar do të duhej të jepte përgjigje sesi është e mundur që qytetarët të cilët para pak viteve e kishin pritur me lule këtë mision, tashme po e kërcënojnë atë. Pakënaqësi ndaj këtij misioni kishte paraqitur çuditërisht edhe pakica serbe, pjesëtarët e të cilës në shumë raste i kishin sulmuar me mjete të forta pjesëtarët e këtij misioni. Prandaj, politikat e ‘mbrapshta të UNMIK-ut’ dhe raportimi i shtypit për këto zhvillime, sigurisht që ka ndikuar dhe ndihmuar në ngritjen e pakënaqësive. Një element tjetër i cili ka ndihmuar në konfirmimin e raporteve të brishta mes shqiptarëve dhe serbëve është qëndrimi i misionit ndërkombëtar të OKB-së, dhe polarizimi që ka krijuar brenda etnive në Kosovë. Pra, UNMIK-u, duke shprehur pozicionim në raport me shqiptarët dhe etnitë tjera, kishte krijuar një situatë të ngritjes së nacionalizmit.

4.4 Gazeta “Zëri”, 17 mars 2004

Raportim krejt ndryshe lidhur me rastin e mbytjes së tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër ka bërë gazeta “Zëri”. Raportimi i kësaj të përditshmeje për rastin e humbjes së jetës së fëmijëve në lumin Ibër, të fshatit Çabër të Mitrovicës, ka qenë jashtëzakonisht profesional, i bazuar në fakte, pa gjykim e vlerësim editorial, gjë që reflekton edhe në strukturën e këtij raporti kaq të ndjeshëm. Gazetari nuk ngutet të jep vlerësime për ngjarjen, nuk e vendos dëshmitarin (fëmijën) në planin e parë dhe përpiket që gjatë strukturës së tekstit të mos bëjë ndonjë provokim ndëretnik. “[Mbititulli] “Druhet për një tragjedi në fshatin Çabër të Zubin-Potokut”, [Titulli] “Zhdukën në ujërat e lumit Ibër tre fëmijë shqiptarë” dhe [Nëntitull] “Florian, Egzon e Avni Veseli janë zhdukur dje rreth orës 16:00, në fshatin Çabër, kur janë rrëmbyer nga ujërat e lumit Ibër, derisa po iknin nga dy serbë që ishin nisur drejt tyre. Lumin ka arritur ta kaloj Fitim Çerkin Veseli.”¹⁶⁴ Pra, në këtë rast gazetari

¹⁶³Epoka e re, “Edhe kështu u brohorit: “UNMIK mos u ngut – UÇK-ja t’kallë barut”, 17 mars 2004, fq.6

¹⁶⁴Zëri, “Zhduken në ujërat e lumit Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004, fq.1

nuk i jep përfundimet e tij për ngjarjen, duke respektuar aspektin etik e profesional, por raporton se në lumin Ibër janë zhdukur tre fëmijë shqiptarë. Pra, për fatin e fëmijëve ende nuk dihet asgjë zyrtarisht, nuk dihej se këta të rinj a ishin të gjallë apo të vdekur.

Gazetari përmes raportimit nuk bënë konstatim për ngjarjen, dhe nuk paraqet përfundime për numrin e viktimave.

Prandaj, derisa institucionet zyrtare nuk japin detaje më tepër për një ngjarje kaq tragjike, konstatim apo përfundim të epilogut nuk mundin të japin as redaksitë, sepse kjo është në kundërshtim me standardet profesionale të raportimit dhe etikës së gazetarisë. Ndërkaq, tek mbititulli gazetari nuk e përdor

dramaticitetin e ngjarjes, dhe nuk jep përfundime tek nëntitulli. Tek kreu i lajmit apo raportit, gazetari thekson se për fatin e fëmijëve nuk dihet asgjë, ndryshe nga raportimi i dy të përditshmeve të tjera, të cilat e kanë konstatuar epilogun e ngjarjes, pa e mbështetur në fakte dhe deklarata zyrtare. Në paragrafin pasues redaksia nuk jep përshkrim të situatës, dhe bënë mirë sepse ende zyrtarisht nuk dihej sesi kishte ndodhur ngjarja dhe nuk kishte deklarim zyrtar për këtë ngjarje. Rrethanat dhe vendin e ngjarjes redaksia e përshkruan përmes burimeve zyrtare, të kryetarit të Këshillit për Mbrojtjen dhe të Drejtave e Lirive të Njeriut (KMDLNJ), në Mitrovicë Halit Beranit, i cili thekson se deri në ora 22, fëmijët nuk ishin gjetur. Për dallim nga tekstet e analizuarua më lartë, teksti i gazetës “Zëri”, përmbillet me sfond. “Çabra është fshati i vetëm në komunën e Zubin Potokut i banuar me shqiptarë”.¹⁶⁵ Prandaj, në përgjithësi raportimi i gazetës “Zëri”, për ngjarjen tragjike të fshatit Çabër, ka qenë brenda standardeve profesionale të raportimit, duke e respektuar etikën morale dhe profesionale, dhe duke i qëndruar koherent strukturës së raportimit.



Fotografia 3. Ballina e gazetës “Zëri”, 18 mars 2004



¹⁶⁵Zëri, “Zhduken në ujërat e lumit Ibër tre fëmijë shqiptarë”, fq.12

4.5. Gazeta “Bota Sot”, 17 mars 2004

Se mediet ndonjëherë mund të jenë të njëanshme në raportim, të pa balancuar në informim dhe të ndjeshme në krijimin e opinionit publik, më së miri mund ta shohim gjatë analizës kritike të njërit nga raportet kryesore të gazetës “Bota Sot”. Nisur nga brishtësia e përgjithshme në Kosovë, kjo e përditshme më 17 mars, boton një tekst i cili në esencë përmban elemente të shumta të nxitjes së urrejtjes ndëretnike. “Bota Sot”, sjellë në ballinën e saj një lajm nga veriu i Kosovës, i cili në esencë bënë thirrje për nxitje të tensioneve ndëretnike. “[Titull] Bandat serbe fillojnë aktivitetet kriminale për dëbimin e



Fotografia 4. Ballina e gazetës “Bota Sot”, 18 mars 2004

shqiptarëve nga veriu [Nëntitull] Burimet shqiptare nga lagja ‘Kodra e Minatorëve’, në pjesën veriore të qytetit, kanë njoftuar se të hënën rreth orës 19:00, bandat rebele serbe ia kanë vënë zjarrin tendës së Sadri Pecit¹⁶⁶. Ky titull, bashkë me nëntitullin paraqesin shkelje etike dhe profesionale të gazetarisë, të cilat ndër të tjera, bien në kundërshtim me konceptet teorike të cilat i kemi trajtuar më lartë, tek kapitulli i zhanreve. Ky tekst i cili brenda tij ka elemente të nxitjes së urrejtjes ndëretnike është i bazuar në burimet e gazetës, mirëpo deklarimet zyrtare në këtë raport nga ana e zyrtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), bien në kundërshtim me titullin dhe kreun e raportit. Shumica e tekstit në raport, paraqet një gjuhë të urrejtjes, e cila rrjedh si rezultat

¹⁶⁶ BSM “Bandat serbe fillojnë aktivitetet kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga veriu”, *Bota Sot*, 17 mars 2004, fq.3

i imponimit të mendimeve të gazetarit. Madje, në bazë të raportit shihet se gazetari s'ka qenë fare në vendin e ngjarjes dhe burimet anonime që i përdorë nuk ka arritur që t'i argumentoi as nëpërmjet dëshmitarëve okular.

“Burimet shqiptare nga lagja ‘Kodra e Minatorëve’, kanë njoftuar se të hënën në pjesën veriore të qytetit, rreth orës 19:00, bandat rebele serbe ia kanë vënë zjarrin tendës së Sadri Pecit, banor i lagjes së lartpërmendur”.¹⁶⁷ Kreu i këtij raporti të botuar në gazetën “Bota Sot”, i cili e mbështet titullin e këtij teksti të botuar në ballinë, nuk paraqet fakte, burime e as argumentim. Kjo e degradon raportimin profesional dhe e deformon mendimin e opinionit publik, karshi ngjarjeve të cilat zhvilloheshin gjatë asaj periudhe. “Zjarr vënien në tendën e Sadriut e ka konfirmuar edhe zëdhënësi i ShPK-së, për rajonin e Mitrovicës, Arbër Beka. Ai ka thënë se policia është informuar për këtë zjarr përmes telefonit nga një person dhe menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes... Ai ka thënë se nuk ka të dyshuar akoma, kurse hetimet i ka filluar njësitë përkatës të policisë”.¹⁶⁸

Përdorimi i gjuhës dhe nxitjes së urrejtjes ndëretnike janë të ndaluara për mediet, sipas rregullores për media të nënshkruara nga përfaqësuesi Special i OKB-së në Kosovë. “1.1 Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike ose kundër cilitdo grupi tjetër që jeton në Kosovë, veprime të cilit mund të prishin qetësinë dhe rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim, i cili zgjatë jo më shumë se pesë vjet, ose dënohet me të dyja”.¹⁶⁹ Por, një gjuhë e tillë e shprehur në këtë të përditshme, ku teksti i shkruar është i firmosur me tri initiale, e bënë të paqartë dhe shqetësues këtë formë të raportimit. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë format teknik të përdorur nga ana e gazetës “Bota Sot”, sepse përveç këtij teksti, në të tjerat raporte është shkruar inicialja e emrit i shoqëruar me mbiemrin e plotë të gazetarit. Më tutje ky tekst i cili është kryeartikulli i ditës në këtë të përditshme, vazhdon më tutje përdorimin e një gjuhe jo adekuate dhe nxitëse, duke mos e kursyer as misionin e UNMIK-ut. “Do theksuar se familjen 12 anëtare të Sadriut, ashtu sikur edhe mijëra familje tjera shqiptare, e kanë dëbuar me dhunë nga shtëpia e tij në lagjen ‘Kodra e Minatorëve’, kriminelët serbë me qëllim të spastrimit të asaj pjese të qytetit nga shqiptarët...”,¹⁷⁰ vazhdon opinionin e tij dhe

¹⁶⁷BSM “Bandat serbe fillojnë aktivitetet kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga veriu”, *Bota Sot*, 17 mars 2004, fq.3

¹⁶⁸Po aty, fq 3

¹⁶⁹RREGULLORE NR.2000/4 “MBI NDALIMIN E NXITJES SË URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOSDURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR DHE ETNIK”, UNMIK/RREG/2000/4, 1 shkurt 2000, http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_04.htm (9.9.2017)

¹⁷⁰BSM “Bandat serbe fillojnë aktivitetet kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga veriu”, *Bota Sot*, 17 mars 2004, fq.3

vlerësimin e tij gazetari, rreth një ngjarje e cila në esencë, ishte ngjarje që do të duhej të trajtohet krejt më ndryshe.

Kjo e përditshme në këtë numër të saj, kishte raportuar edhe për ngjarjen e ndodhur në lumin Ibër. Ashtu siç kanë raportuar edhe gazetaret e tjera, burimi kryesor i kësaj ngjarje është fëmija i mitur, i mbijetuar, i cili e rrëfen ngjarjen në cilësinë e dëshmitarit. Kjo e përditshme i kishte kushtuar vëmendje të madhe në këtë numër të botuar edhe protestës gjithpopullore të organizuar për të kundërshtuar sulmin ndaj rezidencës së presidentit Ibrahim Rugova. Mirëpo, kjo gazetë nuk i ka kushtuar aspak hapësirë një proteste tjetër gjithpopullore të mbajtur në gjitha qytetet e Kosovës, kundër arrestimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, nga ana e UNMIK-ut. Pra, edhe në këtë rast shihet qartë se politikat editoriale të kësaj gazete janë të afërta me LDK-në dhe Rugovën, gjë e cila është në kundërshtim me standardet profesionale të raportimit, por ka edhe ndikim në polarizimin e shoqërisë.



Fotografia 5. Ballina e gazetës “Kosova Sot”, 18 mars 2004

4.6 Gazeta “Kosova Sot”, 17 mars 2004

Për dallim nga të përditshmet e analizuar më lartë, gazeta “Kosova Sot”, nuk ka raportuar fare për ngjarjen e ndodhur në Çabër, për tre fëmijët e zhdukur në lumin Ibër. Tema kryesore e trajtuar në këtë numër ka të bëjë me fushën e raportimit nga sektori i ekonomisë. Pra, ngjarja kryesore ka të bëjë me trajtimin e humbjes së miliona eurove në Kosovës, si rezultat i mungesës së ligjeve për energjinë. Ngjarja e dytë për nga rëndësia e trajtuar në gazetën “Kosova Sot”, është protesta gjithpopullore e thirrur në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së. Ndërsa në ballinë kjo e përditshme i ka kushtuar vëmendje bllokimit të rrugëve Prishtinë - Gjilan dhe Prishtinë-Shkup, nga ana e serbëve. Pra, gjatë analizimit të këtyre dy ngjarjeve shihet qartë gjendja e brishtë në

Kosovë, e cila më pas merr epilogun e një trazire të dhunshme ndëretnike. “Dhjetëra mijëra protestues fajësojnë UNMIK-un për kriminalizim të UÇK-së”.¹⁷¹ Megjithatë raportimi për këto dy ngjarje është brenda standardeve profesionale të raportimit ku struktura e tyre përbënë të gjitha elementet e domosdoshme të raportimit.

4.7 Analizë e tërësishme kritike e raportimit të shtypit për Trazirat e Marsit 2004

Data 17 mars i vitit 2004, konsiderohet si ngjarja ndëretnike më rënda në Kosovën e pasluftës. Shtypi ditor në këtë ditë i kishte mobilizuar ekipet e gazetarëve për të mbuluar këto ngjarje të dhunshme ndëretnike, e cila kishte përfshirë të gjithë vendin. Tekstet e ballinave në të gjitha gazetat ishin të mbushura me raportime për dhunën nga zona të ndryshme të vendit, të shoqëruara me fotografi nga vendi i ngjarjes, ndërsa i gjithë shtypi në ballinat e saj kishte sjellë pamjet tragjike të shoqëruar me tekste që flasin për numrin e të vdekurve dhe të plagosurve. Shtypi ditor, përpiket t’i identifikoj shkaktarët që e shkaktuan përplasjen ndëretnike dhe faktorët që e zgjeruan këtë ngjarje në gjithë vendin. Sipas raportimit të tyre, trazirat ndërlidhen drejtpërdrejt me ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër, ku tre fëmijë shqiptarë u zhdukën në lumin Ibër, të cilët më vonë u gjetën të vdekur. Të gjendur në një situatë jashtë kontrollit, misioni i UNMIK-ut, në vend që të mobilizohej për ta rikthyer situatën nën kontroll dhe për të qenë transparent ndaj medieve në lidhje me situatën e krijuar, ky institucion ndërkombëtar, i akuzon mediet se nuk po i mbulojnë ngjarjet profesionalisht, duke ua tërhequr vërejtjen atyre dhe në të njëjtën kohë duke e cenuar lirinë e shprehjes.

Mirëpo, studiuesi i opinionit publik, i cili njihet si njëri nga themeluesit e gazetarisë moderne në ShBA, Ualter Lipman, në studimin e tij për opinionin publik thekson se secili nga ne tenton ta gjykojë një gazetë dhe secili nga ne gjykon, pjesë të lajmeve në të cilin ndihet i përfshirë. Mirëpo sipas tij, një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm lexuesit. “Lexuesi është i vetmi gjykues pothuajse i përditshëm dhe nuk mund të ketë padi ndaj tij për shkelje të premtimit apo mosbesimit”,¹⁷² thekson Lippmann, duke shtuar se besnikëria e lexuesit nuk është e përcaktuar me asnjë lidhje apo marrëveshje. Kundër medieve ishte pozicionuar edhe Komisioneri i Përkohshëm

¹⁷¹S. Ahmeti, M. Feka, Q. Thaçi, “Dhjetë ra mijëra protestues fajësojnë UNMIK-un për kriminalizim të UÇK-së”, *Kosova Sot*, 17 mars 2004, fq.2

¹⁷²Walter Lippmann “Opinion Public”, 1920, fq.213, <http://www.howardnema.com/wp-content/uploads/2016/08/lippmann.pdf> (7.11.2017)

për Media, i cili kishte paralajmëruar masa ndëshkuese ndaje medieve, në veçanti ndaj televizioneve.

Por, ky veprim ishte kundërshtuar ashpër nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK), të cilët kishin konsideruar se një veprim të tillë arbitrar nga ana e KPM-së është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në politikat redaktuese. “AGPK-ja e sheh si arbitrar ndërhyrjen në politika redaktuese të televizioneve dhe thekson se KPM-ja nuk është institucion për ta ndalur të vërtetën por për ta korrigjuar punën joprofesionale. AGPK-ja mirëpret çdo lloj këshille profesionale të medieve nga ana e KPM-së por e sheh si të dëmshëm ndërhyrjen arbitrar në politikat editoriale për sa i përket mbulimit të ngjarjeve në zhvillim”.¹⁷³ Kjo vërejtje nga ana e KPM-së, ndaj medieve kishte ardhur pikërisht në natën kur kishte shpërthyer dhuna në Kosovë, mirëpo, primare në këtë kohë do të duhej të ishte për institucionet ndërkombëtare dhe vendore kthimi i sigurisë dhe shpëtimi i jetëve të qytetarëve, ndërsa për mënyrën e raportimit të merreshin më vonë.

Një pjesë e madhe e medieve dhe e gazetarëve ndoshta mund të kenë pasur mungesë të përvojës për raportime të tilla, të cilat prodhojnë dhunë ndëretnike, mirëpo për dallim prej teksteve të botuara për zhdukjen e tre fëmijëve, raportimi për shpërthimin e dhunës ishte më përmbajtjesorë në aspektin e raportimit nga konfliktet ndëretnike. Gazeta “Koha Ditore” të gjithë ballinën ia kushton ngjarjes së dhunshme, duke e vlerësuar atë si të tmerrshme, ndërsa tekstin kryesor të ballinës e nisë me numrin e viktimave. Përderisa një ditë më parë kjo e përditshme kryeartikullin ia kishte kushtuar ngjarjes tragjike të Çabrës, që në esencë përbën elemente të nxitjes ndëretnike me titull: “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”,¹⁷⁴ një ditë më vonë, “Koha Ditore”, raporton brenda standardeve profesionale të raportimit. “16 të vdekur dhe 575 të lënduar në trazirat që përfshinë të gjitha anët e Kosovës”.¹⁷⁵ Informacionet e ofruara në titull për numrin e të vrarëve dhe të plagosurve, kjo e përditshme e bazon në burime zyrtare dhe të konfirmuara nga institucionet gjegjëse. “Koha Ditore”, i kishte dhënë me të drejtë hapësirë të madhe kësaj ngjarje, duke raportuar nga çdo vend i Kosovës në formë kronologjike. Ajo që mund të konsiderohet si jo profesionale dhe tendencioze janë tekstet e dërguara nga korrespondentët jashtë redaksisë qendrore,

¹⁷³Koha Ditore, “AGPK: Ndërhyrja e KPM-së në politikë redaktuese të mediave është e papranueshme”, 18 mars 2004, fq.5

¹⁷⁴Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, fq.1

¹⁷⁵Koha Ditore, “16 të vdekur dhe 575 të lënduar në trazirat që përfshinë të gjitha anët e Kosovës”, 18 mars 2004, fq.1

të cilët e komentojnë ngjarjen, i japin epitete asaj, dhe në disa raste përdorin figurën stilistike të hiperbolizimit. ‘Dhunë në Prishtinë, Çagllavicë dhe Fushë Kosovë’, ‘Dhunë e ashpër në rajonin e Dukagjinit’, ‘Dhunë fuqishme në Ferizaj, Lipjan e Viti’.¹⁷⁶ Për dallim nga paragrafët e parë të tekstit, të cilët bazohen kryesisht në deklaratat zyrtare të Shtabit të Krizës dhe Qendrës Klinike Universitare (QKU), struktura tjetër e tekstit është ndërtuar përmes përshkrimeve të gazetareve, kohë pas kohe të mbështetur në burime zyrtare. Përshkrimi i ngjarjes dhe burimet e pakta të përdorura gjatë raportimit për Trazirat e Marsit, në ditën e parë janë si rezultat i mbylljes për media të institucioneve ndërkombëtare të UNMIK-ut, KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut, me ç’rast, këto misione në vend se të mobilizoheshin në një situatë krize, dhe të bënin thirrje për qetësi të situatës, ato zgjedhën heshtjen. “Në Çagllavicë flaka u është vënë një numri të madh të shtëpive të serbëve ndërsa popullata e këtij mjedisi është evokuar në drejtim të fshatrave serbe më në thellësi të Kosovës”,¹⁷⁷ përshkruhet një situatë paniku, i pabazuar në deklaratime dhe informacione zyrtare.

Më tutje në tekstin kryesor të 17 marsit, redaksia i jep epitete ngjarjeve në rajonin e Dukagjinit, duke e vlerësuar si dhunë të ashpër në atë rajon, ndërsa i nxjerr përfundimet se kjo po ndodhë për shkak të zhvillimeve në Mitrovicë. “Ngjarjet tragjike të së mërkurës në Mitrovicë kanë tensionuar tej mase qytetarët e Pejës, duke i nxitur në trazira që kanë rezultuar me një të vrarë dhe tetë të plagosur”,¹⁷⁸ vlerëson ngjarjen kolegji i redaksisë, duke aluduar se turma është nisur drejt fshatit Bellopojë, fshat i cili sipas redaksisë po ndërtohej për serbët e kthyer. Burimet që i përdorin mediet shumë herë janë vendimtare për t’i shtyrë agjendat dhe politikat editoriale të tyre përpara. Kjo konsiderohet edhe ‘hilja’ më madhe që e bëjnë redaksitë duke e ruajtur raportimin profesional dhe duke i bartur mesazhet e tyre editoriale. Ndër të tjera, “Koha Ditore”, më tutje, në tekstin të radhës të botuar në të njëjtin numër, i bënë thirrje përmes raportimit të gjithë qytetarëve nga i gjithë vendi që të dalin në mbrojtje të Mitrovicës. Thirrje publike këto që nuk janë institucionale, por, janë thirrje emocionale të shprehura nga protestuesit. “Llapjanët me autobus e minibus mësyn Mitrovicën, Deçani kërkoi të shkonte në Mitrovicë, Gjakova shprehu brengë për Mitrovicën, Malisheva dhuron gjak për të plagosurit, Revoltë e madhe pejane”.¹⁷⁹ Element tjetër i cili theksohet në këtë tekst është pasqyrimi i mesazheve kundër misionit ndërkombëtar të UNMIK-

¹⁷⁶Po aty, fq.3

¹⁷⁷Po aty, fq.1

¹⁷⁸Koha Ditore, “Protestuesit shprehën dhimbje për tre fëmijë të mbytur dhe kërkuan të shkonin në Mitrovicë”, 18 mars 2004, fq.8

¹⁷⁹Koha Ditore, “Protestuesit shprehën dhimbje për tre fëmijë të mbytur dhe kërkuan të shkonin në Mitrovicë”, fq.8

ut, si dhe deklaratimet e pakonfirmuara të gazetës se serbët kanë filluar të mobilizohen dhe të tubohen në kufirin me Kosovën. Tek ky numër i gazetës “Koha Ditore”, shumica e ngjarjeve të mbuluara kanë pasur pak informacione zyrtare, tekstet nga terreni janë të mbuluara përmes përshkrimeve, brenda të cilave jepet informacion i pakonfirmuar. Përkundër raportimit për dhjetëra të vrarë dhe qindra të plagosur, gjatë analizimit të këtij numri vërehet një hapësirë e vogël e reagimit politik, ndërkombëtar dhe vendor, si dhe mungesë totale e deklaratimit apo hapësirës e reagimeve të KFOR-it, policisë së UNMIK-ut e Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), të cilët në esencë janë institucione që kujdesën për sigurinë e përgjithshme në Kosovë.

Edhe e përditshmja “Epoka e re”, ditës së parë të dhunës ia kushton të gjithë ballinën dhe brendësinë e saj, të shoqëruar me fotografi dramatike nga vendi i ngjarjes dhe me pamje të gjendjes emocionale të protestuesve. Përmes tekstit kjo e përditshme i akuzon direkt serbët për dhunë ndaj shqiptarëve. “Revoltë spontane në tërë Kosovën: Shqiptarët janë zemëruar në kulm me mbytjen e fëmijëve në lumin Ibër. Nga plumba serbë dhe të tjerë, u derdh gjak e u dogjën pasuri të tundshme e të patundshme”.¹⁸⁰ Ajo çka vërehet më tepër nga kjo e përditshme është përdorimi i një numri të madh fotografish, të cilat sikurse teksti i shkruar flasin shumë për atë se çka ka ndodhur gjatë një dite të gjatë të përleshjeve anë e mbanë vendit. Sikurse “Koha Ditore”, edhe “Epoka e re”, vlerëson se ka mjaftuar ngjarja e vrasjes së tre fëmijëve në lumin Ibër për të eskaluar situata në dhunë. Kryeartikulli i këtij numri është një lajm i shkurtër, informativ dhe bazuar vetëm në deklaratat zyrtare të dhëna nga Shtabi i Emergjencës në QKU, që flet për dëmin njerëzor. “Të vrarë 14, të plagosur rreth 500”.¹⁸¹ ndërsa, tekstet e tjera janë përmbledhje e zhvillimeve në terren, të grumbulluara nga ekipe të gazetës nga zona të ndryshme të vendit. Ndryshe nga “Koha Ditore”, “Epoka e re” përmes raportimeve nga terreni i akuzon serbët të cilët kanë shtënë me armë në drejtim të shqiptarëve, të cilët kishin dalë për t’i zhbllokuar rrugët Prishtinë – Gjilan dhe Prishtinë – Shkup, ku kanë mbetur të plagosur qytetarë shqiptarë dhe pjesëtarë të KFOR-it. Përmes raportimit nga komunat e ndryshme të Kosovës, vërehet se shumica e teksteve janë të ndërtuar nga burime jozyrtare, nga dëshmitarë apo pjesëmarrës në protesta të dhunshme, apo nga përshkrimet e ekipeve të terrenit. Për dallim nga “Koha Ditore”, e cila në raportet nga komuna paraqiste një gatishmëri për t’u nisur drejt qytetit të ndarë të Mitrovicës, aty ku nisën trazirat, në këtë të përditshme, titujt janë informues dhe të drejtpërdrejtë. “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë

¹⁸⁰Epoka e re, “të vrarë 14, të plagosur rreth 500”, 18 mars 2004, fq.1

¹⁸¹Po aty, fq.1

të plagosur më armë zjarri, Mijëra qytetarë të Deçanit u solidarizuan me Mitrovicën, si me protestë ashtu edhe me dhurim gjaku, Revoltë e madhe e qytetarëve ferizajas, bllokohet aksi rrugor Ferizaj – Gjilan – Shkup, Edhe Gjakova përkrah Mitrovicën”.¹⁸² “Epoka e re”, gjatë këtij numri të raportimit kritikon politikën e misionit ndërkombëtar UNMIK-ut, ndërsa i jep një hapësirë më të madhe mesazheve politike, sidomos mesazheve të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës.

Ndryshe nga e përditshmja “Koha Ditore”, që kishte raportuar për gjashtëmbëdhjetë të vrarë dhe “Epoka e re”, për katërmëdhjetë, tjetra e përditshme “Zëri”, raporton për dhjetë të vrarë, ndërsa e vlerëson 17 marsin si ditën më të rëndë për Kosovën. Raportimi me shifra të ndryshme për numrin e të vrarëve, ndikon në besueshmërinë tek publiku, pavarësisht se ky numër mund të ketë ndryshuar nga çasti në çast. Edhe “Zëri”, në tekstin kryesor të tij, bënë konstatime për arsyen e trazirave duke i ndërlidhur këto ngjarje me ngjarjen tragjike të Çabrës, ndërsa shumica e titujve që e mbulojnë raportimin për dhunën ndëretnike janë nxitës. “Së paku dhjetë të vdekur dhe qindra të lënduar është epilogu i protestave të shqiptarëve në Mitrovicë dhe në anë tjetra të Kosovës, të cilët kishin dalë që të shprehin revoltën për shkak të vdekjes së tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër...”.¹⁸³ Pra, sikurse “Koha Ditore”, “Epoka e re”, ngjashëm edhe “Zëri”, konsiderojnë se Trazirat e Marsit 2004, janë përplasja më e madhe ndëretnike e ndodhur në Kosovën e pasluftës. Në disa tituj kjo e përditshme bënë vlerësimin e ngjarjes e cila tek publiku mund të reflektojë në forma të ndryshme e të ndjeshme. Prandaj, vlerësimi apo mendimi i gazetarit brenda teksti është në kundërshtim me rregullat dhe standardet profesionale të raportimit. “Çabra qanë për tri viktime të njoma”,¹⁸⁴ “Serbë e shqiptarë përleshën në Çagllavicë”, “U vihet zjarri objekteve serbe në Fushë Kosovë”.¹⁸⁵ Në përgjithësi në të përditshmen “Zëri”, prezent janë titujt të cilët brenda tyre përbëjnë elemente ndëretnike, siç janë të theksuar edhe në titujt e cituar më lartë, ndërkaq në ballinë gjendet edhe një titull vlerësues me elemente nxitëse, “Luftë e vërtetë në Mitrovicë – së paku gjashtë të vrarë dhe qindra të plagosur”.¹⁸⁶ Pra, në situata të tilla kur ngjarjet janë në zhvillim dhe ka zhvillime të shumta të cilat ndërlidhen me ngjarjen e njëjtë, publiku është i bombarduar me informacione, prandaj duhet pasur kujdes në vlerësimin e ngjarjeve të tilla. Në këtë rast loja me tituj, qoftë edhe përmes figurave stilistike, nuk duhet të përdoret në kreun e lajmit, pas parasysh të

¹⁸²Korrespondenët e “Epokës së re”, “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë të plagosur nga armë zjarri”, *Epoka e re*, 18 mars 2004, fq.8

¹⁸³Ekipi i “Zërit”, “Dita më e rëndë e Kosovës prej përfundimit të luftës”, *Zëri*, 18 mars 2004, fq.1

¹⁸⁴Ekipi i “Zërit”, “Dita më e rëndë e Kosovës prej përfundimit të luftës”, *Zëri*, 18 mars 2004, fq.1

¹⁸⁵Po aty, fq.1

¹⁸⁶Përparim Isufi, “Luftë e vërtetë në Mitrovicë – së paku 6 të vrarë dhe qindra të plagosur”, *Zëri*, 18 mars 2004, fq.1

kaluarën mes shqiptarëve dhe serbëve, e kaluar e përgjakshme që ende është e freskët në mendjen dhe ndjenjat e publikut, dhe se problemi me serbët ende nuk është i definuar politikisht. Gazeta “Zëri”, rreth dymbëdhjetë faqe ia kishte kushtuar ngjarjes së Trazirave të Marsit 2004, duke raportuar nga secila komunë për zhvillimet atje, numrin e të vrarëve, numrin e të plagosurve, dëmet materiale dhe djegiet. Por, edhe këtu, ngjashëm si në gazetatat e lartcekura, një pjesë e madhe e teksteve sidomos nga përmbledhjet në komuna të ndryshme të Kosovës, shihet një ndërtim i tekstit me pak burime zyrtare dhe me opinione e deklarata të ndryshme të korrespondentëve të pa bazuara në burime zyrtare.

Gazeta “Bota Sot”, duke e vlerësuar 17 marsin si ditën më të përgjakshme në Kosovë, boton në ballinën e saj një fotografi të një personi të gjakosur, të shoqëruar me titullin kryesor: “Vriten 14 shqiptarë, plagosën 500 të tjerë”,¹⁸⁷ ndërsa ngjitet me tekstin kryesor, publikon fotografitë e tre fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër, trupat e dy prej të cilëve tashmë ishin gjendur të vdekur. Në numrin e saj, kjo gazetë kësaj ngjarje ia ka kushtuar rreth pesëmbëdhjetë faqe, duke ia lënë një hapësirë të vogël reagimeve dhe deklaratave politike. Shumica e titujve në këtë numër të gazetës “Bota Sot”, kanë elemente të nxitjes së urrejtjes ndëretnike. “Serbët vranë me armë zjarri gjashtë shqiptarë dhe plagosën rëndë shumë të tjerë”.¹⁸⁸ Pra, i gjithë tregimi, struktura dhe narracioni brenda këtij teksti është i pa mbështetur në deklaratime zyrtare, brenda së cilit madje nuk ka asnjë deklaratë të cituar drejtpërdrejt. Kjo formë e raportimit bie në kundërshtim edhe me studimet e teoricienëve të zhanrit, të cilët vlerësojnë se citimi i drejtpërdrejtë e fuqizon titullin dhe kreun e raportit, por rrit besueshmërinë e tij. Madje sipas tyre, kur kemi të bëjmë me raportime të tilla të ndjeshme, duhet pasur jashtëzakonisht kujdes, për të mos nxitur provokimin e masës.

Edhe kjo përditshmeje, në njërën anë vlerëson se vrasja e tre fëmijëve në lumin Ibër ishte shkak kryesor i fillimit trazirave, e në anën tjetër vazhdon ta rris nxitjen e trazirave përmes raportimit që lidhet me këtë ngjarje. “Gjenden trupat e pajetë të vetëm dy vogëlushëve që u mbytën në lum duke ikur nga kriminelët serbë”.¹⁸⁹ Prandaj, vlerësimet që bëhen nga ana e redaksisë, e sidomos epitetet të cilat brenda tyre shfaqin elemente nxitës ndëretnik, janë në kundërshtim me anën etike dhe ligjore të raportimit. Brenda këtij numri të gazetës në disa tekste të ndryshme jepen lajme për numrin e të vdekurve, gjë e cila tek lexuesi mund të sjellë paqartësi për ta kuptuar

¹⁸⁷Bota Sot, “Vriten 14 shqiptarë, plagosën rreth 500 të tjerë”, 18 mars 2004, fq.1

¹⁸⁸Po aty, fq.3

¹⁸⁹BSM “Gjenden trupat e pajetë të vetëm dy vogëlushëve që u mbytën në lumë duke ikur nga kriminelët serbë”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.3

ngjarjen siç duhet. “Deri më tash janë mbi dhjetëra shqiptarë të vrarë dhe qindra të plagosur”.¹⁹⁰ Brenda këtij numri të raportimit shihet qartë një mungesë e thirrjeve të mesazheve politike për qetësimin e situatës, përkundrazi, titujt vazhdojnë të përbëjnë elemente të nxitjes së urrejtjes ndëretnike. Një shembull të tillë mund ta shohim edhe në raportin i cili lidhet me seancën e Kuvendit të Kosovës. Nga teksti i kësaj seance të Kuvendit, kemi përsëri një titull, i cili nuk përputhet me deklaratimet e deputetëve të cilët përfaqësojnë subjektet më të mëdha politike. “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lumë nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”.¹⁹¹ Mesazhet kryesore të raporteve të kësaj ditë, të vlerësuar si më të rëndën në Kosovën e pasluftës, brenda tyre kanë një gjuhë të ashpër të nxitjes së urrejtjes ndëretnike. Prandaj, përdorimi i një gjuhë të tillë në raportim, përveç së bie në kundërshtim në aspektin profesional, është shqetësues edhe për sigurinë e përgjithshme, kur dihet se qëllimi kryesor dhe njerëzor në ato momente ka qenë rikthimi i qetësisë dhe normalitetit.

E përditshmja tjetër “Kosova Sot”, shpërthimin e trazirave dhe revoltën e qytetarëve e ndërlidhë me mbytjen në lumin Ibër të tre fëmijëve shqiptarë. Të gjitha zhvillimet e ditës i përmbledh me një fotografi nga vendi i ngjarjes, ku shihen përplasje dhe plagosje, ndërsa titullin kryesor ia dedikon zhvillimeve dramatike. “Shpërthen dhuna, mbi 15 të vdekur dhe mbi 575 të plagosur në gjithë Kosovën. Mitrovica ishte skena kryesore e akteve të dhunës. Policia e UNMIK-ut, KFOR-i, ShPK-ja, u munduan ta pengojnë përshkallëzimin e dhunës, por kjo ishte e pamundur. Në orët e mbrëmjes situata është qetësuar disi, ndërkohë rajoni i Çagllavicës mbetet i tensionuar disi”.¹⁹² Pothuajse në shumicën e titujve brenda këtij numri janë të theksuara elemente të nxitjes ndëretnike, ku në shumicën e titujve apo mes titujve, fjala shqiptarët dhe serbët janë të kthyera në një rutinë, edhe pse bëhet fjalë për përplasje ndëretnike brenda një vendi apo shteti. Në këtë rast, përdorimi i shpeshtë i elementeve etnike ka ndikuar dhe ndihmuar në organizimin e masës, pas parasysh të kaluarën e këtyre dy komuniteteve. Për shumicën e qytetarëve të Kosovës ende ishin të freskëta kujtimet e të kaluarës me shtetin e serb, në agjendat ditore ndër temat kryesore të diskutimit ishte fati i të pagjeturve, ndërsa mbi një milion qytetarë ishin zhvendosur jashtë Kosovë, ndërsa mijëra shtëpi ishin djegur apo rrënuar. I gjithë ky kontekst mes dy etnive, i provokuar edhe

¹⁹⁰Sh. Osmani, “Deri me tash janë mbi dhjetëra shqiptarë të vrarë dhe qindra të plagosur”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.5

¹⁹¹L.Hajdari, “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lumë nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.7

¹⁹²Kosova Sot, “Shpërthen dhuna”, 18 mars 2004, fq.1

me raportimin për vdekjen e tre fëmijëve në lumin Ibër, kishte rritur nacionalizimin dhe rikthyer në kujtime urrejtjen mes shqiptarëve dhe serbëve. Vetëm gjatë kësaj ditë në këtë të përditshme janë ofruar rreth shumë fotografi nga zona të ndryshme të Kosovës, përmbajtja dhe mesazhi i të cilave ka ofruar për lexuesin dhe shikuesin vetëm mesazhe emocionale dhe thirrje për reagim. Madje edhe në tekstin: “Politikanët bëjnë thirrje për ruajtjen e gjakftohtësisë”,¹⁹³ paraqiten dy fotografi të cilat bien në kundërshtim me mesazhin në titull, pra brenda tyre paraqiten djegiet dhe trazira në rrugë, si dhe përplasje me forcat ndërkombëtare të sigurisë.

4.8 Reagimet politike dhe mbulushmëria nga ana e shtypit

Shtypi ditor gjatë dy ditëve të para të trazirave, reagimet e institucioneve politike të përfaqësuesve ndërkombëtare dhe atyre të Kosovës, për nga hapësira i kishte vendosur në plan të dytë të agjendës. Reagimet e tyre më tepër mund të shihen dhe gjykohen si mesazhe dëshpërimi karshi zhvillimeve dhe përshkallëzimit të dhunës në gjithë vendin. Megjithatë, në bazë të raportimeve në shtyp, reagimet politike karshi situatës dramatike ishin të pakta dhe me qëndrime të zbehta politike. Natyrisht që reagimet institucionale e në veçanti ato të sigurisë në situata të tilla ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek opinioni publik. Gazeta “Koha Ditore”, paraqet në ballinën e saj reagimet e gjitha institucioneve ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë, pas një takimi të përbashkët të përfaqësuesve vendor e ndërkombëtarë. “Deklaratë e përbashkët e liderëve politik, anëtarëve të Quint-it, BE-së dhe PSSP-së. Liderët porosisin ‘Kthehuni në shtëpi’”,¹⁹⁴ ky është mesazhi politik për protestuesit, i shoqëruar me një lutje për qytetarët: “Nuk ka asnjë arsye për të sulmuar apo ngacmuar fqinj. Aktet e tilla janë të patolerueshme. Ato janë turp për të gjithë ne”.¹⁹⁵ Pra, ky është mesazhi i përbashkët i një grupi të rëndësishëm të politikës vendore e ndërkombëtare në Kosovë, të cilët në mënyrë indirekte i kanë atakuar mediet për ngritjen e tensioneve ndëretnike gjatë raportimit të tyre. “Gjithashtu medieve u është bërë thirrje se duhet të punojnë më me përgjegjësi dhe të mos ndihmojnë në shtimin e tensioneve me deklarata të pabazuara”.¹⁹⁶ Pra, në

¹⁹³Kosova Sot, “Politikanët bëjnë thirrje për ruajtjen e gjakftohtësisë”, 18 mars 2004, fq.4

¹⁹⁴Gazmend Syla, “Liderët porosisin: ‘Kthehuni në shtëpi’”, *Koha Ditore*, 18 mars 2004, fq.1

¹⁹⁵Po aty, fq.3

¹⁹⁶Po aty, fq.2

reagimin e tyre të përbashkët kjo komponentë politike i ka fajësuar mediet të cilët sipas tyre kanë ndikuar përmes teksteve të tyre në përshkallëzimin e situatës ndëretnike.

Mirëpo, në situata të tilla politika më së lehti është t'i akuzojë mediet. Megjithatë, në reagimin e tyre të zbehtë, nuk ofrohet ndonjë përgjigje për daljen nga situata apo për gjetjen e shkaktarit të vërtetë që e kishte sjellë situatën deri në këtë pikë. Në anën tjetër, për t'i treguar ndasitë politike të cilat ditëve të fundit kishin shënuar një rritje mes qëndrimeve politike ndërkombëtare dhe vendore, shihet në reagimin e përbashkët të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët i kanë fajësuar ndërkombëtarët për tensionet e krijuara në Kosovë. "Parlamentarët ndërpresin punën, akuzojnë ndërkombëtarët për dhunën në Kosovë".¹⁹⁷ Prandaj, kjo situatë e tensionuar politike, ka ndikuar në situatën në terren, duke mos anashkaluar në këtë rast edhe publikimet dhe reagimet e Beogradit, të cilat përmes deklaratave nacionaliste e kanë tensionuar situatën e brendshme në Kosovë, dhe kanë kërcënuar se do i mbrojnë serbët në Kosovë me ushtri dhe polici. "Këshilli i Sigurisë i Qeverisë së Serbisë dhe Këshilli për Kosovën të cilët pas seancës u kanë thënë gazetarëve se kanë marrë vendimin që nga Qeveria e Serbisë të kërkojnë që ta dërgojë më se urgjentisht ushtrinë dhe policinë në kufi me Kosovën, për t'ua dhënë përkrahjen apo siç kanë thënë ata mbrojtjen e serbëve të Kosovës, por nëse duhet edhe popullsisë shqiptare".¹⁹⁸

Prandaj, nis nga reagimet politike në Serbi dhe raportimi i medieve për to, e ku këto media për serbët e Kosovës kanë qenë burimi kryesor i informimit, dhe në anën tjetër situata politike dhe reagimet në Kosovë, kanë ndikuar në frymën e nxitjes së urrejtjes ndëretnike. "Koha Ditore", i ka publikuar edhe reagimet ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë.

Gazeta "Epoka e re" nuk ka asnjë lajm në ballinën të reagimeve vendore apo ndërkombëtare për situatën e tensionuar në Kosovë. Dy lajme të rubrikës politike që janë të vendosura në ballinën e kësaj të përditshmeje nuk janë fare të rëndësishme për publikun. Protesta e organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër sulmit në rezidencën e presidentit Rugova, është njëri nga këto raporte që i është dhënë hapësire, madje duke ironizuar me përmbajtjen e tij. "[Mbititulli] Pa sens: LDK protestoi dobët në mbrojtje të personalitetit të Rugovës. [Titull] U bë fjalë për 'terrorin politik'".¹⁹⁹ Ndërkaq, lajmi i dytë politik i publikuar ka të bëjë me ndërprerjen të vizitës në ShBA,

¹⁹⁷Po aty, fq. 2

¹⁹⁸Naile Mala Imami, "Këshilli serb i Sigurisë i sugjeron qeverisë dërgimin e ushtrisë në kufi me Kosovën", *Koha Ditore*, 18 mars 2004, fq.4

¹⁹⁹Burim Etemaj, "Njerëz vriten në Mitrovicë, LDK-ja proteston për një bombë: 'terror politik', thotë!", *Epoka e re*, 18 mars 2004, fq.3

të kreut të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hashim Thaçi, për shkak të zhvillimeve në Kosovë. Ndërsa, ngjashëm me të përditshmen “Koha Ditore”, në brendësi të saj “Epoka e re”, boton reagimin e Qeverisë së Kosovës, e cila bënë thirrje për qetësi dhe deklaratën e përbashkët të shteteve të Quint-it, PSSP-së dhe Institucioneve të Kosovës, të cilat po ashtu bëjnë thirrje për qetësi. Gjithashtu “Epoka e re”, duke u bazuar në deklaratat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, boton tekstin në të cilin akuzon UNMIK-un, për dështim rreth mos efikasitetit ndaj situatës së krijuar në Kosovë. Duke pas parasysh situatën e tensionuar politike, pakënaqësitë ndaj UNMIK-ut, ndasitë e theksuara të brendshme politike në Kosovë dhe ndërhyrjet nga ana Beogradit, kjo reflekton ndaj situatës së krijuar në terren, ku këto dallime dhe ndasi vërehen edhe në reagime të ndryshme politike të cilat nuk përbëjnë mesazhe të qarta politike.

Edhe e përditshmja tjetër, gazeta “Zëri”, në ballinën e saj i kushton fare pak rëndësi deklaratave politike. Ka vetëm dy të tilla, njëra nga përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian (BE), i cili dënon dhunën ndëretnike në Kosovë, dhe tjetri i cili nuk ndihmon fare në qetësimin e situatës në terren që vije nga Kuvendi i Kosovës. “Kuvendi kërkon goditjen e strukturave paralele për qetësimin e situatës në Kosovë [Nëntitull] Tolerimi i strukturave paralele serbe dhe i bandave kriminale që nxisin dhe vrasin qytetarë të Kosovës është politikë e gabuar që do ta destabilizojë Kosovën, thuhet në deklaratën e miratuar dje nga deputetët kosovarë”.²⁰⁰ Prandaj, kur analizohen deklaratimet politike të serbëve në Beograd dhe deklaratimet politike të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të raportuara dhe të publikuara nga shtypi, shihet qartë se këto reagime të cilat bartin mesazhin përmes shtypit janë deklarata të një politike të papjekur të cilat e vështirësojnë gjendjen e tensionuar në terren. Gazeta “Zëri”, i ka publikuar në brendinë e saj edhe thirrjet për qetësi të institucioneve politike ndërkombëtare dhe vendore.

Ndërkaq “Bota Sot” i jep hapësirë në ballinën e saj dy informacioneve nga fusha e politikës. Një hapësirë më të madhe i kushtohet protestës së organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër sulmit në rezidencën e Rugovës ndërsa në fund të faqes e vendos thirrjen për qetësi të reagimit të përbashkët të politikës ndërkombëtare e vendore. Ndërsa e gjithë faqja e shtatë e gazetës i është kushtuar deklaratës së dalë nga Kuvendi i Kosovës, me një titull nxitës që rezulton

²⁰⁰Zijadin Gashi, “Kuvendi kërkon goditjen e strukturave paralele për qetësimin e situatës në Kosovë”, *Zëri*, 18 mars 2004, fq.8

si rezultat i deklaratave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lum nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”.²⁰¹

Edhe e përditshmja “Kosova Sot” ka botuar vetëm një informacion të shkurtër politik, që bënë thirrje qytetarëve për të qëndruar brenda shtëpive të tyre. “Qeveria i drejtohet popullit: Përmbahuni!”²⁰² Pra ky është titulli i vetëm i cili brenda tij nuk ka informacion të plotë, shoqërohet me deklaratën e kryeministrit të asaj kohe, Bajram Rexhepi, se: “Qeveria kërkon që qytetarët të qëndrojnë në shtëpitë e veta, të mbretërojë arsyeja pasi që aktet të cilat mund të pasojnë e rrezikojnë sidomos pjesën veriore të Kosovës dhe vetë Mitrovicën, që me të vërtetë të vijmë në një situatë para një akti, të cilin nuk e dëshiron askush”.²⁰³

Prandaj, parë nga konteksti i raportimit të shtypit për reagimet dhe deklaratimet politike rreth Trazirave të Marsit 2004, shihet qartë polarizimi politik ka ndikuar në situatën e përgjithshme të trazirave ndëretnike. Pavarësisht dhjetëra të vlarëve dhe të plagosurve mesazhet politike janë të pakta, të cilat më tepër ngjajnë në reagime të obligimeve etike, duke mos paraqitur në asnjërin reagim nga to, përgjegjësitë e tyre karshi obligimeve ndaj qytetarëve të Kosovës.

4.9 Raportimi i shtypit për ditën e dytë të trazirave

Pothuajse e gjithë përmbajtja e shtypit në ditën e dytë i ishte dedikuar trazirave ndëretnike, sidomos raportimit nga terreni dhe teksteve të ndërtuara në mënyrë interpretive. Të tillë kanë qenë raportimet në gazetën “Koha Ditore”, me temën kryesore: “Apelet politike me efekt të kufizuar – dhuna vazhdon”.²⁰⁴ Titulli në njërën anë jep vlerësimin e efekteve politike në terren, ndërsa në anën tjetër tregon për vazhdimin e dhunës, kurse i gjithë teksti, si në aspektin strukturor, ashtu edhe në atë përmbajtjesor, fokusohet në interpretimin e situatës në gjithë Kosovën, duke u bazuar kryesisht në përshkrim, me pak burime zyrtare të institucioneve gjegjëse, si: KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, Shërbimi Policor i Kosovës si dhe institucioneve të politikës vendore e ndërkombëtare. Edhe ato pak burime zyrtare të përdorura në tekste në shumicën e rasteve nuk i destinohen emrave konkret të zyrtarëve, por shumica janë burime në emër të institucioneve dhe

²⁰¹L. Hajdari, “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lum nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.7

²⁰²I. Krasniqi, “Qeveria i drejtohet popullit: Përmbahuni!”, *Kosova Sot*, 18 mars 2004, fq.2

²⁰³Po aty, fq.2

²⁰⁴Koha Ditore, “Apelet politike me efekte të kufizuara – dhuna vazhdon”, 19 mars 2004, fq.1

kryesisht janë të përdorura përmes ligjëratës së zhdrejtë. I gjithë teksti në esencë flet për dhunën ndëretnike mes shqiptarëve dhe serbëve, duke i identifikuar edhe vendet të cilat kanë qenë pika të ndjeshme ndëretnike, si vendbanime në të cilat ndasia ndëretnike ka qenë për vite e brishtë, objektet e kultit dhe objektet fetare, monumentet historike, etj.

Prandaj, në rrethana të tilla të trazirave apo konflikteve ndëretnike, mediet duhet të kenë kujdes të shtuar në raportimin e tyre, duke pasur kujdesin e veçantë në trajtimin e çështjeve etnike, racore, fetare e kulturore. Këta janë disa nga nëntitujt e tekstit kryesor të gazetës “Koha Ditore”: “Granatime dhe shkëmbime zjarri në veri të Mitrovicës”, “Dhuna nga Veterniku bartet në Prishtinë, rezulton me vënien e flakës Kishës ‘Sveti Nikol’ në Tasligje”, “Shkatërrim dhe djegie në Lipjan, Ferizaj dhe Rahovec”, “Në Pejë, Klinë, Gjakovë ditë e manifestuar me protesta”.²⁰⁵ Vlen të theksohet në këtë rast se në pjesën e parë të tekstit kryesor, i është dhënë hapësirë reagimeve politike, të cilat kjo e përditshme i vlerëson me efekte të kufizuara, gjë e cila bie të jetë në kundërshtim me përmbajtjen e tekstit. Në dy raste brenda tekstit, shihet se politika vendore me veprimet e saja ka pasur efekt tek masa, siç është rasti i ish-kryeministrit Bajram Rexhepi dhe kryetarit të AAK-së Ramush Haradinaj. “Kryeministri Rexhepi, Veternikun e ka vizituar bashkë me ministrat Et’hem Çeku, Jakup Krasniqi dhe Behxhet Brajshori, bashkë me të cilët i ka bindur protestuesit të largohen nga postblloku i KFOR-it”²⁰⁶ dhe “Telefonata e Ramush Haradinajt bëri që të qetësohen gjakrat e qindra protestuesve në Deçan, të cilët ishin nisur për në Manastirin e Deçanit në këtë komunë”.²⁰⁷

Pra, në të dyja rastet shihet se si kryeministri i Kosovës Rexhepi dhe kreu i një subjekti politik kanë arritur që përveç që t’i ndalojnë veprimet e protestuesve, edhe t’i qetësojnë ata dhe t’i largojnë nga rrugët. Prandaj, përfaqësuesit politik institucional dhe të atyre me ndikim, kanë mund të kontribuojnë më tepër në qetësimin e situatës në terren. Në këtë numër të kësaj të përditshmeje botohen reagime dhe qëndrime editoriale të medieve serbe, titujt e të cilave janë kryesisht joadekuate në raport me situatën në terren dhe efektin e tyre i cili reflekton drejtpërdrejt me situatën në terren. “Çoviq: Vetëm ushtria serbe mund t’i mbrojë serbët e Kosovës”, “Në Beograd dhe Nish digjen xhamitë”, “Tigrat e Arkanit në veri të Kosovës”, “Kryetari i Serbisë: Në Kosovë, terrorizëm i organizuar”.²⁰⁸ Prandaj, raportimet e tilla bien në kundërshtim me studimet e teoricienëve të cilët

²⁰⁵Po aty, fq.4

²⁰⁶Koha Ditore, “Apelet politike me efekte të kufizuara – dhuna vazhdon”, 19 mars 2004, fq.4

²⁰⁷Po aty, fq.4

²⁰⁸Naile Mala Imami, “Në Beograd dhe Nish digjen xhamitë”, *Koha Ditore*, 19 mars 2004, fq.6

vlerësojnë se në rrethana të jashtëzakonshme përmbajtja e lajmeve nuk paraqet vetëm një ngjarje. “Në fakt, përmbajtja e lajmeve nuk është thjeshtë reflektim i ngjarjeve aktuale”.²⁰⁹ Pra, në situata të trazirave, edhe raportimi ditor reflekton dhe ndikon tek publiku më tepër sesa një raportim i zakonshëm ditor.

Gazeta “Epoka e re” një ditë pas trazirave të dhunshme, që rezultoi me dhjetëra të vrarë, në tekstet e saj përveç raportimeve, e adreson fajin drejt politikës ndërsa i akuzon misionet ndërkombëtare për vrasjen e shqiptarëve. Mirëpo, në asnjërin nga titujt e ballinës të kësaj të përditshme nuk ka të publikuara deklaramë politike apo intelektuale përmes të cilave do të bëhej thirrje për qetësi edhe pse situata në terren vazhdon të mbetet e tensionuar. Shumica e teksteve janë vlerësuese dhe interpretuese të ngjarjeve, gjë që bie në kundërshtim me standardet profesionale të raportimit. Po ashtu, titulli kryesor i mbështetur nga mbititulli dhe nëntitulli, nuk janë fare të përfshira brenda ndonjë teksti apo deklarimi konkret. “[Titulli] Status quoja në Kosovë përfundoi me shumë viktima, [Mbititulli] UNMIK-u dhe një pjesë e politikës se kanë asnjë vlerë besimi tek protestuesit. [Nëntitull] Politika mashtruese kushtoi 31 jetë. Janë mbi 600 të plagosur e të lënduar. Disa shumë rëndë. Numri i viktimave mund të jetë shumë i madh”,²¹⁰ theksohet në numrin e gazetës “Epoka e re”, të 19 marsit. Kjo e përditshme ndër të tjera akuzon misionet ndërkombëtare në Kosovë, të cilat u kanë shkaktuar vdekje shqiptarëve. “Si u vranë protestuesit shqiptarë nga Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-it”,²¹¹ tekst brenda të cilit ngritën dilemat dhe vënë në pikëpyetje besueshmërinë mbi këto dy misione ndërkombëtare, ndërsa në anën tjetër, nëpërmjet një analize të situatës, Adem Demaçi i shfajëson qytetarët karshi trazirave dhe dhunës në terren. “Zotërinj të institucioneve formale të Kosovës, zotërinj të UNMIK-ut, zotërinj të regjimit të Beogradit, për erupsionin e pakontrolluar të mllefrit e dëshpërimit qytetarë të Kosovës, ju jeni fajtorë, e askush tjetër. Mos u mundoni t’i mjegulloni e t’i fshihni gjynahet tuaja. Mos u mundoni t’i gjeni kriminelët e fajtorët për vdekjen e dhjetëra qytetarëve të pafajshëm jashtë radhëve tuaja. Mos u mundoni t’i lani duart nga gjaku i qindra të plagosurve kosovarë me fraza bajate e demagogjike”.²¹² Pra, nëpërmjet këtij teksti shohim tendencën e krijimit të një amnistie të qytetarëve për trazirat e shkaktuara duke hedhur gishtin në anën tjetër, ndaj politikës dhe misioneve

²⁰⁹Linda L. Putnam dhe Martha Shoemaker, “Changes in Conflict Framing in the News Coverage of an Environmental Conflict”, 2007 Journal of Dispute Resolution (2007)
<http://scholarship.law.missouri.edu/jdr/vol2007/iss1/10/> (30.11.2017)

²¹⁰Epoka e re, “Politika mashtruese kushtoi 31 jetë”, 19 mars 2004, fq.1

²¹¹Po aty, fq.1

²¹²Po aty, fq.1

ndërkombëtare. Prandaj, duke parë dhe analizuar tekstet kryesore të kësaj të përditshmeje dhe duke pas parasysh relevancën e këtyre ngjarjeve, kolegji editorial i kësaj të përditshmeje ka vendosur të trajtojë dhe të shpreh pakënaqësinë e një kaste politike e cila kishte krijuar situatën deri në këtë gjendje kritike dhe jo t'i jep hapësirë thirrjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për kthimin e qetësisë. Siç shihet edhe në raportimet e mëhershme, "Epoka e re" vazhdon ta rrisë dozën e kritikës, kryesisht ndaj UNMIK-it, kritikë të cilën e kishte bërë edhe më parë duke i argumentuar dështimet e këtij mision në raport me pritshmëritë dhe obligimet e tij. Në këtë kontekst kemi edhe një raport të korrespondentëve të Ferizajt, të cilët duke u bazuar në dëshmitarë okular, pa burime zyrtare dhe emra konkret, sjellin një tekst nxitës kundër misionit të KFOR-it. "Grekët e KFOR-it e shkelën me tank".²¹³ Kështu, duke filluar nga titulli i këtij teksti, struktura, argumentimi dhe barasvlerësimi i raportit dhe situatës së krijuar në terren shihet një tendencë e cila reflekton dhe ngjallë gjendje emocionale tek masa.

Reagimet dhe thirrjet për qetësi nga ana e institucioneve të Kosovës, misioneve ndërkombëtare: UNMIK-it dhe KFOR-it, Policisë së UNMIK-it, Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe reagimeve dhe thirrjeve të diplomatëve botërorë vendosën në planin e dytë të raportimit, duke iu dhënë pak hapësirë brenda teksteve dhe aspak hapësirë në ballinë, tekstet e të cilës zakonisht kanë efekte më të mëdha tek opinioni publik. Prandaj, sipas autorëve dhe studiuesve të medieeve, raportimit në rrethana të jashtëzakonshme nuk është vetëm një raportim informimi sepse impakti i këtyre raportimeve infiltrohet në interpretimin e situatës në terren. Gazeta "Bota Sot", sikundër raportimit të ditëve të mëparshme të analizuara më lartë, kishte vazhduar me politika editoriale të mbështetura në deklaratat politike të liderëve institucional, të cilët vinin nga subjekti politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Edhe në këtë numër të 19 marsit, dy tekstet kryesore në këtë të përditshme janë: Deklarata e presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe kryetarit të Kuvendit Nexhat Daci i cili vije nga i njëjti subjekt politik. Mesazhet politike në ballinën e kësaj të përditshmeje janë kryesisht politike. "Ky vend, i cili ka kaluar nëpër përgjakje nuk ka zgjidhje tjetër përveç pavarësisht të vet".²¹⁴ Prandaj, në këtë kryetitull, mesazhi nuk i përshtatet zhvillimeve dramatike në vend, por një deklaratë politike e cila flet për pavarësinë e vendit, pavarësisht që në këto rrethana do të duhet të bëhej thirrje vetëm për

²¹³Skënder Idrizi, "Grekët e KFOR-it e shkelën me tanks!", *Epoka e re*, 19 mars 2004, fq.16

²¹⁴L. Hajdari, F.Musa "Ky vend, i cili ka kaluar nëpër përgjakje nuk ka zgjidhje tjetër përveç pavarësisht të vet", *Bota Sot*, 19 mars 2004, fq.5

qetësi dhe ndalje të dhunës. Gjithashtu edhe mbajtja e seancës së Kuvendit dhe fjalimet aty ishin kryesisht të ndërlidhura me zhvillimet e trazirave në gjithë vendin. Ndërsa, në brendësi të saj, “Bota Sot” publikon një kolazh të fotografive nga ngjarjet e një dite më parë në terren, duke ofruar pamje të cilat prodhojnë reaksion tek opinioni publik dhe në këtë formë thyejnë parimet e një raportimi etik e profesional.

E përditshmja tjetër “Kosova Sot” në raportimin e saj një ditë pas trazirave të dhunshme ndëretnike, ku mbetën të vrarë dhjetëra e qindra të plagosur, politikën e saj editoriale e kishte fokusuar kryesisht në mesazhet e duhura politike dhe reagimet vendore e ndërkombëtare të cilat bëjnë thirrje për qetësi dhe presion mbi masën. “NATO-ja shton numrin e paqeruajtësve pas protestave të dhunshme.... 1100 trupa shtesë.... Forcat që po dislokohen tani atje janë ekstra dhe do të ndihmojnë në kthim të shpejt të stabilitetit dhe ato janë tregues i dukshëm i vullnetit dhe aftësisë së NATO-s për ta bërë këtë, tha zëdhënësi Apatheraï.”²¹⁵ Përmes tekstit kryesor të botuar në këtë të përditshme, jepet mesazhi i qartë për mos tolerancë të zgjatjes së dhunës dhe mos ndikim e provokim të dhunës së mëtejshme në terren. Edhe në dy raporte të tjera, të cilat kanë zënë hapësirë me titujt dhe përmbajtje janë në kuadër të së njëjtës frymë, për kthim në normalitet. “Rexhepi shpërndan protestuesit”,²¹⁶ “Në Kosovë të rivendoset qetësia”,²¹⁷ “S’ka më tolerim për protestat e dhunshme”.²¹⁸ Prandaj, edhe në ditën e dytë të trazirave, te shumica e teksteve të botuara në shtypin ditor dominojnë politikave të tyre editoriale, të cilat i kanë vendosur në plan të parë. Në këtë kontekst, shumica e teksteve kanë qenë vazhdimësi e raportimit për trazirat, brenda të cilave kanë krijuar mozaikun e politikave të tyre editoriale. Në pjesën më të madhe të teksteve kryesore është përdorur një raportim i formës interpretuese, me ç’rast një pjesë e madhe e teksteve kanë pasur elemente interpretuese të politikave editoriale më tepër sesa një interpretim i fakteve në terren. Prandaj, dhuna ndëretnike nuk mund të konsiderohet si ngjarje e përditshme e raportimit dhe si rezultat i kësaj, shtypi duhet të ketë përgjegjësi për dilemat që ngritën gjatë raportimit, standardet profesionale të raportimit që përdor, etikën e raportimit të cilën duhet ta maksimalizojë, balancimin të lajmeve apo raporteve, fokusimin në informacione brenda burimeve zyrtare si dhe përgjegjësinë ndaj profesionit dhe shoqërisë, etj.

²¹⁵Kosova Sot, “NATO dërgon 1100 ushtarë shtesë në Kosovë”, 19 mars 2004, fq.3

²¹⁶ Kosova Sot, “NATO dërgon 1100 ushtarë shtesë në Kosovë”, 19 mars 2004, fq.3

²¹⁷ Po aty, fq.2

²¹⁸Alma Rraci, “S’ka më tolerim për protestat e dhunshme”, *Kosova Sot*, 19 mars 2004, fq.6

4.10 Ngjarjet e marsit sipas editorialeve, opinionëve dhe komenteve të botuara në shtypin ditor

Pa dyshim që editorialet, opinionet dhe komentet të botuara në gazeta, si nga aspekti tipologjik ashtu edhe në atë editorial, të botuara në shtyp janë pjesë e rëndësishme e formimit të opinionit publik. Editorialet paraqesin qëndrimin e politikave editoriale të kolegjiëve të redaksisë dhe si të tilla, brenda tyre mund të vlerësohet dhe gjykohet diskursi dhe qëndrimi i agjendave redaksionale për temat e ndryshme të preokupimit shoqëror. Brenda këtij asociacioni hyjnë edhe komentet dhe opinionet, të cilat shtypi i boton kryesisht kur përputhen me agjendat e tyre dhe politikat editoriale. Në këtë kontekst, në shumicën e rasteve, opinionbërësit ose janë pjesë e brendshme e redaksive të shtypit, ose mendimet e tyre përputhen me mesazhin e tyre. Gjatë kësaj faze, për ta sqaruar edhe më tej ndikimin e shtypit në trazirat ndëretnike të marsit 2004, do t'i analizojmë qëndrimet editoriale të shtypit lidhur me ngjarjen më të rëndë ndëretnike në Kosovën e pasluftës. Editorialet, opinionet dhe komentet e botuara në shtyp gjatë kësaj periudhe të trazirave të dhunshme ndëretnike paraqesin edhe analizimin kontekstual të trazirave, zhvillimeve politike dhe faktorëve, të cilët sipas tyre mund ta kenë shkaktuar një valë të dhunshme në gjithë vendin. Gjithashtu, këto editoriale, opinione, analiza e vështrime, do të na bëjnë të kuptojmë nga këndvështrime të ndryshme të profileve të ndryshme, rrethanat e krijuara në ngjarjet e Trazirave të Marsit 2004.

Gjatë periudhës së trazirave ndëretnike të marsit 2004, një pjesë e qëndrimeve editoriale të gazetës “Koha Ditore”, janë shkruar nga ana e botuesit të saj Veton Surroi, i cili përveç kësaj, ka qenë pjesë aktive e politikës. Në kolumnën e tij të parë për trazirat e marsit me titull “Vdekja tragjike e një politike dhe e njerëzve nga ajo”,²¹⁹ Surroi e ndanë në katër pika, brenda së cilës jep konkluzione dhe përfundime. Në pjesën e parë përmes përshkrimit paraqet gjendjen e krijuar pas fillimit të trazirave, të cilën e quan anarkiste. Surroi e akuzon drejtpërdrejt politiken kosovare si shkaktarin kryesor të fillimit të trazirave sepse sipas tij, iluzionin e një Mitrovice të qetë, e prishi mbytja në lumin Ibër e tre fëmijëve shqiptarë. Mirëpo, Surroi në këtë rast nuk e adreson problemin në adresën e misionit ndërkombëtar, ku i gjithë territori i Kosovës ashtu edhe ndarja e Mitrovicës ishte nën përgjegjësinë dhe kompetencat e këtij misioni. “Thyerja e iluzionit që tragjik. Për fëmijët shqiptarë të Çabrës, sipas rrëfimeve të para ikin nga ndjekja e fqinjëve të tyre serbë. Më pastaj për

²¹⁹Veton Surroi, “Vdekja tragjike e një politike dhe e njerëzve nga ajo”, *Koha Ditore*, 18 mars 2004, fq. 3

mitrovicasit e vrarë e të plagosur, shumica prej tyre shqiptarë, por edhe serbë. Dhe, për Kosovën si tërësi, një lloj hakmarrje e Mitrovicës për harresën që e kanë bërë kosovarët e tjerë deri tani”.²²⁰ Në pikën e radhës të këtij editoriali, Surroi thekson se UNMIK-u dhe politika kosovare, nuk po sjellin asgjë të re për problemet të cilat ekzistojnë në Kosovë. Ai e mbyllë editorialin e tij duke e vlerësuar politikën vendore e ndërkombëtare si të vdekur, duke aluduar se qytetarëve nuk ka se çka t’iu ofrojë më tepër një politikë e vdekur, dhe për këtë sipas tij, ata kanë filluar t’i shfaqin energjinë e dhunës. Mirëpo, shumë më lehtë është të akuzosh dikë në situata të tilla kur më së shumti kërkohet zgjidhje. Adresimi i fajësisë mbi liderët politik shqiptarë, vë në theks tendencën e tij për promovim dhe për një alternativë ndryshe politike që do të mund ta ofronte. Edhe në numrin e radhës në gazetën *Koha Ditore*, editorialin e radhës ia kushton trazirave të dhunshme më titullin “Tash e tërë Kosova është peng. Përndjekja e serbëve, shfaqja e liderëve anonim, arroganca e UNMIK-ut; shenjat e leksioneve të pamësuar tash e pesë vite”.²²¹ Edhe në këtë analizë të shkruar nga Veton Surroi e të ndarë në katër pika, paraqet problemet dhe faktorët që sipas tij, ndikuan në trazirat ndëretnike. Në pikën e parë paraqet problemin politik të Mitrovicës, i cili nxiti reagimin e dhunshëm të shqiptarëve karshi enklavave serbe dhe cenimin e raporteve të shqiptarëve me ndërkombëtarët. Sipas tij, edhe pse reagimi i masës ishte spontan, orët në vazhdim treguan se turmat ishin të organizuara dhe të udhëhequra nga grupe të caktuara të njerëzve. “Ndërsa përgjatë 24 orëve të kaluara ata që drejtonin turmat, herë prezantoheshin si lider veteranësh të UÇK-së, herë si liderë studentorë. Dhe në këtë intermexo prej 24 orësh, kapaciteti organizator vërtetohej në numrin e armëve të cilat u shfaqën saora në ‘demonstrimet paqësore’”.²²² Ndër të tjera, në këtë tekst paraqiten tri lloje të pushtetit të cilat e kanë krijuar situatën deri tek trazirat: Misioni i UNMIK-ut, i cili sipas tij, mos punën e arsyeton me fjalët se janë çlirimtarët tanë; mos aftësinë e politikës kosovare, e cila në vend që të bëjë thirrje për qetësi, kërkojnë njohjen formale (i referohet deklaratës së ish-presidentit Ibrahim Rugova) dhe Beogradit, i cili po mundohet të arsyetohet, sipas Surroit tek ndërkombëtarët se është i vetmi që mund ta siguroj paqen në Kosovë. Sipas tij, qytetarët dhe Kosova tashmë janë pengje sepse trazirat e marsit nuk na ofruan së paku një përgjigje sesi duhet vepruar më tutje. Pra, edhe në këtë editorial të shkruar nga botuesi i kësaj të përditshmeje,

²²⁰ Po aty, fq.3

²²¹Veton Surroi, “Tash e tërë Kosova është peng”, *Koha ditore*, 19 mars 2004, fq.3

²²²Po aty, fq.3

shihet më tepër si një qëndrim politik, i cili është jashtë çdo përgjegjësie sesa i një mesazhi apo një situatë për të dalë nga një situatë e rëndë.

Koha ditore në këtë numër të saj, në faqen “Vështrime dhe editoriale” ka botuar një tekst të autorit Bashkim Muça me titull: “Lumi i gjakut dhe integrimi i detyruar”, përmes të cilit akuzon administratën e UNMIK-ut për paaftësinë e saj të treguar në Kosovë dhe paaftësinë e politikës kosovare për të trajtuar çështjet e rëndësishme. “Toleranca e qëllimshme e administratës së OKB-së ndaj organizimit jo institucional të serbëve, veçanërisht në pjesën veriore të Mitrovicës dhe paaftësia e politikës kosovare për të ushtruar trysninë e duhur për këtë çështje, qëndron në thellësinë e asaj që po reflektohet sot në Kosovë”.²²³ Muça në këtë vështrim të tij, thekson se trazirat ndëretnike filluan si rezultat i mbytjes në lum të tre fëmijëve shqiptarë, mirëpo ky ishte reagimi i një akumulimi të gjatë të pakënaqësive. Brenda kësaj faqeje është botuar edhe një koment i njohësit amerikan për zhvillimet në Ballkan, Daniel Server, i cili thekson se trazirat ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve e kanë dëmtuar rëndë procesin e Kosovës dhe ka treguar para bashkësisë ndërkombëtare se Kosova nuk ka shënuar progresin e mjaftueshëm. Sipas Server, çfarëdo që ka ndodhur me tre fëmijët e përmbytur në lumin Ibër, reagimi i dhunshëm nuk është zgjedhje. “Kështu që demonstruesit e kanë dëmtuar rëndë Kosovën dhe aspiratat e saja, po aq sa e kanë dëmtuar edhe serbët”,²²⁴ është thënë në komentin e njohësit amerikan për zhvillimet në Ballkan, Daniel Server.

Në numrin e radhës në të përditshmen “Koha Ditore”, botohet një vështrim i Marton Abramovitz, anëtar ekzekutiv i Komitetit Ndërkombëtar të Krizave. Në vështrimin e tij, Abramovitz, duke i vlerësuar zhvillimet në Kosovë si më të këqijat që nga viti 1999, vlerëson se kjo situatë do të rrezikojë ndarjen e Kosovës. Sipas analizës së tij, papërgjegjësia politike e BE-së dhe qëndrimi i administratës amerikane në linjat e asaj politike ka ndikuar në rritjen pakënaqësive në Ballkan. “Dështimi i vendosjes së shtetësisë së Kosovës krijon paqartësi masive në Ballkan, nxit tensionet midis shqiptarëve dhe serbëve, vonon investimet dhe rritjen ekonomike dhe e mbanë Serbinë të përqendruar në të kaluarën”.²²⁵ Abramovitz, në analizën e tij identifikon dy faktorë të cilët kanë shkaktuar këtë situatë; faktori politik dhe grupi që ka organizuar trazirat dhe përplasjet ndëretnike. “Dhuna e kësaj jave ka eksponuar dështimin e politikës perëndimore në Kosovë. Do

²²³Bashkim Muça, “Lumi i gjakut dhe integrimi i detyruar”, *Koha Ditore*, 19 mars 2004, fq.10

²²⁴Bashkim Muça, “Lumi i gjakut dhe integrimi i detyruar”, *Koha Ditore*, 19 mars 2004, fq.10

²²⁵Morton Abramowitz, “Kthimi prapa në Ballkan”, *Koha Ditore*, 20 mars 2004, fq.7

të shohim në disa ditët e ardhshme nëse Perëndimi e njeh këtë, ose që është më e besueshme, do të vazhdojë llafet e veta për nevojën që Kosova të përmbushë standardet jorealiste dhe për domosdoshmërinë e vazhdimit të administratës së OKB-së”,²²⁶ thekson Abramovitz, duke shtuar se organizatorët e dhunës duhet të ndëshkohen. “Dhuna shqiptare – një pjesë e saj, ose pjesa më madhe e parapërgatitur nuk mund të falet dhe duhet të ndalet”.²²⁷ Pra, kjo e përditshme e cila boton analiza të njohësve ndërkombëtarë, i ofron publikut përmes tyre shkaktarët e dhunës dhe nevojat emergjente që duhet të ndërmerren. Por, për dallim nga editorialet e mëparshme, ky njohës i zhvillimeve në Kosovë, nuk e akuzon politikën shqiptare për një situatë të tillë, por pikërisht atë ndërkombëtare.

Përmes një teksti të botuar në “Koha Ditore”, gazetari dhe aktivisti humanitar gjerman Rupert Nojdik, i ishte drejtuar qytetarëve të Kosovës, duke theksuar se ajo çfarë ka ndodhur në trazirat e 17 dhe 18 marsit është një krim dhe gabim shumë i madh, i ndërmarrë nga qytetarët shqiptarë të Kosovës. Sipas tij, me një goditje dhe për një ditë u harxhua krejt kredia e fituar dhe se çdokush në Evropë, në qarqe dhe seli qeveritare, në shoqëri dhe media është sërish i trishtuar dhe se nuk ka një shpjegim. Nojdik në këtë tekst citon një analizë të Bernard Kuper në gazetën gjermane “Suddeutsche Zeitung”, për të analizuar shkaktarët e trazirave. “Demonstratat dhe dhuna e shqiptarëve kundër serbëve të mbetur në Kosovë i ka turpëruar si administratën ndërkombëtare të OKB-së, ashtu edhe trupat paqësore të NATO-s. E kjo ndodhi sepse bashkësia ndërkombëtare që kohë të gjatë mendohej të fshehte gjendjen faktike. Dhe tash ende nuk mund të konstatohet përfundimisht se a ishte një punë e koordinuar tërë kjo apo një reaksion spontan i popullatës”,²²⁸ thekson Nojdik, duke shtuar se aksione të tilla masive asnjëherë nuk mund të sqarohen e të bëhen përmes spontanitetit. Pra, në bazë të analizës së editorialeve, komenteve, opinioneve e vështirimeve të botuara në gazetën “Koha ditore”, mund të nxjerrim si përfundim disa elemente, ndër to edhe qëndrimet politike editoriale të kësaj të përditshmeje, e cila haset në hapësirën në ballinë dhe promovimin politik të botuesit të saj, por ndër tjera edhe nevojën për ndryshime politike që do të duhej të ndodhnin. Gjithashtu, shihet se kjo e përditshme gjithnjë i ka dhënë një hapësirë edhe reagimeve apo analizave politike të njohësve të zhvillimeve në Kosovë e Ballkan.

²²⁶Po aty, fq.7

²²⁷Po aty, fq.7

²²⁸Rupert Neudeck, “Ajo që keni bërë është më shumë se një krim – është një gabim”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004, fq.10

E përditshmja tjetër, “Epoka e re” ka botuar një numër të kolumneve, editorialeve dhe opinioneve, ku kryesisht trajtohet tema e trazirave ndëretnike. Përmes një kolumne me titull: “Status-quos i erdhi fundi sërish, por me viktima!”, Sadri Ramabaja për trazirat ndëretnike dhe për numrin e njerëzve që kanë humbur jetën e fajëson politikën e UNMIK-ut. “Ditët tragjike të 16 dhe 17 marsit dëshmuar se UNMIK-u, jo që nuk është në gjendje të qeverisë me tej Kosovën, por edhe se e ka penguar në ndërtimin e strukturave vendëse, që do të kishin mundësi dhe përgjegjësi të marrin në duar qeverisjen e Kosovës”,²²⁹ thekson Ramabaja, duke shtuar se mos organizimin politik të Kosovës e ka shfrytëzuar jo vetëm shteti i Serbisë, por edhe segmente të UNMIK-ut dhe OSBE-së. Sipas tij, demokracia e kontrolluar dhe menaxhuar keq nga ana e UNMIK-ut krijoi anarki në terren. “Si kundërvënie ndaj anarkisë Kosova ka nevojë të ndërtojë me urgjencë strategji nacionale të qartë. Institucionet e Kosovës ndodhën para alternativës: Bëje ose vdis”.²³⁰ Prandaj, në bazë të kësaj kolumne, pjesë të fajit dhe të përgjegjësisë për trazirat ndëretnike duhet të bartë edhe UNMIK-u, i cili duke u bazuar në tekst, ka dështuar në realizimin e arritjes së qëllimeve të misionit të tij. Në një tekst tjetër autorial me titull: “Gjynahet fatale të UNMIK-ut”²³¹, të botuar në këtë numër, veprimtari Bedri Islami fajësinë kryesore për gjendjen e krijuar në Kosovë dhe për dhunën ndëretnike ia adreson misionit qeverisës ndërkombëtar në Kosovë. “Ndoshta askund tjetër më shumë se në Kosovë, shfaqur në të gjitha format e saj, një organizëm ndërkombëtar nuk ka qenë kaq i paafte, kaq cinik dhe mjerisht i largueshëm sesa UNMIK-u. Më e pakta nga gjithçka që mund të thuhet është në dështimin e plotë të këtij Misioni, i cili u pa si diçka e jashtëzakonshme, u kthye gradualisht në diç normale për t’u ulur gjithnjë e më poshtë, në degradimin e tij”,²³² vlerëson në shkrimin e tij autorial Islami, duke e akuzuar UNMIK-un dhe duke i dhënë epitetin e mjerimit, të quajtur Mitrovicë.

Në një analizë të radhës, të botuar me datën 22 mars në gazetën “Epoka e re”, me titull: “Zvarritja e perëndimit, shkaku i trazirave në Kosovë”,²³³ gazetari i cili kishte raportuar në periudhën e luftës në Kosovë, Daglas Hamilton, thekson se zvarritja e perëndimit rreth çështjes të së ardhmes së Kosovës, duhet të mbajë përgjegjësi për shpërthimin e dhunës nën protektoratin e OKB-së. “Perëndimi ka këmbëngulur se kufijtë e Ballkanit nuk do të ndryshojnë për të krijuar

²²⁹Sadri Ramabaja, “Status-quos i erdhi fundi sërish por me viktima!”, *Epoka e re*, 19 mars 2004, fq.7

²³⁰Po aty, fq. 7

²³¹Bedri Islami, “Gjynahet fatele të UNMIK-ut”, *Epoka e re*, 19 mars 2004, fq.8

²³²Po aty, fq.8

²³³Po aty, fq.8

shtete mono etnike, por ka dështuar në zëvendësimin e frikës raciale dhe urrejtjes me tolerancën, për të mos e përmendur me pastaj ripajtimin”.²³⁴ Hamilton ndër të tjera në analizën e tij, citon diplomatët e ndryshëm perëndimor të cilët sipas tij, kanë qenë në dijeni se dhuna në Kosovë do të shpërthejë, mirëpo nuk kanë bërë sa duhet që kjo të ndalohet dhe të ecet më tutje me zhvillimet atje. Në mesin e tyre Hamilton citon edhe diplomatën amerikan Riçard Holbruk, i cili sipas tij kishte thënë se i ka parashikuar zhvillimet e tilla në Kosovë dhe se shtyrja e statusit të Kosovës do të ishte një gabim i madh dhe do të shtynte rritjen e dhunës. Analizën e tij, Hamilton e mbyll me një dilemë të perëndimit. “Perëndimi i trembet faktit se një Kosovë e pavarur do të sillte një reagim zinxhir kërkesash të shqiptarëve të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë Jugore për t’u bashkuar me Shqipërinë e Madhe”.²³⁵

Në një tjetër koment të botuar në gazetën “Epoka e re”, me titull: “Pse pikërisht tani?”, analisti i BBC-së për çështje të Evropës Juglindore, Gabriel Partosh, i rëndit një sërë çështjesh të cilat sipas tij, janë indice të trazirave. Sipas tij, fillimi i bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit si dy vende jo të barabarta, problemi i Mitrovicës, zgjedhjet të cilat do të mbahen shumë shpejt në Kosovë, sulmet me granata në rezidencën e Rugovës si dhe deklaratimet e kryeministrit të Serbisë, Koshtunica për kantonizimin e Kosovës, janë disa prej arsyeve që i kanë provokuar nxitjen e tensioneve ndëretnike. “Ka shumë, sidomos në anën e shqiptarëve që ndoshta janë ekstremist, të cilët nuk duan të flasin me Beogradin derisa Kosova të fitojë pavarësinë dhe vetëm pastaj ata mund të flasin me Beogradin”,²³⁶ thekson analisti i BBC-së për çështje të Evropës Juglindore. Në një tekst tjetër autorial, Agim Vinca shkruan se fëmijët e mbytur në fshatin Çabër janë shaktari kryesor i cili provokoi dhunën dhe reagimin e masës. “Mbarë opinionin kosovar (dhe ai botëror) ishte informuar një natë më parë për vdekjen tragjike të tre fëmijëve në fshatin Çabër, të vetmit fshat të banuar me shqiptar në pjesën veriore të Kosovës, të kontrolluar nga ekstremistët serbë...”.²³⁷

Ndërkaq, politikani i njohur Arbër Xhaferi, numëron një varg faktorësh të cilët sipas tij, ndikuan në shpërthimin e dhunës në Kosovë. Sipas tij, zvarritja e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, tolerimi i proceseve dezintegruese që krijuan enklavat serbe, mungesa e kushteve

²³⁴Douglas Hamilton, “Zvarritja e Perëndimit – shkaku i trazirave në Kosovë”, *Epoka e re*, 22 mars 2004, fq.3

²³⁵Po aty, fq.3

²³⁶Gabriel Partosh, “Pse pikërisht tani”, *Epoka e re*, 20 mars 2004, fq.4

²³⁷Agim Vinca, “Vdekja e llahtarshme dhe protesta groteske për xhamin e rezistencës”, *Epoka e re*, 20 mars 2004, fq.6

elementare të jetesës, krijimi i dy-tri burokracive paralele, ndërkombëtare, kosovare dhe serbe, indiferenca ndaj propagandës gebelsiane nga Beogradi, janë vetëm disa nga faktorët që u akumuluan dhe shkaktuan shpërthimin e trazirave. Xhaferi beson se çështjet e pazgjidhura dhe statusi përfundimtar i Kosovës do të jetë shumë shpejt në agjendat që do të sjellin zgjidhje në favor të shumicës. “Kam bindjen e thellë se çështja e Kosovës është në prag të zgjidhjes përfundimtare dhe në favor të shqiptarëve, prandaj të mos lejojmë që pikërisht në këtë fazë, të bëhemi vetë pengesë e këtij procesi...”.²³⁸ Pra, edhe ediorialet, komentet, analizat dhe opinionet e botuara në të përditshmen “Epoka e re”, qoftë nga intelektualë dhe njohës ndërkombëtarë apo vendorë, përmes teksteve të tyre, i kanë paraqitur përmes gjykimeve të tyre shkaktarët që mund të kenë nxitur shpërthimin e trazirave. Ishin faktorë të shumë e të ndryshëm të cilët mund të na paraqesin grafikën e qartë të paktën për kontekstin e problemeve, prej të cilave ka mjaftuar një provokim që të shkaktojnë trazirat e marsit. Shumica prej këtyre vështrimeve në këtë të përditshme i paraqesin konkretisht edhe politika editoriale të kësaj të përditshme, pra fajësinë dhe bartjen e përgjegjësisë nga ana e përfaqësuesve ndërkombëtarë për dështimet e tyre në Kosovë. Pra, siç është theksuar edhe gjatë analizës së teksteve, “Epoka e re”, gjithnjë ka qenë kritike ndaj UNMIK-ut dhe politikave të saj.

Në anën tjetër e përditshmja “Bota Sot”, më datën 17 mars boton një tekst autorial me titull: “A ishte Koshtunica ai që organizoi sulmin me bomba kundër Rugovës?!”, të shkruar nga Elida Buçpapaj, përmes të cilit autorja paralajmëron protestën e cila do të mbahet në Prishtinë si shenjë kundërshtimi ndaj sulmit me granata në rezidencën e Ibrahim Rugovës. Pra, edhe në këtë rast, ky editorial përputhet me politikat editoriale dhe afërsinë me presidentin Rugova dhe partinë të cilën e udhëheq ai (LDK). “Ndërkohë edhe shqiptarët e Kosovës do të protestojnë në Prishtinë. Por, kjo protestë e tyre nuk do të jetë vandale si ajo e serbëve që bllokoi rrugën kryesore dhe lëvizjen duke akuzuar shqiptarët për qëllime profitore”.²³⁹ Në esencë ky tekst autorial nëse lexohet dhe analizohet përmban brenda tij një gjuhë të nxitjes së urrejtjes ndëretnike, brenda së cilit në çdo argument pro dhe kundër janë dy etnitë kryesore të cilat atakohen brenda tekstit, ku paraqiten dallimet dhe polarizimet e mëdha. Vetëm në këtë tekst, autorja 37 (tridhjetë e shtatë) herë e

²³⁸Arbër Xhaferi, “Ja disa nga faktorët që irituan popullin e Kosovës”, *Epoka e re*, 20 mars 2004, fq.6

²³⁹Elida Buçpapaj, “A ishte Kushtunica ai që organizoi sulmin me bomba kundër Rugovës?!”, *Bota Sot*, 17 mars 2004. fq.5

përmend termin shqiptar-serb, duke aluduar gjithnjë në dallime e thelluara ndëretnike. Andaj, duhet theksuar se ky tekst autorial publikohet vetëm një ditë para shpërthimit të trazirave të marsit.

Në një tekst tjetër autorial të botuar në këtë numër nga autori Hasan Mujaj, me titull: “Akti terrorist në shtetin e Kosovës”,²⁴⁰ përmes kontekstit të tij, prodhon panik, frikësim e hamendje tek opinioni publik. Përmes këtij teksti autorial, ndërliidhen paralele mes terrorizmit ndërkombëtar dhe sulmit me granatë në rezidencën e presidentit Rugova. “Prandaj, edhe lufta kundër terrorizmit duhet të jetë e nivelit ndërkombëtar dhe obligim i secilit shtet paqësor e demokratik. Akte terroriste po ndodhin edhe në Kosovë. Sulmi terrorist u bë edhe në Rezidencën e kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova”.²⁴¹ Pra, në kontekstin e zhvillimeve dhe problemeve të përgjithshme në të cilat kalon Kosova, kjo temë dhe ky epitete i një terrorizmi ndërkombëtar, është diçka e re që gjatë analizës na shfaqet si fenomen në hapësirën e teksteve aoriale.

Përkundër faktit që në ballinën e datës 18 mars, e përditshmja “Bota Sot”, tekstin kryesor e ka për vrasjen e 14 (katërmëdhjetë) shqiptareve, në komentin e radhës që vije nga autori Skënder Buçpapaj, nuk paraqet ky zhvillim temë për të, por më tepër trajton një temë me titull: “Pse asnjë serb i Kosovës nuk është dërguar deri më sot në Hagë?”, që në esencë paraqet elemente tërësisht të cilat janë jashtë një aktualiteti për trajtim, aq më pak kur brenda këtij numri të botuar, lajmi kryesor flet për katërmëdhjetë të vrarë gjatë përlëshjeve ndëretnike. “Mos dërgimi i serbëve të Kosovës në Hagë mund të mëtohet nga ndërkombëtarët për ta shmangur etiketimin e pakicës serbe në Kosovë si bashkëpunëtor në krimet kundër kombit shqiptar të Kosovës. Në të vërtetë, kjo sjellje e ndërkombëtarëve përbën efekt të kundërt...”.²⁴² Ndërkaq, përmes një qëndrimi editorial të shkurtër, kjo e përditshme thekson se terrorizmi i Serbisë, përmes strukturave të saja në Kosovës, është shkaktari kryesor i trazirave. “Sistemi paralel i Serbisë jo vetëm që nuk është dobësuar, jo vetëm që nuk është shpërbërë, por me veprimet e fundit sistematike dhe të larmishme në Kosovë, ai po demonstroi se e ka situatën në dorë në këtë vend”,²⁴³ theksohet në editorial, duke i akuzuar serbët për vënie të mjeteve shpërthyes, bllokime të rrugëve kryesore, sulme fizike kundër policisë ndërkombëtare dhe shqiptarëve, mbytjen e fëmijëve shqiptarë në lum, etj. “Bota Sot” në editorialin e saj të datës 19 mars, vazhdon të ndjekë politikën e saj editoriale dhe të trajtojë tema pa u bazuar

²⁴⁰Hasan Mujaj, “Akti terrorist në shtetin e Kosovës”, *Bota Sot*, 17 mars 2004, fq.6

²⁴¹Po aty, fq.6

²⁴²Skënder Buçpapaj, “Pse asnjë serb i Kosovës nuk është dërguar deri më sot në Hagë?”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.4

²⁴³Bota Sot, “Në Kosovë vepron terrorizmi serb”, 18 mars 2004, fq.2

në kontekstin e zhvillimeve dramatike. Këto tema të ngritura dhe të trajtuara madje nuk paraqesin as interes për publikun. “Liderët kombëtarë të Kosovës tregojnë përgjegjshmëri të lartë përballë situatës së imponuar”, që sipas këtij editoriali, po paraqesin pjekuri politike. “Sapo në Mitrovicë filloi përgjigjja ndaj veprimit tejet flagrant dhe tejet të përbindshëm të Serbisë dhe të revanshizmit serbomad, që mbytën tre fëmijë shqiptarë në ujërat e ftohta të lumit Ibër, kryetari i shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, zotëri Ibrahim Rugova, mbajti një konferencë për shtyp ku i bëri thirrje qytetarëve të mos lejojnë përshkallëzimin e situatës pas situatës së imponuar nga Serbia...”.²⁴⁴ Pra, përveç qëndrimit editorial me elemente të pavërteta, siç është rasti i referimit të statusit të Kosovës, përmes këtij editoriali paraqitet një dezinformim sa i përket situatës në terren. Derisa papërgjegjësia politike shihet si njëri nga elementët që ka ndikuar në lejimin e nxitjes së trazirave, në këtë editorial paraqitet figura e Presidentit të Kosovës, i cili sipas tekstit gjatë një konference të mbajtur, e sjellë gjithë situatën nën kontroll.

Edhe përmes një komenti tjetër, të botuar në këtë numër, me autor Bardhyl Ajeti, shteti serb akuzohet si fajtori kryesor, i cili i ka nxitur dhe provokuar reagimin e masës pas vrasjes së tre fëmijëve në lumin Ibër dhe pas agresionit serb brenda territorit të Kosovës. Në esencë, ky koment bie në kundërshtim me qëndrimin editorial, i cili fliste për një burrshtetas të fuqishëm e për sovranitetin e Kosovës. “E mërkura e 17 marsit 2004 është data më e rëndë për shqiptarët e Kosovës që nga viti 1999. Mu për këtë edhe tash e tutje, një arsye më shumë duhet ta kenë forcat e KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut, për të luftuar bandat serbe të cilat po gjejnë vend nëpër enklavat serbe në Kosovë, sepse pa shkatërrimin e bandave serbe nuk do të ketë paqe dhe siguri në Kosovë”.²⁴⁵ Pra, editorialet në këtë të përditshme kanë qenë të fokusuar jashtë kontekstit dhe situatës në terren. Edhe përmes editorialeve i është qëndruar besnik politikave ditore të raportimit në këtë të përditshme.

4.11 Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në shtyp gjatë raportimit për Trazirat e Marsit 2004

Njëri nga problemet i cili mund të prodhojë pasoja sociale është përdorimi i gjuhës së urrejtjes gjatë raportimit në media. Pasojat më të mëdha për shoqërinë janë atëherë kur media e

²⁴⁴Bota Sot, “Liderët kombëtarë të Kosovës tregojnë përgjegjshmëri të lartë përballë situatës së imponuar”, 19 mars 2004, fq.2

²⁴⁵Bardhyl Ajeti, “‘Ndal’ revoltave të 17 marsit”, *Bota Sot*, 19 mars 2004, fq.7

vendos në agjendën e saj përdorimin e gjuhës së urrejtjes, për t'i realizuar politikat editoriale të saj. Por studiuesit e gazetarisë dhe etikës së medias theksojnë se format më shprehura të gjuhës së urrejtjes janë ato të shprehura përmes sulmeve verbale apo në të shkruar. “Forma më e zakonshme e gjuhës së urrejtjes janë sulmet verbale ose në të shkruar ndaj grupeve të ndryshme për shkak të origjinës së tyre racore, etnike ose kombëtare”,²⁴⁶ ka theksuar në studimin e tij, Luis A. Day. Se përdorimi i gjuhës së urrejtjes paraqet problem dhe se është shndërruar në diskurs të përditshëm është shqetësues edhe për një grup studiuesish, për të cilët gjuha e urrejtjes paraqet shqetësim “Gjuha e urrejtës vazhdon me të madhe të përdoret në diskursin e përditshëm si term i përgjithshëm duke ngatërruar kërcënimet konkrete për sigurinë e individëve apo grupeve me raste, kur njerëzit mund të shfaqin zemërimin e tyre ndaj autoritetit”,²⁴⁷ theksojnë ky grup studiuesish në punimin e tyre sipas të cilit, problemi me gjuhën e urrejtjes vetëm sa po shtohet dita ditës.

Ndërkaq, Ellen Gardner në studimin e tij për rolin e medieve në konflikt, thekson se liria e shprehjes është duke u keqpërdorur nëpërmjet gjuhës së urrejtjes. “Trupat e duhur vendore dhe ndërkombëtare duhet të rregullojnë përdorimin e transmetimit dhe shoqëria si tërësi duhet të jetë e vetëdijshme nga rreziqet dhe ngatërrimet e keqpërdorimit të lirisë së shprehjes nëpërmjet gjuhës së urrejtjes”,²⁴⁸ thekson Gardner, sipas të cilit një gjë e tillë ndihmon dhe ndikon edhe në nxitjen e rasteve të ndryshme dhe problemeve sociale.

Mirëpo, edhe pse liria e shprehjes në vendet demokratike është e garantuar me aktet më të larta juridike, ajo nuk e nënkupton si të tillë përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 42 të saj, thekson se censura është e ndaluar përveç rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme. “Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”,²⁴⁹ thuhet në Nenin 42, pika 2 të Kushtetutës së Kosovës, që flet për lirinë e medieve. Sipas aktit më të lartë juridik, edhe liria e shprehjes në përgjithësi është e garantuar me ligj, përderisa ajo nuk keqpërdoret për të nxitur

²⁴⁶Louis A. Day, “Ethics in Media Communications: Cases and Controversies”, edicioni i 5-te, (USA: Wadsworth Publishing, 2005), f. 295

²⁴⁷Iginio Gagliardone, Danit Gal, Thiago Alves dhe Gabriela Martinez. “Countering Online Hate Speech”, Francë: UNESCO Publishing, 2015, f. 7

²⁴⁸Ellen Gardner, “The Role of Media in Conflicts” në *Peacebuilding: A Field Guide*, Luc Reychler dhe Thania Paffenholz (red.), (Londër: Lynne Rienner Publisher, 2001), f. 309

²⁴⁹Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, fq.13, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> (15.94.2018)

urrejtje. “Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.²⁵⁰ Edhe Neni 147, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, parasheh masa ndëshkuese ndaj gjithë atyre që nxitin apo përhapin publikisht urrejtje. “Kushdo që nxitë ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovë, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”²⁵¹ është theksuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke vazhduar në paragrafët 2, 3 dhe 4, ku jepen sqarime rreth masave, ndaj atyre që bëjnë një keqpërdorim të tillë.

Edhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK), në udhëzuesin e saj për Kodin e Medieve të Shkruara të Kosovës ndalon përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga mediet e shkruara dhe ato online. “Mediet nuk duhet të publikojnë asnjë material, i cili në çfarëdo mënyre përmban apo nxitë gjuhë të urrejtjes, gjuhë denigruese apo veprime kriminale. Mediet nuk duhet të publikojnë shkrime që nxisin ose që shkaktojnë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësive të kufizuara fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit a besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve të tjera”,²⁵² thuhet në këtë udhëzues të KMSHK-së, sipas të cilit një gjë e tillë vlen edhe për gazetatat online. Por, edhe në kohën e administrimit të Kosovës nga misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut, gjuha e urrejtjes dhe përdorimi i saj nga media sanksionohej nëpërmjet rregullores së veçantë të firmosur nga përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Bernard Kushner. “Kushdo që nxitë ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike ose kundër cilitdo grupi tjetër që jeton në Kosovë veprime të cilit mund të prishin qetësinë dhe rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim, i cili zgjatë jo më shumë se pesë vjet ose dënohet me të dyja”,²⁵³ shkruhet në Nenin e parë të kësaj Rregullore mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar e etnik. Prandaj, duke u bazuar si në aspektin ligjor dhe atë vetërregullues,

²⁵⁰ Po aty, fq.13

²⁵¹Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-82, 2012, fq. 67

(<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf> (15.04.2018))

²⁵²KMSHK, “Udhëzues për Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës”, Prishtinë, 2015, fq.3, <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-mars2015.pdf> (16 prill 2016)

²⁵³UNMIK, RREGULLORE NR.2000/4 “MBI NDALIMIN E NXITJES SË URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOSDURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR DHE ETNIK”, UNMIK/REG/2000/4, 1 shkurt 2000

në këtë pjesë të studimit do të analizojmë përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga mediet e shkruara gjatë raportimit për Trazirat e Marsit 2004.

4.11.1 Koha Ditore

Me datën 17 mars të vitit 2004, “Koha Ditore” tekstin kryesor të vendosur në ballinën e saj e kishte për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër, ku humbën jetën tre fëmijë shqiptarë. Kjo shënon edhe ditën kur trazirat shpërthyen fillimisht në Mitrovicë, e më pas në gjithë vendin, ndërkaq vet mediet më vonë konstatuan se njëri nga shkaktarët për nxitje të trazirave ishte mbytja e fëmijëve në lum. “Koha Ditore”, në tekstin kryesor të datës 17 mars, kishte shkelur rregulloren e UNMIK-ut duke bërë nxitje të urrejtjes etnike përmes gjuhës së përdorur gjatë raportimit. “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”,²⁵⁴ Pra, ky është kryelajmi i cili përbënë nxitje ndëretnike si dhe paraqet shkelje etike dhe të standardeve profesionale të raportimit. Përveç vlerësimit të ngjarjes që bëhet në tekst gjatë raportimit, ajo që e forcon gjuhën e nxitjes së urrejtjes ndëretnike është fakti se aty nuk një pjesë e fjalëve që në esencë përbëjnë shkelje të tilla, janë mendime të interpretuara nga ana e kolegjiut të redaksisë.

Elemente të përhapjes publike të nxitjes dhe mos durimit etnik vërehen edhe në raportin tjetër të kësaj gazete të datës 17 mars, me titull: “Serbët bllokojnë rrugët nga Prishtina për në Shkup dhe Gjilan, sulmojnë kalimtarët”, brenda të cilit reporterët së paku tri herë referohen me fjalët “rebelimi serb”, ndërkaq deklaratën e një taksisti i cili ishte maltretuar nga serbët, e vendos në pjesën qendrore të raportit, i cili flet për maltretimin që i kanë bërë serbët. Mirëpo, burimet zyrtare të policisë të cilët nuk e konfirmojnë një gjë të tillë i vendosë në pjesën e fundit të raportit. Edhe një ditë më pas e përditshmja “Koha Ditore” kishte bërë një raportim të gjerë për dhunën e përhapur në gjithë vendin ku janë evidentuar elemente të urrejtjes edhe në këtë pjesë. “Me thirrje të zëshme të masës me altoparlantë rrugëve të qytetit ‘Mitrovica u gjakos nga kriminelët serbë! Në Mitrovicë po vriten fëmijë, gra dhe pleq. Ngrihuni të protestojmë’, ajo po egërsohej çdo herë e më shumë, duke djegur në fillim flamurin e UNMIK-ut në ndërtesë për t’ia dhënë flakën më pastaj automjeteve të OKB-së para ndërtesës së saj”,²⁵⁵ raportohej për zhvillimet në Pejë, duke mos i mbështetur këto elemente nxitëse në burime dhe deklarata zyrtare, për të shtuar më tutje se: “Në

²⁵⁴Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, Prishtinë, fq.1

²⁵⁵Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004, Prishtinë, fq.3

Viti situata ka eskaluar me djegie shtëpish të serbëve dhe me dëmtim të Kishës ortodokse, njoftohet nga burime të pakonfirmuara nga kjo komunë...”.²⁵⁶ Shumica e pjesëve të raportit për trazirat përbëjnë elemente të nxitjes së urrejtjes etnike, janë të ndërtuara mbi përdorimin e gjuhës së përfulur, të pa mbështetur në deklarime zyrtare si dhe mbi deklaratat e protestuesve të cilët në këtë rast kanë shprehur në mënyrë spontane dhe emocionale gjuhë të theksuar të urrejtjes ndëretnike. “Me shpejtësi u tubuan mijëra njerëz të të gjitha moshave, të cilët defiluan nëpër rrugën qendrore të Ferizajt me pankarta dhe thirrje: ‘Çagllavica nuk është Serbi’, ‘UNMIK, mos përgatit tragjedi të reja’, ‘UNMIK, po imponon luftë të re’, ‘Mitrovicën nuk e japim’”,²⁵⁷ thuhet në kreun e lajmit të korrespondentit nga Ferizaj.

Megjithatë, në shumicën e teksteve në ditët në vijim, e përditshmja “Koha Ditore” ka qenë e kujdesshme në përdorimin e gjuhës e cila do të prodhonte shkelje të rregullores së UNMIK-ut, e cila kishte fuqi juridike, përmes përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë.

4.11.2 Epoka e re

Edhe e përditshmen “Epoka e re”, me datën 17 mars, lajmin kryesor të ballinës e ndërlidhë me tragjedinë e ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, brenda të cilit bie në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar dhe etnik. “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë [titull] Sipas fëmijës që ka mbijetuar Fitim Veseli, një grup serbësh i kanë sharë fëmijët shqiptarë, i kanë sulmuar dhe më pas iu kanë vërsulur qenin. Në përpjekje për të shpëtuar, fëmijët janë futur në lumin Ibër, por nuk kanë dalë më të gjallë. Ndërkaq, të hënë në mbrëmje në Kodrën e Minatorëve është djegur tenda e Sadri Pecit, me gjithë orenditë që ishin brenda saj. Aty jetonte familja 12 anëtarëshe e Sadri Pecit. Serbët anëmbanë Kosovës po krijojnë probleme dhe destabilitet [nëntitull]”,²⁵⁸ është theksuar brenda ballinës në këtë të përditshme.

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes është prej faktorëve i cili ndikon në eskalimin e situatës dhe përplasjet ndëretnike. Efektet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes shihen në numrin e radhës në të përditshmen “Epoka e re”, pra në numrin e 18 marsit. “[Mbititull] Revoltë spontane në tërë

²⁵⁶Po aty, fq.3

²⁵⁷Ekipi i korrespodenëve, “Protestuesit shprehën dhimbje për 3 fëmijët mbytur dhe kërkuan të shkonin në Mitrovicë”, *Koha Ditore*, 17 mars 2004, fq.8

²⁵⁸Epoka e re, “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004, fq.1

Kosovën: Shqiptarët janë zemëruar në kulm me mbytjen e fëmijëve në lumin Ibër. Nga plumba serbë dhe të tjerë u derdh shumë gjak e u dogjën pasuri të tundshme e të patundshme. [titull] “Të vrarë 14, të plagosur rreth 500”.²⁵⁹ Në situata të jashtëzakonshme, mediet e kanë të vështirë të përmbahen nga fjalët që prodhojnë gjuhë të urrejtjes, sepse ajo përdoret nga të përfshirit në tregim. “Banorët serbë të fshatit Çagllavicë të Prishtinës vazhdimisht shtinin me armë zjarri ndaj policisë, KFOR-it dhe turmës së qytetarëve shqiptarë”,²⁶⁰ është theksuar në njërin nga raportet, i cili trajton situatën e krijuar në terren pas shpërthimit të trazirave.

Në disa raste, një numër i tekstet brenda tyre kanë futur elemente të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së urrejtjes etnike, duke i cituar mbishkrimet e parullave apo pamfleteve të cilët i kanë bartur protestuesit gjatë shprehjes së pakënaqësisë së tyre. “Qytetarët e mllefosur kanë filluar të brohorasin ‘UNMIK-u dhe serbët po na vrasin’, e pastaj kanë thirrur zëshëm numrin e të vrarëve e të plagosurve shqiptarë në Mitrovicë”.²⁶¹ Më tutje, në këtë numër të gazetës elemente të nxitjes së gjuhës së urrejtjes shfaqen në raportin e korrespondentëve të cilët kanë bërë përmbledhjen e ngjarjes nga rajone të ndryshme të Kosovës. “Lidhur me të vrasin në këtë protestë, burimet në terren flasin se ai në Guranjak ishte përplasur e kacafytur me një serb. Në ndërhyrje, një police ndërkombëtare ka shtënë mbi shqiptarin duke e goditur nga afër për vdekje. I vrari është Esat Ramë Tahiraj, 32-vjeçar, nga fshati Fierzë, vëlla i dëshmorit Shaqir Tahiraj dhe pjesëmarrës në luftën për liri”,²⁶² është thënë ndër të tjera nga korrespondenti nga Peja, i cili jep të gjitha këto informata që përbëjnë elemente të nxitjes dhe urrejtjes, duke mos u bazuara në informacione apo burime zyrtare. Përkundër një përkujdesje të shtuar gjatë raportimit, më datën 19 mars 2004, e përditshmja “Epoka e re”, ka botuar gjithashtu lajmin e radhës të pakonfirmuar zyrtarisht, nga korrespondenti i saj në Ferizaj, me titull: “Grekët e KFOR-it shkelin me tanke!”²⁶³ duke vazhduar më tutje në tekst se: “Nga konfrontimet e ashpra që ndodhën ndërmjet protestuesve dhe pjesëtarëve të KFOR-it, në afërsi të Kishës ortodokse serbe, pas orës 21 të së mërkurës së kaluar, ka vdekur një i ri ferizajas i moshës 15-17 vjeçare. Sipas dëshmitarëve okularë, i riu, identiteti i të cilit nuk u bë i njohur për shkak të mos posedimit të dokumentacionit, pësoi nga tanku i forcave greke të KFOR-it...”.²⁶⁴ Në

²⁵⁹Epoka e re, “Të vrarë 14, të plagosur rreth 500”, 18 mars 2004, fq.1

²⁶⁰Epoka e re, “Një i vdekur në Çagllavicë, disa të plagosur shumë shtëpi në zjarr”, 18 mars 2004, fq.7

²⁶¹Korrespondentët e “Epokës së re”, “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë të plagosur nga armë zjarri”, *Epoka e re*, 18 mars 2004, fq.8

²⁶²Korrespondentët e “Epokës së re”, “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë të plagosur nga armë zjarri”, *Epoka e re*, 18 mars 2004, fq.8

²⁶³Skënder Idrizi, “Grekët e KFOR-it e shkelën me tanks!”, *Epoka e re*, 19 mars 2004, fq.16

²⁶⁴Po aty, fq.16

situata të tilla, siç është rasti i trazirave ndëretnike në Kosovë, publiku gjithnjë është i prirë për të reaguar nën afekt, ndërkaq tek mediet rritet numri i lexuesve apo audiencës.

Nëse e shohim numrin e radhës të gazetës “Epoka e re”, në ballinën e saj kemi një seri titujsh, të cilët padyshim se kanë ndikim situatën e trazuar në terren. [mbititull] “Në fshatin Brainë të Besianës, një shtëpi shqiptare e djegur nga bandat serbe”. [titull] “Koshtunica thërret për vrasje të shqiptarëve, bandat futën në Kosovë”.²⁶⁵ Pra, ky është teksti kryesor i këtij numri, për të vazhduar me lajmin e dytë për nga rëndësia, i cili konstaton tradhtinë e misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, me titull: “Magjistratja Prishtinë-Shkup ende mbahet e mbyllur nga KFOR-i”,²⁶⁶ “UNMIK-u e tradhtoi Rexhepin, rruga nuk u zhblllokua”.²⁶⁷ Nga këto dy tekste, konsiderojmë se brenda tyre përbëjnë elemente të cilat bien në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut, e cila ishte nxjerrë enkas nga ky mision për ta sanksionuar përdorimin e gjuhës e cila mund të prodhojë gjuhë të urrejtjes, mos durimit dhe nxitje të reagimeve etnike. Ndërkaq, në lajmin e tretë për nga rëndësia të vendosur në ballinën e këtij numri është intervista me njërin nga të plagosurit gjatë trazirave, i cili thekson se plumbat që ia kanë shkaktuar plagën atij kanë ardhur nga pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut. “Nuk e di kush më ka qëlluar, veç e di që plumbi ka ardhur nga ana e majtë e rrugës, pra nga policia e UNMIK-ut që ishin aty”,²⁶⁸ për ta përmbyllur ballinën e saj në këtë numër me një lajm të fundit, i cili flet për rezistencën dhe luftën që po bëjnë shqiptarët për ta mbrojtur veriun e Kosovës, që në esencë, kjo formë e raportimit brenda saj përbën elemente të nxitjes së gjuhës së urrejtjes ndëretnike. “Lajmi i fundit. Në veriun e Mitrovicës po terrorizohen banorët shqiptarë kundër të cilëve nuk po kursehen mjetet”. Në ndërkohë, “Epoka e re” mëson se fshatarë të fshatrave veriore kanë vendosur të rezistojnë me armë dhe të mbrojnë kufirin deri atje ‘ku ka bërë luftë Kadri Bistrica’, tej Zveçanit. Ata thonë se kanë çarmatosur dy paramilitarë serbë dhe i kanë lëshuar lakuriq të shkojnë nga kanë ardhur. Koncentrimi i tyre është përreth fshatit Çabër. Ata thonë se nuk do të lejojnë jetësimin e ndarjes së Kosovës, për çka dyshojnë se ekziston ndonjë marrëveshje e fshehtë”,²⁶⁹ është thënë në lajmin e fundit të raportuar për këtë numër të gazetës, pa i konfirmuar informatat zyrtare, apo të mbështetura në ndonjë burim tjetër informacioni.

²⁶⁵Epoka e re, “Koshtunica thërret për vrasje të shqiptarëve, bandat futën në Kosovë”, 20 mars 2004, fq.1

²⁶⁶Epoka e re, “Lajmi i fundit”, 20 mars 2004, fq.1

²⁶⁷Epoka e re, “UNMIK-u e tradhtoi Rexhepin, rruga nuk u zhblllokua”, 20 mars 2004, fq.1

²⁶⁸Nexhmije Ahmeti, “Plumbi më ka ardhur nga Policia e UNMIK-ut”, *Epoka e re*, 20 mars 2004, fq.2

²⁶⁹Po aty, fq.1

4.11.3 Bota Sot

Gazeta “Bota Sot”, gjatë raportimit të saj për trazirat e dhunshme ndëretnike në disa raste ka rënë në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2000/4, mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar dhe etnik. Në njërin nga raportet kryesor kjo e përditshme përdor gjuhë të urrejtjes ndëretnike dhe këtë gjuhë nuk mund ta argumentojë me fakte. “Serbët vranë me armë zjarri gjashtë shqiptarë dhe plagosën rëndë shumë të tjerë”.²⁷⁰ Prandaj, sipas titullit, të gjashtë viktimat janë shqiptarë të vrarë nga serbët, mirëpo gjatë raportimit më tutje për këtë ngjarje, nuk dihet as identiteti, as etnia e viktimave. “Dihet se dy të vdekurit që gjenden në shtëpinë e shëndetit në Mitrovicë janë... nga Mitrovica, kurse për 4 të tjerët që ndodhën në spitalin e Prishtinës, ende nuk është bërë i ditur identiteti”,²⁷¹ thuhet ndër tjera në këtë raport. Gjithashtu kjo e përditshme kur flet për ngjarjen tragjike të fshatit Çabër, gjuha që përdor gjatë raportimit dhe epitetet e përdorura përbëjnë elemente të gjuhës së urrejtjes si: kriminelët serbë, ekstremistët serbë, fashistët serbë etj. Në shumicën e raporteve të këtij numri të gazetës “Bota Sot”, nuk mungojnë elemente dhe interpretime të ngjarjes nga ana e redaksisë, e në këtë kuadër edhe të përdorimit të gjuhës së urrejtjes. “E gjithë kjo revoltë është bërë pas disa sulmeve të njëpasnjëshme të ekstremistëve serbë ndaj qytetarëve shqiptarë, sulme këto që janë bërë nga serbët që jetojnë nëpër enklava”,²⁷² thuhet ndër të tjera në raportin i cili flet për zhvillimet e fundit, të ndodhura në lagjen periferike të Prishtinës, atë të Çagllavicës. Raportimet për dhunën ndëretnike në Kosovë kjo e përditshme i mbyllë në faqen 17, përsëri me një titull që flet për dy etnitë e përfshira në konflikt ndëretnik. “Serbët nxjerrin me dhunë shqiptarët nga banesat e tyre”,²⁷³ thuhet ndër të tjera në këtë numër të së përditshmes “Bota Sot”.

Kjo e përditshme në numrin e 19 marsit sjellë një tekst autorial të kryetarit të Qendrës Rajonale të KMDLNJ-së, Halit Berani, brenda të cilit autori përdor një gjuhë e cila i tejkalon siç edhe theksojnë studiuesit, përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Problemet me përdorimin e gjuhës në këtë tekst fillojnë qysh në titullin e tij: “Edhe në lagjen ‘7 shtator’, 3 çetnikë serbë maltretojnë shqiptarët”,²⁷⁴ - brenda të cilit paraqiten elemente të nxitjes së urrejtjes etnike. Ky tekst dokumentar

²⁷⁰BSM, “Serbët vranë me armë zjarri gjashtë shqiptarë dhe plagosën rëndë shumë të tjerë”, *Bota Sot*, 18 mars 2004, fq.3

²⁷¹Po aty, fq.3

²⁷²Besim Toska, Asdren Gashi, “Vritet një shqiptar, plagosën dhjetëra të tjerë”, *Bota Sot*, 19 mars 2004, fq.13

²⁷³Halit Berani, “Serbët nxjerrin me dhunë shqiptarët nga banesat e tyre”, *Bota Sot*, 19 mars 2004, fq.17

²⁷⁴Po aty, fq.17

i Beranit, i cili në esencë është i ndërtuar përmes ngjarjeve në retrospektivë, ndër tjera botohet në një kohë jo adekuate për botim, sepse tashmë urrejtja dhe dhuna ndëretnike kishte shpërthyer dhe tekste të tilla vetëm sa e ndihmojnë eskalimin e situatës në terren. “Më 11.2.2000, në orën 16:00, në lagjen ‘Lumbardhi’, 5 kriminel shkuan në banesë të Zeqir (Jashar) Zeqës (58) - 5 anëtarë të familjes me dhunë i nxorën nga banesa, duke i kërcënuar se nëse i zë terri në pjesën e okupuar të qytetit, do të likuidohen. Edhe në lagjen ‘7 shtatori’, çetnikë serbë shkuan në banesën e Muhedin (Sinan) Kaçanikut (68) - 2 anëtarë të familjes, me ç’rast i dëbuan me dhunë nga banesa. Siç raportoi ai, dy serbë i sulmuan në rrugë dy të reja shqiptare: Lindita (Xhemail) Hasani (19) e Elfete (Ragip) Aliu (18), banore të lagjes në fjalë, të cilat po ktheheshin nga qyteti,²⁷⁵ thuhet në hyrje të tekstit, i cili deri në fund të tij, është i ndërtuar në këtë formë dhe në këtë stil të gjuhës së përdorur. Në këtë numër, “Bota sot” faqet e mesit i ka rezervuar për t’i ofruar publikut ngjarjen e trazirave të marsit përmes një kolazhi me fotografi. Në mesin e shumë fotografive që paraqesin dhimbjen e asaj që ka ndodhur në terren, paraqiten dy fotografitë e dy të rinjve të përgjakur, duke iu bërë një koment me tekst në mes të dy fotografive.

Në numrin e radhës e përditshmja “Bota Sot” publikon tekstin e radhës nga ditari i Halit Beranit, kryetar i Qendrës Rajonale të KMDLNJ-së në Mitrovicë, tekst i cili brenda trajtimit të tij përbënë përdorim të gjuhës së urrejtjes. Megjithëse ky është ditari i Beranit, në rrethanat e krijuara në terren pas trazirave ndëretnike, ky tekst paraqet elemente shtesë të nxitjes së trazirave të dhunshme ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve, duke ua risjellë atyre në kujtesë të kaluarën e përgjakshme. “Në pjesën e okupuar të qytetit, një grup kriminelësh serbë i sulmuan me gurë civilët shqiptarë”,²⁷⁶ është theksuar në titullin e këtij teksti, të botuar në “Bota Sot”.

4.11.4 Kosova Sot

E përditshmja “Kosova Sot”, në numrin e botuar të saj të datës 18 mars, i kushton një rëndësi të madhe zhvillimeve dramatike të ndodhura gjithandej Kosovës. Edhe pse në shumicën e teksteve nga terreni gjuha e përdorur nga reporterët mbetet mjaft e kujdesshme, ndonjë herë gjuha e urrejtjes apo nxitjes së urrejtjes racore dhe etnike mbetet brenda diskursit të atyre që flasin për

²⁷⁵Po aty, fq.17

²⁷⁶Halit Berani, “Në pjesën e okupuar të qytetit, një grup kriminelësh serbë i sulmuan me gurë civilët shqiptarë”, *Bota Sot*, 20 mars 2004, fq.13

zhvillimet e këtyre ngjarjeve. Një gjuhë e tillë përdoret edhe në tekstin, brenda të cilit citohet deklarata e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. “Tolerimi i strukturave paralele serbe dhe bandave kriminale që nxisin dhe vrasin qytetarët e Kosovës është politikë e gabuar që do ta destabilizojë Kosovën”,²⁷⁷ është thënë në deklaratën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të botuar në këtë numër të shtypit me titull: “Parlamenti: Nuk do t’i tolerojmë më bandat vrasëse”.²⁷⁸ Në këtë numër të shtypit, “Kosova Sot” përmes një fotoalbumi i ka publikuar mbi tridhjetë fotografi të shoqëruara me komentime, përmbajta e të cilave ka ofruar pamje të rënda për publikun. Një ditë më pas, “Kosova Sot” në faqet e saja speciale kushtuar trazirave ndëretnike, vendos një titull i cili përmban elemente të gjuhës së urrejtjes dhe i cili nuk mbështetet në burime as anonime, as zyrtare. “Serbët plagosin tre shqiptarë”,²⁷⁹ është thënë në titullin e këtij raporti nga Mitrovica, ndërkaq, Shtabi i Krizës në Qendrën Shëndetësore të Mitrovicës konfirmon se këta persona janë plagosur me plumba gome, duke mos deklaruar më shumë. Edhe brenda këtij numri të shtypit i është kushtuar një rëndësi e veçantë botimit të fotografive nga zona të ndryshme të dhunës, i shoqëruar me komentimin e tyre, për të cilat do të diskutojmë në pjesën e radhës. Në numrin e saj të datës 22 mars, gazeta “Kosova Sot” ka botuar një tekst speciale kushtuar trazirave të dhunshme, i cili në esencë përmban përdorim të gjuhës së urrejtjes. “Shqiptarët thonë se serbët bëjnë spastrim etnik në veri të Mitrovicës”.²⁸⁰ Ky është titulli i këtij shkrimi, i cili është i ndërtuar kryesisht në rrëfime të qytetarëve, të cilët gjatë intervistës, përveç shprehjes së tyre emocionale, paraqesin frikën e shtuar të këtyre banorëve nga droja e ndonjë sulmi të serbëve ndaj tyre. “Më së shumti po frikësohemi se ekstremistët dhe kriminelët serb do të na hyjnë nëpër shtëpi e banesa në veri për të ndërmarrë ndonjë masakër tjetër, siç kanë bërë edhe herëve tjera”,²⁸¹ kishte deklaruar një qytetar shqiptar.

4.12 Analizimi i Trazirave të Marsit 2004 në shtypin ditor përmes fotografisë

Kur flasim për fotografinë, të gjithë mendjen e kemi tek rrjetet sociale, tek ato familjare dhe artistike. Mirëpo fotografia ka një rol të rëndësishëm edhe në fushën e gazetarisë. Mediet e

²⁷⁷S. Ahmeti, “Nuk do t’i tolerojmë më bandat vrasëse”, *Kosova Sot*, 18 mars 2004, fq.6

²⁷⁸Po aty, fq.6

²⁷⁹Kosova Sot, “Serët plagosin tre shqiptarë”, 19 mars 2004, fq.2

²⁸⁰Arsim Bilalli, “Shqiptarët thonë se serbët bëjnë spastrim etnik në veri të Mitrovicës”, *Kosova Sot*, 22 mars 2004, fq.7

²⁸¹Po aty, fq.7

ndryshme, si ato të shtypit, mediet online e aq më pak ato vizuale, as që mund të imagjinojnë raportet e tyre pa dokumentim të pamjeve apo të fotografisë. Prandaj, në këtë pjesë të studimit do t'i analizojmë fotografitë kryesore të publikuara në shtypin ditor në lidhje me trazirat ndëretnike të marsit 2004. Mirëpo, para se t'i analizojmë, do të shohim se çka është fotografia gazetareske. Studiuesja e medieve, Patrisha Holland në një studim për fotografinë e gazetarisë, thekson se secila fotografi duhet të lexohet dhe të shikohet dhe si të tilla secila nga to paraqet një histori në vete. “Secila fotografi e ka historinë e vet. Të kuptuarit e historisë së secilës fotografi veç e veç po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në epokën e prodhimit dhe përpunimit të tyre digjital”,²⁸² thekson Holland, duke shtuar se shtypi britanik në fillim të shekullit XX e kishte futur përdorimin e fotografisë për të dokumentuar dhe për ta ilustruar një artikull. Sipas saj, fotografia e gazetarisë zakonisht është kuptuar ajo e cila ka ofruar pamje dramatike. Mirëpo sipas Holland, fotografia është shumë më shumë se kaq. “Fotografia në shtypin modern mbetet e balancuar në mes të katër poleve të kundërta – të vërtetës, shpesh të botës së tmerrshme; botës së humorit dhe botës së flamurit – flamurit të shou biznesit...”,²⁸³ thekson më tutje Holland, duke shtuar më tutje se fotografia është më shumë se lajm. Në studimin e saj, Holland thekson më tutje se ka shumë rëndësi mënyra e interpretimit të fotografisë së shtypit. “Së pari, duhet të kuptohet rëndësia e saj në historinë e gjatë të medias fotografike; së dyti, ajo paraqet një aspekt të lënë anash të historisë së shtypit popullor të shekullit të XX. Me afrimin e këtyre masmedieve e ka bërë shumë aktual edhe vështrimin e tretë të fotografive të shtypit, e ai ka të bëjë me rolin ideologjik të saj”,²⁸⁴ theksohet në studimin e Holland, për të shtuar më tutje aty se fotografia më triviale bartë mesazhe të cilat janë po aq të rëndësishme sa edhe raportet më prestigjioze gazetareske. Sipas saj, leximi i fotografisë së gazetarisë është njëra nga sfidat që e bartë lexuesi. “Të ballafaquar me këtë ofertë të shumëllojshme, ata që e shikojnë fotografinë në gazeta duhet patjetër të jenë më shumë se shikues pasiv. Ata duhet të bëhen “lexues” që interpretojnë pamjet të cilat i shikojnë, ndërkohë që i kuptojnë në mënyra të ndryshme”,²⁸⁵ është shprehur ajo, duke cituar në punimin e saj perspektiven e redaktorit të disa gazetave Harold Evens, sipas të cilit: “Lexuesi ia imponon asaj që ka bërë fotografi një dozë të hamendjeve të veta, prirjeve, paragjykimeve dhe përvojave dhe kur emocionet e tij janë të forta, ai në fotografi mund ta shohë

²⁸²Patrisha Holland, “Fotografia e gazetarisë”, Revista kërkimore “MEDIA 2”, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009, fq.115

²⁸³Po aty, fq.119

²⁸⁴Patrisha Holland, “Fotografia e gazetarisë”, Revista kërkimore “MEDIA 2”, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009, fq.120

²⁸⁵Po aty, fq.123

të kundërtën e asaj që pritet nga ai”.²⁸⁶ Prandaj, sipas Holland, fotografitë kanë një rol kyç për mënyrën sesi lajmet dhe opinionet i paraqiten publikut.

4.12.1 Koha Ditore

Nëse analizojmë përdorimin e fotografisë në gazetën “Koha Ditore”, do të shohim se kjo e përditshme nuk i jep hapësirë të madhe përdorimit të fotografisë. Zakonisht fotografitë e përdorura në këtë të përditshme janë fotografi të një formati të vogël, kryesisht të përshtatura me ngjarjet të cilat trajtohen apo pjesëmarrësit në atë tregim. Sa i përket raportimit për ngjarjen tragjike të fshatit Çabër, “Koha Ditore”, në këtë raport nuk ka përdorur fare fotografi, as ilustruese, as të dokumentuara nga vendi i ngjarjes.



Fotografia 6. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Koha Ditore”, më 18 mars 2004

Prandaj, duke u bazuar edhe në konceptet teorike të fotogazetarisë të trajtuara më lartë, mund të theksojmë se kjo fotografi prodhon dramaticitet tek publiku, provokon anën emocionale të tij, si dhe dokumenton një realitet të ndodhur pas një përleshje të dhunës ndëretnike. Pavarësisht

²⁸⁶ Po aty, fq 123

që dhuna ishte shpërndarë në të gjithë vendin dhe se trazirat ndëretnike kishin sjellë dhjetëra viktima dhe qindra të plagosur, “Koha Ditore” kishte mbuluar të gjitha këto zhvillime me vetëm dy fotografi, gjë që e dëshmon se kjo e përditshme nuk i ka dhënë rëndësi të madhe shoqërimin të raportimeve me fotografi.

Në numrin e radhës, të datës 19 mars, “Koha Ditore” i ka përdorur vetëm dy fotografi të cilat ndërlidhen me trazirat. Fotografitë e ofruara nuk përmbajnë shumë dokumentim të ngjarjes në terren, ndërkaq kanë një format të vogël brenda strukturës së gazetës. Edhe me datën 20 mars, në këtë të përditshme janë publikuar dy fotografi të dimensionit të vogël, ndërkaq përmes një fotolajmi është ofruar fotografia e disa pjesëtarëve të KFOR-it amerikan, në qytetin e Ferizajt. Mund të ritheksojmë se “Koha Ditore” nuk i ka dhënë rëndësi të madhe përdorimit të fotografisë gazetareske në mbulimin e trazirave të marsit 2004. Kjo shihet më së miri në numrin e vogël të fotografive të botuara gjatë kësaj periudhe, e cila ishte konsideruar si ngjarja më e rëndë ndëretnike e ndodhur në Kosovën pas luftës së vitit 1999.

4.12.2 Epoka e re

Për dallim nga “Koha Ditore”, gazeta e përditshme tjetër “Epoka e re”, vetëm në numrin e botuar të datës 18 mars, ka publikuar rreth 65 fotografi, përmes të cilave ka pasqyruar trazirat e dhunshme ndëretnike. Përveç disa fotografive qendrore të vendosura brenda teksteve, ka pasqyruar nga rajone të ndryshme të Kosovës kolazhe me fotografi, përmes të cilave është dokumentuar e gjithë ajo që kishte ndodhur në ditën e parë të trazirave, më 17 mars.



Fotografia 7. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Epoka e re”, më 18 mars 2004

Pra, këto janë dy fotografitë e të përditshmes “Epoka e re”, të vendosura në ballinën e saj të datës 18 mars, përmes të cilave e arsyeton titullin e saj kryesor, duke shprehur dokumentim të ngjarjes, emocion, dhunë, përplasje e djegie si dhe pamje të fytyrave tragjike të pjesëmarrësve të përfshirë në trazirat e dhunshme të kësaj dite. Prandaj, pavarësisht tekstit, ashtu siç e thekson edhe studiuesja e fotografisë gazetareske, shprehet më së miri në këtë pamje se fotografia është më shumë se lajm kur ajo e pasqyron një ngjarje të dokumentuar. Edhe në ditën e dytë të trazirave të dhunshme, “Epoka e re” bashkë me numrin e madh të teksteve, publikut i ofron një numër të madh të fotografive dokumentare, të cilat pasqyrojnë zhvillimet dramatike të dhunës ndëretnike në të gjithë vendin. Kjo e përditshme shihet qartazi se i ka kushtuar vëmendje të madhe ngjarjeve në zhvillim përmes fotografive, të cilat kanë pasur impaktin e tyre tek lexuesit e shtypit.

Njëren nga fotografitë më dramatike “Epoka e re” e ka publikuar në numrin e radhës të 20 marsit, pamjet e të cilës nuk mund të zëvendësohen me asnjë lloj teksti përshkrues.



Fotografia 8. “Epoka e re”, 20 mars 2004. Fotografia e ceremonisë së varrimit të tre fëmijëve shqiptarë, të cilët humbën jetën në mënyrë tragjike në fshatin Çabër të Mitrovicës. Kjo ngjarje shënon edhe fillimin e Trazirave të Marsit 2004.

Kjo është njëra nga fotografitë më të rënda dramatike e publikuar në gazetën “Epoka e re”, gjatë trazirave ndëretnike të marsit 2004. Kjo fotografi gazetareske dhe kjo pamje e ofruar për publikun zëvendëson çdo lloj raporti të shkruar dhe çdo lloj përshkrimi me fjalë. Përmes kësaj fotografie në të cilën paraqitet fëmija i vdekur, i cili ka humbur jetën në mënyrë tragjike në fshatin Çabër dhe nënën pranë e cila e vajton të birin, përveç dokumentimit, prodhon tek publiku gjendje të fortë emocionale, dramaticitet dhe nxitë reagim të masës. Edhe në brendësinë e këtij numri, këtij morti tragjik i kushtohen dy faqe të këtij numri të shtypi, ndërkaq për lexuesin e saj ofrohen edhe fotografi të tjera të ngjashme me fotografinë e ballinës, të cilat paraqesin dhimbje dhe pikëllim tek publiku. Ndoshta publikimi i këtyre llojeve të fotografisë duhet të shikohet dhe të vlerësohet edhe në aspektin etik të përdorimit të fotografisë gazetareske. Edhe në këtë numër të shtypit, “Epoka e re” ka publikuar disa fotografi të cilat paraqesin kryesisht pasojat e dhunës ndëretnike, mirëpo me një numër më të vogël të fotografive gazetareske të botuara.

Prandaj, në bazë të analizimit të fotografisë gazetareske mund të theksojmë se kjo e përditshme i ka dhënë një rëndësi të madhe përdorimit të fotografisë për të dokumentuar sa më tepër dhunën ndëretnike, e cila kishte nisur në Mitrovicë, e më pas ishte përhapur në shumicën e rajoneve të Kosovës.

4.12.3 Bota Sot

Edhe e përditshmjja “Bota Sot”, sa i përket përdorimit të fotografive në trazirat e dhunshme ndëretnike të marsit 2004, është kujdesur që shumicën e raporteve nga rajone të ndryshme të Kosovës, t’i dokumentojë edhe përmes fotografive.



Fotografia 9. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Bota Sot”, më 18 mars 2004

Në numrin e publikimit të 18 marsit, kjo e përditshme mbështet lajmin kryesor me një fotografi gazetareske, e cila e fuqizon kryeartikullin.

Pra, kjo është fotografia e ballinës së gazetës “Bota Sot”, e cila brenda saj paraqet ngjarjen dramatike, pasojat e dhunës në ditën e parë të trazirave, plagosjen e një të riu si rezultat i dhunës së shkaktuar nëpër rrugët e qendrave të ndryshme të vendit. Në ballinën e saj, kjo e përditshme ka publikuar edhe fotografitë e profileve të tre vogëlushëve shqiptarë të cilët kanë humbur jetën në

mënyrë tragjike, në fshatin Çabër të Mitrovicës. Prandaj, duke analizuar pamjet e fotografive të ofruara në ballinë dhe duke u bazuar në studimet për përdorimin e fotografisë gazetareske, mund të theksojmë se përveç tjerash, këto pamje kanë prodhuar gjendje emocionale tek publiku dhe kanë prodhuar dhe provokuar reagim të masës. Edhe fotografitë e tjera të përdorura në brendësinë e këtij numri të së përditshmes “Bota Sot” janë kryesisht fotografi gazetareske, të cilat kanë dokumentuar momente të dhunës në rajone të ndryshme të Kosovës.

Edhe pse kjo e përditshme nuk është shquar për ndonjë rëndësi të madhe që i ka kushtuar përdorimit të fotografisë në numrin e publikuar një ditë pas, të datës 19 mars 2004, sjellë faqe konkrete brenda saj përmes të cilave paraqet fotografi tejet dramatike.



Fotografia 10. “Bota Sot”, 19 mars 2004, kjo e përditshme i ka publikuar një seri fotografish në këtë numër të saj të titulluara “Fotografitë që flasin vetë”.

“Këto fotografi që i shihni shënojnë një ngjarje të jashtëzakonshme që ndodhi më 17 mars në Mitrovicë. Janë ngjarje të dhimbshme, janë pamje të përgjakshme, janë fotografi që shënojnë një pjesë të historisë së dhimbshme të qytetit të ndarë të Mitrovicës. Këto fotografi flasin vetë, nuk duan komentim. Merrni, shihni, jetoni për pak qaste me Mitrovicën e ndarë, me Mitrovicën e plagosur e të vranë, me Mitrovicën e përgjakur. Kujtojeni Mitrovicën edhe njëherë, kështu siç është

në fotografi”.²⁸⁷ Ky është komenti që i është bërë këtyre fotografive, të cilat edhe ashtu përmbajnë pamje të rënda dhe dramatike, pamje të përgjakshme me afekte të jashtëzakonshme për publikun. Natyrisht që përdorimi i këtyre pamjeve që i ofrohen publikut, i cili edhe ashtu në rrethana të tilla dhe të jashtëzakonshme i përjeton shumë më ndryshe sesa në rrethanat e zakonshme. Në numrat e radhës, “Bota Sot” i kthehet rutinës për mënyrën e përdorimit të fotografive. Fotografitë të cilat i përdorë në numrat e radhës janë të një formati të vogël dhe të cilat ndërlidhen kryesisht me ngjarjet dhe zhvillimet e ndryshme, të shoqëruara brenda raportit.

4.12.4 Kosova Sot

E përditshmja e radhës, “Kosova Sot”, i ka kushtuar një rëndësi të madhe përdorimit të fotografisë gjatë raportimit për trazirat ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve gjatë marsit 2004. Kjo e përditshme në numrin e botuar më 18 mars, ka përmbledhur numër të madh të fotografive gazetareske nga të gjitha momentet e trazirave, në rajonet kryesore të vendit, ndërsa kjo është fotografia kryesore e vendosur në ballinë.

²⁸⁷Halit Berani, “Edhe sa herë duhet të përgjakët qyteti i ndarë i Mitrovicës”, *Bota Sot*, 19 mars 2004, Prishtinë, fq.16



Fotografia 11. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Kosova Sot”, më 18 mars 2004

Nëpërmjet kësaj pamje dramatike të ofruar në ballinë, “Kosova Sot” nis raportimin e saj për dhunën e cila kishte shpërthyer në gjithë vendin. Kjo pamje e ofruar përmes objektivit të aparatit fotografik e dëshmon më së miri siç thekson Holland, historinë e vet dhe dëshmon qartë se fotografia është më shumë se lajm. Pamje të tilla të ofruar për publikun, përveç që i japin fuqi teksti i cili ka lidhshmëri me fotografinë, ato ia imponojnë tregimin dhe dramaticitetin publikut në një formë krejt unike. Brenda këtij numri “Kosova Sot”, publikon një numër të madh fotografish, një pjesë e të cilave përbëjnë komentime të ngjarjeve.



Fotografia 12. “Kosova Sot”, më 18 mars 2004, në faqet e mesit publikon njëzet fotografi të trazirave të dhunshme ndëretnike nga pjesë të ndryshme të Kosovës

Ky numër i madh i fotografive gazetareske të botuara në faqet e mesit të gazetës, tregon më së miri rëndësinë që i ka dhënë ky medium këtyre ngjarjeve. Këto fotografi të dokumentuara, e fuqizojnë raportimin për trazirat, ngritin dramaticitetin e ngjarjes, rrisin afektin dhe e mobilizojnë publikun për reagim. Edhe në tre numrat e saj të radhës e përditshmjja “Kosova Sot” i ka kushtuar vëmendje fotografive gazetareske nga terreni, me ç’rast nga rajone të ndryshme të Kosovës ka sjell pamje konkrete të asaj që ka ndodhur gjatë ditës. Gjithashtu përmes fotografive të dokumentuara me shumë dramaticitet brenda përmbajtjes, “Kosova Sot” e ka mbuluar ngjarjen e ceremonisë së varrimit të dy nga tre fëmijët e mbytur nga ngjarja tragjike e fshatit Çabër të Mitrovicës.

4.12.5 Zëri

Gazeta “Zëri” ngjashëm me “Kohën Ditore” e ka respektuar formatin e saj standard të raportimit, duke mos i kushtuar ndonjë rëndësi të veçantë fotografisë gazetareske gjatë mbulimit të ngjarjes së trazirave të dhunshme ndëretnike të marsit 2004. Kjo e përditshme gjatë këtyre ditëve

të raportimit i ka kushtuar rëndësi më tepër rëndësi përmbajtjes, duke mos u fokusuar fare në përdorimin e fotografisë. Kjo është fotografia kryesore e ballinës, e cila është botuar në numrin e 18 marsit, të gazetës “Zëri”.




Fotografia 13. Fotografia kryesore e Trazirave të Marsit, e botuar në ballinën e gazetës “Kosova Sot”, më 18 mars 2004

Përveç fotografisë së ballinës, në brendësinë e këtij numri, fotografitë e publikuara nuk prodhojnë dramaticitet dhe emocion, por pasqyrojnë përmes përdorimit në kënd të gjerë momente të dhunës në përgjithësi. Ngjashëm me këtë numër, edhe në ditët në vazhdim gazeta “Zëri” ka raportuar duke e ruajtur strukturën dhe formatin e raportimit, dhe duke mos i kushtuar fotografisë gazetareske ndonjë rëndësi të veçantë për përplasjet e dhunshme ndër etnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve.


4.13.1. Hapësira që i ka dhënë shtypi ngjarjeve të dhunshme ndëretnike të marsit sipas matjes kuantitative

Në këtë pjesë studimit, përmes metodës kuantitative do të analizojmë numrin e teksteve të cilat ndërlidhen me trazirat e dhunshme ndëretnike, të botuara në shtypin ditor gjatë ditëve kritike të dhunës. Nga secila gazetë ditore janë nxjerrë të gjitha tekstet të cilat për nga përmbajtja i janë kushtuar ngjarjes së Trazirave të Marsit 2004.




Grafika 1. Shtypi ditor: 18 mars 2004

Duke u bazuar në numrin e teksteve të publikuara për Trazirat e Marsit 2004, në shtypin ditor të datës 18 mars, rezulton se gjatë kësaj dite janë botuar gjithsej 151 tekste në të gjitha gazetat ditore, ku me shumti tekste janë botuar në të përditshmen “Bota Sot” me 32 për qind. Pas kësaj në gazetën “Kosova Sot” janë botuar rreth 22 për qind e këtyre teksteve, të përditshmet “Epoka e re” dhe “Zëri”, me nga 17 për qind dhe “Koha Ditore” me 12 për qind. Të gjitha të përditshmet raportet për këtë ngjarje i kanë vendosur në plan të parë, duke pas parasysh situatën e krijuar, si dhe numrin e të vrarëve dhe të plagosurve. Shumica e teksteve ndërlidhen me raportimet nga terreni, numrin e të vdekurve e të plagosurve nga përlëshjet ndëretnike, raportimet nga qendrat e ndryshme të Kosovës si dhe reagimet e politikës vendore e ndërkombëtare.




Grafika 2. Shtypi ditor: 19 mars 2004

Një ditë më vonë numri i përgjithshëm i teksteve për trazirat e dhunshme ndëretnike, i publikuar në shtypin ditor është edhe më i madh. Më 19 mars, në të gjithë shtypin ditor kishte 196 raporte, ndërkaq numri më i madh i teksteve është botuar në të përditshmen “Koha Ditore”, me 22 për qind, “Kosova Sot”, më 21 për qind, “Epoka e re” dhe “Bota Sot” me nga 20 për qind, ndërsa gazeta “Zëri” më rreth 17 për qind. Pothuajse të gjitha gazetat ditore i kanë kushtuar rëndësinë më madhe kësaj ngjarje e cila konsiderohet si më rënda në periudhën e pasluftës në Kosovë. Nga kjo ngjarje në të cilën humbën jetën dhjetëra qytetarë dhe mbetën mijëra të lënduar, ka ndikuar që të ketë një numër mjaft të madh të raporteve të cilat ndërlidhen me zhvillimet dhe trazirat në përgjithësi.



Grafika 3. Shtypi ditor: 20 mars 2004

Trazirat e Marsit 2004, kishin pasur vëmendjen e shtypit edhe në ditën e tretë të shpërthimit të tyre. Në datën 20 mars, në shtypin ditor ishin publikuar rreth 127 përmbajtje të cilat ndërlidheshin me trazirat ndëretnike. Në ditën e tretë ishte gazeta “Zëri” ka botuar numrin më të madh të teksteve, me rreth 27 për qind nga totali i përgjithshëm. Në të përditshmen “Koha Ditore” ishin publikuar rreth 20 tekste apo 16 për qind, e më shumë tekste ishin botuar në të përditshmen “Epoka e re”, rreth 20 për qind.



Grafika 4. Shtypi ditor: 21 mars 2004

Gjithashtu në ditën e katërt, kjo ngjarje kishte vazhduar të jetë në agjendën e shtypit ditor, sidomos në të përditshmet “Koha Ditore” dhe “Zëri”. Në bazë të analizimit të numrit të përgjithshëm të teksteve të botuara, kanë 27, gjegjësisht 29 për qind. Krejt ndryshe paraqitet situata tek të përditshmet “Kosova Sot” dhe “Bota Sot”, të cilat kishin një numër më të ulët të teksteve të cilat ndërlidhen me ngjarjen e dhunës ndëretnike. Edhe gjatë datës 21 mars, në shtypin ditor ishin botuar rreth 113 tekste për trazirat ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve.

KAPITULLI V

ANALIZË KRAHASUESE MES MEDIEVE TË SHKRUARA DHE ATYRE ELEKTRONIKE PËR TRAZIRAT E MARSIT

5.1 Radio Televizioni i Kosovës (RTK)

Pa dyshim që televizionet me gjithë zhvillimet teknologjike dhe platformat mediale mbeten pjesë e rëndësishme e mjeteve të informimit. Publiku vazhdon të jetë besnik i kësaj forme tradicionale të marrjes së informacionit. Mirëpo, në ngjarjet e dhunshme ndëretnike të vitit 2004, televizionet kishin një rol edhe më të madh, sepse revolucioni teknologjik i mjeteve të reja të komunikimit dhe rrjeteve sociale ende nuk paraqitnin një trend të ri të teknologjisë informative. Se televizionet gjatë kësaj periudhe kanë pasur një ndikim dhe shikueshmëri të madhe, theksohet në raportin e Komisionerit të Përkohshëm për Media, sipas të cilit, tri televizionet me frekuencë nacionale në Kosovë, e mbulojnë me sinjalin e tyre mbi 70 për qind të territorit të vendit dhe se ndikimi i tyre është jashtëzakonisht i madh në publik.

Po e fillojmë këtë pjesë të analizës për Trazirat e Marsit 2004, me Televizionin Publik të Kosovës dhe rolin e tij në këtë ngjarje të dhunshme ndëretnike. Shumica e gazetave në analizën e theksuar më lartë kishin vlerësuar se trazirat e marsit ndodhën si rezultat i mbytjes në lumë të tre fëmijëve shqiptarë në fshatin Çabër të Mitrovicës. Por cili ishte raportimi i Televizionit Publik. Radio Televizioni i Kosovës (RTK), për ngjarjen tragjike të fshatit Çabër të Mitrovicës, kishte raportuar me një seri të edicioneve speciale të informimit kushtuar zhvillimeve atje. Sipas transkriptit të këtyre edicioneve të përfshira në raportin e Robert Zhilletit, Komisionerit të Përkohshëm të Medieve (KPM), RTK-ja kishte vendosur në agjendë ngjarjen e fshatit Çabër, nga ora 20:30, duke ia kushtuar shtatë edicione deri në orët e mëngjesit. “Tre fëmijët e zhdukur në ujërat e lumit Ibër janë: Florent Veseli - 8 vjeç, Avni Veseli - 11 vjeç, Egzon Deliu - 12 vjeç. Është gjetur ndërkaq, Fitim Veseli - 14 vjeç. Sipas njoftimeve të deritashme, ata janë viktima të sulmit të serbëve në fshatin Çabër. Ekipi ynë gjendet në vendin e ngjarjes dhe së shpejti mund të ndiqni edicionin special të lajmeve, përfshirë edhe intervistën me Fitim Veselin, i cili është dëshmitar i ngjarjes”.²⁸⁸ Ky ishte informacioni i parë për zhdukjen e tre fëmijëve i transmetuar në RTK përmes

²⁸⁸Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.42

titrave, për tri herë radhazi, duke paralajmëruar se kësaj ngjarjeje do i kushtojë edicion special i lajmeve dhe se do të sjellin intervistën me fëmijën e mbijetuar në këtë tragjedi.

Edicionin e parë special për këtë ngjarje RTK-ja sipas raportit e kishte transmetuar në ora 22:28 të datës 16 mars. Ndër tjera, në këtë edicion special të lajmeve, Televizioni Publik, përveç që ishte lidhur me korrespondentin në Mitrovicë, kishte transmetuar intervistën me Fitim Veselin, fëmijën i cili i kishte mbijetuar tragjedisë. Në këtë rast, Transmetuesi Publik ka rënë në kundërshtim me standardet dhe etiken profesionale të raportimit. “Po kemi qenë pra me disa kushërinj të mi duke shëtitur dhe me disa shokë të mi dhe jemi shkuar afër lumit kur disa serb me një qen na u kanë, psh, na kanë shajt prej shtëpisë. I kemi kqyr ata, unë i njoh me i pa dhe shtëpinë ua njoh dhe na jemi munoft me ik po s’kemi mujt e kemi qenë afër lumit. Kam pas edhe vëllaun tem i cili ka qenë Florent Veseli, 9 vjeçar, ai nuk ka ditë not. E kam qit në shpinë, kam notu 15 metra ma shumë s’kom mujt”,²⁸⁹ deklaroi në intervistën e tij Veseli, të cilës i ishte dhënë hapësirë në RTK më tepër se një minutë e gjysmë. Në këtë edicion special, ajo që shihet në analizë është hapësira tejet e kufizuar e deklaramëve zyrtare për ngjarjen si dhe anashkalimi i mesazheve të tyre për mos nxitje e ngutshme për dyshime ndëretnike. “Fillimisht ka pasur zëra të cilët kanë thënë se incidenti kishte ndodhur për motive etnike, pasi që për momentin ne nuk kemi një informacion të tillë këtë gjë ne nuk mund ta konfirmojmë [12 sek]”,²⁹⁰ thuhet në deklarin zyrtar. Për më pak se një orë, RTK-ja transmeton edicionin e lajmeve “Blic” të skemës së rregullt programore me ç’rast, prezantuesja në hapje të edicionit, bënë interpretimin e ngjarjes tragjike në fshatin Çabër. “Ata janë viktima të një sulmi të një grupi të serbëve në fshatin Çabër. Policia, KFOR-i dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë duke kërkuar për fëmijët e zhdukur”,²⁹¹ thekson prezantuesja, duke e kaluar lidhjen e drejtpërdrejtë te korrespondenti në vendin e ngjarjes. “Deri më tash policia nuk ka sqaruar as nuk ka dhënë asnjë informacion më shumë sesa rrëfimi i Fitim Veselit, i vetmi i cili është gjetur. Policia thotë se krejt informacionet çka kemi, i kemi vetëm nga rrëfimi i Fitim Veselit”,²⁹² thekson në paraqitjen e tij reporteri i RTK-së nga terreni.

Edhe pse edicioni i lajmeve është duke u transmetuar rreth mesnatës, sipas transkriptit të përshkruar në raportin e KPM-së, prezantuesja në komunikim me reporterin, e pyet atë për

²⁸⁹Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.43

²⁹⁰Po aty, fq.43

²⁹¹Po aty, fq.45

²⁹²Po aty, fq.45

reagimin e qytetarëve, ndërkaq përgjigja e tij e drejtpërdrejtë në televizion është se të gjithë qytetarët janë nisur drejt fshatit Çabër. “Në qytetin e Mitrovicës, momentalisht situata është e qetë, pasi që pothuajse të gjithë qytetarët janë të drejtuar nga fshati Çabër për të mësuar për fatin e tre fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër”,²⁹³ deklaroi ai, duke paralajmëruar dramaticitetin e ngjarjes në këtë mënyrë. Televizioni Publik, pas kësaj lidhje të drejtpërdrejtë, sipas raportit, e ritransmetoi intervistën me të miturin, i cili kishte shpëtuar nga tragjedia. Pra, në bazë të këtij transkripti, shihet qartë se raportimi për këtë ngjarje tragjike i tejkalon standardet e raportimit profesional dhe bie në kundërshti me studimet shkencore të studiuesve të medieeve.

Nga lidhjet e drejtpërdrejta me Mitrovicën dhe nga ritransmetimi i intervistës me të miturin i cili kishte arritur t’i mbijetojë dhe të dalë nga lumi, për t’i komentuar zhvillimet atje, në studiot e RTK-së ishte vendosur të ftohet për intervistë të drejtpërdrejtë kryetari i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Mitrovicë, Halit Berani. Qëllimin e këtij të ftuari në intervistë mund ta dinë vetëm kolegji i asaj mbrëmje, të cilët tashmë ngjarjen tragjike të fshatit Çabër e kishin vendosur në agjendën e tyre, ndërkaq i intervistuari gjatë intervistës së drejtpërdrejtë dhe emocionale, kishte shprehur përmes diskursit nxitje të urrejtës ndëretnike si dhe kishte bërë konstatime për ngjarjen pa u pabazuar në burime zyrtare. “Sot rreth orës 16 në fshatin Çabër të Zubin Potokut derisa ishin duke lozur, 6 fëmijë të fshatit në fjalë, një grup banditësh serb i sulmojnë këta fëmijë, banditët serb kishin qenë edhe me një qen dhe duke ua sharë nënën shqiptare dhe kështu i kanë detyruar të ikin fëmijët shqiptarë, dy prej tyre kanë arritur të fshihen në rrënjët e shelgjeve buzë lumit lumëbardhë, ndërsa 4 të tjerë kanë ra në ujë...”,²⁹⁴ deklaroi Halit Berani, përfaqësues i KLDMNJ-së për rajonin e Mitrovicës, duke bërë konstatime të tjera për situatën në pjesën veriore të Mitrovicës, pavarësisht që një gjë të tillë, do të duhej ta bënin zyrtarët e Policisë, KFOR-it, apo UNMIK-ut. “Po ne me këto u mësua se banditët serb përveç këtij rasti edhe në orën 19 e 7 minuta sot në mbrëmje, në lagjen 7 shatorit hodhën bomba në afërsi të tre rrokaqiejve dhe këto janë, ne mendojmë se janë si hakmarrje të rastit që ndodhi në Çagllavicë”.²⁹⁵ Gjatë këtij edicioni të rregullt të lajmeve, “Blic” studio e RTK-së lidhet edhe njëherë me korrespondentin nga Mitrovica për të marrë informatat e fundit. Se kjo ngjarje ishte futur në agjendën e Transmetuesit Publik, dëshmohet në edicionin special të lajmeve që transmetohet pas orës një të datës 17 mars.

²⁹³Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.45

²⁹⁴Po aty, fq.47

²⁹⁵Po aty, fq.47

Në hapje të këtij edicioni special, prezantuesja konstaton se është gjetur trupi i pajetë i njërit nga fëmijët e rënë në lumë, ndërkaq aludon se ai ishte viktimë e një grupi serbë.

Ndërkaq, korrespondenti nga vendi i ngjarjes përmes supozimeve të tij, rithekson se është gjetur trupi i pajetë i njërit fëmijë, mirëpo e pranon se një gjë e tillë nuk është i konfirmuar nga burimet zyrtare. “Mirëpo kjo nuk është konfirmuar nga policia, policia madje nuk ka informuar as nuk ka dhënë as ndonjë hollësi lidhur me procesin e kërkimit. Deri më tash ende nuk dihet nëse policia ka gjetur edhe ndonjë trup tjetër”,²⁹⁶ thekson reporteri nga terreni, duke rikujtuar se këta fëmijë janë viktima të një grupi serbësh. Pas lidhjes të drejtpërdrejtë nga vendi i ngjarjes, për të tretën herë brenda pak orësh, ritransmetohet intervista me të mbijetuarin Fitim Veseli. Pas ritransmetimit të intervistës, RTK-ja nga studio qendrore lidhet edhe njëherë me korrespondentin e saj të cilin e pyet për reagimin qytetarë, pavarësisht që ora kishte kaluar mesnatën. “Situata momentalisht është e qetë, mund të themi se është e qetë për shkak se të gjithë banorët janë të hutuar duke pritur që të mësojnë për fatin e këtyre tre fëmijëve, mirëpo shihet një revoltë e banorëve, sidomos ndaj policisë së UNMIK-ut, sepse në mesin e policëve të UNMIK ka edhe policë të minoritetit serb, të cilët kohë pas kohe flasin me zëra të lartë për tu dëgjuar, kështu që banorët janë provokuar, janë ndjerë të provokuar...”²⁹⁷

Sipas raportit të KPM-së, në ora 01:35, Transmetuesi Publik, vetëm pak minuta pas përfundimit të edicionit special, risjell një tjetër edicion të tillë. Me këtë rast, drejtpërdrejt nga Mitrovica lidhet korrespondenti i RTK-së i cili bënë një rezyme të krejt ngjarjes së ndodhur në fshatin Çabër, ndërkaq realizon përsëri një intervistë të drejtpërdrejtë nga vendi i ngjarjes, në fakt intervistën e dytë me Halit Beranin, të cilin korrespondenti sipas transkriptimit të publikuar në raportin e KPM-së, e pyet për reagimin qytetarë pas tragjedisë. “Ajo dihet se çfarë reagimi, kur në një tragjedi të tillë dihet se si kish me reagua jo vetëm banorët e fshatit Çabër që iu ka ndodhur tragjedia por edhe atyre të cilëve nuk ju ka ndodh por që kanë dëgjuar për këtë rast, sigurisht se janë të mllefosur, e posaçërisht për raste të tilla ku ky rast supozohet se është hakmarrje e rastit të plagosjes së serbit që ndodhi në Çagllavicë ku ai ishte një inskenim, për çka serbët janë të prirë për gjëra të tilla...”²⁹⁸ thekson në intervistën e drejtpërdrejtë përfaqësuesi i KLMDNJ-së për rajonin e Mitrovicës, duke bërë interpretimin e zhvillimeve dhe duke provokuar reagimet

²⁹⁶Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.50

²⁹⁷Po aty, fq.50

²⁹⁸Po aty, fq.53

ndëretnike në një situatë të rëndë e tragjike, ku reagimi emocional është më i theksuar. Radio Televizioni i Kosovës, agjendën e tij për këtë ngjarje e kishte vazhduar edhe më tutje. Sipas raportit të KPM-së, ky televizion, rreth orës 2 e 37 minuta e kishte realizuar një tjetër edicion special, duke provokuar gjendjen emocionale të audiencës. Kësaj radhe korrespondenti nga vendi i ngjarjes, kishte intervistuar nga aty babanë e të zhdukurit Egzon Deliu, Zaimin, të cilit e pyet për informatat që ka për djalin e tij, i cili është djalë hasreti pas shtatë vajzave. “Djali jem ditën e kobshme sot u gjind i vdekur nga hordhitë çetnike serbe... por e mbytën në mënyrën ma mizore duke e shtirë që me zor të hedhet në këtë lum...”,²⁹⁹ citohet gjatë intervistës emocionale Zaim Deliu, babai i njërit prej fëmijëve e mbytur në lumë. Sipas këtij raporti, RTK kishte vazhduar që opinionin publik ta mbajë të lidhur me këtë ngjarje.

Madje sipas këtij raporti, në ora 6 të mëngjesit ishte raportuar për situatën e tensionuar në qytetin e Mitrovicës. “Tre fëmijë shqiptarë, Florent Veseli - 8 vjeç, Avni Veseli - 11 vjeç dhe Egzon Deliu - 12 vjeç, janë zhdukur në ujërat e lumit Ibër, ndërsa Fitim Veseli, dëshmitar i ngjarjes, ka thënë se ata janë ndjekur me qen nga një grup serbësh të veriut të Mitrovicës... Policia dhe KFOR-i janë duke kërkuar për tre fëmijët e tjerë të zhdukur. Sipas njoftimeve, situata në Mitrovicë është e tensionuar.[video tekst i lajmeve]”³⁰⁰. Pra, deri në mëngjesin e 17 marsit, pothuajse gjithë natën, Radio Televizioni i Kosovës, i kishte kushtuar disa edicione speciale kësaj ngjarje. Intervista me të miturin e mbijetuar ishte transmetuar disa herë, dy herë ishte paraqitur në intervistë edhe Halit Berani, përfaqësues i KLDMNJ-së për rajonin e Mitrovicës, si dhe babai i njërit prej fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër. Nga gjithë këta të intervistuar, qartësohet agjenda editoriale, si dhe prodhimi i deformuar i opinionit publik. Pak hapësirë i është dhënë burimeve zyrtare, ndërkaq, nuk ka pasur asnjë intervistë me ndonjë përfaqësues institucional. Të gjitha zhvillimet e tjera të ndodhura gjatë ditës në vend, rajon dhe botë kishin një hapësirë të vogël brenda edicionit të rregullt informativ. Ndërkaq, në edicionet tjera speciale informative, fokusi i raportimit ishte vetëm në zhvillimet në fshatin Çabër të Mitrovicës.

²⁹⁹Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.54

³⁰⁰Po aty, fq.55

5.2 Kohavisioni (KTV)

Për dallim nga Televizioni Publik, televizioni tjetër me frekuencë nacionale, Kohavision (KTV) në lidhje me ngjarjen e ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, përveç edicioneve informative të parapara me skemën programore kishte transmetuar vetëm një emision special për këtë ngjarje, i cili kishte zgjatur pak më tepër se pesë minuta. Në hapje të këtij edicioni, sipas raportit të KPM-së, reporteri nga vendi i ngjarjes pasi që kishte ofruar pamje nga ura e Ibrit të pjesëtarëve të TMK-së, UNMIK-ut, KFOR-it dhe ShPK-së, ishte zhvendosur në familjen Veseli, ku shihet pikëllimi i tyre, për ta intervistuar fëmijën e mbijetuar Fitimin, i cili pothuajse e përsërit rrëfimin e njëjtë të tij. “Përnjëherë më shpëtoi nga shpina dhe mora not shumë shpejt dhe e nxana por dikur ishte shumë thellë, më shpëtoi nga shpina prapë, s’munda me gjet dhe kur dola në stom të lumit aty këqyra dhe më nuk e pash askund dhe i pash ‘shkijet’ duke lypë për andej për neve në stom të Ibrit...”,³⁰¹ citohet në tregimin e tij Fitimi, i cili kishte arritur të dal nga lumi. Sipas tij në momentin kur kishte ndodhur ngjarja tragjike kishin qenë gjithsej gjashtë fëmijë, për tre nga të cilët ende nuk dihet asgjë. Brenda këtij edicioni të shkurtër special informativ, transmetohet deklarata e Trejsi Beker, përfaqësues i UNMIK-ut, i cili thekson se nuk dihet motivi i kësaj ngjarje, dhe se janë duke punuar për të zbuluar fatin e tre fëmijëve të zhdukur. “Krejt çka dimë për momentin është se janë zhdukur tre fëmijë. Kemi marrë informacionin se në lumin Ibër kanë rënë 4 fëmijë, mirëpo fatmirësisht njëri nga ata ka shpëtuar dhe gjendet në shtëpinë e tij. Moshë e këtyre fëmijëve e dimë se është 9 deri 12 vjeç. Ne edhe më tutje jemi në kërkim të trupave të tjerë dhe se motivi i këtij incidenti nuk dihet”,³⁰² thekson në deklaratën e tij përfaqësuesi i misionit të UNMIK-ut.

5.3 Televizioni 21

Televizioni 21 kishte raportuar për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër në edicionin informativ “Flash”, të orës 22:00. Sipas transkriptit të edicionit informativ të datës 16 mars, të përshkruar në raportin e KPM-së për Trazirat e Marsit 2004, theksohet se Televizioni 21,

³⁰¹Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.56

³⁰²Po aty, fq.57

lajmin për zhdukjen e tre fëmijëve e kishte transmetuar të parin. Duke u bazuar në standardet profesionale të raportimit, shihet se në hapje të edicionit informativ prezantuesi i lajmeve bënë konstatim të ngjarjes, pavarësisht faktit që as gjatë lidhjes së drejtpërdrejtë nga Mitrovicën nuk kanë deklarata zyrtare për të treguar se çfarë ka ndodhur në fshatin Çabër. “Sot rreth orës 16:00 në fshatin Çabër, dy serbë kanë ndjekur katër fëmijë shqiptar dhe gjatë përpjekjeve për t’iu ikur atyre, fëmijët janë hedhur në lumin Ibër. Për të mësuar më në hollësi, në linjë telefonike kemi korrespondentën tonë në Mitrovicë, Mirlinda Jashari”,³⁰³ thekson prezantuesi i lajmeve, duke e bartur linjën tek korrespondentja e cila bënë një rezymë të ngjarjes, pa përfshirje të ndonjë deklarimi zyrtar, gjatë transmetimit. “Siç rrëfen fëmija 13 vjeçar, Fitim Veseli nga ky fshat, në këtë kohë ai dhe 5 moshatarë të tij kishin qenë duke shëtitur matanë lumit Ibër. Në ato çaste nga një shtëpi serbe kanë dalë dy persona të cilët kishin me vete një qen dhe kanë filluar t’i ndjekin fëmijët. Nga frika 4 nga fëmijët kanë kërcyer në lumin Ibër, me shpresë se duke notuar do ta kalojnë atë”³⁰⁴, ka shtuar ndër të tjera reporterja nga vendi i ngjarjes. Televizioni 21 gjatë këtij edicioni kishte informuar opinionin publik edhe për zhvillimet e tjera të ndodhura në vend. Pra, lajmi për tragjedinë në fshatin Çabër, është transmetuar në këtë televizion vetëm si informacioni i fundit, pa pasur ndonjë qëllim që kjo ngjarje të kthehet në agjendë mediale.

5.4 Analizë krahasuese mes shtypit dhe televizioneve për ngjarjen tragjike të Çabrës

Në bazë të analizimit të transkripteve të KPM-së, për edicionet informative, në veçanti të raportimit për ngjarjen e ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, ku tre fëmijë ishin zhdukur në lumin Ibër, mund të theksojmë se nga tri televizionet me frekuencë nacionale, Transmetuesi Publik e kishte kthyer në agjendë këtë ngjarje tragjike. Radio Televizioni i Kosovës (RTK), pothuajse nga orët e mbrëmjes, e deri në orët e hershme të mëngjesit të 17 marsit, kishte transmetuar disa edicione speciale informative. Disa herë ky medium kishte transmetuar intervistën me fëmijën e mbijetuar, duke e provokuar gjendjen emocionale të publikut dhe duke nxitur në këtë formë urrejtje ndëretnike. Intervistimi i fëmijës së mitur, në gjendje të rëndë emocionale dhe psikologjik, vetëm sa i thellon problemet e raportimit. Kjo situatë paraqet shkelje të theksuar etike dhe të standardeve

³⁰³Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004, fq.58

³⁰⁴Po aty, fq.58

profesionale të raportimit. Në këtë rast, Transmetuesi Publik e shtyn tutje agjendën e tij, duke e intervistuar dy herë Halit Beranin, kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Mitrovicë, i cili në dy intervistat kishte përdorur gjuhë të urrejtjes me elemente të nxitjes ndëretnike. Gjithashtu, për ta shtyrë më tutje agjendën, gjatë kësaj serie të edicioneve speciale informative në RTK, realizohet intervistë emocionale me babanë e njërit nga fëmijët e zhdukur, që sipas reporterët ishte djalë i hasretit pas shtatë vajzave.. Kohavisoni dhe Televizioni 21, në bazë të analizës së transkripteve të ofruara në Raportin e KPM-së, shihet nuk e kanë pasur në agjendën e tyre raportimin për ngjarjen në të cilin ishin zhdukur tre fëmijë shqiptarë. Prandaj, në qoftë se e krahasojmë raportimin e medieve elektronike dhe shtypit mund të theksojmë se Radio Televizioni i Kosovës dhe dy nga gazetave ditore, kur kanë raportuar për ngjarjen e rëndë të ndodhur në fshatin Çabër, kanë raportuar për këtë ngjarje për t'i shtyrë agjendat e tyre para, duke bërë kështu shkelje etike dhe profesionale gjatë raportimit. Pas shpërthimit të trazirave, mediet në përgjithësi kishin theksuar se këto trazira ndodhën si rezultat i ngjarjes tragjike të ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, dhe humbjes së jetës së tre fëmijëve shqiptarë. Mirëpo, nëse kjo ngjarje ka qenë shkaktari kryesor i fillimit të trazirave, atëherë këto media për të cilat do të flasim tek përfundimet, e kanë rolin e tyre të këtë ngjarje.

KAPITULLI VI

MASAT ADMINISTRATIVE NDAJ MEDIEVE (PAS NGJARJEVE TË MARSIT)

6.1 Analizë e raporteve vendore dhe ndërkombëtare për Trazirat e Marsit 2004

Pas ngjarjeve të cilësuar si më të dhunshmet ndëretnike në Kosovën e pasluftës, ku mbetën dhjetëra të vrarëve dhe mijëra të plagosurve, organizata dhe institucione të ndryshme vendore e ndërkombëtare filluan të grumbullonin informacione për shkaktarët që krijuan Trazirat e Marsit 2004. Në mesin e shumë raporteve të publikuara për këtë ngjarje, kishte të tilla që kishin paraqitur konkluzione konkrete në lidhje me rolin e mediejeve në nxitjen e dhunës. Pjesë e këtij hulumtimi do të jenë raporti i OSBE-së, raporti i KPM-së dhe raporti të RTK-së, ku përmes metodës së analizës së diskut, do t'i analizojmë dhe përfshijmë gjetjet dhe konkluzionet të cilat ndërlidhen me rastin studimor.

6.2 Analizë e raportit të OSBE-së për Trazirat e Marsit 2004

Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka hartuar një raport për këtë ngjarje me titull: “Roli i mediejeve në ngjarjet e marsit në Kosovë”, prej tetëmbëdhjetë faqesh, në të cilin përshkruan rolin e mediejeve dhe kujdesin që duhet ta kenë në situata të tilla, siç është rasti i Kosovës, ku raportet ndëretnike janë të tensionuara. “Të lidhësh mediet me humbjen e jetëve mbart rrezikun e kalimit të vijës së hollë ndarëse midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, edhe në rastet e shoqërive pa konflikte etnike. Por në një shoqëri që ka përjetuar konflikt etnik, edhe vetëm raporti i njëanshëm mund të çojë në dhunë. Ky raport ofron ide dhe rekomandime rreth riparimit të deficiencave të qarta të mediejeve me qëllim që të parandalohen situata të ngjashme në të ardhmen dhe të garantohet një terren i lirë, i drejtë dhe i balancuar medial në Kosovë”,³⁰⁵ është theksuar në hyrje të këtij raporti, duke vazhduar më tutje se mediet kanë përgjegjësi që të reagojnë në mënyrë adekuate dhe profesionale, sepse moskujdesi në raportim mund të orientojë rrjedhën e ngjarjeve. “Pa moskujdesin dhe raportimin sensacional në 16/17 mars, ngjarjet do të kishin marrë tjetër rrjedhë. Nuk do të kishin nivelin e intensitetit dhe brutalitetit që kemi parë ose pikërisht për këtë, as që do të kishin ngjarë”.³⁰⁶ Në këtë raportin e OSBE-së

³⁰⁵OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq.2

³⁰⁶Po aty, fq.2

theksohet se raportimi për mbytjen fatale të fëmijëve në fshatin Çabër, nuk është trajtuar profesionalisht dhe se nuk ka qenë e trajtuar me idenë e ndjenjës së shmangies së dhunës. “Në veçanti, kthesa kategorike që i dhanë mediet mbytjes fatale të fëmijëve duket se nuk është mbështetur nga asnjë raport i vlefshëm nga pikëpamja gazetareske dhe nuk ka qenë e nxitur nga ndjenja për të ndihmuar shmangien e dhunës. Ajo ku çoi ishin demonstratat masive me natyrë të dhunshme me pjesëmarrjen e 50-60 mijë vetëve krahasuar me 18,000 pjesëmarrës para incidentit dhe mbulimit të tij në media”,³⁰⁷ thuhet në përmbledhjen e përgjithshme të raportit të OSBE-së, duke ritheksuar më tutje në raport se sektori i shërbimit transmetues, manifestoi nivel të papranueshëm emocional, njëanshmëri, pakujdesshmëri dhe vullnet “patriotik” të kuptuar keq.

Prandaj, sipas gjetjeve të raportit, në mbrëmjen e 16 marsit nga të tri televizionet kryesore kosovare, në mënyrë të veçantë RTK-ja meriton kritikën më të ashpër të mundshme. Në përmbledhjen zyrtare të këtij raporti të OSBE-së, theksohet si përfundim i veçantë se ngjarjet e mesit të marsit ishin kriza e parë serioze në të cilën hasen mediet në Kosovë, sidomos ato elektronike, që besohet se mund të jenë një nga arsyet e shkaktimit të trazirave të dhunshme të marsit.

Kur analizojmë raportin e OSBE-së, vërejmë në pjesën në të cilën trajtohen rrethanat që shkaktuan dhunën ndëretnike. Aty theksohet se raportimi i medieve për mbytjen e tre fëmijëve në fshatin Çabër, cilësohet si një nga elementet që nxiti reagimin e masës. “Dëshmi rrethanore dhe mendime të mbledhura nga një numër institucionesh dhe nga autori i këtij raporti sugjerojnë se mënyra se si u cilësua lajmi për mbytjen e fëmijëve dhe si u prezantua nga mediet kryesore përbën *casus belli*³⁰⁸. Atë, që organizatorët e demonstratave ekstremiste kundra UNMIK-ut nuk mundën të arrinin në të kaluarën, e arriti lajmi për mbytjen e fëmijëve”.³⁰⁹ Sipas këtij raporti, mediet e konstruktuan tragjedinë e fshatit Çabër, sepse siç thekson raporti, mediet në këtë rast televizive, e rregulluan ngjarjen sipas editorialit të tyre. “Në asnjë moment gjatë intervistave të emetuara të fëmijës ai nuk tha ‘ne jemi ndjekur nga një grup i serbëve me një qen’. Stacionet televizive vendosën ta rregullojnë storjen sikur serbët i kishin ndjekur faktikisht fëmijët shqiptarë drejt vdekjes së tyre me anë të qenit”.³¹⁰

³⁰⁷OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq.2

³⁰⁸Sqarim: “Casus” belli është një shprehje latine që do të thotë "një veprim apo ngjarje që provokon ose përdoret për të justifikuar luftën

³⁰⁹OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq. 3

³¹⁰OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq.3

Përveç televizioneve, në këtë raport kritikohet për mënyrën e raportimit edhe shtypi. “Madje edhe e respektuara e përditshme ‘Koha Ditore’ në 17 mars ka këtë kryetitull në ballinë: ‘Tre fëmijë shqiptarë mbyten në Ibër, të ndjekur nga serbët’. U la të besohej tek opiniononi i gjerë se përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ishte kryer një krim i poshtë, i motivuar etnikisht”.³¹¹ Pra, sipas raportit të OSBE-së deri në këtë pikë të analizimit të raportit, vërehen kritika për mënyrën e raportimit të medieve elektronike dhe shtypit, në lidhje me raportimin për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, ku humbën jetën në mënyrë tragjike tre fëmijë shqiptarë. Më tutje në këtë raport për të identifikuar sa më shumë mendime për trazirat e marsit, janë marrë dhe analizuar tekstet e shkruara nga autorët Halil Matoshit, që në atë kohë ishte redaktor i javores “Zëri” dhe Ylber Hysa, kolumnist. “Rebelimi ishte një reaksion zinxhir që e pushtoi Kosovën për pak orë. Ishte shkëndija e Çabrës që e ndezi zjarrin që pastaj dogji shtëpinë tonë Kosovë. Natyrisht në kohën e teknologjisë së avancuar, rebelimi transmetohej drejtpërdrejt në TV, gjë që influencoi fort që çdo adoleshent në Kosovë të donte të ishte pjesë e asaj që po emetohej pa pushim për 24 orë. Ky transmetim kishte shumë ndikim tek ata që nuk e dinin ç’po ndodhte dhe sugjeronte se tash të gjithë duhet të rebelohen, se të gjithë duhet ta përdorin këtë rast që të rrëmbejnë atë që ka mbetur prej sundimit të ligjit dhe vetë ligjit”,³¹² citohet brenda raportit të OSBE-së, pjesa e editorialit të Halil Matoshit. Në raport gjithashtu është cituar gjithashtu kolumnia e Ylber Hysajt, të botuar në gazetën “Koha Ditore”. “...pavarësisht nëse lajmi është i vërtetë apo jo, ne kemi tendencë t’i besojmë nëse ashtu dëshirojmë. Kështu ishte rasti me serbin në Çagllavicë; Serbët e morën si të mirëqenë se keqbërësi duhet të ketë qenë shqiptar dhe bllokuan rrugët. E njëjta gjë u përsërit kur u përhap lajmi i mbytjes së fëmijëve shqiptarë”,³¹³ citohet kolumna e Hysajt. Më tutje në raportin e OSBE-së për trazirat e dhunshme ndëretnike të marsit, është bërë analizimi i mënyrës së raportimit, i të tri televizioneve me frekuencë nacionale dhe i shtypit ditor. Duke u analizuar transkripti i lajmeve në televizione (RTK, KTV dhe RTV21), janë identifikuar shkelje profesionale të raportimit në televizione, me theks të veçantë në Transmetuesin Publik, ku është evidentuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe raportim i njëanshëm. Edhe pse shtypit i është kushtuar më pak vëmendje në raportin e OSBE-së, nuk kalon pa kritika dhe vërejtje për formën e mbulimit të ngjarjeve të mesit të marsit dhe shkeljes së standardeve profesionale të raportimit. “Në të vërtetë

³¹¹Po aty, fq.3

³¹²Po aty, fq.5

³¹³Po aty, fq 7

nëse media do të kishte raportuar për tre fëmijët njësoj si për ngjarjet në Graçanicë, ndoshta Kosova nuk do kishte përjetuar situatën që përjetoj në ditët në vazhdim”,³¹⁴ theksohet në një përfundim për mënyrën e raportimit të televizioneve. Kritika për mënyrën e raportimit të televizioneve është dhënë edhe për datën 17 mars, të cilat kishin transmetuar sipas raportit ngjarjen e trazirave drejtpërdrejt, duke rritur dhe provokuar situatën në terren. “30 të lënduar dhe një i vrarë është bilanci i ditës së sotme. Personi i vrarë është një serb që sipas dëshmitarëve, doli nga shtëpia me kallashnikov dhe provokoi protestuesit ku ata i morën armën, si rrjedhojë serbi vdiq nga plagët”,³¹⁵ citohet deklarata e korrespondentit nga Gjilani, për televizionin Kohavision (KTV), më datën 17 mars.

Krejt në fund, në raportin e OSBE-së i cili flet për rolin e medieve në ngjarjet e marsit në Kosovë, pas analizimit të ngjarjes në tërësi, janë nxjerrë konkluzione dhe rekomandime të cilat do të duhet të jenë në shërbim të medieve. Ndër konkluzionet kryesore në raport është theksuar se mediet kanë injektuar raportime emocionale, të paverifikuara rreth ngjarjes tragjike me fëmijët e pafajshëm, si dhe kanë raportuar njëanshëm për arrestimet e padrejta të “çlirimtarëve” nga UNMIK-u, dhe bllokimi i rrugëve kryesore. “Mediumi televiziv shqiptar i Kosovës vendosi ta cilësonte incidentin e mbytjes së tre fëmijëve si një rast vdekje i shkaktuar direkt dhe pa asnjë dyshim prej serbëve kundërshtarë. Asnjë provë nuk u dha për ta dëshmuar këtë dhe fëmija i intervistuar nuk e deklaroi këtë aq qartë dhe fuqishëm sa u prezantua nga mediet”,³¹⁶ është thënë në njërin nga konkluzionet kryesore të raportit të OSBE-së. Ndërkaq, sa i përket rekomandimeve, përmes tyre është kërkuar që të këtë trajnim për përfaqësuesit e medieve si dhe të ndërmarrin masa për përmirësimin e gjendjes së medieve në përgjithësi në Kosovë. Në një pikë tjetër rekomanduese, është kërkuar nga KPM-ja që të jetë më rigoroz në ndëshkimin e medieve kur ato e shkelin nenin e kodit të sjelljes. “Komisionari i Përkohshëm për Media (KPM) do të përkrahet në përpjekjet e tij për të zbatuar Rregulloren ekzistuese dhe posaçërisht Nenin 2.2 të ‘Kodit të Sjelljes për mediet transmetuese të KPM-së’ që thotë: “Transmetuesit nuk do të emetojnë materiale që nxisin krimin ose aktivitete kriminale ose përmbajnë në vetvete rrezik për të shkaktuar lëndim të tillë si vdekje, plagosje apo dëmtim të pasurisë apo akte të tjera dhune”,³¹⁷ thuhet ndër të tjera në rekomandimet e raportit të OSBE-së.

³¹⁴OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq.11

³¹⁵Po aty, fq.13

³¹⁶Po aty, fq.16

³¹⁷OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë 2004, fq.16

6.3 Analizë e raportit të KPM-së për Trazirat e Marsit 2004

Shumë më kritik në raportin e tij ishte Komisioneri i Përkohshëm për Media (KPM), Robert Zhillet, i cili i kritikon ashpër televizionet për mënyrën e raportimit për Trazirat e Marsit 2004, me theks të veçantë Radio Televizionin i Kosovës (RTK). Në hyrje të raportit të tij dyzet faqesh, Zhillet paraqet një konstatim të tij, duke i akuzuar televizionet që e provokuan situatën edhe ashtu të rënduar ndëretnike në Kosovë në mes të shqiptarëve dhe serbëve. “Në mbrëmjen e 16 Marsit, mediet kosovare raportuan për zhdukjen dhe mbytjen e supozuar të tre djemve në lumin Ibër afër Mitrovicës. Brenda disa orëve, trupi i njërit djalë ishte gjetur. Përkundër apeleve të policisë së UNMIK-ut për maturi, raportet televizive në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt ia mvëshën vdekjet një sulmi të serbëve, duke i dhënë këtij incidenti mundësinë e menjëhershme për të tendosur marrëdhëniet etnike, tanimë të acaruar në Mitrovicë dhe gjetiu në Kosovë”,³¹⁸ theksohet në hyrjen e këtij raporti, i cili në fund bartë firmën e kryesuesit të këtij institucioni. Duke mos folur për rolin e institucionit që ai drejton, për punën e tij në raport me televizionet, ndër të tjera ai i akuzon mediet që kanë bërë thashetheme kur ato kanë raportuar për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër. “Saktësia faktike, toni dhe përmbajtja e raporteve që prekin çdo aspekt të etnicitetit, janë veçanërisht qenësore për të parandaluar subjektet transmetuese që të bëhen katalizatorë të dhunës. Karshi deklaratave eksplozive, në gazetarinë profesionale nuk ka hapësirë për thashetheme ose hamendje për të vërtetën”,³¹⁹ thekson Zhillet. Raporti i KPM-së, ndahet në tri pjesë, ku secila prej tyre flet për fakte dhe rekomandime për televizionet me frekuencë nacionale (RTK, KTV dhe RTV21), ndërkaq në fund, përmes një shtojce paraqitet transkripti i të gjitha edicioneve informative, edicioneve speciale të lajmeve në këto televizione për datën 16 dhe 17 mars 2004. Pjesa e parë e raportit i kushtohet analizës së RTK-së, ku paraqiten 37 fakte për mënyrën e raportimit, 24 konkluzione dhe 7 rekomandime, përmes të cilave kritikohen televizionet dhe kërkohen masa ndëshkuese ndaj tyre, sidomos ndaj RTK-së.

Meqenëse më lartë është analizuar mënyra e raportimit në mes shtypit dhe televizioneve, në këtë pjesë të analizimit të këtij raporti do të fokusohemi më tepër tek konkluzionet dhe rekomandimet. Në njërin nga konkluzionet e dala nga raporti, është akuzuar Televizioni Publik për fragmentim të ngjarjes së trazirave gjatë raportimit. “Që nga raportet e para të fragmentuara

³¹⁸Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq. 2

³¹⁹Po aty, fq.4

për mbytjet në ujë të tre fëmijëve që u bënë gjatë lajmeve kryesore të mbrëmjes së 17 marsit, karakteri i mbulimit të lajmit nga RTK-ja duket të ketë qenë i cytur nga një dëshirë për një ngjarje dramatike dhe sensacion, dhe ndoshta nga rivaliteti me dy stacionet private, pa një ndjenjë të përgjegjësisë për efektet që transmetimet e tyre mund të kenë pasur në një mjedis jo stabil politik”,³²⁰ theksohet në këtë pikë të raportit, duke i akuzuar përgjegjësitet e RTK-së, se më tepër i kanë besuar gjatë raportimit deklaratës së fëmijës - dëshmitar të ngjarjes, sesa burimeve zyrtare të UNMIK-ut. Kjo sipas theksimeve në raport ishte një gjë e pamatur dhe joprofesionale. Një pikë e konkluzioneve e cila paraqitet në raport ka të bëjë me përfaqësuesit e RTK-së, të cilët e kanë paralajmëruar kryeministrin Rexhepi për tensionet ndëretnike të ngritura, ndërkaq në anën tjetër, gjatë raportimit e kanë bërë gjënë e kundërt. “9. Shprehja e shqetësimit të përgjegjësve të RTK-së rreth situatës politike ishte aq e paqëndrueshme saqë ndien obligim ta paralajmërojnë Kryeministrin në mbrëmjen e 16 marsit se standardet plotësisht janë në kundërshtim me materialin që ata kishin zgjedhur të transmetojnë - dy intervista të ndara dhe nxitëse me z. Berani; në reportazhet e korrespondentëve që kthyen tregimin e paqartë të fëmijës të traumatizuar në një mbrojtje të faktit se serbët kishin mbytur fëmijët; zemërimin e hidhur të babait të pikëlluar ndaj serbëve”,³²¹ - thuhet ndër të tjera në pikën nëntë të konkluzioneve të raportit të KPM-së.

Në konkluzionin e radhës shprehet habi sesi RTK-ja, gjatë mbrëmjes së 16 marsit e kishte ndaluar transmetimin e reklamave për t’u fokusuar në raportimin e ngjarjes tragjike të fshatit Çabër, ndërsa përmes përdorimit të gjuhës kishte rënë në kundërshtim me rregullat e saj. “Shumë nga reportazhet e RTK-së në mbrëmjen e 16 marsit me adresimin e tyre ‘banditët serbë’ dhe ‘hordhitë çetnike’ dhe përdorimi i shkujdesur i termit ‘sulm’ për të përshkruar se çka u kishte ndodhur fëmijëve - përveç materialit tjetër të emetuar më 17 mars, duket të jetë në konflikt me Kodin Editorial të Sjelljes të vet RTK-së në lidhje me përdorimin e gjuhës ‘emocionuese’ apo ‘provokative’”,³²² thuhet më tutje në këtë raport, duke theksuar se kjo formë e gjuhës bie në kundërshtim edhe me Nenin 2.2 të Kodit të Sjelljes për Mediet Elektronike të KPM-së.

Në asnjërin nga konkluzionet nuk përfshihet ndonjë pikë apo kritikë për autoritetet ndërkombëtare, edhe misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut në Kosovë, që kishte rolin ekzekutues në çdo institucion, mirëpo fajësia bie vetëm mbi përfaqësuesit shqiptarë. Një gjë e tillë shihet edhe në

³²⁰Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq.18

³²¹Po aty, fq.19

³²²Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq.20

pjesën e raportit i cili flet për rekomandimet, mirëpo që në pikën e parë parasheh që kontrolli ndërkombëtar mbi institucionet publike, në këtë rast mbi RTK-në, të shtohet edhe më shumë. “Prandaj, ne rekomandojmë kthimin e menjëhershëm të një këshilltari të lartë ndërkombëtar në RTK, të paktën deri në fund të këtij viti. Kjo pozitë kërkon një person me reputacion të padiskutueshëm për integritetin gazetaresk dhe përvojë me subjektet transmetuese publike në këtë rajon”,³²³ theksohet në pikën e parë të rekomandimeve, duke i rekomanduar UNMIK-ut edhe në pikën tjetër që të bëjë një rishikim të strukturës, funksioneve dhe anëtarësisë, personelit të Bordit të Drejtorëve dhe Operacioneve Transmetuese. Ndër rekomandime tjera të theksuara në raportin e KPM-së janë pikat të cilat bëjnë thirrje për trajnimin e gazetarëve, respektimin e hapësirës programore që i garantohet pakicave si dhe rekomandimin për ndihmë ndërkombëtare për RTK-në, kryesisht nga vendet dhe televizionet publike evropiane, të cilat kanë traditë në mënyrën e raportimit dhe menaxhimit.

Në pjesën e dytë të raportit të KPM-së, në qendër të analizës është KTV-ja, e cili sipas raportit kishte bërë shkelje profesionale sikurse RTK-ja, kur ka raportuar për tragjedinë e fshatit Çabër. “Pas raportit të korrespondentit, pasoi intervista e KTV-së me djalosin e mbijetuar, Fitim Veseli. Në këtë intervistë që duket se është bërë përafësisht dy orë pasi që djaloshi kishte biseduar me RTK-në, ai e bën të qartë se ai dhe shoqëruesit ikën prej një qeni, jo prej serbëve. Pjesërisht ai thotë: “ishim duke shëtitur matanë lumit dhe kur disa serbë, d.m.th. dy serbë deshën të na sulmojnë, por sa për ata, ne kishim shpëtuar por kishin edhe një qen. Se ne kishim frikë prej atij se prej shkijeve jo, se ju kishim shpëtuar atyre se ishin shumë larg por qeni vrapojke shpejt dhe ne ishim afër lumit”,³²⁴ theksohet tek pjesa e raportit ku prezantohen faktet e raportimit të cilat lidhen me KTV-në. Mirëpo, brenda këtyre fakteve në raport kritikohen reporterët të cilët sipas shkruesve të këtij raporti, nuk e kishin sqaruar mjaftueshëm gjatë intervistës me të miturin arsyen e vërtet se pse ata (fëmijët), kishin menduar se ai grup i serbëve do i sulmonte.

Pra, brenda raportit shihet një tendencë në përzierjen e kompetencave profesionale të punës së gazetarëve, mirëpo, një dilemë të tillë raporti nuk e ngritë për përgjegjësit e misionit ndërkombëtar të cilët kishin pushtetin ekzekutues, dhe përgjegjësinë e sigurisë në nivel vendi. Sipas raportit të KPM-së, të firmosur nga Robert Zhillet, ngjashëm me RTK-në, edhe KTV-ja, nuk kishin qenë bashkëpunuese gjatë raportimit për ngjarjen tragjike të vdekjes së tre fëmijëve në

³²³Po aty, fq.23

³²⁴Po aty, fq.27

fshatin Çabër, edhe pse, sipas intervistave të përfaqësuesve të këtyre institucioneve ndërkombëtare, ata iu kishin tërhequr vërejtjen medieeve që të jenë të kujdesshme në raportim, për shkak të ndjeshmërisë së ngjarjes. “Ajo dhe përfaqësuesit e tjerë të UNMIK-ut thanë se korrespondentët e të dy televizioneve, RTK-së dhe KTV-së nuk bashkëpunonin, duke rastisur në vendin e kërkimit edhe përkundër instruksioneve, por që “KTV-ja nuk ishte edhe aq jo bashkëpunuese; RTK ka qenë më i keqi”,³²⁵ thuhet ndër të tjera tek pjesa e grumbullimit të fakteve për mënyrën e raportimit të KTV-së.

Në raport përmbliidhen 5 konkluzione për KTV-në, të cilat kishin qasje kritike për mënyrën e raportimit dhe mbulueshmërinë e ngjarjeve të trazirave ndëretnike të marsit 2004. “Raportimi i KTV-së për mbytjen e mundshme në ujë të tre fëmijëve më 16 mars dha një besim të pajustificuar në storjen e djaloshit të mbijetuar. Duke vepruar kështu, KTV-ja dështoi në prezantimin e një paqartësie në lidhje me atë se çfarë kishte ndodhur, siç kërkonte policia nga ta. Efekti i rrjetit televiziv ishte që të kontribuonte në përshtypjen e përgjithshme, të pambështetur nga fakti i verifikueshëm, se serbët i kishin shtyrë fëmijët të gjenin vdekjen në lum”,³²⁶ theksohet tek konkluzionet për KTV-në, duke u paralajmëruar për masa ndëshkuese, për mos sjelljen e arkivit për ngjarjen e marsit tek institucioni i KPM-së. “Dështimi i KTV-së për sjelljen e video-kasetave nga arkiva, të shumicës së programit të saj, përbën shkelje të kushteve të licencës së saj dhe do të trajtohet si e tillë”.³²⁷ Tek pjesa e fundit e raportit janë paraqitur tri rekomandime për këtë televizion, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me ngritjen profesionale të kapaciteteve të saj, e sidomos të korrespondentëve lokal. Gjithashtu, përmes një rekomandimi kërkohet ndëshkim për KTV-në, për mos ruajtje të arkivit të saj, sipas normave të caktuara nga ana e KPM-së. “KPM-ja do ta ngarkojë me sanksione dështimin e KTV-së në ruajtjen për 21 ditë të arkivës së programeve të saj të transmetuara. KTV-ja do të jetë mirë e këshilluar për ta implementuar këtë sistem brenda 30 ditëve të ardhshme, më së largu”,³²⁸ është thënë në pikën e fundit të rekomandimeve për KTV-në.

Në pjesën e fundit të raportit të KPM-së, është bërë analizimi i mënyrës së raportimit të RTV21, për ngjarjen e lartcekur, duke ofruar edhe për këtë medium fakte, konkluzione dhe rekomandime. Sipas këtij raporti, edhe pse ky televizion kishte raportuar pothuajse dy orë pas RTK-së për ngjarjen tragjike të fshatit Çabër, raportimi kishte qenë i pabazuar në fakte.

³²⁵Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq.28

³²⁶Po aty, fq.31

³²⁷Po aty, fq.31

³²⁸Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq.32

“Prezantuesi paraqiti lajmin duke pohuar kategorikisht se, “Dy serbë ndoqën katër fëmijë shqiptarë sot rreth orës 16:00 në fshatin Çabër dhe gjersa u munduan t’u ikin atyre, kërcyen në lum”. Nuk kishte atributin për burimin dhe as bazë faktike për këtë pohim”,³²⁹ thuhet në raportin për RTV21, duke shtuar më tutje se të njëjtin veprim e kishte bërë edhe korrespondentja e këtij mediumi nga Mitrovica. Raportimet në televizionin 21, sipas raportit KPM-së, nuk përmbanin referenca të burimeve zyrtare, për këtë ngjarje kaq dramatike, që konsiderohet si pikënisje e trazirave të dhunshme ndëretnike. “Raporti i TV21 nuk përmban ndonjë referencë qoftë nga policët e UNMIK-ut, të cilët menjëherë u thanë reporterëve në vendin e ngjarjes afër Mitrovicës se nuk kishte informata të pavarura për mbështetjen e storjes së djaloshit. Duke dështuar ta citojnë në përgjithësi, madje edhe në mënyrë sipërfaqësore të parë në RTK dhe KTV, TV 21 dështoi tërësisht të njoftojë shikuesit e tij për elementin vendimtar të paqartësisë në këtë storje”,³³⁰ është shkruar në pikën 6 të fakteve të raportimit të TV21. Në bazë të analizimit të fakteve të paraqitura në raport, theksohet ndër tjera se ky televizion, kishte raportuar shumë më korrektësi për ngjarjet dhe aktivitetet e tjera të ndodhura gjatë asaj dite në Kosovë, një pjesë e të cilave trajtonte problemet ndëretnike në vend. Edhe tek pjesa e raportit e cila flet për konkluzionet, evidentohen shkelje të Kodit të Sjelljes për Media Elektronike të KPM-së, të cilat kanë ardhur si rezultat i mungesës së burimeve të informacionit gjatë raportimit. “3. Ky dështim mund të interpretohet si shkelje e Nenit 7.2 të Kodit të Sjelljes për Media Elektronike të KPM-së, i cili thekson se: “Emetuesit nuk do të mund transmetojnë material derisa nuk e bëjnë kërkimin rutinor dhe të arsyeshëm për të siguruar saktësinë e tij”.³³¹ Ndërkaq, ndryshe nga rekomandimet e shumta për Radio Televizionin e Kosovës dhe Kohavisionin, për Televizionin 21, në raportin e Robert Zhilletit, parashihet vetëm një rekomandim. “Sikurse shumica e medieve të Kosovës, TV21 do të përfitonte nga trajnimet specifike për korrespondentë dhe redaktorë në teknikat dhe etikën e raportimit të konflikteve. Rëndësia e kërkimit dhe prezantimit të tërësishëm, të këndvështrimit të policisë në çfarëdo incidenti duke përfshirë vdekjen apo lëndimin, posaçërisht kur faktorët etnik mund të jenë të përfshirë, nuk mund të jenë të theksuar mjaft”,³³² është thënë në fund të raportit të KMP-së, brenda të cilit janë analizuar tri televizionet kryesore për mënyrën e raportimit për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër, dhe për trazirat në përgjithësi. Në fund të këtij raporti janë bashkëngjitur

³²⁹Po aty, fq.32

³³⁰Po aty, fq.35

³³¹Po aty, fq.39

³³²Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Media, Prishtinë 2004, fq.35

transkriptet e të gjitha edicioneve informative, me theks të veçantë, të datës 16 dhe 17 mars, të vitit 2004.

6.4 Analizë e raportit të RTK-së për Trazirat e Marsit 2004

Pas Trazirave të Marsit 2004, dhe pas kritikave të mëdha kryesisht nga misionet ndërkombëtare që iu kishin bërë medieve, me theks të veçantë Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për nxitje të trazirave, Bordi i Drejtorëve³³³ të RTK-së, së bashku me menaxhmentin³³⁴ e këtij Transmetuesi Publik, kishin mbajtur mbledhje në të cilën pika kryesore e rendit të ditës ishte: “Analiza e mbulimit të ngjarjeve të marsit në televizion në radio”. Gjatë kësaj pjese të punimit, përmes metodës së analizës së diskut do të analizohet procesverbal i mbajtur në këtë mbledhje të 32 të Bordit të Drejtorëve të RTK-së. Mbledhjen e hapi kryesuesja Vjosa Dobruna, ndërkaq, në mungesë të emërimit të kryetarit, fjalën e mori nënkryetari Blerim Reka, i cili e tregoi arsyen e mbledhjes. “Kjo mbledhje ka një rëndësi të posaçme për arsye të kritikës që i është bërë medieve dhe në kuadër të kësaj, edhe RTK-së”.³³⁵ Megjithatë, çështjen e parë të cilën e ngriti për diskutim Bordi i Drejtorëve, ishte zgjedhja e kryetarit, gjë të cilën e kërkoi anëtari Milazim Krasniqi, që më pas gjeti mbështetjen e anëtarëve të tjerë të Bordit. Mirëpo, për këtë pikë shtesë të rendit të ditës, mbeti të diskutohej pas analizimit të ngjarjeve të marsit dhe raportimit të RTK-së për këto ngjarje.

Bordi i Drejtorëve e kaloi fjalën tek menaxhmenti i RTK-së, për të dëgjuar nga ta për rolin e RTK-së, në trazirat e marsit dhe për kritikën e shumta që kishin ardhur në drejtim të Transmetuesit

³³³Mbledhja 32 e Bordit të Drejtorëve të RTK-së

Në mbledhje marrin pjesë:

Zonj. Vjosa Dobruna, n/Kryetare e Bordit, kryesuese e mbledhjes,

Z. Blerim Reka, n/Kryetar i Bordit,

Z. Boris Bergant, anëtar i Bordit,

Z. Friedhelm Frischenschlager, anëtar i Bordit,

Z. Milazim Krasniqi, anëtar i Bordit,

Z. Nuhi Rexhepi, anëtar i Bordit,

Z. Muhamet Mustafa, anëtar i Bordit

³³⁴ Nga menaxhmenti i RTK-së:

Z. Agim Zatriqi, Drejtor i përgjithshëm i RTK-së,

Z. Astrit Salihu, zv/Drejtor i përgjithshëm i RTK-së,

Zonj. Elvana Prekazi, Drejtoreshë e administratës e RTK-së,

Z. Liridon Cahani, Drejtor i TV,

Z. Avni Spahiu, Drejtor i Radiove

Zonj. Rafaela Prifti, Menaxhere për marrëdhënie me publikun,

Z. Agron Dida, Drejtor i operacioneve dhe teknikës

³³⁵RTK, Mbledhja 32, “Bordit të Drejtorëve të RTK-së-Procesverbal”, Prishtinë, 13.04.2004, fq.2

Publik. Me të marr fjalën, zëvendës drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Astrit Salihu, ka hedhur poshtë vlerësimet dhe kritikën e institucioneve ndërkombëtare duke theksuar se ata nuk kanë bërë analizë përmbajtësore të raportimit. “Konsiderojmë që vlerësimet e bëra që nga niveli i Sekretarit të Përgjithshëm të KB [Kombeve të Bashkuara] e deri te KPM-ja janë të paqëndrueshme. Në to nuk vërehet ndonjë qasje dhe analizë profesionale e medieve, madje konsiderojmë se pa u bërë analiza përmbajtësore e mbulimit të ngjarjeve, kanë dalë vlerësimet se mediet kanë dështuar dhe se kanë qenë ato që i kanë nxitur trazirat”,³³⁶ kishte theksuar Salihu, duke i kërkuar Bordit që edhe ai t’i rishikojë materialet e edicioneve të lajmeve dhe të edicioneve speciale të lajmeve të transmetuara në mbrëmjen e 16 marsit. Sipas tij, Bordi duhet ta shohë materialin edhe të intervistës së fëmijës, intervistë e cila kishte marrë shumë kritikë nga misionet ndërkombëtare. Ai kishte shtuar më tutje se menaxhmenti i RTK-së, mundet të ofrojë edhe materiale të cilat nuk i ka transmetuar duke e pasur parasysh ndikimin e tyre. “Ekzistojnë edhe pamjet që nuk i kemi transmetuar duke i konsideruar si shumë të rënda për opinionin, pamje të njerëzve të vdekur, të vrarë, të njerëzve ku shihet trutë në tavolinë dhe mendojmë që është mirë që Bordi t’i shohë edhe ato në mënyrë që ta ketë një pasqyrë për vendimet editoriale”.³³⁷ Gjatë transmetimit të materialeve para Bordit, drejtori i përgjithshëm Agim Zatriqi, së bashku me zëvendësin e tij, Astri Salihun, arsyetuan materialet e transmetuara duke pretenduar se RTK-ja, ka qenë korrekte në raportim. Më pas ndërhyjnë anëtar i Bordit, Boris Bergan, i cili theksoi se me pamjet e materialeve nuk do të mund të nxirrnin asnjë përfundim. Ai ka thënë se nga informacionet që ka, flitet se mediet kanë shkaktuar tensione ndëretnike. “Nga informatat jozyrtare që i kam, kam kuptuar se mediet mund të kenë shkaktuar ose mund të kenë ndikuar në ngritje të tensionimit. Kam dëgjuar nga disa burime, jo zyrtarisht dhe ju keni të drejtë se e tëra filloi me historinë e fëmijëve”,³³⁸ citohet në raport të ketë thënë Bergan, duke kërkuar nga menaxhmenti që të japin vlerësimin se a kanë vepruar konform rregullave dhe standardeve profesionale. Duke shpjeguar situatën në ditën kritike, zëvendës drejtori Salihu, kishte deklaruar se i gjithë menaxhmenti, gjatë asaj periudhe ishte në presion të dyfishtë. “Ne kemi qenë nën një presion permanent nga ngjarjet në njërin anë dhe nga KPM-ja, nga ana tjetër. KPM-ja kërkonte prej nesh që të “informojmë por mos të nxisim”. Mirëpo kjo kërkesë në dukje në rregull, në kontekstin që ishte kishte kuptimin e reduktimit të informatave

³³⁶Po aty, fq.4

³³⁷Po aty, fq.5

³³⁸RTK, Mbledhja 32, “Bordit të Drejtorëve të RTK-së-Procesverbal”, Prishtinë, 13.04.2004, fq.6

dhe pamjeve, sidomos pamjeve nga ngjarjet. Ka qenë e pamundur të punohet në ato rrethana”,³³⁹ kishte theksuar ai. Më tutje, Salihu kishte theksuar se RTK-ja me skemën programore i është përshtatur ngjarjeve, sepse ato e diktojnë skemën, por siç thekson ai, në mbledhjen me Bordin e Drejtorëve, një nga problemet ka qenë edhe ikja nga përgjegjësia e përfaqësuesve të institucioneve të cilët nuk kanë pranuar të jenë në emisionet e RTK-së, dhe t’i adresohen publikut me mesazhet e tyre për qetësi. “Çdo natë kemi pasur debate edhe pse kemi pasur vështirësi që të sigurojmë emra autoritativ që do t’i drejtoheshin opinionit. Kemi kërkuar që të vijë Kryeministri, por ai nuk ka ardhur, nga rezidenca e Kryetarit të Kosovës nuk kemi pasur përgjigje, Krye parlamentari z. Daci ka qenë i sëmurë. Pra ne kemi pasur mungesë të çfarëdo qëndrimi zyrtar rreth ngjarjeve për 22 orët e para, çka e ka vështirësuar shumë punën tonë”.³⁴⁰

Në anën tjetër, Agim Zatriqi, ka shtuar se analizimi i RTK-së duhet të bëhet në tri rrafshje; profesionale, ligjore dhe politike. Sipas deklaratave të tij të nxjerra nga procesverbali, ai kishte theksuar se RTK është transmetuesi më i ri Publik në Evropë dhe ka nevojë për ngritje të kapaciteteve të tij, ndërkaq sa i përket aspektit ligjor, Zatriqi ka thënë se po e pret raportin e KPM-së, për t’i parë shkeljet që ka bërë. Ndërsa duke folur për rrafshin politik, drejtori i Përgjithshëm ka ngritur dilema se a ishte përdorur RTK-ja si pjesë e konspiracionit për Trazirat e Marsit. Ai i akuzon institucionet ndërkombëtare që kanë bërë presion të madh mbi Transmetuesin Publik. “Çka do të ndodhte me RTK-në, po të vazhdonte dhe të thellonte RTK-ja shkallën e reduktimit të informatave, pamjeve dhe të relativizonte e të zbuste tej mase informatat që kërkoheshin prej neve. Po të bënte RTK-ja atë çka është kërkuar prej neve, ne nuk do të kishim më RTK, do të shndërroheshim në zëdhënësin e pushtetit dhe ky kishte qenë fundi i kredibilitetit të RTK-së dhe fundi i shërbimit të pavarur publik transmetues të Kosovës”.³⁴¹

Sipas transkriptimit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve, pas raportimit të menaxhmentit, fjalën e kishte marrë anëtari i Bordit, Milazim Krasniqi, i cili kishte thënë se gjatë marsit pakënaqësia ndaj UNMIK-ut ishte rritur dhe kishin ndodhur shumë ngjarje, të cilat natyrisht që RTK-ja është dashur t’i mbulojë. “Lidhur me ngjarjet e marsit, ne në Kosovë e dimë se është rritur jashtëzakonisht shumë disponimi kundër UNMIK-ut. Ky disponim është rritur për disa shkaqe që unë vetëm do t’i përmend: 1. Papunësia prej 70%, 2. Bllokimi agresiv, pothuaj arrogant i procesit

³³⁹Po aty, fq.9

³⁴⁰Po aty, fq.10

³⁴¹RTK, Mbledhja 32, “Bordit të Drejtorëve të RTK-së-Procesverbal”, Prishtinë, 13.04.2004, fq.13

të privatizimit, 3. Mos bartja e kompetencave është një kontekst që ka prodhuar këtë potencial, 4. Aferat korruptive në Kosovë. Problemi tjetër është kolapsi energjetik pesëvjeçar”,³⁴² kishte theksuar Krasniqi, për të shtuar se asnjëra nga këto ngjarje nuk mund të mos raportohet. Pas bashkëbisedimit me përfaqësuesit e menaxhmentit të RTK-së, Bordi nuk kishte marr ndonjë vendim konkret.

³⁴²Po aty, fq.13

KAPITULLI VII

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

7.1 Përfundime

Ky studim i disertacionit, përmes studimit teorik dhe hulumtimit shkencor, ka sjell rezultate konkrete në hipotezat apo paragjykimet e ngritura në fillim të këtij rasti studimor. Ky punim shkencor me temën: “Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004”, është bazuar në komponentin teorik të studimeve kritike të Shkollës së Frankfurtit, qasje e cila është përdorur kryesisht gjatë hulumtimit shkencor. Përveç kësaj, baza e analizës kërkimore është mbështetur në teoritë e shtypit, teorinë e zhanrit, ndërkaq, për ta ndërlidhur studimin me periudha të ndryshme është trajtuar edhe historia e gazetarisë shqiptare. Për t’i testuar hipotezat e ngritura të këtij objekti studimor, janë përdorur trembëdhjetë metoda, të cilat janë kombinuar brenda rastit studimor, për të arritur deri tek rezultatet konkrete shkencore.

Analizimi i trazirave në aspektin medial është diçka e re në fushën e studimit të Shkencave të Komunikimit dhe të Gazetarisë në vendin tonë, prandaj këtu janë hedhur hapat e parë që konsiderohen vetëm si nisje e zgjerimit të hulumtimeve shkencore në këtë fushë. Për t’i dhënë përgjigje shkencore në fushën e gazetarisë, Trazirave të Marsit 2004, kjo temë është zgjedhur me shumë kujdes në bashkëpunim me mentorin tim, Prof. asoc. Milazim Krasniqi, kontributi dhe këshillat e të cilit mbetën të jashtëzakonshëm në arritjen e rezultateve konkrete, gjatë punës së tij mentoriale. Edhe pse jemi futur në dekadën e dytë prej kur trazirat e dhunshme ndëretnike e kapluan vendin, ngjarje ndër më të dhunshmet në Kosovën e pasluftës, kjo temë ende mbetet pa një përgjigje si në sistemin e drejtësisë, ashtu edhe në aspektin e hulumtimit shkencor të rolit të medieve, në këtë rast të shtypit, në gjithë këto zhvillime. Deri sa bota është e zhytur në ç’rregullime dhe trazira të dhunshme, padyshim që raportimi i medieve, roli i tyre në krijimin e opinionit, nxitja dhe futja e ngjarjeve në agjendat editoriale, mbetet rast i studimit në botë. Ndërkaq ne do e trajtojmë këtë ngjarje të ndodhur në Kosovë, për të dhënë përgjigje konkrete.

Për shkak të specifikave të veçanta, ky hulumtim shkencor është trajtuar nga tre komponentë, prej të cilëve kanë dalë rezultate konkrete shkencore. E para ka të bëjë me kontekstin e ngjarjes, e dyta me analizimin kritik të raportimit të shtypit dhe rolit të tij në krijimin e opinionit publik, rolit të shtypit në nxitjen e trazirave dhe në të tretën janë analizuar pasojat që i ka prodhuar kjo ngjarje e dhunshme ndëretnike.

I. Duke filluar nga kompilimi i ngjarjes, konteksti politik, ekonomik, ndasitë etnike, protestat, sulmet me granata dhe nga analiza kritike për mënyrën e raportimit të shtypit para fillimit të trazirave, do t'i paraqesim përfundimet e para të këtij studimi. Në bazë të hulumtimit shkencor tek konteksti i ngjarjes mund të nxjerrim konkluzionin e parë të përgjithshëm, sipas të cilit, në ngjarjen e Trazirave të Marsit 2004, kishte të përfshirë akterë të ndryshëm nga profile dhe grupe të ndryshme të interesit, një pjesë e të cilëve ishin të përfshirë në mënyrë të organizuar dhe pjesa tjetër viktimë e agjendave të ndryshme, kishin ndihmuar në krijimin e një situatë të tillë para shpërthyes. Edhe një pjesë e misionit ndërkombëtar të UNMIK-ut, ishin të përfshirë në krijimin e rrethanave të tensionuara në Kosovë. Kjo është gjetje e dalë nga kompilimi i ngjarjes dhe analizimit të kontekstit të rastit studimor, ku përmes metodave të ndryshme shkencore, janë analizuar faktorët e ndryshëm rrethorë, që kanë ndihmuar në rritjen e tensioneve ndëretnike. Pra, UNMIK-u, përmes veprimeve politike kishte nxitur tensione tek shumica shqiptare. E gjendur para një situatë të brishtë, ky mision në vend që të përgatiste fazën e re politike, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, nis tensionimin e situatës me arrestimet e ish-luftëtarëve të UÇK-së. Sipas gjetjeve në studim, Administrata Ndërkombëtare në vend që t'i rrisë masat e sigurisë në terren, e gjen mënyrën e mbylljes për publikun, duke i futur në këtë rast brenda agjendës së saj mediet, të cilat ishin të detyruara të raportnin për ngjarjet që po zhvilloheshin në Kosovë. Ndër të tjera, ky mision i cili i kritikon ashpër mediet për nxitje të trazirave, në raportet rregullta në Këshillin e Sigurimit, nuk kishte ngritur shqetësime asnjëherë se mediet po krijojnë polarizime shoqërore gjatë raportimit të tyre të përditshëm. Sipas gjetjeve, shtypi kishte kritikuar disa herë UNMIK-un, se krijonte favore ndaj pakicave serbe, duke e anashkaluar shumicën shqiptare.

Gjetje tjetër e cila e mbështetë argumentimin është se UNMIK-u, në momentet kritike ka zgjedhur heshtjen dhe mbylljen për komunikim me mediet, ndërkohë që mediet janë detyruar të operojnë me informacione dytësore. Pra, asnjëherë UNMIK-u, nuk i ka dhënë ndonjë sqarim pas trazirave të dhunshme, se cili ka qenë roli i tij në raport me publikun dhe mediet, dhe cilat interesa publike i ka përfaqësuar. Situata e krijuara politike dhe situatat e veprimeve paralele politike është një tjetër gjetje. Përplasja e politikave të UNMIK-ut, me ato të institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse është një tjetër argument. Vlen të theksohen mospajtimet politike mes përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe UNMIK-ut, për çështjen e muraleve në Kuvendin e Kosovës, të cilat përfaqësuesit ndërkombëtarë i vlerësonin si me motive nacionale. Padyshim që kjo situatë e krijuar, ka prodhuar opinion negativ denigrues për institucionet ndërkombëtare. Pra,

tek shumica shqiptare ishte krijuar perceptimi se UNMIK-u, me politikat e tij, po vepron kundër interesave shqiptare. Kjo pakënaqësi dhe ky frustrim publik është shtuar edhe më tepër pas fillimit të arrestimeve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, një pjesë e konsideruar e të cilëve tashmë ishin në sferën politike e publike. Ky studim konstaton se këto veprime kishin prodhuar një situatë të trazuar në terren, ku në emër të këtyre zhvillimeve dhe paqartësive politike, kishin nisur të sulmohen me bomba institucionet politike ndërkombëtare e vendore. Natyrisht që një gjë e tillë i është përshtatur grupeve të ndryshme të interesit, të cilat e kanë parë një moment të duhur situatën e krijuar. Sipas studimit një element tjetër që ka ndikuar në brishtësinë situatës në terren është ndarja e veriut të Kosovës, mbi baza etnike, mos zhvillimi ekonomik dhe papunësia në shifra të larta enorme, pakënaqësitë e sindikatave dhe të punëtorëve me mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, etj. Duke i testuar hipotezat e ngritura në këtë punim, janë paraqitur gjithashtu rezultate konkrete për rolin e shtypit në këtë periudhë, pra para fillimit të përplasjeve ndëretnike.

Në këtë studim shkencor është arritur deri tek përfundimet se shtypi ditë në përgjithësi, të paktën gjatë kësaj periudhe njëjavëshe (10-17 mars), nuk kishte shprehur përmes politikave editoriale ndonjë shenjë të nxitjes së trazirave ndëretnike, gjatë raportimit. Mirëpo natyrisht që shtypi është detyruar të përmbushë misionin e tij, duke raportuar për gjitha këto zhvillime që po ndodheshin në terren, e të cilat në esencë kanë qenë ngjarje relevante, por që në të vërtetë kanë prodhuar opinione dhe mendime të tensionuara. Shtypi në përgjithësi gjatë kësaj periudhe kishte raportuar në mënyrë profesionale dhe i kishte mbrojtur interesat e përgjithshëm, por kjo gjë, kishte rënë në kundërshtim me politikat e UNMIK-ut. Dhe krejt kjo, nga ana e këtij Misioni është parë si agjendë e medieve kundër tij.

II. Më lartë në këtë studim paraqitëm gjetjet e këtij hulumtimi shkencor, të cilat ndërlidhën me kontekstin e ngjarjes. Pra, nga rrethanat dhe brishtësitë të cilat i kanë përndjekur të gjitha zhvillimet në Kosovë gjatë kësaj periudhe, në këtë pjesë të këtij hulumtimi shkencor do të paraqiten përfundimet e analizimit të shtypit. Duke e analizuar shtypin në tërësi, mund të nxjerrim si përfundim të parë të komponentit të dytë të këtij studimi shkencor, se raportimi për ngjarjen tragjike të ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, ishte njëri nga indikatorët në mesin e shumë të tjerëve, që ndihmoi në eskalimin e situatës. Disa nga mediet duke raportuar për këtë ngjarje jashtë standardeve profesionale të raportimit, prodhuan opinion të deformuar dhe gjendje emocionale të masa, e cila tashmë ishte e gatshme të reagoje. Gazeta “Koha Ditore” dhe “Epoka e re”, ishin dy

nga pesë gazetat të cilat këtë ngjarje e kishin futur në agjendën e tyre, apo ishin futur në mënyrë spontane brenda kësaj agjende, e cila rezultoi të jetë ngjarja më të rëndë ndëretnike në Kosovën e pasluftës. Duke analizuar anën profesionale të raportimit, mund të theksojmë se gazetat e cekura më lartë, nuk e kanë respektuar etikën dhe standardet profesionale të raportimit dhe kjo e ka komplikuar edhe më tepër përfshirjen e tyre brenda një agjende të përgjithshme. Tri gazetat e tjera: “Bota Sot”, “Zëri dhe “Kosova Sot”, gjatë raportimit për ngjarjen e fshatit Çabër, i kishin dhënë më pak hapësirë në numrin e tyre të botuar. Në këtë pjesë duhet theksuar se edhe tri televizionet me frekuencë nacionale, këtë ngjarje e kishin futur brenda agjendës së tyre, në veçanti Radio Televizioni i Kosovës, i cili e kishte luajtur rolin e bajraktarit gjatë këtyre zhvillimeve. Natyrisht që kur një ngjarje futet në agjendat e televizioneve dhe shtypit, e maksimalizojnë efektin tek publiku. Një ditë më pas të gjitha mediet raportuan se shkaku kryesor i fillimit të trazirave ishte ngjarja tragjike e ndodhur në fshatin Çabër të Mitrovicës, mirëpo, duke mos dhënë asnjëra ndonjë sqarim se kush e prodhoi opinionin publik për atë ngjarje, nga u informua publiku për atë tragjedi, si dhe cili ishte roli i medieve në këtë ngjarje. Këtu duhet theksuar natyrisht se kjo mbetet vetëm njëri nga faktorët kryesor të kësaj agjende, sepse pjesën tjetër të e agjendës e ka shtyrë tutje misioni i UNMIK-ut. Kjo sepse, përfaqësuesit ndërkombëtarë por edhe vendor i janë shmangur me dashje përgjegjësisë publike. Këta të ngarkuar me përgjegjësi publike, përkundër kërkesave mediale, nuk kanë pranuar që të flasin për zhvillimet, ndërkohë që mediet janë detyruar t’i mbulojnë ato. Mirëpo, as kjo nuk i amniston mediet nga shkeljet etike dhe profesionale që kanë bërë.

Kjo qasje kishte vazhduar të mbetet e njëjtë edhe në ditën kur trazirat tashmë kishin marrë përmasa në gjithë vendin. Mediet janë ballafaquar me mungesën e informacionit zyrtar gjatë periudhës, kur kishin filluar protestat e dhunshme. Mungesa e reagimeve nga ana e institucioneve politike ndërkombëtare, institucioneve vendore dhe atyre të sigurisë, ka ndikuar që dhuna të zgjerohet, sepse pjesëmarrësve në trazira iu ka munguar mesazhi institucional, i cili do të mund t’i frikësonte me pasojat ligjore, apo t’iu bënte të qartë se dhuna do të jetë e patolerueshme. Sipas gjetjeve në këtë hulumtim shkencor, mund të konkludojmë se gjatë orëve dramatike, shtypi ka operuar kryesisht me informacione nga terreni, shpeshherë të pakonfirmuara, të pasakta dhe jo zyrtare. Në këtë rast është krijuar mundësia që pjesëmarrësit në protesta të dhunshme të jenë protagonist të diskursit publik. Kjo ka ndihmuar në prodhimin e deformuar të informacioneve. Një gjë e tillë, është më e vërejtur në tekstet e korrespondentëve nga rajone të ndryshme të Kosovës, të cilët përveç që janë përfshirë në interpretim të ngjarjes, kanë bërë shkelje profesionale duke

imponuar mendimin e tyre për situatën në terren, dhe duke shkaktuar përfshirje emocionale brenda raporteve të tyre. Natyrisht që në situata të tilla, nevoja për informacion shtohet, por, kur këto ngjarje raportohen duke mos i respektuar standardet profesionale të raportimit pasojat më të mëdha i bartë publiku. Gjithashtu, shtypi ditor gjatë periudhës së trazirave, i kishte shtyrë agjendat e tij përmes editorialeve, komenteve dhe opinioneve të botuara, brenda të cilëve janë evidente edhe politikat editoriale.

Në komponentin e dytë të këtij studimi shkencor është analizuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes në kuadër të raportimit të shtypit ditor për trazirat e dhunshme. Nga përfundimet në këtë pikë të studimit, mund të theksohet se shtypi ditor gjatë raportimit për ngjarjet e dhunshme ndëretnike, brenda raportimit të tyre në disa raste, të cilat janë të theksuara më gjerësisht, në pjesën e hulumtimit shkencor, kanë përfshirë brenda tyre elemente të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes ndëretnike, edhe pse një gjë e tillë ka qenë e sanksionuar dhe e penalizuar nëpërmjet mekanizmave ligjor. Gjithashtu, përveç gazetës “Koha Ditore” dhe “Zëri”, gazetat tjera, kanë publikuar një numër të madh të fotografive gazetareske, përmbajtja e të cilave në shumicën e rasteve paraqet shkelje të standardeve etike. Publikimi i një numri të madh të fotografive me përmbajtje emocionale, natyrisht që ka ndikuar tek perceptimi dhe krijimi i opinionit publik, apo ia lë lexuesit mundësinë e vet të interpretimit dhe të perceptimit të situatës përmes imazheve të krijuara. Në fund të këtij konteksti, kemi një përfundim, i cili flet për hapësirën që i ka dhënë shtypi trazirave ndëretnike, që rezulton se vetëm në ditën e parë të trazirave, shtypi ka botuar më shumë se 150 (njëqindpesëdhjetë) tekste, përmes të cilave kanë prodhuar dhe imponuar krijimin opinionit publik.

III. Në pjesën e fundit të këtij disertacioni është bërë analizimi i pasojave që ka prodhuar ngjarja më e rëndë ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve dhe roli i medieve në këtë situatë. Duke i analizuar raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë projektuar enkas për Trazirat e Marsit, shihet se përveç shtypit, televizionet janë akuzuar më tepër për nxitje të trazirave ndëretnike. Duke i analizuar transkriptet e edicioneve të lajmeve të televizioneve me frekuencë nacionale (RTK, KTV dhe RTV21), shihet se raportimi për trazirat e marsit, sidomos në Televizionin Publik, ka ndihmuar në prodhimin e opinionit dhe nxitjes së trazirave ndëretnike.

Krejt si përfundim i këtij disertacioni mund të konkludojmë se mediet në përgjithësi, e në këtë rast shtypi, kanë luajtur një rol të rëndësishëm gjatë periudhës së trazirave të dhunshme ndëretnike në Kosovë. Si i tillë shtypi duhet të marrë përgjegjësinë që iu takon, në mënyrë që në

situata të tilla të ketë një rol më konstruktiv dhe të kontribuoj që ngjarjet e tilla në të ardhmen të kenë sa me pak pasoja për shoqërinë dhe vendin. Shtypi duhet të mbetet i kujdesshëm gjatë raportimit për ngjarje të tilla, sidomos kur problemet që shfaqen përbëjnë elemente të nxitjes ndëretnike. Mediet duhet të jenë të përgatitura që ta mbrojnë interesin e publikut dhe të shtetit.

7.2 Rekomandime

- Mediet duhet të jenë të kujdesshme, profesionale dhe objektive gjatë raportimit në situata të trazirave të dhunshme.
- Mediet duhet të jenë tejet objektive, kur trajtojnë tema dhe raportojnë për problemet ndëretnike.
- Mediet duhet të dinë për përgjegjësinë që kanë, kur raportojnë për tema të ndjeshme.
- Mediet në situata të trazirave duhet të mbrojnë objektivat nacionale.
- Mediet nuk duhet të përfshihen në asnjë agjendë kur raportojnë për tema që mund të kenë pasoja sociale.
- Mediet nuk duhet të përdorin gjuhën e urrejtjes, nxitjes dhe as komentimin e ngjarjeve gjatë raportimit të temave ndëretnike dhe dramatike.
- Mediet duhet që vazhdimisht të jenë vigjilente për temat që ngritin dhe të mos provokojnë tema që mund të shkaktojnë pasoja emocionale dhe trazira tek publiku.
- Mediet duhet ta kenë parasysh kontekstet e ngjarjeve, para se të raportojnë për to.
- Mediet duhet të kenë kujdes në mënyrë që të mos përfshihen në agjendat që janë kundër interesit të publikut.
- Mediet duhet që vazhdimisht t'i trajtojnë reporterët e tyre për raportime nga trazirat dhe situatat e jashtëzakonshme.

LITERATURA

- Barbier, Frederik dhe Chatherina Bertho Lavenir, “Historia e Medias nga Dideroi tek Interneti”, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2004;
- Bell, Judith. “Si veprohet në një projekt kërkimor”, Dudaj, Tiranë, 2008;
- Beqaj, Belul. “Çfarë ishte roli i RTK-së në trazirat e marsit 2004”, Prishtinë: N.Sh. “Studio Forma”, 2007;
- Boriqi, Hamit, dhe Mark Marku, “Historia e shtypit shqiptar 1”, Tiranë: UFO University Press, 2007;
- Boriqi, Hamit. “Gazetaria 2”, Tiranë: Shblu, 2004;
- Curran, James dhe Michael Gurevitch, (red.) “Mass Media and Society”, edicioni i katërt, New York: Oxford University Press, 2005;
- Curran, James. “Sociologjia e shtypit”, Revista kërkimore “MEDIA”, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009;
- Dawson, Catharine. “Practical Research Methods”, Oxford OX4 1RE, United Kingdom, 2002;
- Day, Louis A. “Ethics in Media Communications: Cases and Controversies”, edicioni i 5-te, USA: Wadsworth Publishing, 2005;
- Dominick, Joseph R. “Dinamika e komunikimit masiv-Media në periudhën digjitale”, Tiranë: UET press, 2010;
- Eadie, William F. “21 century Communication A reference handbook”, volume 1&2, Los Angeles: SAGE, 2009;
- Elihu, Katz, Xhon Durham Peters, Tamar Leibes dhe Avril Orloff, “Tekste kanonike të kërkimit në media”, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2009;
- Gagliardone, Iginio, Danit Gal, Thiago Alves dhe Gabriela Martinez. “Countering Online Hate Speech”, Francë: UNESCO Publishing, 2015;
- Gardner, Ellen. “The Role of Media in Conflicts” në Peacebuilding: A Field Guide, Luc Reychler dhe Thania Paffenholz (red.), London: Lynne Rienner Publisher, 2001;
- Giddens, Anthony. “Sociologjia”, Tiranë: Cabej, 2007;
- Hall, Stuart, Dorothy Hobson, Andrew Lowv dhe Paul Willis “Cultura, Media, Language”, Londër: Taylor & Francis, 2005;

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

- Holland, Patrisha. “Fotografia e gazetarisë”, Revista kërkimore “MEDIA 2”, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009;
- Horkheimer, Max dhe Theodor W. Adorno “Dialektika dhe Iluminizmi”, Tiranë: ISP&DRITA, 2000;
- Jakupi, Ali. “Metodologjia e punës shkencore kërkimore”, Ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2005;
- Kellner, Douglas M. dhe Meenakshi Gigi Durham, “Media and Cultural Studies”, USA: Blackwell Publishing Ltd, 2001;
- Kosumi, Bajram. “Tipologji dhe zhanër”, Prishtinë: OLYMP, 2013;
- Kovach, Bill dhe Tom Rosenstiel “Elementët e Gazetarisë”, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2009;
- Krasniqi, Milazim. “Ankthi i vjetër në shekullin e ri”, Prishtinë: Zëri ynë, 2011;
- Krasniqi, Milazim. “Ekskomunikimi si histori e fshehur”, Prishtinë: Rozafa, 2016;
- Krasniqi, Milazim. “Gazetaria nën trysinë e aleatëve të saj – teknologjisë dhe publikut). Revista kërkimore “MEDIA”, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2013/14;
- Krasniqi, Milazim. “Hyrje në gazetari”, Prishtinë: Rozafa, 2008;
- Lippmann, Walter. “Public Opinion”, 1920, <http://www.howardnema.com/wp-content/uploads/2016/08/lippmann.pdf> (7.11.2017)
- Littlejohn, Stephan W. dhe Foss A. Karen, “Encyclopedia of communication theory”, Londër: SAGE, 2009;
- Maigret, Eric. “Sociologjia e komunikimit dhe e mediave”, Tiranë: UET/Press & Papirusi, 2010;
- McLuhan, Marshall. “Instrumentat e Komunikimit-Media si një zgjatim i njeriut”, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2008;
- McNair, Brain. “News and Journalism in the UK”, Londër: Routledge, 2009;
- McQuail, Denis. “Mass communication theory: An introduction” London: Sage, 1983;
- Missouri Group, “Raportimi dhe shkrimi i lajmeve”, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005;
- Monografia “Rilindja 1945-1985” (Tekste për monografi), Prishtinë: Rilindja, 1985;
- Pesmen, Sandra. “Writing for the Media”, Illinois: NTC Contemporary, 1983;
- Popper, Karl R. “Për filozofinë dhe shkencën”, Tiranë: Shtëpia Botuese “Fan Noli”, 2009;

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Putnam, Linda L. dhe Martha Shoemaker, “Changes in Conflict Framing in the News Coverage of an Environmental Conflict”, *Journal of Dispute Resolution*, 2007,

<http://scholarship.law.missouri.edu/jdr/vol2007/iss1/10/> (30.11.2017)

Randall, David. “Gazetaria universale”, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2003;

Russ-Mohl, Stephan. “Gazetaria-tekst didaktik dhe praktik”, Tiranë: K&B, 2010;

Siebert, Fred, Theodore Peterson dhe Wilbur Schramm “Four theories of the press”, Chicago: University of Illinois Press, 1956;

Sokoli, Lekë. “Metodat e kërkimit”, Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2011;

Wilson, Bradley, Donald L. Ferguson dhe Jim Patten, “Journalism Today”, USA: Glencoe, 2005;

Wynford, Hicks, Sally Adams, Harriett Gilbert dhe Tim Holmes “Writing for Journalists”, edicioni i dytë, Londër: Routledge, 2008;

SHTYPI DITOR

Abramowitz, Morton. “Kthimi prapa në Ballkan”, *Koha Ditore*, 20 mars 2004.

Ahmeti, Nexhmije. “Plumbi më ka ardhur nga Policia e UNMIK-ut”, *Epoka e re*, 20 mars 2004.

Ahmeti, S. “Nuk do t’i tolerojmë më bandat vrasëse”, *Kosova Sot*, 18 mars 2004.

Ahmeti, S., M. Feka dhe Q. Thaçi, “Dhjetë ra mijëra protestues fajësojnë UNMIK-un për kriminalizim të UÇK-së”, *Kosova Sot*, 17 mars 2004.

Ajeti, Bardhyl. “‘Ndal’ revoltave të 17 marsit”, *Bota Sot*, 19 mars 2004.

B. S., “Kosova do të jetë e pavarur me ose pa pëlqimin e Serbisë”, *Bota Sot*, 12 mars 2004.

Berani, Halit. “Edhe sa herë duhet të përgjakët qyteti i ndarë i Mitrovicës”, *Bota Sot*, 19 mars 2004, Prishtinë.

Berani, Halit. “Në pjesën e okupuar të qytetit, një grup kriminelësh serbë i sulmuan me gurë civilët shqiptarë”, *Bota Sot*, 20 mars 2004.

Berani, Halit. “Serbët nxjerrin me dhunë shqiptarët nga banesat e tyre”, *Bota Sot*, 19 mars 2004.

Bilalli, Arsim. “Shqiptarët thonë se serbët bëjnë spastrim etnik në veri të Mitrovicës”, *Kosova Sot*, 22 mars 2004.

Bota Sot, “Liderët kombëtarë të Kosovës tregojnë përgjegjshmëri të lartë përballë situatës së imponuar”, 19 mars 2004.

Bota Sot, “Në Kosovë vepron terrorizmi serb”, 18 mars 2004.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Bota Sot, “Vriten 14 shqiptarë, plagosën rreth 500 të tjerë”, 18 mars 2004.

BSM “Bandat serbe fillojnë aktivitetet kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga veriu”, *Bota Sot*, 17 mars 2004.

BSM “Gjenden trupat e pajetë të vetë m dy vogëlushëve që u mbytën në lumë duke ikur nga kriminelët serbë”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

BSM, “Serbët vranë me armë zjarri gjashtë shqiptarë dhe plagosën rëndë shumë të tjerë”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

Buçpapaj, Elida. “A ishte Kushtunica ai që organizoi sulmin me bomba kundër Rugovës?!”, *Bota Sot*, 17 mars 2004.

Buçpapaj, Skënder. “Pse asnjë serb i Kosovës nuk është dërguar deri me sot në Hagë?”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

Buzhala, Berat dhe Arbana Xharra, “Humolli: Do të ketë protesta sa të ketë UNMIK dhe KFOR”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004.

Ekipi i “Zërit”, “Dita më e rëndë e Kosovës prej përfundimit të luftës”, *Zëri*, 18 mars 2004.

Ekipi i korrespodenëve, “Protestuesit shprehën dhimbje për 3 fëmijëtë mbytur dhe kërkuan të shkonin në Mitrovicë”, *Koha Ditore*, 17 mars 2004.

Epoka e re, ““Kasneci i ri”, Sveti Sava, Istoku, riserbizimi i Kosovës”, 12 mars 2004.

Epoka e re, “Edhe kështu u brohorit: “UNMIK mos u ngut – UÇK-ja t’kallë barut”, 17 mars 2004.

Epoka e re, “Koshtunica thërret për vrasje të shqiptarëve, bandat futën në Kosovë”, 20 mars 2004.

Epoka e re, “Lajmi i fundit”, 20 mars 2004.

Epoka e re, “Ngritet në këmbë gati e gjithë Kosova”, 16 mars 2004.

Epoka e re, “Një i vdekur në Çagllavicë, disa të plagosur shumë shtëpi në zjarr”, 18 mars 2004.

Epoka e re, “Politika mashtruese kushtoi 31 jetë”, 19 mars 2004.

Epoka e re, “Serbët bllokojnë në Çagllavicë, sulmojnë shqiptarët në Graçanicë”, 17 mars 2004.

Epoka e re, “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004.

Epoka e re, “Serbët mbysin në lumin Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004.

Epoka e re, “të vranë 14, të plagosur rreth 500”, 18 mars 2004.

Epoka e re, “Të vranë 14, të plagosur rreth 500”, 18 mars 2004.

Epoka e re, “UNMIK-u e tradhtoi Rexhepin, rruga nuk u zhbllokua”, 20 mars 2004.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Etemaj, Burim. “Njerëz vriten në Mitrovicë, LDK-ja proteston për një bombë: ‘terror politik’, thotë!”, *Epoka e re*, 18 mars 2004.

Etemaj, Burim. “Protestuesit kërkojnë nga UNMIK-u që ta rishikoj politikën e vet ndaj Kosovës”, *Epoka e re*, 17 mars 2004.

Filipaj, Gjergj. “Gazetarët tregojnë rrëfimet për sulmet ndaj tyre”, *Koha Ditore*, 13 mars 2004.

Gashi, Zijadin. “Kuvendi kërkon goditjen e strukturave paralele për qetësimin e situatës në Kosovë”, *Zëri*, 18 mars 2004.

Hajdari, L. “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lum nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

Hajdari, L. “Nuk mund të tolerohen krimet, ndjekja e fëmijëve dhe hedhja e tyre në lumë nga bandat serbe që veprojnë në veriun e Kosovës”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

Hajdari, L. dhe F.Musa “Ky vend, i cili ka kaluar nëpër përgjakje nuk ka zgjidhje tjetër përveç pavarësimit të vet”, *Bota Sot*, 19 mars 2004.

Halitaj, Agron. “UNMIK-u dhe mediat në ngjarjet e marsit”, *Koha Ditore*, 27 mars 2004.

Hamilton, Douglas. “Zvarritja e Perëndimit – shkak i trazirave në Kosovë”, *Epoka e re*, 22 mars 2004.

Hoti, F. dhe E. Musa, “Protestuesit i bënë thirrje UNMIK-ut që ta rishqyrtojë politikën ndaj UÇK-së”, *Zëri*, 17 mars 2004.

Idrizi, Skënder. “Grekët e KFOR-it e shkelen me tanks!”, *Epoka e re*, 19 mars 2004.

Islami, Bedri. “Gjynahet fatele të UNMIK-ut”, *Epoka e re*, 19 mars 2004.

Isufi, Përparim. “Luftë e vërtetë në Mitrovicë – së paku 6 të vrarë dhe qindra të plagosur”, *Zëri*, 18 mars 2004.

Koha Ditore, “16 të vdekur dhe 575 të lënduar në trazirat që përfshinë të gjitha anët e Kosovës”, 18 mars 2004.

Koha Ditore, “AGPK: Ndërhyrja e KPM-së në politikë redaktuese të mediave është e papranueshme”, 18 mars 2004.

Koha Ditore, “Apelet politike me efekte të kufizuara – dhuna vazhdon”, 19 mars 2004.

Koha Ditore, “Protestuesit shprehën dhimbje për tre fëmijë të mbytur dhe kërkuan të shkonin në Mitrovicë”, 18 mars 2004.

Koha Ditore, “Shpërthim para selisë së UNMIK-ut në Mitrovicë”, 14 mars 2004.

Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004.

Koha Ditore, “Tre fëmijë shqiptarë mbytën në Ibër, duke ikur nga serbët”, 17 mars 2004.

Korrespondenët e “Epokës së re”, “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë të plagosur nga armë zjarri”, *Epoka e re*, 18 mars 2004.

Korrespondentët e “Epokës së re”, “Ditë e rëndë në Pejë: Një i vrarë dhe shtatë të plagosur nga armë zjarri”, *Epoka e re*, 18 mars 2004.

Kosova Sot, “NATO dërgon 1100 ushtarë shtesë në Kosovë”, 19 mars 2004.

Kosova Sot, “Politikanët bëjnë thirrje për ruajtjen e gjakëftohësisë”, 18 mars 2004.

Kosova Sot, “Serët plagosin tre shqiptarë”, 19 mars 2004.

Kosova Sot, “Shpërthen dhuna”, 18 mars 2004.

Krasniqi, I. “Qeveria i drejtohet popullit: Përmbahuni!”, *Kosova Sot*, 18 mars 2004.

Mala Imami, Naile. “Këshilli serb i Sigurisë i sugjeron qeverisë dërgimin e ushtrisë në kufi me Kosovën”, *Koha Ditore*, 18 mars 2004.

Mala Imami, Naile. “Në Beograd dhe Nish digjen xhamitë”, *Koha Ditore*, 19 mars 2004.

Morina, Bajrush. “Fotografia origjinale dhe falsifikatorët e historisë”, *Bota Sot*, 10 mars 2004.

Muça, Bashkim. “Lumi i gjakut dhe integrimi i detyruar”, *Koha Ditore*, 19 mars 2004.

Mujaj, Hasan. “Akt terrorist në shtetin e Kosovës”, *Bota Sot*, 17 mars 2004.

Musliu, Jeton. “Pas Prishtinës, dialogu shkon në Beograd”, *Epoka e re*, 10 mars 2004.

Neudeck, Rupert. “Ajo që keni bërë është më shumë se një krim – është një gabim”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004.

Osmani, Sh. “Deri me tash janë mbi dhjetëra shqiptarë të vrarë dhe qindra të plagosur”, *Bota Sot*, 18 mars 2004.

Palokaj, Augustin. “Është mëkat që kosovarë t vetëm 5 vjet pasi u ndihmuan nga ushtarët ndërkombëtarë t’i sulmojnë ata”, *Koha Ditore*, 24 mars 2004.

Palokaj, Augustin. “NATO thotë se nxitësit dhe organizatorët e dhunës do të dënohen”, *Koha Ditore*, 25 mars 2004.

Palokaj, Augustin. “Solana thotë se organizatorët e dhunës në Kosovë kanë lidhje me partitë politike”, *Koha Ditore*, 26 mars 2004.

Partosh, Gabriel. “Pse pikërisht tani”, *Epoka e re*, 20 mars 2004.

Ramabaja, Sadri. “Status-quos i erdhi fundi sërish por me viktima!”, *Epoka e re*, 19 mars 2004.

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Rugova, Arben. “Dialogu, privatizimi, standardet në rrugë të duhur“, *Koha Ditore*, 11 mars 2004.

Rugova, Arben. “Takimi i parë për të zhdukurit nuk zbardhi gjë”, *Koha Ditore*, 10 mars 2004.

Rraci, Alma. “S’ka më tolerim për protestat e dhunshme”, *Kosova Sot*, 19 mars 2004.

Sadikaj, Rifat “Kështu po krijohet enklava e re në Burim”, *Epoka e re*, 15 mars 2004.

Surroi, Veton. “Tash e tërë Kosova është peng”, *Koha ditore*, 19 mars 2004.

Surroi, Veton. “Vdekja tragjike e një politike dhe e njerëzve nga ajo”, *Koha Ditore*, 18 mars 2004.

Syla, Gazmend. “Liderët porosisin: ‘Kthehuni në shtëpi’”, *Koha Ditore*, 18 mars 2004.

Toska, Besim dhe Asdren Gashi, “Vritet një shqiptar, plagosën dhjetëra të tjerë”, *Bota Sot*, 19 mars 2004.

Vinca, Agim. “Vdekja e llahtarshme dhe protesta groteske për xhamin e rezistencës”, *Epoka e re*, 20 mars 2004.

Xhaferi, Arbër. “Ja disa nga faktorët që irituan popullin e Kosovës”, *Epoka e re*, 20 mars 2004.

Xhemajli, Blerim dhe Zija Miftari, “Serbët bllokojnë rrugët nga Prishtina për në Shkup dhe Gjilan, sulmojnë kalimtarët”, *Koha Ditore*, 17 mars 2004.

Xhemajli, Blerim. “Solana: Dhuna e fundit e ka kthyer Kosovën me vite prapa”, *Koha Ditore*, 25 mars 2004.

Zëri, “Zhduken në ujërat e lumit Ibër tre fëmijë shqiptarë”, 17 mars 2004.

RAPORTE DHE BURIME TË TJERA

Isufi, Përparim. “Dy të Arrestuar për Vrasjen Dy Zyrtarëve të UNMIK-ut më 2004”, Kallxo.com, Prishtinë, 5 korrik 2017, <http://kallxo.com/dy-te-arrestuar-per-vrasjen-dy-zyrtareve-te-unmik-ut-me-2004/>, (21.08.2017)

KlanKosova, “Zona e Debatit - Shkumbin Mehmeti: Rrëfimi ekskluziv për vrasjet e pasluftës - 11.01.2018”, video në YouTube, 1:16:26. 13 janar 2018, <https://www.youtube.com/watch?v=s7H1CpfP6vc>

KMSHK, “Udhëzues për Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës”, Prishtinë, 2015, <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-mars2015.pdf> (16.04.2016)

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-82, 2012,

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf> (15.04.2018)

Komisioneri i Përkohshëm për media, Raporti i Komisionerit të Përkohshëm për media, Prishtinë, 23 prill 2004;

Kumanovo Military Technical Agreement (NATO) June 1999,

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/Kumanovo%20Military%20Technical%20Agreement%20%28NATO%29%20June%201999.pdf (24 gusht 2017)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> (15.94.2018)

Leposhtica, Labinot. “Dosja e EULEX për Trazirat e Marsit 2004, Urdhra nga Struktura të Larta të UÇK-së”, Kallxo.com, Prishtinë, 6 korrik 2017, <https://kallxo.com/dosja-e-eulex-per-trazirat-e-marsit-2004-urdhra-nga-struktura-te-larta-te-uck-se/> (21.08.2017)

OKB, Këshilli i Sigurimit, “Annex Rambouillet Accords- Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo”, 18 mars 1999,

http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf (24.08.2017)

OKB, Këshilli i Sigurimit, “Report of the secretary-General on the United Nation Interim Administration Mission in Kosovo”, 22 prill 2002,

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/S-2002-436.pdf (25.08.2017)

OSBE, “Roli i Mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë”, Raport, Vjenë, 2004;

Osmani, Taulant. “Kosovarët Nuk Pajtohen me Prokurorin e EULEX-it për Trazirat e Marsit 2004”, Kallxo.com, Prishtinë, 9 korrik 2017, <http://kallxo.com/kosovaret-nuk-pajtohen-prokurorin-e-eulex-per-trazirat-e-marsit-2004> (21.08.2017)

RTK, Mbledhja 32 e Bordit të Drejtorëve të RTK-së-Procesverbali, Prishtinë, 13 prill 2004;

Shehu, Bekim. “Kuvendi i Kosovës votoi PRO themelimit të Gjykatës Speciale”, DW, 03 gusht 2015, <http://www.dw.com/sq/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-votoi-pro-themelimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-speciale/a-18624966> (3 mars 2018)

UNMIK, Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara, Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në

mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999, <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara> (24.08.2017)

UNMIK, RREGULLORE NR. 2001/13 “MBI THEMELIMIN E RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS”, UNMIK/REG/2001/13, 15 qershor 2001,
http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_13.htm,
(18.08.2017)

UNMIK, RREGULLORE NR.2000/37 “MBI SJELLJEN E MEDIAVE TË SHKRUARA NË KOSOVË”, UNMIK/REG/2000/37, 17 qershor 2000,
http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_37.htm,
(18.08.2017)

UNMIK, RREGULLORE NR.2000/4 “MBI NDALIMIN E NXITJES SË URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOSDURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR DHE ETNIK”, UNMIK/RREG/2000/4, 1 shkurt 2000,
http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_04.htm
(9.9.2017)

UNMIK, RREGULLORE NR.2000/4 “MBI NDALIMIN E NXITJES SË URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOSDURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR DHE ETNIK”, UNMIK/REG/2000/4, 1 shkurt 2000,
http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_04.htm
(17.04.2016)

UNMIK, Security Council “Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo”, 30 april 2004,
https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/S-2004-348.pdf, (19.08.2017)

Jetëshkrimi i autorit me listën e punimeve të botuara

MA Muhamet Jahiri

Muhamet Ramadan Jahiri ka lindur më 02 prill 1982 në Prishtinë. Ka mbaruar gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, ndërsa në vitin 2006 i ka përfunduar studimet në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në Universitetin e Prishtinës, duke fituar titullin Baçelor. Dy vite më vonë i ka mbaruar studimet themelore në Departamentin e Gazetarisë, të Fakultetit të Filologjisë, me ç’rast në vitin 2008 ka fituar titullin Baçelor i Gazetarisë. Në vitin 2011, ka mbaruar studimet Master në Departamentin Gazetari dhe Kontakte me Publikun, në Fakultetin e Filologjisë, ku ka fituar graden: Master i Shkencave të Filologjisë, fusha e Shkencave të Komunikimit. Në vitin 2013, Jahiri i ka regjistruar studimet e doktoraturës në fushën e Shkencave të Komunikimit dhe të Gazetarisë, në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Nga viti 2009 deri në vitin 2013, Jahiri ka qenë i angazhuar në cilësinë e asistentit në Departamentin e Gazetarisë të Fakultetit të Filologjisë, ndërkaq në vitin 2013 është zgjedhur asistent i rregullt në këtë Departament, ku vazhdon edhe më tutje të jetë pjesë e këtij departamenti. Nga viti 2017, Jahiri, me propozim të Departamentit dhe me vendim të Këshillit të Fakultetit është emëruar sekretar i departamentit të Gazetarisë, pozitë të cilën e mban edhe tani. Ka marrë pjesë në disa komisione të pranimit të studentëve të rinj, ndërkaq nga viti 2010 është anëtar i redaksisë së revistës kërkimore “Media”, e cila botohet nga departamenti i Gazetarisë. Jahiri aktualisht është asistent në lëndët: “Hyrje në gazetari I”, “Raportim”, “Histori e gazetarisë evropiane”, “Histori e gazetarisë shqiptare” dhe “Edukim medial”, si dhe është pjesëmarrës në shumë organizime të Departamentit të Gazetarisë.

Gjatë kësaj periudhe Jahiri, ka botuar një numër të punimeve shkencore si dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme shkencore e profesionale si:

- “Etika e medieve dhe ndërhyrja në privatësinë e politikanëve”, ligjëratë dhe prezantim të hulumtimit shkencor, në Konferencën Ndërkombëtare “Prishtina Media Days”, e organizuar nga Departamenti i Gazetarisë, në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës dhe SEEMO-n, 2017
- “Etika e medieve online në Kosovë”, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2016

- “Identiteti kosovar i konstruktuar në mediet e shkruara” (1-29 shkurt 2008), ICCMS “Media Industry; Trends, Dynamics and Challenges”, 2015
- “Teoritë e opinionit publik dhe reflektimi i tyre”, Revista kërkimore Media 5, 2014
- Recension për librin “Gazetaria”, Sefan RusMol: “Një libër që duhet ta posedojë secili”, Revista kërkimore Media 4, 2012
- “Ndikimi i reklamuesve në politikat editoriale gjatë fushatave zgjedhore”, Revista kërkimore Media 2, 2010
- “Gjendja e gazetarisë në Kosovë”, me Susan Moeller Profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare & Media dhe Drejtor, Qendra Ndërkombëtare për Media dhe Agjendës Publike, SHBA, ligjëratë, 2012
- Ligjërues në projektin e UGK-së në bashkëpunim me Ambasadën e Francës “Fokusi i ri për Kosovën, simpozium, 2012
- “Ligji i punës dhe mediet”, konferencë, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2011
- “Gazetaria Nationale”, konferencë, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2010
- “Dy vjet shtet-Mediet”, debat, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2010
- “Perspektivat e Transmetuesit Publik”, Konferencë-panelist, 2009
- Projekti për fotografi: “Republika e Kosovës në syrin e të rinjve”, workshop, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2012
- “Raportimi nga sektori i ekonomisë”, workshop, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2011
- “Raportimi nga sektori i politikës”, workshop, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), 2011
- “Trafficking of Human Beings Awareness Session” trajnim i OSBE-së – Departament for Security and Public Safety, 2007
- “Awareness on Victimization Session”, trajnim i OSBE-së – Departament for Security and Public Safety, 2007
- “Drug Awareness Session”, trajnim i OSBE-së – Departament for Security and Public Safety, 2007

Krahas fushës akademike Jahiri, ka ushtruar edhe profesionin e tij. Nga viti 2007 deri në vitin 2012, ka punuar në të përditshmen “Epoka e re”, duke mbuluar sektorin e politikës, ndërkaq ka

Tema: Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për Trazirat e Marsit 2004

qenë bashkëpunëtor në disa revista. Në vitin 2009, së bashku me një grup të gazetarëve ka themeluar Unionin e Gazetarëve të Kosovë, ku është zgjedhur kryetar i saj. Ka qenë njëri nga themeluesit e shtojcës “Gazetaria”, e botuar nga studentët e Departamentit të Gazetarisë gjatë periudhës 2005-2007, ndërkaq më vonë anëtar i revistës “UP News”, e botuar nga studentet e departamentit të Gazetarisë.

Jahiri jeton në Prishtinë, është i martuar me Qëndresë Mustafën dhe ka një fëmijë.